

MARIN BARLETI

BIBLIOTEKA

E

949.65


13.27

TE

GJIROKASTER



RRETHIMI
I
SHKODRËS



948.65

B27

MARIN BARLETI



RRETHIMI I SHKODRËS

E përktheu nga origjinali
Henrik Lacaj



3275

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

BOTIM I TRETE

ALHAMBRA
DE SUGAR

H Y R J E

Me veprën «Rrethimi i Shkodrës» lexuesi shqiptar ka mundësinë të njihet me autorin e parë të letërsisë sonë, me veprën e parë të historiografisë shqiptare dhe me një nga burimet më të rëndësishme vendëse për njohjen e atij shekulli të lavdishëm të historisë sonë, që është shekulli XV, epoka e Skënderbeut.

Lexuesi shqiptar i shekullit XX do të njohë kështu një dëshmi dokumentare të asaj lufte vigane që zhvilluan banorët e qytetit e të rrethit të Shkodrës për mbrojtjen e këtij qyteti shqiptar, luftë që nuk ishte thjesht një episod me rëndësi lokale, por një hallkë e asaj lufte prej një shekulli që pobiajti populli shqiptar për lirinë e pavarësinë e tij dhe një-kohësish për mbrojtjen e Evropës nga pushtimi osman. Në-përmes «Rrethimit të Shkodrës» lexuesi i sotëm do të njohë nga goja e një bashkëkohësi dhe bashkëluftëtar frymën e zjarrtë të lirisë, patriotizmin e madh popullor që valonte në zemrat e luftëtarëve shqiptarë në këtë luftë të madhe për liri, do të njohë edhe kontributin e shquar që dha një autor shqiptar në atë lëvizje të rëndësishme kulturore-shkençore evropiane, që njihet me emrin e humanizmit të shek. XV-XVI.

Nuk është e rastit që në krye të letërsisë sonë qëndrojnë dy vepra që mund të quhen dy monumente të kësaj periudhe të lavdishme: «Rrethimi i Shkodrës» dhe «Historia e jetës dhe e veprave të Gjergj Kastriotit Skënderbeut», të dyja të dala nga pena e autorit tonë Marin Barleti. Në kushtimet që u paravë dy veprave të tij si parafjalë, Barleti vë në dukje motivet që e shtynë — me gjithë ngurrimet e shpjegueshme nga vështirësitë e ndërmarrjes — t'i përvishej një pune kaq të madhe e të rëndësishme. Kjo ndodhë vetëm sepse ai e

ndiente veten moralisht të detyruar ndaj atdheut të tij shqiptar, dikur aq të lumtur e famëmadh, që kishte rënë tanë në mjerimin më të dhimbshëm. «Kisha përshtypjen, — thotë Barleti 'në hyrjen e veprës që kemi përpara, — sikur ajo dhimbje kërkonte diçka.. prej meje që kisha qenë një gjymtirë, një pjesë me rëndësi e atij dhei,... për ta përjetësuar me një përmendore letrare» dhe, sikur të isha një njeri i kohës sonë që flet për «porosi shoqërore», Barleti thekson detyrën ndaj «atdheut, që të mos i mohoja diçka të drejtë e të ndershme... që ai kërkonte prej meje», të mos e «bëja veshin të shurdhë... përpara atij vendi aq të dashur prej meje».

Kësaj ndjenje përgjegjësie, këtij detyrimi ndaj atdheut dhe detyrave të kohës, letërsia përparimtare shqiptare u ka mbetur besnikë që nga Marin Barleti e deri në ditët tona.

* * *

Po kush ishte Marin Barleti? — do të pyesë me të drejtë lexuesi. Për fat të keq, kësaj pyetjeje ne nuk mund t'i japim një përgjigje të mjaftueshme¹⁾. Ato që dimë për datat e jetës së tij, janë vetëm këto: Ai ishte një prift prej Shkodre, autor i tri veprave latinisht: «Rrethimi i Shkodrës», botuar në Venedik më 1504; «Histori e jetës dhe e veprave të Skënderbeut», botuar në Romë midis viteve 1508-1510, dhe i një «Përbledhje e jetëve të papëve dhe perandorëve», botuar në botim të dytë nga duar të tjera në Romë më 1555 (botimin e parë nuk e njohim). Nuk dimë pra as datën e lindjes, as atë të vdekjes. Ndonjë të dhënë për jetën e tij mund ta nxjerrim aty-këtu nga përbajtja e veprave të tij.

Duke u nisur nga emri latinizues Barletius, disa autorë të huaj kanë shfaqur mendimin se shkrimitari ynë ka qenë prej kombësie italiane, nga qyteti Barleta. Të tjerë kanë dashur ta bëjnë dalmat sllav. Thënë të tillë janë në kundërshtim të hapur me vetë autorin, i cili, më se një herë, e quan Shqipërinë atdheun e tij dhe veten pjesëtar të popullit shqiptar. Për sa i përket formës latinizuese të emrit, dihet zakoni i humanistëve, që u jepnin emrave të tyre trajta latine ose

1) Shih studimin themelor të F. Pall, Marino Barlesio, uno storico umanista, Bukuresht, 1938.

greke, nganjëherë edhe i përkthenin. Nuk është jashtë mundësisë të mendojmë se autorin tonë në të vërtetë mund ta kenë quajtur Bardheci ose aty afër.

Sic na thotë vetë në veprën që kemi përpara, Marini ishte prift katolik nga Shkodra, vendlindja e tij. Më 1474, në Rrethimin e Parë të Shkodrës nga turqit, ai ndodhej në qytet si dëshmitar i ngjarjeve, ndërsa në Rrethimin e Dytë më 1478 mori pjesë në luftimet. Pra, në këtë kohë duhej të ishte në një moshë të rritur. Të gjitha këto na shtyjnë të mendojmë se Marini mund të ketë lindur në fillim të dhjetëvjetorit 1450-60. Rinia e tij bie pra në kohën e luftërave të Skënderbeut, të cilat i njoju, sic na thotë, nëpërmes tregimeve të shokëve të luftës së heroit. Në këtë kohë ai duhet të ketë njojur edhe vetë disa qytete e krahina të Shqipërisë, për të cilat na jep të dhëna mjaft të sakta në veprat e tij. Pas mbrojtjes heroike, me dorëzimin e qytetit të Shkodrës në pranverë të vitit 1479, Marini bashkë me qytetarë të tjerë kaloi në Itali dhe gjeti strehim në Venedik, ku Republika u caktoi të gjithë të ikurve një pension. Këtu e ka rrënjen ajo ndjenjë «mirënjohnjeje» dhe ai qëndrim filovenedikas i Barletit, që vihet ré në një varg rastesh në veprën që kemi përpara. Në Venedik dhe në Romë, ku ai gjithashtu duhet të ketë qëndruar, sepse ka botuar atje një libër, Barleti plotësoi kulturën që kishte marrë në Shqipëri dhe u njoht më afër me rrymat kulturore e shkencore të kohës.

Ndonëse në mërgim, larg Shqipërisë, Marin Barleti, sic na thotë vetë, nuk e harroi atdheun fatkeq. Të shumtë ishin shqiptarët që me trup rronin në Itali, por me mendje në atdheun e largët dhe në të kaluarën lavdiplotë. Ata nuk kishin hequr dorë nga shpresëa për ta parë Shqipërinë të lirë, për t'u kthyer përsëri në atdheun e vet. Shumë nga ata morën pjesë në ekspeditën luftarake të Gjon Kastriotit, të birit të Skënderbeut, në Shqipëri në vitin 1481; pak vjet përpara se të botohej «Rrethimi i Shkodrës», më 1501, ishte kthyer në atdhe, së bashku me një grup shqiptarësh, i nipi i heroit, i mbiquajtur Skënderbeu i Ri, për t'u vënë në krye të lëvizjes që kishte shpërthyer në Shqipëri. Dhe më në fund, në vitet 1499 deri më 1503, Hungaria dhe Venediku ishin në luftë me Turqinë. Kishte pra kushte objektive që e ushqenin shpresën e të mërguarve. Mund të thuhet pra se ajo që e shtynte Marin Barletin të shkruante librin e tij, nuk ishte vetëm nos-talgjia për një të kaluar të bukur të largët, por nevoja aktuale e çastit për t'u dhënë zemër shqiptarëve për një ndërmarrje të re luftarake. Kjo viente edhe për veprën e dytë,

«Historinë e Skënderbeut», të shkruar e botuar disa vjet më vonë.

Midis njerëzve, me të cilët kishte të bënte Marin Barleti në Venedik e përgjithësisht në Itali, ishin edhe mjaft bashkë-luftëtarë të Skënderbeut. Midis tyre shquhej Pjetër Engjelli, një pjesëtar i familjes së madhe feudale të Engjëllorëve të Drisshit, i cili kishte pasur një pozitë me rëndësi në ushtrinë e Skënderbeut dhe ishte i vëllai i Pal Engjellit, kryepeshkop i Durrësit dhe burrë shteti në shërbim të Skënderbeut. Bashkëjetimi me Pjetër Engjellin, tregimet e këtij dhe të tjerëve për luftërat e udhëhequra nga Skënderbeu, nxitjet e tyre të vazhduara, luajtën një rol me rëndësi që të shihnin dritën dy veprat e tij, thotë Barleti në parafjalën e «Përmbledhjes, së jetëve të papëve e perandorëve» që i është kushtuar pükërisht Pjetër Engjelli.

Kur vdiq Marin Barleti? Në «Historinë e Skënderbeut» përmendet një ngjarje e janarit 1508. Fakti se «Përmbledhja» përfshin akoma jetën e papës Juli II, por pa arritur deri në fundin e saj, (Juli II vdiq më 1513) dhe se vepra i kushtohet Pjetër Engjellit të gjallë, d.m.th. para se të vdiste, më 1512, të gjitha këto na bëjnë të pranojmë se Marin Barleti duhet të ketë vdekur ose më 1512, ose pak pas këtij viti. Data e saktë sot për sot nuk ka mundësi të përcaktohet.

* * *

Sic u tha më sipër, tri janë veprat e botuara të Marin Barletit që njohim. Dy nga këto trajtojnë tema krejtësisht shqiptare, «Rrethimi i Shkodrës», që kemi sot përpara, si dhe «Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut». Nga «Përmbledhja e jetëve të papëve dhe perandorëve» që u përmend më sipër, i përket Shqipërisë vetëm parafjala. Prej kësaj vepre të tretë, u tha, nga dora e Barletit është vetëm pjesa që shkon deri më 1512, vazhdimi i përket një dore të huaj.

Vepra e dytë, nga koha e botimit — Histori e Skënderbeut — është vepra kryesore e Marinit, vepër që e bëri autorin e saj një nga autorët më të njothur në Evropë, e jo vetëm për kohën e tij. Me gjithë të metat që janë vënë në dukje shpeshherë, sic janë p.sh. karakteri panegjirik, ekzagjerimet, pasaktësitetë në lidhje me kronologjinë dhe të dhëna të tjera,

«Historia e Skënderbeut» e Barletit është dhe mbetet një burim i pazëvendësueshëm për historinë e luftërave të popullit shqiptar dhe përgjithësisht të Evropës juglindore në shek. XV. Prej saj janë ushqyer dhe rrojnë veprat e panumërtë që janë botuar gjatë shekujve për heroin tonë deri në ditët tona.

Nuk është më i paktë interes i që paraqet vepra tjetër e Barletit, e para nga koha e botimit, «Rrethimi i Shkodrës». Siç e thotë titulli, ajo trajton atë periudhë kulmonjëse të historisë së këtij qyteti të lashtë shqiptar, kur pushtuesit osmanë, për herë të dytë, u përpoqën ta shtinin në dorë me anë të një rrethimi të gjatë e mizor të viteve 1478-79.

Si një dëshmi e drejtëpërdrejtë bashkëkohëse e njërsës nga ngjarjet historike më dramatike të këtij shekulli, «Rrethimi i Shkodrës» pati një sukses të madh në botën e lexuesve, ndonëse më të vogël nga «Historia e Skënderbeut». Pas botimit të parë, më 1504, «Rrethimi i Shkodrës» u rishtyp disa herë latinisht (më 1566 në Bazel të Zvicrës, më 1578 dhe 1596 në Frankfurt-mbi-Majn të Gjermanisë) dhe u përkthye e u botua në disa gjuhë evropiane (më 1565 italisht, ribotuar disa herë me radhë në Venedik, më 1569 polonisht në Brest-Litovsk, më 1576 frëngjisht në Paris etj. etj.). Si burim me rëndësi, vepra e Barletit u vlerësua dhe u shfrytëzua nga historianët e njohur të Perandorisë Osmane I. Hammer — Purgstall, W. Zinkeisen, N. Jorga etj.

* * *

Ngjarja historike, së cilës i është kushtuar libri i M. Barletit, nuk ishte vetëm një ngjarje me rëndësi lokale. Me të drejtë autor i veprës që kemi përpara e konsideron luftën që bëjnë shkodranët për mbrojtjen e qytetit të tyre si një pjesë të pashkëputur të gjithë asaj lufte që po bënte populli shqiptar prej dhjetëra e dhjetëra vjetësh kundër pushtimit osman; mund të shkonim edhe më larg dhe pa druajtje mund të thoshim se lufta për Shkodrën ishte pjesë e asaj lufte me të cilën populli shqiptar kontribuoi për të mbërthyer në vend forca të rëndësishme të armikut dhe për t'i prerë rrugën vërvshimit shkatërrimtar të osmaneve drejt Perëndimit, drejt Italisë.

Vetë ngjarjet flasin në këtë drejtim mjaft qartë. Edhe pas vdekjes së Skënderbeut në janar 1468, qëndresa e shqiptarëve vazhdonte e papërkulur, por tashmë e ngushtuar dhe

e përqendruar në zonën malore të Shqipërisë së Veriut, periferia fushore e së cilës mbrohej nga vargu i fortësave Krujë-
-Lezhë-Danjë-Drisht-Zhabjak. Strumbullari dhe boshti kryesor i këtij sistemi mbrojtës ishte qyteti i fortifikuar i Shkodrës me kalanë e tij të lashtë e të fuqishme. Pas dy disfatave që kishte pësuar Mehmeti II para Krujës më 1466 dhe 1467, osmanët në Shqipëri kishin drejtuar vetëm inkursione të zakonshme të akinxhinje krahinorë, sepse ishte Lindja ajo që kishte pushtuar për disa kohë vëmendjen e Mehmetit II, «ngadhënjimtarit», siç i pëlgente atij të titullohej. Lufta që vazhdonin venedikasit qysh prej vitit 1463 në detin Egje krijuante ndërlikime të rrezikshme për sultatin në Lindje; në fakt diplomacia venedikase kishte krijuar marrëdhëniet me princat myslimanë të Karamanisë, në jug të Azisë së Vogël, dhe, në lidhje me këta, flota venedikase po ndërmerrte inkursione shkatërruese në bregdetin e Egjeut. Rreziku ishte edhe më i madh, sepse në këtë lidhje u përfshi më në fund edhe sundimtari i fuqishëm i Turkmenisë, Uzunhasani, i cili filloi nga ana e vet inkursione në lindje të Azisë së Vogël kundër tokave të Mehmetit.

Në këto kushte, Mehmeti II e kishte quajtur të nevojshtëm të sqaronë së pari situatën në Lindje. Kësaj detyre iu kushtuan fushatet e viteve 1471-1473 që i sollën sultanit fitimin e ishullit të Eubesë në Egje dhe shpartallimin e kundërshtarëve të tij në jug e në lindje të Anatolisë. Tani ai, më në fund, i pati duart të lira për një aksion të madh në përendim, për t'i shpënë përpëra kufijtë e perandorisë. Po përkëtë ai duhej të shtinte së pari në dorë plotësisht Shqipërinë, duhej të siguronte krahët nga shqiptarët. Nuk është e rastit, pra, që Mehmeti II vendosi të godiste së pari drejt Shkodrës, duke vazduar bllokimin e Krujës. Historiani bashkëkohës venedikas Corialano Cepione, pjesëmarrës në ngjarjet që u zhvilluan gjatë kësaj kohe në Shqipëri, shkruan në lidhje me këto: «Turku (sulltani-AB) vendosi të pushtonë Shkodrën, kryefortesën e gjithë vendit, sepse shpresonte që, po ta kishte marrë, mund të shtinte në dorë gjithë vendin. Dhe shpresonte se, po të kishte shtënë nën zotërimin e vet Shqipërinë, mund të kalonte me armatën gjirin e Adriatikut dhe me një ushtri të fortë të pushtonë Italinë.»¹⁾

Por këtë qëllim Mehmeti nuk mundi ta realizonte veçse me vështirësi e në disa etapa. Së pari u dërgua Sulejman pasha bejlerbeu i Rumelisë, i cili në maj 1474 u shtrua para Shkodrës me

1) C. Cepione Delle cose fatte da M.P. Mocenico, Venezia 1570, p. 43.

forca të mëdha ushtarake — historianë si Hammer e Zinkeisen flasin për 80 000 ushtarë me 500 deri 1000 gamile të ngarkuara me metal për të derdhur në vend topa. Rrethuesit ndërtuan një urë mbi Bunë për të penguar hyrjen e flotës venedikase nga deti në ligjen. Ky ishte rrethimi i parë i Shkodrës nga ana e osmanëve.

Si gjithmonë, në të tilla raste, popullsia e fushës ishte tërhequr në vendet e mbrojtura — në ishullin e Lezhës, në malet, në qytetet e ishujt e bregdetit dalmat. Në qytet kishin mbetur 6000 banorë, nga të cilët 2000 ishin luftëtarë efektivë. Midis tyre kishte edhe reparte të rinjsh malësorë. Jashtë qytetit vepronin reparte shqiptarësh të komanduar nga Johan Cernojeviçi, të cilët, me varkat e tyre të vogla nëpër ligjen, shqetësonin rrethuesit dhe përpinqeshin t'i vinin në ndihmë qytetit. Forcat efektive, pra, në dorën e të cilëve ishte mbrojtja e qytetit, ishin krejt shqiptarë, kurse komandanti i fortesës ishte venedikasi Anton Loredano. Venedikasit vetë, si gjithmonë, i shmangeshin çdo angazhimi në tokë; flota u përqendrua në grykën e Bunës dhe u ngjit prej këndej lumi përpjetë deri në Shirgj; por ajo nuk qe në gjendje të çante bllokimin dhe të shkatërronte urën e ndërtuar nga rrethuesit; as në tokë forcat venedikase nuk mundën të kryenin ndonjë aksion efektiv në ndihmë të të rrethuarve; tepër e madhe ishte epërsia e kalorës së shpejtë turke. Flota nga ana e vet mezi mundi t'i shpëtonte pritës që i vunë turqit në një ngushticë të lumi. Kështu fatin e luftës e vendosi trimëria e mbrojtësve shqiptarë të Shkodrës. Megjithëse 4 topa të mëdhenj kishin arritur të shkatërronin një pjesë të mureve, shqiptarët mbroheshin me këmbëngulje prapa ledheve prej dhei që kishin ngritur. Ata i bënë ballë një sulmi të përgjithshëm që zgjati 8 orë e në të cilin komandantët turq i shtynin me forcë, me çomange, rrethuesit që të hynin në vijën e betejës pranë ledheve. Kështu erdhi mesi i gushtit. Ethet maliqë, të përhapura në këtë zonë, bënë edhe ato efektin e vet në këtë mes. Në këto kushte bejlerbeu vendosi të hiqte dorë nga rrethimi. Pasi dogjën kështjellën e braktisur të Danjës, turqit u larguan.

Një valë gjëzimi pëershkoi Evropën Perëndimore, e cila fitoren e korruar në Shkodër e konsideroi si një fitore të vetën. E jo pa të drejtë. Relacioni bashkëkohës i Gjergj Merullës na e dëshmon këtë qartë. Kur osmanët sulmonin muret e Shkodrës, britja e tyre e luftës, që arrinte deri në kupën e qiellit, ishte «Roma! Roma!» — gjë që tregon se synimet e pushtuesit nuk kishin për qëllim të ndaleshin në qytetin

shqiptar, por e konsideronin atë si një hallkë për të kaluar në Itali, për të pushtuar Romën. Fitores së shkodranëve mjeshtri Paolo Veronese i kushtoi pikturen e tij madhështore, me të cilën stolisi një nga sallat e pallatit të dogjave në Venedik, kurse poeti bashkëkohës Xhamaria Filelfo, në një poemë këndoi qytetin krenar që kishte bërë të dështonte me turp plani i «ngadhënjimtarit». Me të drejtë historiani Hammer Purgstalli, shek. 19, duke bërë fjalë për inkursionet turke që po në këtë vit (1474) arriten të futeshin deri në Austri, shkruante: «Qëndresë trimash, sic nuk i gjetën ushtritë grabitqare osmane në Kroati, Karnie, Karinti, Stiria dhe Sloveni, ato e gjetën në Shqipëri, përpara mureve të Shkodrës.»

Mehmeti u detyrua, kështu, ta linte punën e Shkodrës për ta zgjidhur me një ekspeditë të dytë. Ndërkohë, më 1475, ai u ra zotërimeve gjenoveze e venedikase në Detin e Zi, pushtoi qytetet e Tanës, Kafës, Azovit, garnizonet e të cilave, ndryshe nga ai i Shkodrës, nuk kishin asnjë mbështetje në popullsinë vendëse, dhe u dorëzuan brenda katër ditëve pa asnjë qëndresë. Më 1476 i erdhi radha Moldavisë, mbi të cilën ra shuplaka dërrmëtëse e forcave osmane.

Republika e Shën-Markut ndërkohë u përpoq të zhvillonte më tej traktativat e pages që i kishte filluar me kohë me sulttanin. Por kërkasat e pamatura të këtij nuk lejuan që të përfundohej një marrëveshje midis dy palëve; në mënyrë të veçantë Mehmeti II ngulte këmbë për dorëzimin e qyteteve Krujë e Shkodër, sepse, pa zhdukur qëndresën e tyre, ai nuk mund të mendonte për ndërmarrje të mëtejshme drejt Perëndimit e Italisë, sic ëndërronte prej kohësh.

Për këtë qëllim Mehmeti dërgoi më 1477 forca të reja për në Krujë, për rrethimin e sulmin e katërt të këtij qyteti. I dobësuar nga bllokada e vazduar prej kohësh dhe prej inkursioneve të përvitshme, qyteti heroik i Skënderbeut gjeti akoma forca për të qëndruar; madje, reparte shqiptare bashkë me venedikas arritën t'u shkaktonin, më 2 shtator, një disfatë forcave rrethuese, ndonëse nuk ditën ta shfrytëzonin fitoren që korrën.

Më 1478 sulltani mblodhi të gjitha forcat për të ndërmarrë përsëri një aksion vendimtar në Shqipëri. Turqit i kishin gjithë kushtet e favorshme për të arritur këtu një fitore. Vendi ishte dërrmuar nga inkursionet e përvitshme, forcat ekonomike e njerëzore kishin shtetur. Në fushën ndërkombëtare kushtet ishin gjithashtu të favorshme për ta: një varg shtetesh italiane, midis të cilave papati, ishin ftohur nga «zelli luftarak» që kishin treguar më parë; madje mbreti Fer-

dinand i Napolit, i biri i aleatit të dikurshëm të Skënderbeut në luftën kundër turqve, kishte përfunduar me sultani një marrëveshje që u lejonte anijeve turke të përdornin limanet e Mbretërisë së Napolit për aksionet e tyre në bregdetin Adriatik kundër Venedikut; njëkohësisht akinxhinjtë osmanë kishin arritur, duke djegur e shkretuar, deri në prapashpinën e Venedikut — zjarret që shënonin rrugën e tyre shiheshin me sy nga qyteti i lagunave! — në një kohë kur në qytet bënte punën e vet murtaja dhe forcat detare të Republikës ishin përqendruar rreth Qipros në pritje të një sulmi osman; në këto kushte ishte e qartë se qytetet e fundit shqiptare, për mbrojtjen e tyre, nuk mund të llogaritnin asnë forcë tjetër veçse forcat e veta.

Kështu filloi ajo epope heroike, lufta e qyteteve dhe e kalave të fundit që kishin mbetur ende të lira në Shqipëri, epilog i denjë i luftës thua jse shekullore që po bënин shqiptarët për lirinë e tyre; filloi rrëthimi i pestë i Krujës, filloi ai rrëthim i dytë i Shkodrës, të cilin Marin Barleti, me dashuri prej biri, e përjetësoi me veprën e tij të parë.

Sulltani bëri përgatitje shumë serioze për këtë ndërmarrje. Ai ngarkoi me këtë mision komandantët e tij më të njojur e më të sprovuar dhe u vu në lëvizje dhe vetë, si kurdoherë në të tilla raste, i shoqëruar nga «forcat e Azisë dhe të Evropës». Reparte speciale i prinin ushtrisë kryesore, me detyrë të hapnin rrugë e të shtronin ura. Reparte kalarësie u vërsulën drejt Krujës dhe u shtruan rreth qytetit, banorët e të cilit ndodheshin në kulmin e ngushticës, në pragun e vdekjes nga uria.

Më 14 maj para Shkodrës u shfaq, me një pjesë të forcave turke, bejlerbeu i Rumelisë, Daut pasha. Mijëra deve — shifrat shkojnë deri në 10 000! — sillnin furnizimet e paqisjet e ushtrisë, ndër të tjera edhe metalin me të cilin filloi derdhja e topave të mëdhenj për të rrahur qytetin.

Disa javë më vonë, mbasi u dorëzua më në fund Kruja — e mundur nga uria, por jo nga armët! — dhe pas masakrimit shtazarak të banorëve të saj, erdhi para Shkodrës bejlerbeu i Anadollit me forcat e veta dhe më 1 korrik edhe sulltani vetë.

Një mori çadrash zbardhëllonin mbi kodrat e malet rreth e përqark qytetit — përshkrimi i Barletit është aq i gjallë, saqë edhe sot, kur e lexon, të duket sikur qëndron bashkë me autorin në shkëmbinjtë e kalasë dhe prej së larti vështron atë mizëri njerëzish që lëviz atje poshtë, te këmbët e Rozafës së lashtë. Disa nga rrëthuesit shtrojnë ura mbi lumin e Kirit e të Bunës, kurse të tjerë, në bregun e lumit,

ndërtojnë anije për t'u bëre ballë sulmeve të barkave të shpejtë shqiptare që vijnë nëpër ligen nga viset përreth dhe me sulme të rrufeshme përpiken të lehtësijnë shtrëngesën e rrethuesve kundër qytetit. Atje më larg, përtej Bunës, kalorës po i ngjiten malit të Shën-Markut (Taraboshit), prej nga vëzhgojnë qytetin e rrethuar dhe drejtojnë inkursione grabitqarë në viset përreth e deri në bregdet. Nga ana tjetër e kalasë, në Kodrën e Pashës (sot Tepet), ku e ka kuartierin e përgjithshëm sulltani, rrethuesit ngrenë një kullë të lartë prej druri, që do të shërbejë për të drejtuar kundër qytetit të rrethuar zjarrin e artillerisë, e cila është vendosur prapa kësaj kodre, në breg të Kilit, në rrugën që shpie për në Drisht. Edhe pse mund të quhet e fryrë, siç është e zakonshme në të tilla raste, shifra prej 350 000 ushtarësh turq që na jep Barleti bashkë me ndonjë bashkëkohës tjetër, forcat që kishte vënë në lëvizje sulltani ishin me të vërtetë vigane, ashtu siç qe vigane edhe qëndresa që hasën ato në Shkodër.

«Çfarë çerdhe të mrekullueshme paska zgjedhur shqiponja për të rritur zogjtë e vet!» — paska thirrur Mehmeti, kur pa së pari Shkodrën, na tregon Barleti. Autentike apo jo, shkodranët i bënë të vërteta këto fjalë: Shkodra u tregua me të vërtetë një çerdhe shqiponjash.

Nga qyteti, i cili qysh në rrethimin e parë e kishte humbur një pjesë të popullsisë, ishin larguar me kohë pleqtë e fëmijët, të paaftë për luftë; ishin braktisur shtëpitë që ndodheshin jashtë rrerhit të mbrojtur nga muret e fortesës. Në qytetin-kala kishin mbetur 1600 burra, midis të cilëve një pakicë ushtarësh venedikas, po edhe fshatarë të rretheve, si dhe një numër i vogël grash. E komandonte mbrojtjen qeveritari venedikas Antonio da Lece. Në zjarrin e luftës mbrojtësit e qytetit u çelikosën e u shkrinë në një trup të vetëm; ata, më në fund, si një familje e madhe, hanin, si të thuash, nga një kazan; midis tyre nuk pati frikacakë e tradhtarë; dallohej midis tyre rinia — Barleti shpeshherë përmend trimëritë e të rinxve fshatarë; por nuk qëndronin më prapa nga burrat edhe gratë e vajzat. Midis mbrojtësve rronte fryma e heroit, Skënderbeut — nuk është e rastit që emri i tij zihet në gojë një varg herësh, ashtu siç thuhet shprehimi shqiponja që se një nga figurat më të shquara midis mbrojtësve, murgu Bartolome, kishte qenë një nga bashkëluftëtarët e heroit. Nuk është e rastit, mendoj unë, që turqit më vonë i dhanë Shkodrës emrin Iskenderie — qytet i Skënderit; qoftë sepse mendonin që hija e këtij kishte qëndruar midis mbrojtësve.

tësve, qoftë edhe sepse ia atribuonin themelimin e qytetit luftëtarit të madh, Aleksandrit të Maqedonisë.

Në rrethimin e Shkodrës u vunë në veprim armët e rënda të artilerisë, në një shkallë që tregonte se po merrte fund tashmë teknika e vjetër feudale e luftimit. 11 topa të mëdhenj — njëri prej të cilëve hidhte gjyle deri në 600 kilo! — filluan të rrithnin ato anë të mureve të qytetit, ku ishte porta dhe ku e përpjeta e kodrës ishte më e butë dhe u lejonte sulumesve ngjitje më të lehtë. Vetëm në një ditë, më 11 korrik, këta topa arritën të hidhnin deri 178 gjyle — një numër kolosal, i panjohur deri atëherë për teknikën e kohës. Për së shpejti muret filluan të binin dhe të rrethuarit u detyruan t'i vinin në vend duke ngritur ledhe të drunjta ose dheu. Më 22 korrik filloj sulmi i përgjithshëm. Duke kapërcyer gjithë vështirësitë, sulumesit arritën deri te porta, ku solën edhe dy kulla të drunjta, që do t'u lejonin të hidheshin në qytet; por mbrojtësit, me trimëri të çuditshme, me gjithë humbjet e rënda që pësuan, i prapsën të gjitha sulmet.

Më 27 u përsërit një sulm i dytë i përgjithshëm që zgjati pa ndërprerje deri më 28 korrik. Nga të 11 topat goditej porta e madhe, ku u zhvilluan luftime homeri, pa vënë ré se gjylet goditnin po aq të rrethuarit shkodranë, sa edhe sulumesit osmanë.

Humbjet e rënda dhe dështimin që pësuan osmanët, e bënë të qartë se Shkodra nuk mund të merrej me sulm të drejtpërdrejtë. Por nga ana tjetër prestigji i sulltanit kërkon-te një sukses të shpejtë. Këtij qëllimi duhej t'i shërbente aksioni i ndërmarrë kundër kalave të Zhabjakut, në bregun verilindor të ligenit të Shkodrës, Drishtit e Lezhës. E para ra shpejt, po Drishti i vogël, ndonëse i dërrmuar nga sëmundja e murtajës, u bëri ballë për 16 ditë me radhë goditjeve të tërbuara të artilerisë; me mure të rrënuara, ai nuk u dorëzua; mbrojtësit e tij qëndruan heroikisht me armë në dorë deri në fundin e hidhur, në të cilin kishte ardhur të asistonte vetë Mehmeti. Një pjesë e mbrojtësve që u kap e gjallë, u ther nga osmanët para mureve të Shkodrës — po edhe ky krim shtazarak nuk mundi t'ua ulte vendosmërinë shkodranëve për të vazhduar qëndresën. Më në fund ra edhe Lezha, e braktisur në mënyrë të turpshme, pa luftë, nga qeveritari venedikas, si dhe ishulli i Lezhës, në pyjet e dendura të të cilit ishte strehuar një numër i madh banorësh të vendit.

Po afrohej vjeshta dhe stina nuk lejonte që një ushtri e tillë e madhe të kalonte dimrin në fushë të hapur e pa

mbrojtje. Sulltani, e më vonë dy bejlerbejlerët e tij, u detyruan të têrhiqeshin më në fund me forcat e tyre; por ata ndërtuan në dy brigjet e Bunës nga një kullë dhe lanë aty një forcë të mjaftueshme për të vazhduar bllokimin dhe për të marrë kështu qytetin me anë të urisë. Venediku vetë nuk ndërmori asnjë hap për t'i ardhur në ndihmë ushtarakisht ose me furnizime qytetit, tani që ishte têrhequr fuqia kryesore e osmanëve. Qeveria venedikase gjithë përpjekjet e saj i kishte përqendruar te një aksion diplomatik, për të arritur, me anë traktativash, paqen me Mehmetin dhe për t'i dhënë kështu fund asaj lufte të gjatë që kishte filluar më 1463 dhe nuk i kishte sjellë Republikës veçse humbje. Më 26 janar u nënshkrua paqja në Kostandinopojë dhe më 25 prill 1479 u ratifikua në Venedik. Në Shqipëri Venediku detyrohej t'i njihet sultani zotërimin e Krujës, të Shkodrës dhe të qyteteve të tjera që kishte humbur gjatë luftës; për banorët e Shkodrës parashikohej që ata të liheshin të lirë të qëndronin ose të largoheshin, po të donin, nga qyteti, bashkë me kamjen e tyre.

Por ata që kishin mbetur, parapëlqyen pa përjashtim të merrnin rrugën e hidhur të mërgimit, sesa t'i nënshtrohen heshin armikut të urryer.

Ky është shkurt tregimi i Rrethimit të Dytë të Shkodrës, i ndërtuar në bazë të tregimit të Barletit, i plotësuar me të dhënat e disa burimeve të tjera. Por burimi kryesor mbetet gjithmonë autor i shkodran; atij s'kanë c'i shtojnë ndonjë gjë me rëndësi dokumentet arkivale bashkëkohëse ose disa kronika venedikase dhe osmane-turke që e çekin këtë ngjarje.

Kronisti turk Ashik pasha Zade têrthorazi na e vërteton çka thotë Barleti për rëndësinë që i jepte Mehmeti pushtimit të Shkodrës. Ai tregon se si sultani, duke i hedhur një vështrim hartës me vendet që nuk i ishin nënshtruar, i têrhoqi vëmendjen Shkodra dhe, për të gjetur shkaqet, pyeti: «Mos vallë ata kanë shumë ushtarë e shumë burra trima?» Dhe kronisti shton: «Në mendjen e padishahut pushtimi i kësaj kështjelle mbeti si një èndërr!» Kronistë si Kivamiu, Idrizi e të tjerë vërtetojnë deri në hollësirat më të vogla dhe deri në datat, të dhënat e Barletit për sa u përket artilerisë, vepreve luftarakë para Shkodrës, si dhe pushtimit të kalave të tjera. Sipas tyre komandanti i shquar turk Ahmet Gedik pasha, i cili njihet mirë trimërinë e shqiptarëve dhe vështirësitet e kësaj ndërmarrjeje, nuk pranoi ta udhëhiqte ekspeditën kundër Shkodrës dhe për këtë arsyen burgos.

Kronistë venedikas na shtojnë disa të dhëna të tjera.

Ata tregojnë se sa e pakië qe gatishmëria për ndihmë e qeverisë venedikase për qytetin faikeq që vazhdonte të mbanj i bllokuar gjatë gjithë dimrit 1478-79. Po këto burime na thonë se, kur u dorëzua qyteti në prill 1479, nga 1600 burrat që patën mbetur në qytet e morën pjesë në mbrojtje, cishin shpëtuar të gjallë vetëm 450 dhe përveç tyre 150 gra. Më në fund burimet venedikase na bëjnë të ditur edhe një fakt tjetër me interes, që Barleti nuk e ka përmendur, ndoferta për të mos e mbyllur librin me një disakord. Qeveritari venedikas në Shkodër, Antonio da Lece, emrin e të cilit Barleti nuk e zë në gojë kurrë, disa kohë pasi ishte shpërbyer për merita në mbrojtjen e Shkodrës nga Senati, u zxor, para gjyqit dhe u dénuia me burg, internim dhe humjen e gjithë pasurisë dhe të titujve. Siç kishte dalë nga të zhënët e shkodranëve të mërguar, qyteti i Shkodrës kishte asur akoma mjaft rezerva ushqimore për të vazduhar qëndresën, ndërsa nga raportet e Da Leces qeveria ishte informuar për të kundërtën.

* * *

Veprën «Rrethimi i Shkodrës» Barleti e ka ndarë në e kapituj, ose, siç quheshin pas zakonit të shkrimitarëve ztikë, në tre libra. Libri i parë përban një parathënie, ku ztuar dukës së Venedikut, Leonard Loredo os; në të cilën utori parashtron motivet që e shtynë t'i përrishej kësaj pu z. Më tej ai, duke hyrë në temë, rreshton mendimet e au rëve të ndryshëm për prejardhjen e turqe, jep emrat e lltanëve deri në pushtimin e Kostandinopojës më 1453 dhe Baron me shënimë historike rreth Shkodrës dhe përshkri zin e pozitës së saj.

Libri i dytë fillon me përpjekjet që bën Mehmeti II për pushtuar Shkodrën më 1474 dhe vazhdon me ekspeditën dytë në pranverë, katër vjet më vonë; përshkruhen operat e rrethimit, bombardimet e rënda nga artileria dhe yerja e sulmeve të furishme të rrethuesve.

Libri i tretë tregon dështimin e të gjitha sulmeve dhe ndimin e sulttanit për t'u têrhequr e për ta marrë qytetin anë të urisë. Bien Zhabjaku, Drishti dhe Lezha. Pasi fundohet paqja midis Venedikut e Mehmetit, dorëzohet

Shkodra, banorët e së cilës vendosin pa përjashtim të marrin rrugën e mërgimit.

Këto janë shkurt ngjarjet që përbëjnë skeletin e «Rethimit të Shkodrës». Por rreth tyre Marin Barleti, si historian e shkrimtar i shquar, ka ringjallur në relativisht pak fakte një botë, një epokë të tërë.

Ndërsa dokumentet arkivale bashkëkohëse, si dhe disa kronistë turq ose venedikas e gëkin rrëthimin e Shkodrës duke e parë nga jashtë, me sytë e të huajve, shkrimtari ynë na jep një kuadër të gjërë, të parë nga brenda qytetit, me sytë e një dëshmitari, ose, më mirë, të një bashkëluftëtarit. Në një tablo të pikluruar «al fresko», Marin Barleti na paraqet plot gjallëri ngjarjet dramatike që u zhvilluan brenda në Shkodër dhe rreth saj: alarmin e madh që shkakton lajmi i afritit të turqve, po edhe vendosmérinë e qytetarëve. Për të luftuar, përgatitjet e tyre ië ethshme, valët e tertiuara të sulmeve që u thyen në muret e qytetit, ose, më mirë, në trimérinë e mbrojtësve të tij, skendët e panumërtë të trimërisë individuale e kolektive, hollësirat e veprimeve luftarakë dhe të efektive të bombardimeve dhe, para së gjithash, vullnetin e paepur të shkodranëve; patriotizmin e ndërgjegjen e tyre si shqiptarë, bindjen që qëndrojnë për një çështje të madhe e të drejtë. Të gjitha këto janë paraqitur në tablo dramatike, me një stil dinamik e plot kolorit, siç e kanë vetëm një shkrimtar i talentuar.

Si humanist i shkullit XV-XVI, historiani Marin Barleti kishte një koncept të dyanshëm të historisë. Ajo duhej t'i shërbente së vërtetës, duhej të ishte mësuese e jetës, të mësonte njerëzit, siç thotë ai në parathënie, «të hapnin sytë tuar si duhet punët e njerëzimit». Por nga ana tjetër shkrimdësi konceptit estetik të historisë: historiu duhej t'i shërbente po ag edhe së bukurës. Prandaj cdhe kujdesi për formën e jashtme, orvatja për të stolicur idenë me një veshje sa më të bukur. Njohës i thellë i lzetërsisë klasike, ai shkroi një latinishtë elegante, duke ecur sidomos në gjurmët e historianit roman Tit Livi. Nuk janë të rralla rastet këtu, si dhe të iera të hqijatura nga autorë klasikë, duke ia përshtatur situatës, duke ua vënë në gjigjë personazheve të veta. Stili i bllëzuar e ndonjëhcrë disi i fryrë, toni retorik në përshkrimin e episodave e në mënyrë të veçantë në fjali met që u

vë në gojë personave historikë, sajognë esencën e stilit të tij prej humanisti.

Por për ne Barleti është para së gjithash historian e, nën këtë prizëm, ne vlerësojmë veprën e tij. Ç'vlerë historiografike ka «Rrethimi i Shkodrës»? Sa meritojnë besim të dhënat e tij dhe sa të sakta janë burimet mbi të cilat është mbështetur autor?

Burimet që ka kërkuar dhe përdorur Marin Barleti për hartimin e veprës së tij, janë të ndryshme — letrare dhe gojore. Kjo flet përfaktin që autor i është përgatitur seriozisht përf detyrën e tij. Për historianë e lashtë të Shqipërisë dhe të Shkodrës ai ka përdorur, nganjëherë edhe pa i përmendur emrat, të dhënat e autorëve antikë si Straboni, Poseidon, Plini, Tit Livi etj. Për historianë e turqve ai ka shfrytëzuar veprën e humanistit Enëa Silvio Pikolomini (më vonë papa Piu II) «Përshkrimi i Azisë dhe Evropës», e cila, nga ana e vet, është një përbledhje të dhënash prej burimesh të ndryshme. Këto pasqyrojnë njohjen e paktë që kishin ato kohë përf historianë e turqve. Të dhëna përf historianë e Shkodrës në fund të shekullit XIV, përf marrëdhëniet e Balshajve me Venedikun, si dhe përf rrethimin e parë të vitit 1474, Barleti ka marrë nga kronika e G. Merulës e sidomos nga vepra e një bashkatdhetari të tij, gjithashtu të mërguar në Itali, nga fjalimi panegjirik që i kishte drejtuar dogjës së Venedikut humanisti shkodran Marin Beçikemi, panegjirik që ishte botuar më 1503, dy vjet para botimit të librit të vet,

Me interes është një pasazh i Barletit përf një burim të panjohur nga ne, të shkruar, siç thotë ai, në «gjuhën popullore», ku tregohet legjenda e themelimit të Kalasë së Shkodrës në një mënyrë të ndryshme nga ç'e njohim ne sot. Potë mendohej se gjuha popullore është shqipja, atëherë do të kishim këtu dëshminë e ekzistencës së një letërsie shqipe që në shk. XV, një gjysmë shekull para Buzukut. Autori ynë, përf të kaluarën e Shkodrës, mbështetet dhe mbi traditën lokale, mbi atë që ka dëgjuar nga pleqtë, siç është p.sh. lajmi përf shpërthimin e ujërave dhe origjinën e re të ligjenit të Shkodrës.

Po të këtij burimi duhet të jenë të dhënat përf historianë e Shkodrës në fund të shk. XIV e në gjysmën e parë të shk. XV — një histori plot peripeci dramatike e plot ndeshje midis rivalësh të ndryshëm, që u shfaqën para mureve të këtij qyteti. Por, ndonëse shkodranët kishin ngritur krye disa herë kundër sundimit venedikas që rëndonte mbi ta — si p.sh. në vitet 1405, 1410 - 1411, 1429 — Marin Barleti,

në frysmin e tij filovenedikase, nuk e gjen me vend që ta përmendë. Me rëndesi janë, nga ana tjetër, të dhënat që vijnë nga njohja vetjake, si dhe nga tradita lokale, për ndryshimet që kanë ndodhur qysh nga fillimi i shekullit XV në shtrirjen e qytetit të Shkodrës, për lëvizjen që bëri ai duke u tjerhequr nga fusha, ku ishte tregu, në qytetën e mbrojtur, për ndryshimet aq të shpeshta në rrjedhën e Drinit etj.

Por pjesën më të vlefshme të veprës «Rrethimi i Shkodrës» e përbën përshtimi i ngjarjeve që autorë i ka parë vetë me sy, në të cilat ka marrë pjesë vetë. Fakti se tregimi ecën shpeshherë nga dita në ditë, se autorë, p.sh., shënon numrin e të shtënave të përditshme të artilerisë turke, na bën të mendojmë se vepra është shkruar në bazë të shënimeve të marra gjatë rrethimit, ndofta edhe në formë ditari, sepse shifra, të dhëna me kaq hollësi, nuk mund të jenë marrë vetëm nga kujtesa pas kaq vjetësh. Këndej mund të nxirrej përfundimi se materiali i veprës mund të ketë qenë përgatitur që me kohë dhe është redaktuar përfundimisht më vonë, pas vitit 1503, siç tregon fakti që është përdorur akoma panegjiriku i Beçikëmit i vitit 1503.

E quajmë me vend ta theksojmë edhe një herë se kronistët turq i vërtetojnë më së miri të dhënat e autorit tonë përsë i përket rrethimit të Shkodrës; me këtë zhuleftësitet mohimi i vlerës burimore që i është bërë vepres së Marin Barletit nga disa studiues, siç ka qenë në mënyrë të veçantë G. Voigti. Ai karakter saktësie që na rezulton për «Rrethimin», nuk ka se si të mos merret parasysh edhe për vlerësimin pozitiv të veprës madhore të Barletit, të «Historisë së Skënderbeut».

Të gjitha këto arsy, pra, i jepin vepres së Marin Barletit «Rrethimi i Shkodrës» karakterin e një tregimi të vërtetë, të një burimi të saktë e autentik. Kjo vlen edhe pasi të bëjmë disa zbritje të nevojshme. Është vënë në dukje nga një varg studiuesish, veçanërisht te «Historia e Skënderbeut», se një e metë e madhe e Marin Barletit si historian janë fryrjet dhe ekzagjerimet, veçanërisht në përshtrimin e luftërave, në shifrat e humbjeve të turqve, si dhe fjalimet e letrat e shpikura etj. Kjo vërejtje është deri diku me vend — veçanërisht për «Historinë e Skënderbeut», ku autorë nuk kishte veçse pak burime direkte. Po ndryshtë qëndron puna te «Rrethimi». Asnjë që lexon me kujdes këtë vepër nuk mund të mos vëré re se tregimi i luftimeve — ndonëse edhe këtu ka zbulimë oratorike që shkojnë deri në ndërhyrjen e faktorëve të mbinatyrorshëm! — ka karakter realist, ka indikacione

të hollësishme që shpjegohen, siç u tha, vetëm nga fakti që mbështeten mbi pjesëmarrjen personale të autorit dhe që vërtetohen edhe nga anë të tjera.

Sa për fjalimet, që edhe në këtë vepër zënë një vend të madh, është e qartë se asnjieri nuk mund t'i quajë ato riprodhime të sakta të fjalëve të thëna në të vërtetë në rastet e ndryshme. Por, ndonëse duhet bërë ky koncesion, ato, me gjithatë, mund të konsiderohen deri diku si besnikë për sa i përket frysë së tyre. Të paktën mund ta themi, këtë përfjalimet e mbajtura nga shqiptarët, mund të supozohet se qytetari i Shkodrës në këto çaste mund të mendonin e të ndienin kështu siç e ka formuluar nga kujtesa më vonë një pjesëmarrës i këtyre ngjarjeve. Natyrisht edhe këtu ka ndërhyrë autorit. Toni i zjarrtë i dashurisë për Venedikun, p.sh., duhet konsideruar si një reverancë e autorit para Senatit, e bërë në kushtet e vitit 1504.

Për sa u përket fjalimeve që mbahen në kampin turk, ato natyrisht janë prodhim i plotë i autorit. Është e vërtetë se Barleti na jep në disa raste disa hollësira nga kampi turk, që mund t'i ketë marrë nga shqiptarët të mobilizuar me forcë, siç ndodhte, nga turqit. Por këto fjalime janë kompozuar për t'u shërbyer qëllimeve të autorit. Vini re, p.sh., se me sa mjeshteri i ka përdorur Barleti fjalët që i vë në gojë Ahmet pashës në librin e tretë për të mburrur, — me gojën e turkut! — trimërinë e shqiptarëve, trimërinë e shkodranëve, «që ruajnë ende shpirtin e forcën e Pirros, nga i cili rrjedhin...» Në formën e një panegiriku, Ahmet pasha rreshton vargun e gjatë të vendeve, krahinave, qyteteve në Evropë dhe në Azë, që sulltani ngadhënjyes ka mundur t'i pushtojë... dhe vetëm njëra, kjo «fole shqiponjash», kjo Shkodër mizore nuk u përkul... Në këtë situatë, edhe pse nuk janë të siguruar historikisht, fjalët që i atribuon Barleti sulltanit: «O sikur të mos ia kisha dëgjuar kurrë emrin Shkodrës!», kanë një kuptim të brendshëm të thellë, që tërthorazi vërtetohet nga fjalët e cituara më lart të Ashik pasha Zadesë.

Në këtë kuptim, pra, vepra e Barletit, edhe kur nuk na jep dëshmi historikisht të sakta për ngjarjet e vitit 1478-79, ka një rëndësi të madhe; ajo na pasqyron mendimet, botën e ideve të një shqiptari të shek. XV e të fillimit të shek. XVI. Mund të themi se kjo anë e dytë e veprës së Barletit ka po aq vlefte për njohjen e kohës, siç e kanë edhe faktet e sakta historike që na jep.

Si në «Historinë e Skënderbeut», ashtu edhe në «Rethimin» lexuesi do të vëré re se, me gjithë kushtet eko-


nomike-shoqërore ende të pazhvilluara, në gjirin e marrëdhënieve feudale, në Shqipëri është rritur e zhvilluar një ndjenjë e zjarrtë patriotizmi, është krijuar një ndërgjegje që del nga kuadri i ngushtë i një «patriotizmi feodal», ose nga kuadri i patriotizmit lokal të një qyteti ose krahine, një ndërgjegje që pa dyshim është frgji i luftës së madhe popullore që për dhjetëra e dhjetëra vjet ngriti krahinat e Shqipërisë kundër pushtuesit të huaj. Krenaria patriotike ndihet e fortë në pasazhin kur Barleti tregon se besimi mendjemadhi i sulltanit për të pushtuar i cili është shpejtë Evropën dështoi, kur ai hasi me «fisin epirot» (shqiptar), me të cilin atij iu deshi të luftojë themjse 30 vjet. «Illi jemi gjak tjetër, kemi të tjera zakone, të tjera kanune e ligje... — thotë njëri nga heronjtë shkodranë për të treguar për se nuk mund të pajtoheshin ata me pushtuesit e huaj. Eashkë me këtë ndjenjë «ndryshimi», shfaqet edhe ndjenja e qartë e eprerisë morale, që rrjedh nga ndërgjegjja e luftës së drejtë që bën populli shqiptar, ndjenjë që përshkon gjithë veprën. Barleti e shpreh këtë mendim përsëri me gojën e tjetërkarjt: «— Çfarë trimërie mund të kryejë një njeri që lufton me përdhunë? Turqit luftojnë me të padrejtë për të shfletën në derdhë dikza që s'është e tyre...», ndërsa shqiptarët dinë për se luftojnë, «ata luftojnë për familjet, për atdheum, për fëmijën.» Dhe, për të shpjeguar natyrën e «popërkulum» të shqiptarëve, autor i ynë u referohet tipareve të karakterit të popullit, nezitive të tij psikologjike: shqiptarët s'i binden asciut, përosig atij, të cilat duan vetë ti binden; ata s'e pranojnë sundimin e huaj! Që këto fjalë s'ishin thjesht një lloj vetëmburrjeje, por rezultat i një vëzhgimi të hollë, këtë e vërteton fakti se një vërejtje të tillë, pothuaje me të njëjtat fjalë, e bën edhe një bashkëkohës turk, kronisti Dursunbej.

Natyrisht Marin Barleti kaq ndjenje krenarie, frysht i patriotizmit popullor, i jep një sfond dhe argumentim historik. Për humanistin shqiptar, shqiptarët nuk janë tjetër veçse fisi anitik e i fumshëm i epirotëve, për të cilin kishin shkruar kaq autorë të mëdhenj, idolët e tij. Që ky nuk ishte një mendim i izoluar, vetëm i një njeriu të shkencës, e tregojnë letrat e njohura të Skënderbeut drejtuar primit të Tarantos, ku shumë vjet më parë para formacionit të njëjtë mendim. I shlyrë nga kjo ndjenjë, autor i ynë shfrytëzon çdo rast; edhe kur është kthe folur për një ngjarje bashkëkohëse, për të bërë ekspozitë historike, për të fshir për fillimet legjendare antikë për qytatet e Shqipërisë — raste kur krenaria e tij

prej patrioti bashkohet me krenarinë e tij prej humanisti. Natyrish lufta që zhvillonin shkodranët nuk ishte vetëm një luftë e shqiptarëve kundër pushtuesve të huaj, por ishte edhe një luftë e të krishterëve kundër turqve myslimanë. Prandaj nuk ka se si të mungojë, si në gjithë dokumentacionin e kohës, edhe në veprën e Barletit ngjyra fetare. Faktori fetar shërben për ta theksuar dhe acaruar edhe më tepër konfliktin me pushtuesin e huaj. Nuk ka dyshim se pristi katolik Marin Barleti do ta përdorte dhe e përdori këtë faktor me insistim. Por nga ana tjetër duhet theksuar se Marin Barleti ishte përfaqësues i humanizmit, ishte ushqyer me idetë përparimi të kohës. Ai, luftën e madhe të shqiptarëve kundër turqve, e sheh, sipas shembullit të autorëve antikë, si një luftë kundër «barbarit», kundër «tiranit», për «lirinë». Ndryshe nga teologët mesjetarë, humanistin tonë e shquan një ndjenjë optimizmi, besimi në idealin e njeriut me ndjenja dhe interesa tokësore, me një qëndrim aktiv ndaj botës. Marin Barleti prift zhdukjet kështu pothuajse krejt prapa humanistik. Me gjithë besimin në ndërhyrjen e fuqive hyjnore që shfaqet aty-këtu, po aq e thellë është bindja se përenditë nuk u vijnë në ndihmë përtacëve dhe të ngathtëve, por vetëm atyre që lëvizin duart dhe rrinë gjithmonë të gatshëm. Edhe aty ku Barleti flet për çudira, është për të vënë rë se ai u referohet tregimeve të të tjerëve, duke ua lënë kështu atyre përgjegjësinë për sa tregojnë.

* * *

Për ta plotësuar kuadrin e dhënë nga Marin Barleti, e pamë me vend t'i bashkëngjitim këtij botimi si shtojcë dy dokumente bashkëkohëse: relacionin e Gjergj Merulës për Rrethimin e Parë të Shkodrës dhe një fragment nga fjalimi panegjirik që i drejtoi humanisti shkodran Marin Beçikemi më 1503 dukës venedikas L. Loredano. Autori i dokumentit të parë është historiani humanist Gjergj Merula (lindi më 1431), në Aleksandria të Italisë së Veriut dhe vdiq më 1494), cili, në bazë të informatave të mbledhura në Venedik nga dëshmitarë të ardhur nga Shqipëria në ditët e para të shtatorit 1474, d.m.th. posa ishin larguar turqit, hartoi këtë relacion që ua drejtoi në formë letre të vëllait dhe një mik.



Marin Barleti, meshtar shkodran (i kush-ton) princit Leonard Loredanit, dogjës fort të ndritur të aristokracisë veneciane dhe Senatit të shenjtë të saj¹) «Rrethimin e Shkodrës».

LIBRI I PARË

Parathënie

Fort i ndrituri princ Leonard Loredani!²)

Kur në historinë e njerëzimit ndodh diçka e jashtëzakonshme, diçka shumë e hidhur, shumë e rëndë, diçka për t'u vajtuar, që duket se vjen ose për të parë më mirë sesa i brishtë është njeriu ose për të zgjuar njëfarë dhimbjeje ndaj njëri-tjetrit, atëherë, zakonisht, dalin disa njerëz të cilët jo vetëm që e vështrojnë me njëfarë admirimi e keqardhjeje atë ngjyrje të hidhur, por, për më tepër, përpinqen ta përjetësojnë edhe me anën e penës.

Edhe me të vërtetë, sikurse na mësojnë për bukuri stokët³), po të shqyrtohet natyra e brishtë dhe e pasigurt e kësaj bote, njeriu menjëherë kujtohet se rrëziqet e fatke-qësitet janë krijuar pikërisht për njeriun me qëllim që ky të shohë mirë se, ndërsa lumturia e amshuar është vetëm për të vdekshmhit, përkundrazi për njeriun në këtë botë s'ka as gjë të amshuar, asgjë të qëndrueshme e të sigurt, me një fjalë: të shohë se ku qëndron ndryshimi midis natyrës hyjnore dhe asaj njerëzore. Kështu njerëzit e kuptojnë se kanë lindur edhe për një qëllim humanitar, d.m.th: që t'i vijnë në ndihmë njëri-tjetrit.

Megjithatë, dhe kjo mund të jetë diçka karakteristike, njerëzit shpesh e kanë zakon t'i shkaktojnë hidhërimë e trish-time njëri-tjetrit, po ndonjëherë edhe e ngushëllojnë njëri-tjetrin, i japin edhe ndihmën konkrete shoku-shokut.

Pa dyshim ka sjellë dobi të madhe dhe meriton lavdi, në lidhje edhe me epokën tonë, puna e atyre, të cilët e kanë bindur njerëzimin se nuk mjafton t'ua qajmë hallin të vuajturve, por duhet edhe t'u japim dorën e t'u lehtësojmë vuajtjet, kështu do të tregohej admirim për pësimet e tyre dhe këto pësimë mund t'u lihesin me shkrim si dëshmi e gjallë e pasardhësve. Edhe këta, duke pasur parasysh të gjitha ato vuajtje, do të pësonin një tronditje shpirtërore aq të madhe, saqë do të hapnin sytë e do të shikonin mirë se si duhet mbajtur timoni për të drejtuar si duhet punët e njerëzimit, gjithashtu, duke lexuar me pikëllim historinë e të vuajturve, do të mësonin t'u jepnin atyre përkrahjen e duhur.

Fort i kthjellëti princ! Duke kujtuar me veten time të gjitha këto mësimë të mira, të shenjta e të miratueshme, kushedi sa herë më ka dalë i gjallë para syve të mi gjithë ai mjerim, ai fat i tmerrshëm, ajo fatkeqësi, ajo humbje aq e hidhur që pësuan shkodranët kur u rrethuan. Aq shumë u zgjat ai rrethim, aq ua mëren shpirtin shkodranëve ato luftime, aq e madhe qe kërdia që e dërrmoi atë popul, i cili s'kishte pikë faj, saqë do të kishte zgjuar dhimbje e mëshirë edhe në zemrat e vetë barbarëve të pashpirt e të egër. Edhe kisha përshtypjen sikur ajo dhimbje kërkonte diçka vetëm prej meje, që kisha qenë një gjymtyrë, një pjesë me rëndësi e atij dheu. Po të kisha mundësi të këndoja edhe unë ashtu si i këndon poeti andin⁴) udhëheqësit da'rda, kurrë s'do ta kaloja në heshtje dhe me mosmirënjojje një ngjarje kaq të rëndësishme, por në një mënyrë o në një tjetër do të orvatesha ta përjetësoja me një përmendore letrare. E, ndërsa do të lexohej kushedi sa herë me kënaqësinë më të madhe historia e të gjitha atyre vuajtjeve dhe të zezave, nëpër të cilat u përshkuat shkodranët, që ikën e u shpérndanë në të katër anët e botës, do të lindte edhe ndër të tjerë ndonjë shkëndijë dhimbjeje e mëshire ndaj atyre të shkretëve e kjo shkëndijë do të arrinte të nxirrite ndihmën bujare pranë princave aq të mëshirshëm.

Mirëpo unë, duke u shmangur më së pari nga detyra e një njeriu stoik dhe e një qytetari të ndershëm e pastaj duke në c'pikë arrinte aftësia ime si njeri edhe fugia e dashurisë ndaj atdheut, për të cilin me arsyen e me të drejtë çdo qytetar e ka për detyrrë të derdhë edhe pikën e fundit të gjakut, nuk kisha mundësi ta bëja veshin shurdh ndershëmërisht përparrë ajo fjala e Horacit⁵), i cili na këshillon të marrim përsipër

vetëm një bërrë, që u përshtatet shpatullave tonë, pra nuk më pëlqente ta meritoja dënimin e poetit të Helikonit⁶⁾, në qoftë se stili im nuk do të pajtohej me subjektin e zgjedhur. Mua ma merrte mendja se aftësia ime nuk i përgjigjej thuajse fare një subjekti të tillë. Në këto rrethana nuk dija as unë se si të veproja, s'dija nga t'ia mbaja, q'drejtëm të merrja një herë e mirë. Këtej kisha frikë se mos po dënohesha si njeri i keq, po t'i mohoja atdheut diçka të drejtë e të ndershme që ai kërkonte prej meje. Kisha frikë se mos akuzohesha për mungesë gjykimi, po t'ia kisha nisur një vepre kaq të shkëlqyer, e cila dukej se kërkonte shumë prej meje si shkrimitar mjaft i regjur. Kisha frikë se, kur të kisha filluar me njëfarë hovi të guximshëm, mos mbetesha pastaj mu në mes të rrugës. Pastaj shtohej edhe fakti se vepra ime i duhej paraqitur një princi aq të madh dhe një senati aq të lartë edhe e di se si njëri ashtu edhe tjetri kërkojnë diçka të limuar me zotësi dhe të përpunuar me zell të madh.

E unë sidomos e dija mirë dhe e rrëfeja singerisht se për një punë të tillë nuk kisha aq talent, ose nuk isha i pajisur me një stil të rrjedhshëm dhe me gjykime të vlefshme, bile nga kjo anë isha i pagdhendur, i shterpët, i thatë. Edhe në të vërtetë, në qoftë se është e vështirë të shkruash për subjekte të tjera, aq më tepër në histori, që është aq e larmishme, gjen vështirësi në kulm, se aty ngjarjet e ndryshme, digresionet e ndryshme, fatet e ndryshme të njerëzimit djuhet të përshkruhen herë me një stil e herë me një tjetër në mënyrë që shpirti i shqetësuar i atij që shkruan të ushqehet me veprën që krijon, gjithashtu t'u kënaqet shpirti edhe lexuesve. Po t'i kisha unë të gjitha këto visare si të thuash në laboratorin tim, atëherë, për besë, puna do të dilte e lehtë dhe e thjeshtë. Këtej rrođhi që unë, mjaft i rënduar nga pesha e një barre kaq të madhe, e gjykova më të arsyeshmë të qëndroja në heshtje sesa t'ua vrisja veshin lexuesve me një vepër të pagdhendur e jo të bukur. Mirëpo nga ana tjetër, kur m'u kujtua jo vetëm fatkeqësia e madhe e atdheut tim aq të dashur, por edhe besnikëria e pasembullt që kurdoherë ka treguar populli shumë besnik i Shkodrës ndaj zotërimit tënd, o princ fort i kthjellët, në çdo rast dhe deri në pikën e fundit, kur m'u kujtua edhe fitorja lavdiplotë që korrën shkodranët kundër tèrbimit të të gjithë atyre barbarëve të pashpirt, merita këto të cilat në asnjë mënyrë s'duhën lënë në harresë, pse do të ishte mosmirënjojje, bile mund të jepin mbi të gjitha material të shkëlqyer për të shkruar e pra

meritojnë patjetër të nxirren në dritë, atëherë vendosa t'i përvishem këmbë e kokë kësaj pune madhështore. Qëllimi ishte që të dukej se e kryej detyrën time ndaj atdheut si qytetar i ndershëm dhe se u dëshiroj nder e lavdi atyre qytetarëve aq besnikë. Pastaj kisha për qëllim që jo vetëm të kërkoj nder pranë princave të dashur për shkodranët, por të bëj në mënyrë që, simbas shembullit të një besnikërie aq të madhe, edhe qytetet e tjera, edhe popujt e tjerë të jenë më të gatshëm për t'i dashur udhëheqësit e vët, për t'i nderuar e për t'i mbrojtur.

Unë më së pari do të vërtetoj se vetë perëndia u dha qytetarëve tanë besnikë ngadhënjimin, për të cilin ata e kishin humbur shpresën. Aq fort i ranë Shkodrës dhe aq e shkallmuani atë me muaj e muaj ata mijëra e mijëra barbarë, saqë nuk do të na bënte përshtypje më të madhe rrëthimi i dikurshëm i Saguntit në Spanjë ose ai i Kasilinit⁷⁾ në Itali atëherë kur i pati dërrmuar me ushtritë e veta ai udhëheqësi i tmerrshëm i kartagjenasve, ai burri i fortë, Hanibali. Edhe mbrojtësit e Shkodrës, të cilët u treguan aq besnikë, nuk do të mbeteshin pa marrë çmimin që meritonin: për të gjithë ata burra bota shprehu ndjenjat më të thella të respektit.


Tashti pra, o princ fort i ndritur, unë do t'ia nis të përkujtoj rrëthimin, me të cilin sulltani i fundit i turqve, Mehmeti, i dërmoi shumë rëndë shkodranët dhe kjo s'duhet të harrohet kurre, së pari sepse ai qe një rrëthim i jashtëzakonshëm dhe i tmerrshëm, që zgjati shumë dhe mori fund vetëm atëherë kur u shkretuan mbarë Maqedonia, Epiri⁸⁾ dhe Dalmacia e së dyti sepse iu bë ballë me heroizëm menjemdhësisë dhe mizorisë bërbare.

Por unë, përpara se të filloj tregimin, do t'i them nja dy fjalë rrëth origjinës së turqve, sepse në këtë pikë shkrimitarët kanë shprehur mendime të ndryshme. Pastaj do të përmend një nga një emrat e atyre, që në familjen otomane patën sundimin në dorë në një vërg të gjatë qysh prej themeluesit të parë e deri në kohën tonë e kështu do të shohim cilët kanë qenë paraardhësit e sultani Mehmetit. Në këtë mënyrë do të na dalë parasysh çdo gjë përherë e më qartë.

Këtë vepër unë do t'ia kushtoj kthjellësisë sate tamam ashtu sikurse i kushtohet një hyjnie. Kthjellësia jote me dashamirësinë më të madhe më ndihmoftë tashti që po shkruaj, ashtu si thonë se i pati ndihmuar dikur Herakliu Atlasit⁹⁾ të lodhur, që vuante duke mbartur në shpinë pe-

shën e kupës së qiellit. Njëkohësisht kthjelltësia jote e ruajtë këtë vepër nga kafshimet e zemërkëqive, se kjo është një veti e kthjelltësisë sate, e cila përherë ka qenë një mburrje fisnike dhe një mbështetje e pashoqe për burrat e ndershëm. Unë asaj kthjelltësie i mbështetem dhe i kushtohem me mish e me shpirt.

Por tashmë le t'ia nisim punës që kemi marrë përsipër.



FILLIMI

Me sa shoh unë, ata që janë marrë me prejardhjen e turqve, kanë shprehur mendime të ndryshme. Disa pohojnë pa farë dyshimi se turqit janë stërnipër të trojanëve dhe mbështeten në faktin se turqit prej shumëkujt u quajtën edhe teukér¹⁰⁾. Mirëpo ata fare lehtë mund të binden se janë bazuar në një argument të pathemel dhe nuk kanë fakte të sigurta, me të cilat ta përforcojnë mendimin e vet. Disa të tjerëve u është tekur të thonë se turqit rrjedhin nga skithët,¹¹⁾ një fis i egër e i palarë, që rronin gati si shtazë, kishin shtrat të përbashkët; jetesa e tyre ndryshonte nga ajo e zakonshmjë, as fe s'kishin; vetëm në gusht kremtonin si njëfarë festë saturnale.¹²⁾ Ata Perandorinë (Romake s'e panë me sy, por vetëm ia dëgjuan zërin edhe askujt s'i paguan tribut përvëç Oktavian Augustit¹³⁾), edhe atë e paguan vullnetarisht, kur morën vesh se edhe krahinat kufitare i jepnin Augustit vit për vit tributin.

Pastaj disa të tjerë thonë (dhe unë besaj se këta e kanë me të drejtë) që turqit janë pikërisht ata që banonin pranë Tanait¹⁴⁾. Për këta Pomponi¹⁵⁾ thotë: «Gelonët¹⁶⁾ banojnë në një qytet prej druri afër Thisagötës dhe turqit kanë zënë pyje të mëdha edhe jetojnë me gjah; për këtë arsyе disa, të mbështetur disi në natyrën e atyre vendeve, deshën t'i quajnë turqit jo «turci» ose «teucri» por «turcae».¹⁷⁾ Tashti, në kohën kur mbretëronte në Francë Pipini¹⁸⁾ turqit dolën nga portat e Kaukazit edhe nënshtuan shumë popuj të Azisë, më së pari holanët, pastaj kolhët e armenët e në fund persianët e saracenët,¹⁹⁾ të cilët asokohe kishin në dorë Persinë; turqit,

pra, plaçkiten pronä, vranë e prenë e bënë kërdinë nga çdo anë. Ata u përleshën në luftime të rrepcta edhe me avarët¹⁹⁾ dhe pati mjaft të vdekur nga të dyja anët; u përshkuan edhe nëpër Azinë e Vogël; plaçkiten mbarë Pontin dhe Kapadocien²⁰⁾. Veç asaj zunë edhe disa male e gryka të vlefshme, të cilat u dhanë dorë të fitonin një fuqi jashtëzakonisht të madhe me disa sulme të papritura pikërisht si hajdutë. Nga ky shkak turqit, me ato vërsulje të pareshtura, u bënë aq të fortë, saqë zunë të përlesheshin me popujt kufitarë herë me humbje e herë me fitore për të shtënë në dorë sundimin e atyre vendeve. Në këtë mënyrë, herë pas here, ata push-tuan jo vetëm Pontin, por edhe Kapadocien, Galatinë, Bitininë, Lykaoninë, Pisidinë, Friginë, Pamfilinë, Karien²¹⁾ dhe krejt Azinë e Vogël që prej Taurit e deri në brigjet e detit Jon dhe të detit grek, dhe këto nuk i fituan nën udhëheqjen vetëm të një princi, por të disa prijesve të tyre, simbas fatit që pati herë njëri, herë tjetë ndër armë. Ja, kaluan thuajse njëqind e tridhjetë vjet që kur turku dhe otomani Saladin²²⁾, një burrë i fortë, por jo edhe aq pasanik, që ende s'kishte fituar nam ndër të vetët, mbledhi ushtarë dhe me një çetë të vogël, që e kishte formuar me rastin e një kryengritjeje, fillooi të ngacmonte e të shtronte me armë kërcënuese jo vetëm të krishterët, por edhe njerëzit e vet edhe i vuri nën zgjedhë. Në këtë drejtim atij i punoi fati, sepse, ndërsa princat e tjerë grindeshin ndërmjet tyre (dhe ky është helmi më i shëmtuar për sundimtarë e për shtete) dhe copëtohen me njëri-tjetrin, përkundrazi Otomani, duke thirrur e duke mbledhur nga të katër anët njerëz që ishin të dëshiruar për plaçkitje e për pre, brenda pak kohe fitoi nam të madh. Shtiu në dorë shumë kështjella diku me forcë e diku pa nevojë force, sepse ato u dorëzuan vetë, dhe aq lart u ngrit me këto farë ngadhënjimesh edhe fitoi një emër e një autoritet aq të lartë, saqë nga të gjithë pjesëtarët e familjes otomane vetëm ai, me pëlqimin e plotë të të gjithë turqe, u zgjodh mbret, që ata e quajnë Amyrat²³⁾. Edhe aq fort e rrënjosni emrin e vet në shpirtin e barbarëve, saqë këta, përvëç një pjesëtarë të familjes otomane, nuk lejojnë njeri tjetër deri sot të bëhet mbret.

Pas tij erdhi i biri, Orhani²⁴⁾, i cili nuk ndryshonte nga i ati për sa i takon shpirtmadhësisë dhe dëshirës për të sun-duar e, sa për disiplinën ushtarake, për grumbullim ushtrie e mjete lufte, ua kaloi të gjithë të tjerëve që kishin qenë para 'tij. Ai ishte bujar prej natyre, me një karakter të butë dhe me sjellje shumë të ëmbël; si sundimtar tregonte

shumë urtësi, saqë me të tilla cilësi i kishte bërë të gjithë për vete dhe të gjithë e donin. Në këtë mënyrë mblodhi ushtarë nga të gjitha anët dhe formoi taborë të mëdhenj ushtrive dhe perandorinë, që themeloi i ati, ai e zmadhoi në mënyrë të çuditshme. Mbas tij e mori sundimin i biri, Murati²⁵⁾, një goxha burrë si me trup ashtu edhe me vepra dhe shumë i zoti në artin luftarak; edhe ai, duke përfituar nga rasti, e rriti edhe më tepër zo'tërimin që i kishte lënë i ati. Kur Theodor²⁶⁾ Kantakuseni filloj luftën kundër dhëndrit të vet, Joan Paleologut, të cilit me dredhi ia kishte marrë Konstantinopolin, nësa këtë qytet e kishte si në patronazh, ai thirri në ndihmë Muratin, por vetëm me një kusht: që, porsa të merrte fund lufta ndërmjet atyre të dyve, Murati të kthehej në ato vende nga kishte ardhur. Ky mezi qpriti dhe nëpër Helespont²⁷⁾ kaloi prej Azisë në Greqi e me marifet zuri ta zgjaste luftën. Qëllimi i tij ishte që me këtë luftë të gjatë të lodhte dhe të shkatërronte nervash vjehërr e dhëndër e pastaj t'i sulmonte e t'i thyente fare, edhe barbaria arriti qëllimit, ata i dërrmoi krejt; shitu në dorë më parë Galipolin e Kersonezin e pastaj pjesën më të madhe të Greqise²⁸⁾.

Që prej këtij çasti ua nisi pushtimeve fare haptazi dhe në mënyrë të guximshme; ai kishte për qëllim të shtinte në dorë me të gjitha fuqitë perandorinë e grekëve. Mirëpo, ndërsa po bënte këto plane, u vra prej një burri të fortë e trim, prej Milloshi Kobilikut²⁹⁾, princit të Myzisë. Murati la dy djem, Sulejmanin dhe Bajazitin, të cilët nuk i lanë asgjë mangët prindit të vet; ata ditën ta vazhdonin fushatën e nisur nga i ati, ditën të administronin vendin, të mbanin disiplinën në ushtri, me një fjalë ishin të pajisur me zotësi, urtësi e cilësi të tjera. Mirëpo, mbasi vdiq Sulejmani, i gjithë pushteti mbeti në dorë të Bajazitit³⁰⁾, që ishte i madh me shtat, por edhe me shpirt; kishte një trup të lidhur e të fortë; duronte qdo mundim, por kishte edhe një mendje të mprehtë sa s'besohet. Lakmonte gjithnjë gjëra të mëdha, por donte t'i arrinte me përpjekje; ishte guximtar e i gatshëm për të kryer qdo punë, ishte i dhënë me gjithë shpirt pas luftës; aspak s'i pëlqenin pushimi dhe qetësia. Kur ishte puna për të gënjer armikun me anë të stratagjemës, tregohej shumë i zgjuar e i mprehtë; fundi, me atë përvojë, aftësi e urtësi që kishte, tregohej i vaditur dhe i papërtueshëm në qdo gjë, në qdo punë që duhej kryer. I bënte sytë katër dhe qdo punë i dilte përpara. Prandaj aq diti të përfitonë nga fati që i qeshi, saqë, brenda pak kohe, mbasi mori në dorë sun-

dimin, i shtriu kufijtë e vet në të katër anët dhe në të vërtetë nënshtroi thuajse të gjithë Thrakinë, shtypi myzët³¹) dhe thesalët; u sul mbi Maqedoninë, pushtoi Focidën, Beotinë dhe Atikën³²), ndërsa ilirët dhe tribalët³³) pjesërisht i shpartalloi me sulme të pareshtura dhe me plaçkitje të papritura e pjesërisht i vuri nën zgjedhë. Gjithashtu aq e dérrmoi Bizancin, kryeqytetin e perandorisë, me tërë ato shkatërrime e plaçkitje, saqë qytetarët s'mendonin tjetër veçse të shpëtonin dhe disa, po mendoheshin të dorëzoheshin apo jo, ndërsa të tjerët iknin larg nëpër krahina të ndryshme të Italisë, deri atje lart në Francë, për të kërkuar ndihmë. Ndërsa Bajaziti kryente një punë kaq të madhe në Azi e në Greqi dhe u kallte tmerrin të gjithëve, ai Tomir Mesageta, i quajtur Tamberlan³⁴), ishte nisur nga Persia dhe po marshonte me një ushtri të madhe për të shtënë në dorë Azinë.

Këtij i doli përpëra Bajaziti me një ushtri të madhe e të fortë me qëllim që të mbronte kufijtë e vet. Mirëpo fati smirëzi e gjenjeshtar (të cilit duhet t'i besosh fare pak ose aspak), ai fat, që aq fort i kishte qeshur deri në atë çast, e dérrmoi dhe e uli aq poshtë, sa e kishte ngritur përpëra deri në qiell; dhe, në të vërtetë, në një betejë në kufijtë e Armenisë³⁵) u thye, humbi dyqind mijë ushtarë, u zu rob, e lidhën me zinxhirë të artë prapa një qerreje dhe Tamberlani, thuajse triumfues, e vërtiste në të katër anët. Në fund e lanë të lirë, por Bajaziti s'bëri asnë punë të denjë për t'u përmendur dhe vdiq në Azi pa farë lavdie.

Të bijtë, që ishin disa, ranë në dorë të grekëve, sepse, kur u zu rob i ati, ata, për t'iu shmangur rrezikut, u nisën për të kaluar nga Azia në Thraki, mirëpo u takuan me disa anije greke dhe u zunë prej tyre. Kalapinin³⁶), që ishte djali i madh, grekët e lane të lirë dhe ai atëherë shkoi e mori në dorë mbretërinë të shkallmuar e thuajse të shkatëruar e të mbetur pa pikë fuqie.

Asokohe Sigismundi³⁷) mbreti i Panonisë, pa grumbulluar mirë të gjithë ushtrinë dhe pa e radhitur ashtu si duhet, kaloi Danubin dhe i doli përpëra Kalapinit për ta 'thyer. Mirëpo nga guximi që mori njëri prej njerëzve të Sigismundit, nisi përlleshja, por Sigismundit nuk i shkoi mbarë kjo betejë, humbi shatorre e streme³⁸), u vu përpëra dhe u thye për turp e faqe të zezë; ai vjetë mezi që u shpëtoi duarve të armiqve duke kaluar Danubin me një barkë të vogël. Kjo fitore i entuziazmoi aq shumë armiqtë dhe i bëri aq të rreptë, saqë u dhanë me gjithë shpirt për të pushtuar e për të shtypur vendet e krishtera. Mirëpo Kalapini vdiq dhe kur djali i tij,

Orhani, në moshë ende shumë të re, nën udhëheqjen dhe me nismën e disa princave u përpoq të merrete në dorë frerët e mbretërisë, i ungji i tij, Moisiu³⁹), i liruar edhe ai nga grekët, i doli përpëra si armik dhe më tepër tradhtisht sesa me një luftim të rregullt e vau Orhanin e vogël. S'kaloi shumë kohë e vdiq edhe ai pa lënë asnje trashëgimtar. Vendin e tij e zuri Muhameti, djali i tretë i Bajazitit, edhe ai mjaft i ri në moshë dhe mbetërinë e shtiu në dorë pa gjetur ndonjë kundërshtim në rrëthim e vet.

Muhameti bëri punë të madhe në Evropë, gjithashtu shtypi e zhveshi shumë vende të Azisë. Mbasi vdiq edhe ky, e mori fuqinë Murati, i biri⁴⁰), i cili, meqë ndodhej në Azi, porsa dëgjoi se i vdiq i ati, u orvat të kalonte nëpër Helespont në Thraki, mirëpo ia preu hovin me armatën detare perandori i grekëve. Edhe Mustafai, djali i fundit i Bajazitit, kishte qenë liruar nga grekët me qëllim që të merrete në dorë mbretërinë atërore dhe grekët e ndihmuani mjaft, mirëpo Mustafai u thye dhe u vra në luftë e atëherë Murati ngadhënjyes shtiu në dorë të gjithë mbretërinë. Edhe jo vetëm që vendosi qetësinë dhe e mbajti me trimëri, por për më tepër e rriti dhe e zmadhoi mbretërinë, sepse brenda pak kohësh pushtoi Selanikun,⁴¹), qytetin më të shquar e më të përmendur të Greqisë. Mori Helidën dhe të gjithë fushën e Ilirisë e dogji dhe e plaçkiti; shumë kështjella i mori me forcë, disa i rrafshoi përdhe. Në Istmin e Korintit depërttoi me një forcë shumë të madhe; pushtoi Peloponezin, një tokë pjetiore me të gjitha të mirat, të cilën grekët e kishin forcuar mjaft, edhe bëri kërdinë. Shumë qytete shtiu në dorë; bëri plaçkitje të mëdha edhe të gjitha ua dhuroi ushtarëve; fortesat e ledhet, që ishin si një fortifikim i asaj ane, të gjitha i dërrmoi e i rrafshoi me qëllim që ushtria e tij të endej lirisht e të marshonte lehtë ngado që të shkonte. Njëkohësisht i detyroi grekët që të bënin gati edhe një shumë të madhe të hollash. Murati bashkë me tërë ushtrinë hyri në luftë edhe me Vladislau⁴²), mbretin e Panonëve, të cilin e theu, e shpartalloi dhe e vau edhe të gjithë ushtrinë e tij e dërrmoi fare. Në fund u sul mbi Epirin dhe rrëthoi Krujën⁴³), të cilën Skënderbeu, princi i shqiptarëve, ia kishte hequr dore Muratit s'ka më bukur, me trimëri e marifet. Muratit ai rrëthim i doli shumë i gjatë dhe e mërzitti fort e, meqë nuk iu plotësua dëshira që kishte, i brerë nga hidhërimi i fortë, vdiq. Pas tij erdhë i biri, Mehmeti⁴⁴), i cili solli gjithë ato të zeza, gjithë ato dëme; rrënoi e dërrmoi çdo gjë, që një murtajë e vërtetë. Kushedi sa krahina, sa qytete, sa shtet-

te, sa mbretëri e perandori shtiu nën zgjedhë të vet dhe mbarë bota u drodh prej tij. Ai, porsa mori në dorë frerët e të gjithë perandorisë, hoqi ligjet e vjetra dhe shpiku të reja, vuri taksa, zmadhoi ushtrinë, hoqi princa e bujarë. Me njëherë vuri të gjitha energjitet e veta pér të shtënë në dorë Konstantinopolin dhe pér këtë mu te gryka e Bosforit, aty buzë bregut ndërtoi një kështjellë pranë qytetit dhe e fortifikoi shpejt e me kujdes dhe pa farë vonese ia nisi luftës kundër Kostantinopolit, të cilin, me një ushtri të fortë e rrethoi mirë në trajtë e një kurore. Duke shtënë në punë të gjitha mjetet luftarake dhe të gjithë armatën nga të katër anët pér tokë e pér det, e sulmoi qytetin me sa fuqi e hov që pati dhe pas pesëdhjetë e katër ditësh rrethimi e push-toi⁴⁵). Se ç'kërdi e ç'kasaphanë bëri ai ndër meshkuj e femra të çdo moshe, se sa vajza e gra u çnderuan, sa tempuj u dhunuani e çfarë poshtërsish e krimesh u kryen pér inat e tallje të fesë sonë të vërtetë, s'ka burrë që ta shprehë as me fjalë, as me lot, as me gojëtarë.

Mbasi u shkaterrua ai farë qyteti, atëherë edhe Pera, që gjendej përballë Stambollit dhe ishte një koloni gjeno-veze e pasur dhe e përmendur, u trondit nga af terror i papijtur e i zjarrtë, prandaj menjëherë iu dorëzua princ Mehmetit, i cili dha urdhër që të shembeshin ledhet e qytetit, të rrashin robër e të përdoreshin si kafshë. Ky pra eshtë ai Mehmeti, i ati i Bajazit^{45a)} që sundon sot, njeri shpirtmadh, burrë i fortë dhe i djegur pér lavdi, i dhënë me mish e me shpirt pas gjërave të reja dhe i regjur ndër luftëra. Mehmeti, mbasi fitoi autoritet, nam e dinjitet shumë të madh në njerëzit e vet dhe mbasi grumbulloj ushtri të panumërtë, atëherë, pra, kur gjendej në kulmin e fuqisë së vet dhe tregohej gjithnjë e më mizor me popujt e vet aq fat të madh pati, saqë brenda pak kohe shtroi Myzinë, Thrakinë, Peloponezin dhe thuajse mbarë Greqinë.

Shumë iu rrit mendja, pra, këtij barbari të çoroditur nga këto suksese dhe nga ky fat kaq i madh dhe nuk diti ta frepujve të tjerë të krishterë, të bluante në mendje të vet kushedi se çfarë, t'u kërcënohej atyre me gjëra të llahtarshme, zuri të lakmonte mizori të tjera e në fund t'u siguronte vetvetes dhe njerëzve të vet gjëra të mëdha. Menjëherë u hodh në Maqedoni, që sot në gjuhën popullore quhet Arbëri, sepse banorët e atij vendi, thuajse të gjithë, flasin gjuhën arbërore⁴⁶⁾. Tashti, meqë ka shumë që nuk dinë se ku gjen-

det kjo krahinë, unë do të shhangem pak nga tema dhe do të orvatem të përshkruaj kufijtë e saj. Tashti, pra, Maqedonia, siç na dëshmon edhe Plini, ka qenë e përmendur me njëqind e pesëdhjetë fise dhe me dy mbretër, edhe dikur ka qenë perandori e quhej Ematje⁴⁷⁾.

Nga perëndimi shtrihet deri te qyteti i Lezhës, ku janë epirotët; nga lindja ka Magnezinë e Thesalinë me anën e lumit Strimon, i mrekullueshëm me ato shtatë liqene, nga veriu ka Peoninë dhe Pelagoninë⁴⁸⁾; nga perëndimi Dalmacinë. Në bregun e saj gjenden qytetat e qytetarëve romakë: Rizini, Askrivi, Budua, Ulqini, që të vjetrit e quanin Kolqini si qytet të themeluar nga Kolqinë⁴⁹⁾, gjithashtu edhe lumi i Drinit e mbi këtë lumë gjendet qyteti romak Shkodra, nën-tëmbëdhjetë milje larg detit. Vijnë pastaj qytetet e përmendura: Lezha, Akrilisi⁵⁰⁾ dhe Epidamni, të cilin e themeluan korkyrasit⁵¹⁾ e që sot quhet Durrës, sepse Epidamus është një emër ogurzi, Apolonia⁵²⁾, një qytet me baza shumë të shëndosha për hir të ligjeve të tij. Në kufijtë e tij ndodhet një vend i famshëm që quhet Nymfa, sikurse e dëshmon Straboni; aty ndodhet një gur që vjell zjarr e metal e gjithnjë shkon duke u zmadhuar. Nën atë gur janë disa burime që qitin ujë të vakët dhe, siç na tregon Posidoni⁵³⁾, toka aty është plot me bitum, që vlen për të mbrojtur hardhitë nga insektet e dëmshme. Veç asaj aty ka shumë popuj; sidomos kaonët⁵⁴⁾ janë ata që banojnë në një pjesë të madhe të atyre vendeve, sepse, si burra të fortë që janë, ata aty gjithmonë mbajtën zotërimin e vendit. Pastaj andej nga lindja, jo shumë larg prej qytetit të Apolonisë, bie rruga Egnatia, e cila për çdo mil është e shënuar me shtylla guri edhe shtrihet për një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë stade⁵⁵⁾.

Kjo pra, është ajo Maqedonia, e cila (ta them me fjalët e Plinit) dikur pati zotëruar mbarë botën. Maqedonasit patën pëershkuar Azinë, Armeninë, Ilirinë, Arbërinë, Kapodocien, Sirinë, Egjiptin, Taurin, Kaukazin; patën shtruar baktrianët⁵⁶⁾, medët, persianët, duke shtënë në dorë mbarë Lindjen. Maqedonasit patën dalë ngadhënjyes edhe mbi Hindinë duke u endur kudo mbi gjurmët e atit Liber dhe të Herakliut⁵⁷⁾. Tirani, pra, ia nguli sytë Maqedonisë, kësaj krahine kaq të përmendur, kaq madhështore e të mrekullueshme, që kishëte lindur e ushqyer gjithmonë burra të fortë. Tirani filloi ta kërcënonte këtë krahinë me sulme të pareshtura, duke kujtuar se do ta shtypte me lehtësinë më të madhe e ta shtinte sa më parë nën zgjedhë. Mirëpo ai u gabua shumë rëndë dhe puna i dolli fare ndryshe, sepse fisi shqiptar atij i

nxori shumë kokëçarje, i kaluan thuajse tridhjetë vjet duke sulmuar e duke u përleshur vazhdimisht me atë fis dhe nuk mundi ta shtonte ose ta thyente as me forcë, as me hekur. Dhe në të vërtetë të gjithë princat e asaj krahine, prinda të mëdhenj e të vegjël, i dolën përpara për t'i prerë hovin; ata ishin mbledhur tok e lidhur ndërmjet tyre me një miqësi të fortë dhe me një besë të pérhershme, ishin burra të fortë e të paepur që i qëndronin armikut me rreptësinë më të madhe. Edhe Barbari e kishte parë se puna do t'i dilte shumë më e rëndë sesa e kishte paramenduar, prandaj nuk mund ta shkelte krahinen e Maqedonisë pa e larë mirë e mirë me gjakun e ushtarëve të vet. Mirépo, mbasi kaloi një kohë mjaft e gjatë (ose sepse punët e njerëzve ndryshuan dhe morën drejtë tjetër ose pse ashtu deshi perëndia, që ka në dorë punët e njerëzve, pra edhe këtë perandori), të gjithë ata prinda, të cilët kishin mundësi të mbronin fare lehtë vendet e veta, vdiqën nga shkaku i të zezave tonë, të cilat me të drejtë na bëjnë që të vuajmë dhe t'i paguajmë shtrenjtë siç e meritojmë, e pikërisht atëherë armiku i pashpirt më me egërsi zuri ta sulumonte nga çdo anë dhe ta shtypte atë krahinë dhe, si u fut brenda, mori guxim edhe më të madh për ta plaçkitur më shpesh dhe për ta djegur e pjekur.

Në fund, pra, kur mori fuqinë në dorë sulltan Mehmeti, mbasi pushtoi Bizancin, këtë qytet kaq fisnik e të shkëlqyer, shtiu në dorë edhe një perandori tjetër, katër mbretëri, njëzet provincia, dyqind qytete e këto të gjitha të krishtera (sikurse e gjej të shkruar). Atëherë Barbari, si iu rrit mendja prej gjithë kësaj lavdie, lakmoi të arrinte deri në kulm dhe ia preu mendja se fare lehtë do të shtinte në duart e veta çdo gjë e se brenda pak kohe do të bëhej zot i mbarë botës. Dhe në të vërtetë e njihte mirë astrologjinë dhe thoshte se donte vetë perëndia dhe vetë fati, ashtu edhe pozicioni i yjeve që ai t'ia arrinte atij qëllimi. Kishte mësuar të fliste greqisht, latinisht, arabisht, kaldeisht e persisht. Pastaj njihte veprat e njerëzve të mëdhenj: të Jul Cezarit e të Aleksandrit të Madh dhe entuziazmohej për së tepërm nga veprimtaria e tyre, pra kishte vendosur që edhe ai vetë të ekte mbi gjurmët e tyre. E me të vërtetë Mehmeti ishte një njeri guximtar e i papërkulur, kishte një mendje shumë të mprehtë dhe ua kalonte të gjithëve në urtesi e në dinakëri. Kishte vendosur që, mbasi të shtonte Italinë, të nisej drejt Romës dhe ta vinte nën zgjedhë. Mirépo ai gjithnjë thoshte se më përpara duhej të shtihet në dorë Epiri, sepse, që t'ia arrinte qëllimit e të plotësohej krejt dëshira e tij, ai nuk shihte

një vend më të përshtatshëm, më të volitshëm e më të dobishëm sesa Epirin edhe në asnë mënyrë tjetër nuk mund ta arrinte objektivin që i kishte caktuar vetes. Arsyjeja ishte se Epiri, si vend i afërm, jepet lehtësi shumë të madhe për të kryer çdo punë, pastaj kjo krahinë shtrihet edhe buzë detit Jon, që deri diku lag brigjet e Italisë. Në Epir ka pyje e drurë të mëdhenj, që janë shumë të përshtatshëm për ndërtim anijesh e galesh; atje ka limane shumë të mira për flota sado të mëdha. Atje kudo ka fusha shumë pjellore e të bukura e të gjera, kullota të begatshme, lumenj e burime plot shëndet. Tashti, pra, i mprehti e dinaku Otoman, i nxitur nga sa u tha më lart, zuri t'i ngacmonte me sa fuqipati e t'i ndiqte vazhdimisht e pareshtur epirotët, me qëllim që, ose t'i shtronte nën sundimin e vet, ose t'i shfaroste krejt. Mirëpo, meqë kaloi një kohë e gjatë në të cilën ata i nxorën shumë kokëçarje dhe ai hengri grushte të rënda prej tyre dhe, duke mos pasur mundësi të realizonte planet e veta, në fund u bind se populli shqiptar ishte i pathyeshëm dhe vendosi të ndiqte një rrugë tjetër për ta vënë nën zgjedhë dhe shpresonte se nëpër atë rrugë pa farë dyshimi do ta shtronte Epirin.

Sot Shkodra është qendra e bregut të Maqedonisë dhe e asaj pjese të Dalmacisë, që e ka afér.

Për origjinën e saj nuk kemi fakte, s'kemi asgjë të sigurt, pastaj s'ka mbetur asnë kujtim rreth saj; sepse qyteti, mbasi u dogj dy herë nga barbarët dhe mbasi u shkatërrua nga Anici⁵⁸), pretor i romakëve, u dogj krejt dhe vetvetiu. Edhe dihet fare mirë se në këtë kohë u dogjën të gjitha monumentet e vendit dhe të gjitha shkrimet historike të këtij qyteti. Megjithatë, meqenëse unë kam grumbulluar me kujdes çdo gjë që ikam pasur mundësi të kërkoja e të gjeja për origjinën e Shkodrës dhe për gjendjen e atyre që sunduan atje herë pas here, të gjitha këto unë do t'i përshkruaj shkurt.

Tashti, pra, thonë disa të huaj se Shkodra paska qenë themeluar nga Aleksandri i Madh, mirëpo kjo s'duhet pranuar, sepse Shkodra ka ekzistuar shumë më përpara se të lindte Aleksandri i Madh; por edhe vetë muhamadanët shkojnë me këtë arsyetim; sepse Shkodrën në gjuhën e vet e quajnë Skanderi, dhe ky emërtim, sipas shpjegimit të tyre, është një me emrin Aleksandri, mirëpo ky është qyteti i Egjiptit, që themeloi Aleksandri i Madh. Pastaj disa të tjera thonë se Shkodrën e paska themeluar njëfarë Johani, princ shqiptar, i cili për disa vjet paska sunduar në atë qytet, por

pastaj qytetarët dhe populli mbarë i Shkodrës e paskan përzënë këtë princ, sepse tirania e tij ishte bërë e padurueshme e pastaj aty qenka vënë në jetë njëfarë qeverimi popullor. Mirëpo Johani, që u dëbua, kur e detyruan të largohej prej qytetit, ndërsa po nisej, e paska nëmuri Shkodrën, duke lëshuar mbi të mallkimet dhe nëmat më të mëdha. Unë do të thosha se i madhi zot duhet t'i ketë marrë parasysh lutjet e atij njeriu, në qoftë se ka qenë burrë me të vërtetë i mirë, sepse qytetin e Shkodrës dhe krejt atë krahinë gjithmonë e kanë mërzitur armiqtë më mizorë; të gjitha të zezat i ka provuar ai vend. Por, duke menduar me veten time se ç'duhet vënë në pah për sa i takon lashtësisë së këtij qyteti, mund ta rrëfej haptazi e me mburrje se, për sa i takon vjetërsisë dhe historisë së lavdishme të saj, Shkodra duhet të mbahet me të drejtë si një qytet shumë i përmendur në daç për pozicionin e natyrshëm që ka, në daç për begatinë e madhe që gjzon. Andaj mund të besohet se romakët, mbasi u bënë zotër nga çdo anë, dërguan edhe këtu, si në shumë vende të tjera, kolonët e këtë përfundim se Shkodra u quajt qytet i romakëve. Por pastaj, kur ra perandoria e kur punët e Romës shkuan si mos më keq, mund të besohet se Shkodra u shkatërrua e u shkretua prej barbarëve; në këtë mënyrë u zhdukën dhe ato paku shkrime që imbeteshin nga vjetërsia e saj.

Prandaj ne nuk mund të themi asgjë të sigurt rrëth ndertues të parë të këtij qyteti.

Por na patën rënë në dorë disa shkrime, më tepër fragmente sesa analë, në të cilat flitej më shumë për meremetimin që i bënë këtij qyteti stërgjyshërit tanë, sesa për ndertimin e tij.

Ishte shkruar aty, në gjuhën popullore, se njëfarë Roza me motrën e vet të quajtur Fa qenë themelueset e para të Shkodrës e prandaj fortesa e saj quhet Rozafa. Ato të dyja mbretëruan për shumë kohë me fatbardhësi e qetësi. Pastaj thonë se pas tyre, (edhe këtë e mbajnë mend, sepse është gjë e freskët) erdhë si sundimtar njëfarë Nemanjani⁵⁹, i cili sundonte Epirin, Maqedoninë, Dalmacinë, të dy Myzitë dhe tërë Rumelinë. Kur vdiq Nemanjani, la djalin e vet të verbër, Uroshin, të cilin të gjithë i bindeshin sepse ishte i virtytshëm e i urtë. Pas tij mori sundimin i biri Stefani, që la si trashëgimtar të vëtmin djali që kishte; edhe ky quhej Urosh si gjyshi⁶⁰). Ky është kaloi jetën pa iu dëgjuar zëri dhe nuk pati asnjë fëmijë, prandaj paranikët e ndanë zo-

tërimin e tij ndërmjet tyre. Myzia e Poshtme i ra kont Lazrit⁶¹), e Sipërmja Nikollë Zhupanit, Rumelia të tre vëllezërve, Ujkashit, i cili fitoi edhe titullin e mbretit, Andreas dhe Eksikut, ndërsa njëfarë Monçin Deni mori vetëm sundimin e një qyteti detar. Nga ana tjetër prej farefisit të sundimtarit Nemanjan doli Balsha, i cili kishte nën zotërim bregun e Bunës, thuase fare pranë qytetit, deri në 'det. Ky pati tre djem: Gjergjin, Strazimirin dhe Balshën, dhe të tre qenë në nam e në zë⁶²). Këta, pra, e sulmuani Shkodrën, që e kishte nën zotërim Uroshi (për të cilin folëm më lart) dhe e morën. Në të vërtetë asokohe Shkodra ende s'ishte e rrëthuar me mure, por një pjesë ishte në fushë e një pjesë në kodër, ndërsa tashti është krejt në kodër, gjithashtu këta tre vëllezër dëbuani prej Matjes ose Maqedonisë princat Dukagjinë dhe Sopë⁶³) dhe shtinë në dorë Krujën, ku sundonin Sopët, dhe kështu prej fitores në fitore i shpallën luftë Stefanit⁶⁴), mbretit të Myzisë së Sipërmje, të cilin në fund e thyen me gjithë ushtrinë e tij, e shpartalluan dhe e ndoqën deri në Raguzë edhe aty e rrëthuan. Së fundi me ndërmjetësinë e raguzanëve u bë paqja midis tyre dhe u caktuan kufijtë deri te lumi Narenta, që ndan tokat e Faries, qytet i Dalmacisë⁶⁵). Në të vërtetë këtu merrnin fund kufijtë e zotërimit të atyre tre vëllezërve. Mirëpo ata u shtynë edhe më tutje dhe shtinë në dorë brenda pak kohe Albën greke që është në Epir⁶⁶), Kastorian ose Kastorilien dhe të gjithë Vlorën. Derisa qenë gjallë ata të tre (mbasi çuan jetë të lumtur e fatbardhë), të huajt kurrë s'patën guxim ta trazonin Epirin ose Maqedoninë ose t'i hynin brenda. Mirëpo, si kaloi një kohë e gjatë, dy prej atyre vëllezërve vdiqën dhe mbeti gjallë më i vogli, Balsha. Atëherë një kapetan barbarësh, i quajtur Hieurenëz⁶⁷), u sul mbi Maqedoninë me një ushtri turke prej dyzet mijë vetësh. Balsha i doli atij përpara me një ushtri të mbledhur me ngut e shpejt e shpejt, pa pritur që të grumbulloheshin të gjithë ushtarët (dhe komandantët e tij për këtë punë s'i dhanë asnjë këshillë).

Pra, pa iu trembur syri aspak (meqenëse ishte trim e shpirtmadh), u vërsul mbi ushtrinë turke, mirëpo, në një fushë, që nga vendësit quhet Saura, pranë lumit Vjosa, afër Beratit, tokë e Epirit, u thye e u vra ai vetë me tërë ushtrinë. Me vdekjen e Balshës, barbarët nisën për herë të parë ta shkelnin Epirin e ta plaçkitnin. Që atëherë shtinë në dorë Kastorian, Beratin dhe Krujën. Vendin e Balshës si mbret e zuri Strazimir Balshiku, pinjoll i familjes së Balshëve. Ky kishte nën zotërim Shkodrën, Drishtin, Lezhën, Tivarin dhe mbarë

atë krahinë dhe la si trashëgimtar të vetmin djalë që kishët, Gjergjin, i cili Shkodrën ia dha si dhuratë Muratit, mbretit të turqve⁶⁸). Në atë kohë thuajse primitive qytezat e qytetet ende nuk çmoheshin edhe aq; shpirti i njeriut ende nuk ishte ndezur aq fort nga lakkia e verbër dhe e çmendur e sundimit. Më vonë, me kalimin e kohës, vetë Murati ia ktheu Shkodrën si dhuratë Gjergjit, mbasi ky i kishtë dorëzuar Muratit një vajzë shumë të bukur nga farefisi i vet. Në fund Gjergji (me sa thonë) Shkodrën ia dorëzoi si peng dogjës së Venedikut e as nuk ia kërkoi më⁶⁹).

Ky qytet sot ka fituar nam të madh, sepse historia e tij është me të vërtetë madhështore; pastaj ka këtë të veçantë se gjendet mbi një kodër krejt shkëmb dhe rrëth e përqark ka fusha të mëdha shumë pjellorre. Është një qytet i fortë prej natyre, por i fortë edhe prej dorës së njeriut; është shumë i lartë, me një gjerësi që sot është mesatare, sepse, që kur u hodhën themelat e qytetit, rrëthi i mureve shtrihet atje poshtë në fushë më tepër se dy mijë hapa në formë katrore. Pjesës së poshtme të këtij qyteti i binte përmes lumi i Drinit, mbi të cilin ishte ndërtuar një urë guri e mrekullueshme, që ishte aq e gjatë, saqë shkonte e prekte Bunën me pjesën e vet të fundit; edhe sot kanë mbetur disa gjurmë të asaj ure. Vendi, ku më përparsa gjendej vetëm qyteza, tashti përfshin të gjithë qytetin. Për të parë se çfarë qyteti ka qenë Shkodra, mjafton fakti se, kur një ushtri e madhe barbarësh sulmoi tokat e saj, atëherë rrëth pesë mijë kalorës, thuajse e gjithë rinia shkodrane, u turrën të radhitur jashtë qytetit (sikurse thonë) mbas shenjës që jepte këmbora; u përlleshën me armikun pramë lumit të Drinit, që sot ndodhet larg qytetit tetë milje, dhe bënë kërdi të madhe mbi të. Mirëpo, meqenëse ushtria shkodrane ishte shumë më e vogël nënumëri dhe luftimi zgjati shumë, aty nga fundi u lodh edhe u thye keqas. Ata që mbeten pa u vrarë, u tërroqën bashkë me familjet e veta brenda kështjellës edhe atëherë armiku, me një sulm të fortë, u hodh në qytet e, mbasi s'gjeti njeri brenda, e dogji dhe e poqi plot tèrbim në të katër anët dhe e rrafshoi përdhe⁷⁰). Pastaj vuri të gjitha energjitetë për t'i u sulur fortesës, mirëpo, meqenëse s'pati mundësi ta pushtonte, e la dhe iku prej andej. Që prej asaj kohe shkodranët nuk u kujdesën më pér rindërtimin dhe rimëkëmbjen e qytetit, sepse, kur u pa se vetë fortesa paraqitej si vend më i sigurt, ata filluan ta përqendronin qytetin vetëm brenda atij rrëthi. Dhe në të vërtetë kjo qytezë, pér natyrën që ka, bie krejt thikë nga të katër anët, me përjashtim të asaj ame që është

nga veriu, aty zbrejt, si të thuash, me njëfarë pjerrësie dhe aty afër, me largësi sa hedh një shigjetë, ndodhet një kodër plot vreshta e ullishta. Mbi atë kodër, në Rrethimin e Parë⁷¹), sundimtari i Rumelisë, që turqit e quajnë pashë, kishte ngullur shatorren e vet. Që prej asaj kohe gjithmonë ai vend u quajt me emrin e pashës. Ky qytet aq i shkëlqyeshëm e aq i njohur dallohet mbi të tjerët për ajér të shëndetshëm, për ara pjellore e të punuara mirë dhe për ujëra që i ka me shumicë. Nga qyteza syri i përlan thua jse të gjitha fushat përreth, asgjë s'e pengon pamjen; prej andej i sheh të gjitha tokat që përfshijnë një hapësirë të madhe dhe çdo gjë dallohet imtësish. Prej andej sheh bujq që lerojnë tokën, që korrin të lashtat, sheh mullinj, peshkatarë, sa ndër lumënj le sa në liqen (e çfarë liqeni) duke gjuajtur peshk, që del me shumicë të madhe. Pastaj ke vreshtat, kopshtjet, burimet, liqenin e çdo gjë tjetër që ka krijuar natyra për të kënaqur njeriun. Sot rrëzat e këtij qyteti andej nga lindja i lag një degë e vogël e Drinit⁷²), kurse nga perëndimi kalon Buna, që është e begatshme me çdo lloj peshku; ky lumë kalon nëpër qytet me rrymë të shpejtë derisa derdhet në det mbas tetëmbëdhjetë miljesh. Buna buron prej atij liqeni shumë të përmendur, për të cilin të gjithë thonë se është formuar vonë, nga shkaku se shkrimitarët e vjetër nuk e përmendin aspak; gjendet larg qytetit gati gjashtëmbëdhjetë stade.

Këtej mund të merret me mend se ky liqen, sikurse shumë lumenj e liqene të tjera, është formuar vonë; edhe s'duhet kaluar në heshtje një çështje e tillë, sepse këtë mendim kanë pasur edhe ata që e kanë studiuar imtësish konfiguracionin e tokës. Po kështu, me sa duket, vërtetohet edhe sa më kanë rrëfyer banorët më të moçëm të këtij vendi, të cilët më kanë thënë se aty ku sot ndodhet liqeni, dikur ka qenë tokë plot me burime të pashterueshme, nga të cilat lindi ai liqen i mrekullueshëm, aq i madh e i gjerë e i thellë, me një bukuri të rrallë dhe me një rrëth njëqindenjëzetmiljesh⁷³). Ka ajér të shëndetshëm dhe është plot me çdo lloj peshku; ka edhe peshk të madh në çdo stinë. Përreth ka fusha shumë pjellore, kështjella madhështore dhe shumë fshatra. Buzë këtij liqeni ka edhe shkëmbinj, ku shihen të ndërtuara për bukuri disa manastire, ndër të cilat banojnë mjaft meshtarë grekë.⁷⁴) Të mos çuditet, pra, ndokush, në qoftë se thashë se ky liqen është i ri, sepse unë kam lexuar ndër autorë shumë të shquar dhe ndër gjeografë shumë të përmendur se në det ndodh shpesh që dalin ishuj e shkëmbinj, gjithashtu edhe në tokë burime e lumenj, bille edhe dita-ditës. Nuk qe digka jashtë vendi në qoftë se

u shmanga nga tema me një përshkrim të tillë, sepse secili do ta kuptoje se q'rëndësi ka pasur ky qytet e për q'arsye ai tirani i turqve u orvat aq fort për ta pushtuar. Tashti, pra, unë do të përpiqem me gjithë shpirt të vë në jetë çfarë kam vendosur të bëj. E, në rast se stili im do të çalojë, lexuesit të kenë mirësinë të më falin, sepse unë do të parashtroj besnikërisht çdo gjë, ku (sikurse thashë më lart) jam gjetur pranë, çdo gjë që kam parë me sytë e mi, çdo gjë që kam provuar unë vetë.

LIBRI I DYTE

Tashti pra Otomani, duke marrë parasysh se Shkodra ishte qyteti më i përmendur dhe kryeqendra e krahanës së Shqipërisë, ishte roja, syri, forca dhe mbrojtja e të gjithë mbretërisë, dera e detit Jon dhe e Adriatikut, mbrojtja e Italisë dhe e të gjithë të krishterëve, ushqeu një shpresë shumë të madhe për ta pushtuar, sepse në këtë mënyrë do ta kishte shumë lehtë të hynte edhe në Dalmaci, në Iliri dhe në Daunie⁷⁵⁾ dhe kështu do të plotësohej dëshira e tij. E, megjithëse e dinte fare mirë se ai qytet ishte i fortifikuar për mrekulli si nga natyra ashtu edhe nga ëdha e njeriut dhe kishte mbrojtje të fortë, prapëseprapë turku, duke pasur besim të plotë në fuqinë e vet, ia mbushte mendjen vetes se ai qytet nuk do të rezistonte aspak kundër tërë atij turri e tërë asaj fuqie, por do të shtihet në dorë brenda pak kohe, dhe vendosi të dërgonte një ushtri jashtëzakonisht të madhe për ta pushtuar. Priti, pra, që të vinte pranvera, si një stinë e përshtatur përfushata të tillë; përgatiti të gjitha mjetet luftarake, grumbulloj një ushtri shumë të madhe dhe vuri si komandant të saj Sulejmanin, sundimtarin e Rumelisë. Sulejmani në muajin maj⁷⁶⁾ nisi përpëra (simbas zakonit) si vëzhgues disa kalorës të armatosur lehtë dhe ai vetë u shkonte pas plot madhështi me gjithë pjesën tjeter të ushtrisë. Rrethoi qytetin nga të katër anët dhe bëri çdo përpjekje përfshirë t'i lodhur e përfshirë t'i ndrydhur të rrethuarit me terror e panik të madh, me ushtri e me çdo mjet luftarak. I dërrmoi e i shembji ledhet me sa fuqi pati e pastaj me ato vegla luftarake dhe me të gjithë atë ushtri të fortë u orvat ta shtinte në dorë qytetin. Do të shkoja shumë gjatë, po të tregoja se sa mijëra turq lanë jetën aty me turp, se si shko-

dranët, duke luftuar aq burrërisht, mbrojtën veten, atdheun, gratë e fëmijët e vet; kështu turku, si u lodh më kot, u tërhoq me turpin më të madh; u zembraps nga të rrëthuarit e me ç'humbe! Nga fundi, mbasi i shkuan kot të gjitha përpjekjet pér të pushtuar qytetin, turku, në krye të tre muajve, e hoqi rrëthimin. Atëherë shkodranët fituan nam e lavdi të pavdekshme pér këtë fitore të lartë e të shkëlqyer nën udhëheqjen e rektorit, Andon Loredanit⁷⁷). Kur sulltani e mori vesh këtë humbje, u zemërua e u mbush gjithë vrer, sepse shkodranët kishin bërë kërdi në ushtrinë e tij. Turkut më përpara nuk ia merrete mendja se me shkodranët do t'i dilte kaq punë sa i dolli, prandaj, mbas asaj humbjeje, filloj të përpëlitez ta vriste mendjen plot shqetësim a të hynte edhe një herë në luftë me shkodranët a ta linte fare atë punë apo ta sulmonte prapë Shkodrën me një ushtri më të madhe. Në fund, duke e ndier veten të ngacmuar nga gjithë ai gjak që u derdh dhe nga turpi i madh e duke marrë me mend grushtet e forta që kushedi sa herë kishte ngrënë prej epirotëve e pér më tepér duke iu kujtuar vdekja e t'et^{77a} (ishte edhe kokëfortë e s'dinte të lëshonte pe), vendosi të hakmerrej pér gjithë atë gjak që ish derdhur, sepse kishte besim në fuqinë e vet jashtëzakonisht të madhe dhe në trimërinë e ushtarëve të vet edhe shpresonte se do t'ia arrinte qëllimit, po të dinte t'i fuqizonte e t'i përmblidhët ashtu si duhet forcat ushtarake.

E, me qëllim që shpirti i tij të ndizej gjithnjë e më shumë pér atë fushatë, paguante njërin, që çdo ditë t'i kujtonte sultmin që duhej të bëhej mbi Shkodrën. Edhe s'ka dyshim se turku menjëherë do t'ia kishte nisur asaj fushate sikur të mos kishte qenë i detyruar të merrej me disa punë të tjera jo me më pak rëndësi. Mbası kaluan, pra, katër vjet prej Rrethiimit të Parë, gjithë vëmendjen e zemrén e vet sulltani e përqendroi te lufta e Shkodrës, tamam ashtu sikurse kishte vendosur. Pra më së pari dha urdhër që të mblidheshin ushtarë nga të katër anët dhe të rekrutoheshin të gjithë që kishin emrin turk e që kishin moshën e duhur pér të rrëmbyer armët. Dha urdhër të përgatiteshin armë, shigjeta, kuaj, një shumicë e madhe devesh pér të bartur bronzin që nevojitej pér artileri dhe çdo mjet tjetër lufte; pér të gjitha këto kishte specialistë të veçantë që ishin mjeshtër të vërtetë. Pastaj vinin ushqimet e sa e sa sende të tjera të nevojshme pér luftë. Në fund, si pa se çdo gjë ishte e gatshme e në rregull ashtu si déshironte ai, përgatiti nga të gjitha racat një ushtri aq të madhe e të fortë, saqë kurrrë një herë s'e kishte pasur më përpara. Edhe, sapo filloj të dilte gjethi, dërgoi përpara, simbas zakonit,

kalorinë e armatosur lehtë, duke dhënë, gjoja, të kuptohej se ajo kishte për objektiv një vend tjetër. Mirëpo pastaj dredhoi rrugë e, duke ecur prapa kalorisë me të gjithë ushtrinë e vet të armatosur rëndë, vendosi t'i sulej Shkodrës duke përhapur panik në të katër anët. Porsa mbërriti lajmi në Shkodër dhe u hap fjala anekënd, një tmerr i hatashëm e pushtoi qytetin dhe u bë një pështjellim i madh. E aty për aty u mblodh në qytet një turmë e madhe djelmoshash fshatarë, ku ishin më trimat, e barkarësh që kishin hyrë me galetë e veta në lumin e Bunës e të gjithë së bashku filluan të ndërtonin fortifikime e forcoma për mbrojtjen e qytetit, të rregullonin vendet e rojës, të forconin të gjitha pozicionet dhe s'pushuan as ditë, as natë, por, duke u dhënë me mish e me shpirt, punuan pareshtur për t'i kryer si duhet të gjitha punët që ishin të nevojshme për të bartur peshën e rëndë të një lufte aq të madhe, jo ndryshe, por sikur të ishte armiku aty pranë. Ndërsa zhvillohej e gjithë kjo veprimitari në qytetin e Shkodrës, andej nga veriu mal e fushë ishin ndezur flakë; u ishte vënë zjarri fshatrave dhe tymi përhapej deri lart në qiell, shenjë se së shpejti do të kristë lufta. Kur ja, papritmas, nga të gjitha anët filloj një rrëmujë që s'e mori vesh i pari të dytin; disa merrnin arratinë, disa i kishte kapur tmerri, fshatarët braktisnin arat e një pjesë prej tyre me dhen e plaçka drejtohej për më siguri nga brigjet e detit, një pjesë tjetër po vraponte për në qytetin e Shkodrës dhe sillte lajmin se tashmë turqit ishin krejt afër, se kishin plaçkitur të gjithë vendin, se u kishin vënë zjarrin shtepive, se kishin rrëmbyer gjithë atë bagëti me gjithë njerëzit bashkë, kështu që brenda dy ditëve ata kishin djegur e shkatërruar çdo gjë. Ishte asokohe në Shkodër një komandant,^{71b)} i cili, me urdhrin e Senatit të Venedikut, mbante drejtimin e qytetit, si timonieri që mban drejtimin e anijes. Ky komandant, mbasi përgatiti me kujdesin më të madh çdo gjë që nevojitej për luftë, mblodhi në kuvend qytetarët më trima, italianët dhe të gjithë të tjërët që ndodheshin në qytet; vendosi që njerëzit e paaftë për armë dhe të miturit të çoheshin ndër qytetet e bregut të detit, që ishin aty afër. Ndërkaoq armiku mizor e i rrezikshëm më katermbëdhjetë maj u sul me një turr të fortë mbi rrethin e Shkodrës natën, pastaj rrethoi edhe qytetin në formë kurore, duke e mbërthyer mirë nga çdo anë. Në këtë rrethim kishte ardhur Ali beu, sundimtar i Danubit, me tetë mijë kalorës të armatosur lehtë, që në gjuhën e vet i quajnë akinxhinj⁷⁸⁾. Të gjithë këta quhen me këtë emër, sepse shërbejnë si ushtarë

me shpenzimet e veta, nga shkaku se zotërojnë pasuri e tokë, të cilat ua ka dhuruar sulltani për trimërinë e madhe që kanë treguar. Komandanti i këtyre kalorësve e ka për detyrë t'i prijë ushtrisë së të madhit sultani duke plaçkitur, duke shkatërruar e duke rrethuar qytetin. Ai për më tepër prej sulltanit kishte privilegje që, porsa të kishte arritur ushtria aty ku ishte caktuar të arrinte, mund të merrte çdo drejtim që t'i dukej atij mirë e më mirë. Prapa tij vinte i vëllai, Skënder beu, komandant i Myzisë së Sipërmë, me katër mijë kalorës e pastaj vinte Malakoci, komandant i Myzisë së Poshtme me tri mijë kalorës, të gjithë të stërvitur. Ky është ai Malakoci, burrë i urtë, trim e i pashëm, me një palë sy që (sikurse thonë edhe përsytë e Augustit) i vezullonin si rreze dielli dhe s'kishte burrë që mund ta shikonte drejt në fytyrë. Shkodranët, kur panë se u rrethuan nga çdo anë prej gjithë asaj ushtrie, iu përveshën punës dhe, të ngjeshur mirë në armë, ia nisen të luftonin trimërisht atje ndër ledhe, duke flakur përbimi armikun me skorpionë dhe me sa fuqi që kishin shigjeta, gurë, predha e gjyle. Ndonjëherë suleshin edhe jashtë ledheve e u binin turqve papritmas e i zembrapsnin e i vritnin; pastaj, me një gëzim e entuziazëm të jashtëzakonshëm, ktheheshin brenda ledheve ngadhënjimtarë. Pastaj menjëherë mblidheshin më kuvend dhe aty secilit i caktohej vendi që duhej mbrojtur mbi ledhe. Disa të tjerë u ngarkuan që, simbas nevojës që paraqitej, të forconin pozicionet e ndryshme të qytetit, aty ku ishin më të ligshta, edhe t'i rregullonin mirë e më mirë. Shumica e qytetarëve të tjerë bashkë me meshtarët dhe me ushtarë të tjerë zunë vend në shesh me flamurin e artë të shën Markut e të shën Shtjefnit protomartir⁷⁹⁾, pajtor i qytetit, që të jepnin ndihmën e duhur aty ku paraqitej nevoja e ku ishte më i madh rreziku. Si u shpërnda kuvendi, të gjithë, me një shpirt, u drejtuan ndër vendet e caktuara dhe me guxim e trimëri të madhe vunë në zbatim urdhrat. Ndërkajq andej bregut të Drinit, që është larg qytetit tetë milje, u duk një shumicë e madhe shatorresh; atje kishte zënë vend Daut Ganjolla, pasha i përgjithshëm i Rumelisë, me të gjitha repartet e veta, që s'kishin mundur të kalonin lumin, se ishte fryrë nga vërshimi i ujérave, e atëherë një shumicë e madhe turqish, që ndodheshin pranë Shkodrës, i dolën përpëra Daut Ganjollës, sepse ishte një personalitet me rëndësi të madhe. Ky njeri ishte një burrë i pajisur me cilësi të rralla shpirtërorë e trupore; kishte lindur në Epir prej prindërish të kristerë të shtresës së ulët. Si u rrit, barbarët e morën të ri me vete si rob e atje midis tyre u bë aq trim, aq i zoti e aq i

mprehtë, saqë dukej se vetëm ai shkëlgente kur mbretëronte së pari Mehmeti e pastaj i biri, Bajaziti. Edhe u rrit e arriti në një rang aq të lartë të perandorisë, saqë vetëm atij i beso-heshin gjithmonë qështjet që i përkitnin Evropës. Kaq e domin të gjithë dhe e shikonin me sy të mirë, saqë ndonjëherë lindte dyshimi se mos po merrte në dorë ky njeri frerët e mbretërisë otomane, duke hipur vetë në fron. Dauti, pra, më nëntëmbëdhjetë qershori, si e kaloi lumin me tërë ushtrinë e vet, përpëra se të zbardhët drita, iu afrova Shkodrës dhe e nguli shatorren e vet, që ishte shumë e madhe dhe e purpurt, mu në majë të kodrës që sot mban emrin Kodra e Pashës, ndërsa mbarë ushtria e tij nguli shatorret rrëzë asaj kodré dhe në fushë. Ishin njëzet e pesë mijë kuaj e rrëth dy mbëdhjetë mijë deve, ngarkuar me bronz për artileri dhe me municione e vegla të tjera luftarake, të cilat të gjitha u shkarkuan andej Kodrës së Pashës. Nga ana tjetër, të krishterët ishin dhënë me shpirt për ta forcuar qytetin me fortifikime e me stome, duke grumbulluar trarë, dhë e baltë e duke i ngritur sa më lart, sepse e dinin fare mirë se muret do të rrafshoheshin përdhë dhe se armiku do të sulej si i çmendur përmbi to. Mirëpo turqit, kur panë se të rrëthuarit po bënин gjithë ato fortifikime, menduan t'u bënин një dredhi. Gjetën, pra, dy veta prej të vetëve, që e njihnin gjuhën latine edhe, si i veshën me rroba marinarësh, i mësuan mirë dhe i dërguan pranë ledheve me qëllim që t'u thoshin të krishterëve se ishin dy barkarë që pak më përpëra kishin zbritur nga galetë, me të cilat kishte ardhur një i dërguar i Venedikut për t'u marrë vesh me turkun dhe për të bërë paqe. Këta dy veta, pra, i këshilluan të rrëthuarit që të mos kishin asfare frikë, sepse brenda pak ditëve do të bëhej armëpushimi me turqit e prandaj s'ishte nevoja të lodheshin duke bërë gjithë ato fortifikime, sepse tashmë paqja ishte më se e sigurt dhe turqit brenda pak kohe do të iknin. Mirëpo ata të dy nuk ditën të shtire-shin ashtu si duhet, më mënyrë që të mos dilnin më shesh dredhia dhe gënjeshtra e tyre. Në fund, si doli sheshit dinakëria e tyre, u vunë më të ikur dhe për pak sa s'lanë kokën aty më vend. E gjithë kjo lodër u kurdis me qëllim që të krishterët, duke shpresuar më atë që u thoshin ata të dy, ta linin punën e fortifikimit e pastaj armiqtë ta shtinin qytetin më dorë më lehtë me të gjitha ato mjete luftarake që kishin. Armiku, pra, dita-ditës kurdiste dredhi e gracka të tillë; mirëpo të krishterët, të regjur tashmë me këto gënjeshtra e sherre, s'pushonin aspak së punuari, madje i përvisheshın punës edihe më me zjarr e me shpejtësi; punonin me zell e entuziazëm për

të shpëtuar veten e vet dhe qytetin. Barbari kurrë nuk arrinte të shtirej në mënyrë të tillë, saqë të krishterët të mos dikttonin dredhinë dhe sherrin e tij. S'kishin kaluar tri ditë që kishte arritur pasha, kur dha urdhër që mbi lumin e Bunës, një mijë hapa larg qytetit, të ndërtohej një urë druri shumë e madhe e shumë e fortë, që të lidheshin të dy brigjet dhe të kalohej lehtësisht nga njëra anë në tjetrën për arsy se ai lumë ishte rritur tepër nga ujërat dhe nuk mund të kalohej ndryshe në asnë mënyrë. Kishin marrë vesh barbarët se ajo krahinë andej lumi ishte shumë e pasur e se ndër qytetet e bregdetit ishte grumbulluar një shumicë e madhe fshatarësh me kopetë e veta, pra turqit shpresonin të bënин préndër ato anë mbi bagëti e njerëz. Si mori fund ura nga fillimi i qershorit, të nesërmen vetë pasha kaloi mbi urë bashkë me disa kalorës dhe u drejtua te disa instalime, ku zihej gjithë ai peshk, për të shikuar së afërmi strukturën e tyre, e pastaj iu ngjit malit të Shën-Markut, që është shumë i lartë⁸⁰), hipideri në majë dhe prej andej me vëmendjen më të madhe vëzhgoi qytetin e Shkodrës dhe të gjitha pozicionet. Pastaj aty nga mbrëmja u pëershkuan nëpër urë rrëth njëzet mijë kalorës për të shkatërruar e për të plaçkitur krahinat bregdetare dhe fshatrat e qyteteve të aférme. Mirëpo të nesërmen ra gjithë natën një shi aq i madh, saqë në mëngjes aty nga ora tre ata u kthyen e u futën ndër shatorre pa plaçkitur asgjë dhe disa ditë i kaluan në qetësi ndër çadra. Besoj se s'duhet kaluar në heshtje një aksion mjaft i shkëlqyer i rinisë shkodrane. Ishin thuajse nia treqind djelmosha me trup të lidhur, të bëshëm e trima të fortë, që dita-ditës endeshin rrötull ledheve me pushkë në dorë edhe vritënin gjithë ata armiq, saqë u kallën tmerrin dhe ngjallën në zemrat e të gjithë shkodranëve një shpresë të patundur përfitore. Ndërkaq më tetë qershor kishte arritur te lumi i Drimit Mustafa beu, i cili ishte Anadolli. Këtij i doli përpëra pashai i Rumelisë dhe pas tri ditëve, mbasi ngriti shatorret, i solli rrëth gjashtëmbëdhjetë mijë kalorës, të cilët kaluan pranë qytetit të Shkodrës dhe u ndaluan në një vend që banorët e atjeshëm e quajnë Mbi-shkodër dhe atje ngulën shatorret. Të nesërmen, përpëra se të shkomte edhe pashai atje, dërgoi reparte të tjera dhe shumë streme⁸¹) e pastaj ia befi edhe ai vetë me një suitë të madhe në mes të krismës së borive dhe të sa instrumenteve të tjera lufte. Ai e kishte ndarë ushtrinë e vet në pesë skuadra.

Skuadra e parë kishte gjashë flamuj të mëdhenj; flamuri i parë ishte krejt i blertë, i dyti i trëndafiltë e të katër

të tjerët ishin krejt të bardhë. Skuadra e dytë kishte dy flamuj të purpurt. E treta dy të blertë. E katërta dy të verdhë, ndërsa e pesta i kalonte skuadrat e tjera për sasi njerëzish dhe ishte më e stërvitur; me sa dukej, aty ishte vetë pashai. Kjo skuadër kishte shtatë flamuj. Flamuri i parë ishte i bardhë dhe i qëndisur me ar, dy të tjerë ishin të blertë e pastaj vinin katër në ngjyrë të trëndafilit. Skuadrat e tjera kishin flamuj të ndryshëm, por të vegjël e me ngjyra të ndryshme. Ishin, pra, tridhjetë mijë kalorës aziatikë; të gjithë i kishte sjellë me vete pashai i Azisë, për të cilin folënë më lart. Këta aziatikë janë burra të pashëm, shigjetarë të rreptë e të rrezikshëm, por nuk janë aq të fortë, aq luftëtarë e aq të qëndrueshëm në vështirësi sa janë evropianët dhe burrat e Rumelisë. Veçse kuajt i kanë shumë të fortë e të shpejtë; për këtë arsy këtu ndër ne e kemi zakon të themi «burrat e Rumelisë e kuajt e Azisë». Pashait të Anadollit s'ia mbajti të hynte aty për aty në shatorren e vet që ishte pa mbrojtje; ndoshta trembej se mos e pikonin të rrëthuarit me ndonjë bombardë që drejtohej mu matanë, prandaj gjithnjë endej kaluar andej e këtej duke vërejtur me vëmendje pozicionin e qytetit dhe të gjitha vendet e tjera aty afër.

Pastaj andej nga mesdita u fut si të thuash tinëz në shatorren e vet me një pakicë kalorësish. Shatorren e tij, që ishte me të vërtetë e madhe dhe krejt e blertë, e kishin ngulur te një vreshtë që ishte larg qytetit rrëth një mijë hapa. Ngjitur me të ishin dy shaforre të tjera të bardha si bora, të mbrojtura mirë me avlli e me stom në mënyrë që të mos pësonin gjë nga artileria tokësore.

Menjëherë pashai, me qëllim që t'u jepte zemër ushtarëve, u premtoi një çmim të mirë atyre që do të merrnin guxminin të ngjiteshin deri te ledhet kaluar. Edhe të nesërmendy kalorës shumë të stërvitur u hipën kuajve dhe u ngjiten lart andej nga është dera kryesore edhe bënë çmos që të preknin me duar ledhet e qytetit. Mirëpo të krishterët ua vunë syrin mirë edhe njërin e mbytën me gurë e me shigjeta me gjithë kalin e tij, ndërsa tjetrin e hodhën rrokull e poshtë me çfarë patën ndër duar; atij për pak sa s'i kishte dalë shpirti dhe me të vërtetë s'kaluan pak çaste dhe vdiq. Aty për aty disa nga djelmoshat tanë, shumë më të fortë, u flakën jashtë edhe ia prenë kokën atij që kishtë vdekur përpara, pastaj e ngulën në nji heshtë dhe u futën në qytet plot entuziazëm. Mirëpo, meqenëse ende s'kishin arritur të gjithë taboret aziatikë, gjatë gjithë asaj kohe gjithnjë ziente nga turmat e mëdha të barbarëve rruga pranë lumit, e cila shpie në qytet dhe ku-

rrë s'pushonte ajo lëvizje, se vazhdimisht vinin reparte të reja me kuaj, kafshë të tjera e streme drejt ndër shatorre. Më pesëmbëdhjetë qershori arriti edhe një numër i madh njerëzish nga garda e sultanimit, që në gjuhën e vendit i quajnë jeniçerë⁸²⁾. Këta burra thuajse të gjithë janë të krishterë dhe u janë marrë me pahir prindërve të tyre. Duhet ditur se të gjitha ato qytete e krahina të krishtera që ndodhen nën zotërimin e Perandorisë Otomane, përveç që duhet të paguajnë një tribut shumë të rëndë edhe gjëra të tjera që u rrëmbejn turku, për më tepër detyrohen të jadin vit për vit edhe një sasi djemsh në moshë të vogël, të cilët otomani i shpie në Andoll dhe atje ata rriten së bashku dhe stërviten ndër armë prej instruktorësh të ndryshëm deri në një moshë pak a shumë të pjekur. Atje ata vazhdimisht stërviten me ushtrime të ndryshme sidomos në punë ushtarake dhe s'kanë asnjë orë pushim, por detyrohen të përballojnë çdo vështirësi e mundim, të cilat thuajse janë të padurueshme; i detyrojnë të flenë edhe jashtë, me qëllim që të mësohen me çdo vuajtje.

Mbasi stërviten mirë dhe arrijnë moshën e duhur, atëherë i thërret sultani edhe për tre vjet me radhë i vë ndër sprova edhe më të rënda e më të vështira pa i lënë aspak në qetësi, megjithëse janë të këputur fare. I lë të flenë sa më pak, edhe atë pak gjumë duhet ta bëjnë jashtë; ndonjëherë i lë pa fjetur me net e net. Mbasi kalon periudha e tre vjetve, sultani i fut në gardën e vet (ose, si i thotë populli, në familje) dhe secilit i cakton një pagë ditore, duke ia shtuar pastaj mëditjen sipas meritave të tyre. Ata quhen edhe djemtë e të madhit sultani dhe gjithnjë i rrinë afér atij si një ledh, si mbrojtje; kudo i shkojnë atij prapa.

Në këta burra mbështetet e gjithë shpresë, i gjithë sigurimi; në trimërinë e tyre mbështetet interesë i lartë i otomanit. Edhe me të vërtetë, kur sultani niset për luftë, ata i qëndrojnë pranë dhe kurrë nuk largohen prej tij, gjithnjë e ruajnë dhe i bëjnë kurorë si një mur mbrojtjeje. Kur arrin puna deri në një pikë të tillë saqë ata duhet të veprojnë, atëherë do të thotë se (si i thonë me fjalën popullore) ka mbërritur thika në kockë, d.m.th. gjendja është shumë kritike. Edhe janë luftëtarë të rreptë e trima të fortë; në çdo rrezik e ngushticë janë besnikë të mëdhenj. Pa iu trembur aspak syri, vënë jetën e vet në rrezik, sepse janë rritur e stërvitur gjithnjë nën armë, janë mësuar të durojnë çdo vështirësi e mundim (kjo, natyrisht, vjen nga stërvitja e gjatë dhe e pareshtur). Po të jetë puna për të sulmuar ndonjë qytet, janë të parët që vërsulen mbi të, u ngjiten ledheve dhe e pushtojnë. Çdo

aksiōn që kryhet me trimëri e në mënyrë të shkëlqyer, merrat me mend se është kryer vetëm prej tyre.

* Nga këta burra, pra, kishin ardhur rrëth pesë mijë veta, me katër flamuj të bardhë si bora; dhe kur arritën ata, c'duartrokitje e ç'brohoritje shpërthyen nga ana e barbarëve andej e këtej nëpër shatorre; gjëzimi i tyre qe i pamasë dhe tashti të gjithë vështronin se kur po arrinte sulltani. Ndërkohë barbarët gjithnjë i këshillonin të rrëthuarit dhe kërkonin t'i bindnin që të hynin në marrëveshje e të bëhej paqja.

Më trembëdhjetë korrik arriti ndër shatorre një fuqi e madhe barbarësh nëpër rrugën e Drinit; kaloi urën dhe zuri vend matanë Bunës, në disa fshatra e livadhe që vendësít i quajnë Oblikë. Tashti nja dy veta prej atyre barbarëve që arritën të fundit, erdhën, të shoqëruar prej disa vetash, deri në sheshin e tregut, që ndodhet te rrëzat e kështjellës. Këta të dy, që thoshin për veten e vet se ishin njerëz me autoritet të lartë e me rëndësi të madhe dhe nderoheshin nga të gjithë, kërkuan një takim me të rrëthuarit, duke deklaruar se ishin të ngarkuar t'u drejtonin komandantit të kështjellës dhe qytetarëve të tjerë disa fjalë nga ana e sulltanit. Mbasi atyre iu dha leja për t'u takuar e për të folur me të rrëthuarit, më i madhi në moshë mbajti këtë bisedë të shkurtër.

«O burra qytetarë, çdo kombi e rangu qofshi, sulltani ynë na urdhëron t'ju themi sa vijon: Ju po e shihni mirë se sa ngushtë keni rënë e se c'irreziqe ju kërcënohen. Vuajtje e rreziqe shumë më të mëdha e më të rënda ju presim, po nuk e shikuat me kujdes e sa më shpejt gjendjen tuaj. Ju keni dëgjuar edhe më përpara se ç'forcë e çfarë potencial luftarak ka sulltani. Por tashti ju, nga vetë realiteti, do të shihni se sa e tmerrshme dhe e hatashme është ardhja e tij. Veç asaj ju e dini se në çdo fushatë që ka marrë përsipër ai, askush s'ka pasur mundësi t'i bëjë ballë fuqisë së tij në asnjë mënyrë, sado që ai vend mund të ketë qenë i fortifikuar e thuajse i pathyeshëm.

Këtë e dëshmon përpara gjithë botës qyteti i madhërishëm e mbretëror i Konstantinopolit; këtë e dëshmon ishulli i Eubesë,⁸³⁾ aq i pasur e i shkëlqyer, ashtu edhe krahina taurike e shumë e shumë vende të tjera. Prandaj sulltani ynë ju këshillon që t'i dorëzoheni sa më parë ashtu sikurse vepruan krutanët, të cilët iu bindën sulltanit tonë dhe i ranë në dorë pak ditë më përpara, edhe mos pritni që t'ju kapë zemërimi e mllefi i tij, mos pritni që t'ju qëllojnë goditjet e artilerisë dhe të mjeteve të tjera luftarake, turri e fuqia e ushtrisë së tij, së cilës nuk do të keni mundësi t'i shpëtoni në

lartë dhe nga të katër anët bie thikë; rreth e përqark ka fusha të mëdha: në ato fusha luftoi Cezari kundër Pompeut⁸⁴). Kjo kështjellë nuk mund të sulmohet, as mund të shtihet në dorë në asnje mënyrë, sepse në çdo anë e ka fortifikuar natyra dhe dora e njeriut me mjeshtëri të madhe. Aty ka kroje të begatshme e të pashtershme, bile emrin e ka marrë pikërisht prej këtyre, sepse në gjuhën shqipe krua d.m.th. burim. Fushat i ka shumë pjellore e të bukura, po edhe pyjet (sipas mendimit tim) i ka më të hijshme e më të frytshme se në çdo vend tjetër; drurët e atyre pyjeve (sikurse thonë disa) askund nuk i gjen më të gjatë e më të përshtatur për ndërtimin e anijeve. Kruja gjendet larg Durrësit katërmëdhjetë milje e larg Shkodrës pesëdhjetë e shtatë milje dhe, meqenëse ky qytet ishte pranë kufijve të turqve, këta, mba-si vdiq i pathyeshmi princ, Skënderbeu, që e kishte në zotërim, zunë ta ngitnin vazhdimi. Sa qe gjallë Skënderbeu, dy sulltanë u përpoqën ta rrethonin Krujën me sa fuqi patën, por u shkoi mundimi kot, sepse Skënderbeu u bëri ballë me trimëri jashtëzakonisht të madhe e që prej asaj kohe, sa qe gjallë Skënderbeu, s'guxoi asnje ushtri turke të hynte në Shqipëri dhé (si të them) ta pushtonte. Më parë Krujën e pati sulmuar me të gjitha ushtritë e veta Murati, i ati i Mehmetit, e, meqenëse nuk i doli kurssesi ta shtinte në dorë, nga zemërimi e mllefi i fortë vdiq.

Pastaj Mehmeti, të cilil s'ka pak kohë që iu dorëzua Kruja, u orvat ta rrethonte me pahisore⁸⁵) në të katër anët këtë qytet, mirëpo nëasnje mënyrë s'mundi ta shtinte në dorë. Qytetin e fortë të Krujës e pati themeluar njëfarë Karl Sofia⁸⁶), princ i Shqipërisë, edhe në fillim e pati rrethuar me pahisore e me trina e pastaj me mure shumë të forta. S'kaloi shumë kohë dhe Karli u vra prej Balshajve⁸⁷), për të cilët folëm më lart. Balshajt asokohe kishin në zotërim Shkodrën e thuajse krejt Shqipërinë, pastaj morën edhe Krujën. Nga të tre vëllezërit dy më të mëdhenjtë vdiqën dhe mbeti gjallë më i vogli me moshë, Balsha, që përmendëm më përpara. Kur turqit u vërsulën për herën e parë mbi Maqedoni e mbi Shqipëri, Balsha, njeri me karakter të fortë, ende nuk e kishte grumbulluar të gjithë ushtrinë e vet dhe, meqenëse nuk ishte aq i vaditur për luftë, nuk i kishte siguruar trupat ushtarake me rezervat e duhura, as kalorësinë s'e kishte radhitur mu aty ku duhej, por, si të thuash, pa farë kujdesi e me mendje vërdallë ishte vërsulur mbi arnikun me ngut e pështjellueshmë, ndonëse me rreptësi; mirëpo kishte rënë në një pusi e, nësa kishte marrë të ikte, e kishin vrarë. Pas vdekjes

së tij barbarët shtinë në dorë Krujën dhe Beratin, që i përket Shqipërisë, ashtu edhe Kastorian. Mirëpo Kruja nuk qëndroi shumë kohë nën Perandorinë Turke, sepse ai burri fisnik e shpirtmadh, princi i shqiptarëve, Skënderbeu, e çlroi me trimëri nga tirania e turqve në kohën e sulltan Muratit dhe e mbajti pér njëzet e pesë vjet. E, kur u plak, nga frika se mos binte edhe një herë ai qytet nën zgjedhën e turqve, ia dorëzoi vullnetarisht princt të venecianëve. Por tashti le të kthehem tek argumenti ynë.

Ditë pér ditë nga lijeni, që është përbri Shkodrës e përtë cilin folëm, vini me lundra e barka në shumicë shqiptarët që banonin rrëth e përqark atij lijeni e, duke kaluar nëpër Bunë, suleshin si rrufeja mbi shatorret e barbarëve dhe bënin kërdi duke u shkaktuar dëme të mëdha. Disa i vritnin, disa i zinin robër dhe u merrnin kuaj e plaçka të tjera. Edhe kjo ndodhje vazhdimisht, po sidomos natën armiku hante prej tyre grushte më të forta. Kjo punë barbarëve u têrhoqi vëmendjen dhe, me qëllim që t'i përballonin këto sulme, vendosën të ndërtojnë disa gale, me të cilat, mbasi i kryen së punuari në atë vendin afër qytetit, që e quajnë Katilinë, dilnin në lijen dhe dita-ditës përllesheshin me të krishterët; pra në këtë mënyrë barbarët mbronin shatorret e tyre nga sulmet e të krishterëve. Më njëzet qershori turqit ndërtuan në majën e Kodrës së Pashës një kështjellë të drunjëtë në trajtën e një teatri, ku hipnin mjeshtrit e makinave pér të vërejtur qytetin nga të gjitha anët dhe pér të parë se cili pozicion ishte më i përshtatshëm pér t'u rrahur me artileri e me mjete të tjera dhe cila anë e ledheve duhej rrafshuar përdhe. Të nesërmen ndërtuan jo shumë larg kështjellës katër pirgje gati si në trajtë arkash, të lidhura mirë me trarë, edhe i mbushën me gurë të mëdhenj me qëllim që artileritë dhe makinat e tjera, që i kishin vendosur ndërmjet tyre, po ashtu edhe specialistët të siguroheshin mirë dhe të mos pësonin gjë nga goditjet e artilerisë së të rrethuarve. Ndërmjet këtyre pirgjeve, pra, kishin vendosur artilerinë; u kishin vënë edhe kapakë me qëllim që të mund të hapeshin e të myllëshin simbas nevojës. Po ato ditë arritën ndër shatorre rrëth dhjetë mijë deve të ngarkuara me municione dhe me plaçka të tjera, të cilat u shkarkuan matanë Kodrës së Pashës, afër përroit që quhet Kir. Më njëzet e dy qershori barbarët instaluan ndërmjet atyre pirgjeve dy bombarda shumë të mëdha pér të shembur ledhet; njëra hidhë gurin që peshonte katërqind libra e tjetra gurin treqind librash⁸⁸) e atë ditë me atë artileri shtinë vetëm shtatë herë. Me të shtënën e parë

i ranë rrëzës së pиргут që ishte ngritur te dera e madhe përmbrojtjen e ledheve. Me të dytën qëlluan një vendrojë mu përbëti derën e lartpërmendor ku rrinin rojat natën. Të nesërmen në mëngjes arritën në shatorre rrëth gjashtë mijë azapë, të cilët sillnin me vete gjithfarë dengjesh. Azapët janë ushtarë mjafët të aftë e të vaditur për luftë; mbas jeniçerëve ata zënë vendin e dytë. Veshjen e kanë të ndryshme; jeniçerët fesin e kanë të kuq, ndërsa azapët të bardhë, po megjithatë të dy palët i përfshin këmbësoria. Mu atë ditë barbarët shtinë prapë me artileri dhe i tundën mirë ledhet e qytetit; të nesërmen shtinë tetë herë dhe të pasnesërmen shtatë herë, po fundi vetëm me dy të shtëna arritën t'i dëmtonin ledhet. Më njëzet e gjashtë qershori barbarët vendosën në fushë, rrëzë Kodrës së Pashës, artilerinë e tretë për të shembur ledhet e qytetit, mu mbi rrugën që të shpie në Drisht; ai top e hidhte gurin katérqind librash; me të ata rrahën ledhet njëzet e nëntë herë. Njëkohësisht arritën edhe nga dy mijë azapë të tjerë në shatorre nëpër rrugën e Drinit duke sjellë me vete dengje me shumicë dhe gjithfarësh. Të nesërmen shtinë me artileri njëzet e tetë herë; mbas një dite edhe njëzet e gjashtë të tjera. Ndërkaoq gjithnjë po vinin azapë turma-turma, po nëpër atë rrugë. Njëkohësisht thuajse në mes të Kodrës së Pashës aty përballë qytetit përbëti kishën e Shna Premtes vunë edhe topin e katërt. Ai top i hidhte gurët me një peshë prej gjashtëqind e pesëdhjetë librash, por me të atë ditë nuk shtinë asnjëherë. Mirëpo më një korrik me atë top i gjuajtën ledhet tridhjetë e katër herë. Nga mbrëmja e asaj dite erdhën aty në shatorre prej lumit të Drinit rrëth tetëqind streme; kishte arritur edhe i madhi sulltan Mehmeti me trupat e tjera ushtarake e me të gjitha pajimet e veta madhështore. I dolën përpëra plot gëzim e madhështi pashai i Rumelisë dhe pashai i Anadolit.

Më dy korrik, përpëra se të perëndonte dielli, sulltani, i shoqëruar nga kalorësit e vet të zgjedhur e të veshur përbukuri, u drejtua në vendin ku kishin ngritur shatorren. Thonë se sulltani, kur paska parë pozicionin e qytetit dhe mbasi paska vërejtur mirë nga çdo anë fushat përreth, e paska lavdëruar Shkodrën sa s'bëhet dhe paska thënë: «Oh, se q'vend të shkëlqyer dhe të lartë paska zgjedhur shqiponja për vete dhe përfolenë e zogjve të vet.»

Vendi ku ishte ngritur shatorja e sulltanit, paraqitej në këtë mënyrë. Aty në shesh kishin ngritur nëntë shatorre vetëm për sulltanin; ajo më e madhja quhej shatorja e këshillit; pastaj vazhdonin me radhë shatorret e tjera larg njëra-

-tjetrës sa hedh një shigjetë dhe ishin rrrethuar e mbrojtur mirë me një pahisore jashtëzakonisht të fortë; rrreth e përqark në trajtë kurore qëndronin jeniçerët të rrasur njëri pas tjetrit. Edhe në të vërtetë ai vend quhej rrrethi dhe klauzura e sulltanit dhe kishte një rrreth më tepër se dy miljesh. Kishte vetëm një dalje apo një derë; aty natë e ditë rrinin në rojë ushtarë ku ishin më trimat dhe, përpala se të arrihej mu aty ku gjendej sulltani, duhej kaluar nëpër tri radhë rojash, e çfarë rojash! Pastaj pjesa tjetër e ushtrisë turke ishte përhapur përqark në të katër anët jashtë rrrethit dhe klauzurës së sulltanit dhe zinte gjithë atë vend, saqë të gjitha fushat e kodrat ndoshta për nja dyzet milje dukeshin të bardha nga çdo anë plot me shatorre, tamam si në dimër kur mbarë toka vishet në të bardhë prej bore.

Nuk të zinte syri një vend sado të ngushtë ndërmjet shatorreve, aq ishin ngjitur me njëra-tjetren e ndërkaq për disa ditë gjithnjë vazhdonin të vinin reparte të freskëta ushtarake. Sipas mendimit të disa njerëzve me kompetencë dhe të atyre që edhe herë të tjera kishin shërbyer në ushtrinë e sulltanit, në rrrethimin e Shkodrës mund të kenë marrë pjesë nga treqind e pesëdhjetë mijë veta. E gjithë ajo mori njerëzish u tërhoqi vëmendjen të krishterëve besnikë, të cilët hipën mbi ledhe e mbi stom për të parë. Në një vëzhgim të parë u tmerruan e u turbulluan mjaft kur u ranë në sy gjithë ata barbarë të pashpirt, që ishin grumbulluar atje poshtë për të zezë të shkodranëve.

Por, duke marrë parasysh se ishte puna për të shpëtuar të gjithë sa ishin e se do të dilnin fitimtarë ose do të vdisnin, u mblohdhën në kuvend te kisha e Zonjës së Papërlyer të gjithë italianët, shqiptarët e marinaret, me qëllim që të merrnin zemër e të përgatiteshin për një qëndresë heroike. Atëherë u ngrit një shqiptar, fra Bartolomeu, i ardhrit të predikatarëve, njohës i thellë i teologjisë, burrë i mirë e me autoritet të lartë, gojëtar e i pashëm, burrë oxhaku, që dikur, sa ishte pa hyrë në urdhrin e shenjtë, ishte treguar trim e i zoti nën udhëheqjen e të madhit Skënderbej në luftë kundër turqve e prandaj njihte fare mirë jetën, zakonet dhe punët e tyre e pastaj edhe në Itali kishte fituar nam të madh nën udhëheqjen e disa kapidanëve të përmendor e në fund, i frymëzuar nga shpirti i shenjtë dhe i ndritur nga drita hyjnore, kishte braktisur jetën laike dhe i ishte kushtuar jetës fetare; ai, pra, mbajti këtë bisedë: «Burra të fortë e shokë trima! Ata që synojnë t'ia arrijnë lavdisë së vërtetë, duhet të kenë durim e të përballojnë çdo vështirësi, çdo rrezik e mun-

dim, ku tē jenë më tē rëndat, sepse vetëm në këtë mënyrë duhet tē shkëlqejnë pérherë e më tepër e tē spikatin virthytet me tē cilat njerëzit ngrihen lart e më lart. Burrat e ditur kanë thënë se punët e mëdha kryhen me punë tē pareshtur e me zell e se djersa e mundimi e kanë frytin e vet tē merituar. Secili prej nesh duhet tē bindet se ne këtu jemi mbledhur me vullnet tē perëndisë, me qëllim që ky qyteti ynë, me ndihmën e zotit, tē mbrohet e tē ruhet nga tirania e mizoria e tē gjithë këtyre barbarëve me trimërinë tuaj tē lavdishme dhe tē mos dëmtohet feja jonë e vërtetë, por tē arrijë kulmin e shkëlgimit dhe me qëllim që ky tiran i poshtër e i pashpirt ta provojë në fund me fakte se vetëm feja e krishterë është feja e vërtetë dhe e sigurt e se Krishti, zoti ynë, që ne e nderojmë dhe e adhurojmë, është i vetmi zoti ynë, krijues e rregullues i gjithësisë, pér hir tē tē cilit çdo gjë mbahet në botë dhe bie menjëherë pushteti përdhunues i çdo tirani e çdo fuqi, cilado qoftë, rrrokulliset e shembet në çast.

Edhe tē mos ia mbushë mendjen vetes ky tiran i poshtër e i pashpirtë se, mbasi ka pushtuar e ka plaçkitur sa mbretëri e perandori, sa qytete e shtete, po është i zoti tashiti tē na rrëmbejë duarsh edhe këtë qytetin tonë o me forcë, o me dredhi ose me panik. E unë kujtoj se tē gjithë sa jeni këtu e dini mirë, o shokë lufte, se ky tiran dinak e i poshtër asnjë vend tē fortifikuar tē krishterësh s'ka pushtuar me armë, por gjithmonë vetëm me dredhi e me tradhti ose me marrëveshje, me premtime e me besë, tē cilat pastaj s'i ka mbajtur aspak, sikurse dihet nga tē gjithë. Kujtoni, vallë, ju, o shkodranë, se, po tē dorëzoheni, do t'ju falë ai? Thoni ju se s'do t'ju prekë as me pupël otomani i pashpirt, që ka ngrënë sa grushte e tallje prej jush? A s'ju kujtohet se katër vjet përpëra, kur ai ju shpalli luftë, ju bëtë kërdi ndér mijëra e mijëra ushtarë tē tij? Si thoni ju? Do t'jua falë ai gjithë atë gjak? Do t'ju lëshojë tē ikni lirisht pa pësuar asgjë? Sigurisht që jo. Do ta bëjë copë-copë mishin tuaj ashtu si bën kasapi me dhentë në thertore; ai do tē shqyejë gjymtyrët tuaja. A nuk i myti në mënyrën më barbare fqinjët tanë, krutanët, tē cilët s'ka dy ditë⁸⁹⁾ që u dorëzuan, mbasi ai u kishte premtuar se s'do t'i prekte aspak e se do t'i linte tē iknin shëndoшë e mirë? Po atje në Myzi (siç thonë) a nuk ia prieu gurmazin një mbreti vetë Mehmeti me dorë tē vet, që s'ngopet kurrë me gjak njerëzish? Edhe ai mbret i ishte dorëzuar në besë Mehmetit bashkë me tē ungjin. Po princave rashianë⁹⁰⁾ a nuk ua nxori sytë?

E kur u dorëzua qyteti i Theodozizë, që sot quhet Kafa

që gjendet në bregun taurik, sa të krishterë i preu në besë e i vrua! Sa burra i nguli ndër hunj atje në Lesb! Po ç'të them pastaj për sa e sa të tjerë që ka vrarë e prerë mizorish, ndonëse në moshë të njomë e gjithmonë duke i prerë edhe në besë? Unë do të zgjatesha shumë, po të doja t'i numëroja mizoritë e tij. Mirëpo ne s'kemi përsë të çuditemi për këtë, o shokë, sepse askush nuk mund t'i japë tjetrit atë që s'ka vetë. Pra, derisa ky njeri gjithmonë ka qenë i pabesë, si mund t'ia mbante besën tjetërkujt? Shto pastaj, veç kësaj, edhe vese të tjera, si shfrenimin e tij, mendjemadhësinë e tij; ai (sic thonë) që në moshën më të vogël i mori këto vese, u bë i pashpirt, i pafytyrë, i pafre, me një fjalë i poshtër në çdo pikëpamje.

Tashfi a mund të besohet se një shpirt kaq mizor e i ndyrë të heqë dorë në pleqëri prej të gjitha këtyre të zezave, që prej natyre lindin në gjak qysh në moshën më të njomë? Edhe askujt s'i shkon mendja të thotë se ai me drejtësi është bërë zot i çdo gjëje, kur të merret parasysh se brenda një kohe aq të shkurtër ai ka krijuar një perandori kaq të madhe. Dhe me të vërtetë ai çdo gjë përvetësoi në mënyrë të padrejtë e të palejueshme e me përbuzje fëlliqi çdo gjë hyjnore e njerëzore, gjithmonë veproi me dredhi, me të pabesë e me epsh të keq. Çfarë poshtërsish s'ka bërë ai njeri: çdo fëlligshi; ai ka çnderuar, ai ka thyer kurorë. Ai ka dhunuar kishë, ka hequr të gjithë meshtarët, ka ngatëruar urdhra, ka përlyer mbretëri e gjithnjë është orvatur të ngatërhojë e të shuajë çdo gjë religjoze, të madhërishme e të ndershme, a ligjet a kanunet e jetës, a zakone a besë e nder apo çdo disiplinë të drejtë.

Ja, pra, kjo është arsyaja për të cilën duhet të hapim sytë e të ruhemë mirë nga pusitë e këtij farë tirani. T'i mbyllim pra, veshët tanë përpëra miklimeve të tij e të mos tunëndemi aspak nga fjalët e kërcënimet e tij. Le t'i hedhim poshtë zotimet e tij, sepse në këtë botë s'ka burrë që mund t'ia dalë atij në poshtërsi, në paturpësi e në tirani. Dhe në të vërtetë ai zakonisht katolikëve a ka premtuar shumë gjëra vetëm sa për t'i shtënë ndër thonj, sepse asnjërit s'ia ka falur jetën, veçse ia ka pirë gjakun gjithmonë si bishë e egër. Por ç'nevojë të zgjatem me fjalë, kurse ju i dini të gjitha? Unë, ju them të drejtën, e kam moralin lart, derisa shoh se të gjithë digjemi nga dëshira për ta mbrojtur fenë katolike dhe, si trima të fortë e të papërkulur që jemi, kemi shpresë të plotë se do të dalim ngadhënjyes mbi armikun. Veç asaj, duke parë qëndresën dhe dëshirën tuaj për të vdekur qoftë

edhe një mijë herë (po të jetë nevoja) për fenë e vërtetë dhe për zotërimin e Venedikut, unë kënaqem, marr zemër e qëndroj sykokërr, sepse ndër ju shoh bashkim e aspak përcarje, shoh se të gjithë jeni një mendjeje e një zemre, të gjithë i jeni përveshur punës me zell edhe derdhni djersë natë e ditë, pa pushim. E, ajo që ka më rëndësi, është fakti se të gjithë jeni dhënë me mish e me shpirt sidomos pas fesë, të gjithë e nderoni dhe e adhuroni të madhin zot me besimin dhe me përshpirtërinë tuaj, e zoti besnikët e vet i përkrah e i ruan pérherë. Po atëherë pse të trembemi? Ç'është që na bën të dyshojmë? Kush do të dalë kundër nesh? Kush do të guxojë të përlleshet me ne kur kemi ndihmën hyjnore? Le të vijë pra sulltan Mehmeti, që thonë se ka bërë punë të madhe me ata spaolanët⁹¹⁾ e vet, me karasarët, me angurët, me pollujt, me kutagët, me mentelët, me sarhanët, me aidinët, me karailët, me pigët, me pruzët, me makrinët, me alagët, me amazët, me koncelët, me menesenët e me giagidët. Le të vijnë edhe karamanët, ndihmësit dhe aleatët e tij. Le të vijnë arkatinogelët, kandelorët dhe të gjithë aziatikët. Le të vijnë gjithashtu edhe turknanbejtë, auranët, kastorët, serrët, konstaninët, sofitet, nikopolejt, zaharijejt, zermajt, zurrullët, kaliopolejt, sfirkët, shkupjanët, kojanxhinjtë, garipidët, salvatarët e magullidët. Le të vijë pastaj vetë Otomani me të gjithë suitën e vet, me silahtarët e vet, me olofanzët, me muselinët, me azapët, me mihiët, me kariplitlerët, me doganxhinjtë, me akinxhinjtë, mejenicerët e me gjithë atë mori njerëzish që ka. Le të vijnë edhe të dy pashallarët, ai i Rumlisë dhe ai i Anadollit, me të tërë taborët e repartet e veta. Po, fundi, le të vijnë të tërë barbarët, që shërbejnë në ushtrinë e të fuqishmit Mehmet, në ushtrinë e tiranit më mizor e më mendjemadh që ka parë bota. Le të vijnë e të lehin rrëth e përqark ledheve të qytetit tonë, le të bërtasin sa të duan e të sulen mbi ne me të gjitha armët e mjetet luftarake që disponojnë, sikurse e kanë pasur zakon kurdoherë; le të na gjuajnjë me çfarëdo predhash që zotërojnë, le të na qëllojnë nga të katër anët me një breshëri shigjetash; po, fundi, le të përdorin të gjitha instrumentet dhe mjetet luftarake, që ka shpikur e mund të shpikë tashti kjo epoka jonë.

Ç'na interesojnë neve? Ne të gjitha do t'i durojmë, do t'i përballojmë e të gjitha në fund do t'i kapërcejmë edhe do të dalim fitues, sepse bashkë me ne është fuqia e perëndisë. Vetë zoti na mban dorën mbi krye. Po kush e theu dhe e shpartalloi një Faraon⁹²⁾, njeriu më të fuqishëm e më mizor në botë, përvëçse dora e zotit? Kush e çlroi popullin e

Izraelit nga robëria e Egjiptit? Kush i vau djemtë e parë të popullit të Faraonit? Kush e ndau dysh Detin e Kuq? Kush është shtriu përdhe Olofernин, atë kapidanin e madh të Nabukodonozorit? Kush e çlroi popullin, që për pak ishte duke rënë në robëri, përvçese vetë zoti, atëherë kur Judita mbyti Olofernин dhe i shkurtoi kokën? Ai zot, si i mëshirshëm që është, libroi nga thonjtë e mbret Asuerit popullin e vet të zgjedhur, që kishte qenë dënuar me vdekje, kur ai i pashpirti Oman me çdo mënyrë e mjet ishte përpjekur t'ia merrte shpirtin. Ai zot e liroi patriarkun e madh, Abrahamin, nga duart e kaldejve, ashtu edhe Isakun nga fljimi i babait. Liroi Jakobin nga salvimi i vëllait Hesau e Jozefin nga pusia e vëllezërve të tij, Noenë nga përmbytja, Lothin nga shkatërrimi i sodomitëve, Saulin në malin Gelboe, Davidin nga shtypja e Saulit dhe të gjigantit Goli; të tre fëmijët: Librahun, Misahun dhe Abdenagun nga zjarri, Jonën nga barku i peshkut, Adamin nga fundi i ferrit, Pjetrin nga uji, Palin nga prangat e nga burgu. Po unë pse t'ju përmend sa e sa të tjerë, të cilët vetë zoti me pushtetin e vet të lartë i mbrojti e i shpëtoi? Thirreni në ndihmë, pra, o burra, atë zot e ta nderoni me urtësi e pastërti të shpirtit, përvuajtërisht t'i luteni e t'i imbështeteni atij zoti, kushtojuni atij me gjithë mend e zemër, sepse ai do të luftojë për të mirën tonë e do të na mbrojë ne dhe qytetin tonë kundër mizorisë së atij tiranë aq të fëlliqur e të poshtër. Thotë shkrimi i shenjtë: «Në qoftë se perëndia vetë s'e ruan qytetin, kot vëzhgojnë ata që bëjnë rojë në atë qytet.» Këndojini lavde perëndisë dhe lutjuni, se me lutje shlyhen mëkatet e pakësohen ndëshkimet, se lutja shpon qiellin, sjell ndihmën hyjnore dhe armikun e djeg dhe e pjek. Çdo gjë, o burra, që t'i kërkoni me lutje të madhit zot, pa farë dyshimi ju do ta keni, sepse është e pamundur që lutjet e drejta të mbeten pa fryt; me uratë nxjerr çfarë kërkon. Po kush tjetër e shpëtoi Albën greke, që tanët e quajnë Berat, prej thonjve të këtij tirani kaq mizor e të pashpirt përvçese lutja?

Kush e liroi Danielin prej gropës së luanëve? Po Suzannë prej një akuze të rrëme, përvçese lutja? Punë më të madhe kreu Moisiu me anën e lutjeve sesa Josuei me luftë, sepse lexohet për Moisiun se kur ky, gjatë luftës kundër malekitëve, lutej, Izraeli fitonte e, kur pushonte së luturi, populli i Izraelit humbë.

Po ai perandor, Teodozi plak, a nuk doli ngadhënjyes kundër Eugjenit e Arbogastit⁹³⁾ me anën e lutjeve, kur përmrekulli një erë shumë e fortë i ktheu shigjetat dhe armët

e armiqve mu kundër tyre dhe shigjetat e Teodozit vërvite-shin mbi armiq shumë më me forcë sesa mund t'i flakë fuqia e njeriut? Prandaj, o të krishterë shumë besnikë, lutuni me gjithë shpirt dhe kushtojuni krejt zotit tonë shpëtimtar, në lutje të mbështetni shpresën tuaj. Rrëfeni mëkatet tuaja, merrni kungimin sa më me dëshirë e nderim që të jetë e mundur. Edhe ju, o meshtarë të urtë, lutjuni të madhit zot me sa fuqi që keni dhe mos pushoni duke i kënduar lavde natë e ditë në mënyrë që populli i krishterë të korrë një fitore lavdiplotë mbi armikun barbar. Të gjithë sa jeni, o besnikë të dashur, të keni besim në perëndinë, mbrojtësen tonë, sepse, kushdo që ka shpresuar në të, nuk është gënjiyer; t'i mbështeteni asaj, sepse ajo nuk do të lejojë kurrë e kurrë që ne të shuhemi fare, por do të na shpëtojë nga të gjitha rreziqet.

Neve na është ngarkuar barra që të mbrojmë fenë katolike edhe të gjithë krishterimin, pra mjafton kjo pér të na nxitur që të derdhim gjakun tonë deri në pikën e fundit. Mos ju duket ndoshta punë e vogël fakti se pikërisht nga ky sulm i armikut varet shpëtimi ose shkatërrimi i mbarë republikës së krishterë? Ruhuni, pra, prej dredhive, prej gjënjeshtrave e ngatërrresave të barbarit, sepse në këtë drejtim ai tregohet shumë i hollë. Derdhni të gjithë mundimin e djersën tuaj edhe forcojeni mirë qytetin tuaj me roja, me stome e me fortifikime të tjera; natë-ditë bëjini sytë katër, sepse, thotë shkrimi i shenjtë: Ata që rrinë të gatshëm, fitojnë palmë, nder e çmim. Po unë pse flas në këtë mënyrë? Po pse t'ju ngas, derisa (si i thonë një fjale) shoh se ju keni marrë vrapin? Unë shoh fare mirë se ju vetë jeni dhënë me shpirt pér të përgatitur çdo gjë që kërkohet pér të mbrojtur qytetin tuaj në mënyrë që të mos preket nga dora e armikut. Ta mbajmë, pra, moralin tonë lart, sepse asgjë s'na mungon pér të korrur fitoren. Jemi të sigurt. Armë kemi, artileri kemi, munizione kemi edhe i kemi me shumicë. Këtu ndërmjet nesh s'ka shumë prej atyre që s'janë në gjendje të rrrokin armët; këtu s'kemi as gjellëtarë, as gra, as fëmijë, as të ngathët, as të papunë, që duan vetëm të dëfrejnë; këtu jemi të gjithë burra, të gatshëm pér të rrrokur armët, të stërvitur pér luftë. Edhe s'keni pse të mahniteni e të trembeni aspak nga e gjithë kjo mori barbarësh, sepse shumica prej tyre janë njerëz të ligj e të ngathët; ata më tepër janë mësuar të grabitin e të plaçkitin, sesa të luftojnë. Veç kësaj, ne jemi të mbrojtur mirë prej një kështjelle, që e ka fortifikuar aq fort vetë natyra përvëç dorës së njeriut, sepse kjo

kodër bie thikë tħua jse nga çdo anë dhe s'ka burrë që t'i ngjitet aq leħtē. Dhjetē veta nga tanet do tē kenē mundesi tē sprapsin fare leħtē një mijē veta nga ata që do tē sulmojnē, se armiqtē do ta kenē shumē tē vēshtirē tē ngjiten deri kētu lart; edhe sikur tē mos sprapseshin nga ne, ata do tē mberrinin rrēzē ledheve fare tē rraskapitür.

Prandaj, sa mē shumē armiq që tē vijnē tē na sulmojnē, aq mē kērdi do tē bējmē ne mbi ta duke i flakur rrrokoll nga majā e kēsaj kēshtjelle, sepse ne do tē jemi tē palodhur e plot energji. Ata që do tē sulmojnē tē parêt, do tē mbeten tē vrarē, asħtu edhe ata që do tē vijnē pas tyre; vetem ata tē fundit mezi do tē shpētojnē, bile njē pakicē prej tyre; ata do t'u mbathin kēmbēve me turp dhe do t'u kallin tmerrin atyre tē tjerēve që do tē hidhen nē sulm pas tyre. Prandaj sulmet e kota e boshe tē barbarit t'i pritni me plot kurajē e entuziazēm, ta vini nē tallje guximin e tij, se ai nē atē mēn yrē s'bēn tjetēr veçse i bie murit me kokē. Kjo do tē jetē pēr ju dafina e pērhershme, kjo do tē jetē dia-dema e shkēlqyer dhe e pavdekshme, kjo do tē jetē palma, ky do tē jetē ngadħenjimi juaj i vērtetē, dhe që sot si juve asħtu edhe Shkodrēs do t'i dalē nami nē tē katēr anet e dheut. Që sot tē gjithē popujt e tē gjitha kombet pēr hir tē trimērisē suaj me tē drejtē do ta quajnē Shkodrēn mburojē e shtyllē tē mbarē fesē sē vērtetē. E, pra, edhe ju, o Italianē, burra me fe e dituri, luftoni kundēr armikut trimērisht e me shkatħtēsi, asħtu si i ka hije madħerisē dhe bujarisē suaj, dhe t'ju bjerē nē mend se kjo eshtē kēshtjella, se kēto janē ledhet e Shēn-Markut; t'i mbroni, pra, me guxim. Edhe ju, o trimat e detit, burra tē fortē e tē paepur, ju që i jeni kushtuar krejt Krishtit, që gjithmonē e keni pasur pēr zakon t'i suleni barbarit, hidhuni mbi tē me atē rreptēsi që ju karakterizan, kallini tmerrin barbarit dhe ta vini pērpara.

Edhe ju, o qytetarē tē tjerē, bashkatħetarē tē mi, kato-likē shumē besnikē e tē qēndrueshem, mbrojeni trimērisht me hekur qytetin e atdheun tuaj, qoftē edhe duke derdhur gjakun deri nē pikēn e fundit. Kush eshtē ai që nuk e di se q'detyrē keni ndaj kētij qytet? Nē kētē qytet ju u lindet dhe thithēt njē ajer tē pērbashkēt. Mos harroni se sa tē mira patēt ju prej kētij qyteti.

Ky qytet ju siguroi ushqimin, ju rriti me nder e ju solli deri nē kētē moshē; ky qytet ju edukoi me ligje tē drejta, me zakone tē shkēlqyera e me parime mēsimore tē larta. Pērveç asaj, tē keni parasysh fort tē dashurit prindērit tuaj, gratē tuaja, fēmijēt tuaj, po fundi edhe pasuritē tuaja; edhe

adittom waraġġa tolana

aspak nuk duhet të ngurroni, por duhet të përballoni qdo rrezik, t'i shتروheni qdo sprove. Edhe, me qëllim që të mund t'i përbushim të gjitha dëshirat tonë, unë ju këshilloj me gjith zemër që më përpara të merrni nga një kryq të shenjtë dhe me atë ta armatosni gjoksin tuaj. Ta dini se me fuqinë e mrekullueshme të këtij kryqi ai Herakliu, perandor i Romës, doli triumfues kundër Kosdroes, mbretit të Persisë, që ishte armiku i tij më i madh; pikërisht për hir të këtij kryqi të pathyeshëm e të lavdishëm u thyen dyert e ferrit dhe shpëtoi mbarë njerëzimi. Ngrini flamujt me kryq mbi ledh, mbi fortifikime, mbi pirlje e kudo, sepse, për hir të këtij kryqi hyjnor e të dashur, të gjithë qytetarët do të jenë të sigurt e askush s'do t'i prekë, në qoftë se flamurtarët trima do t'i sjellin këta flamuj përpara jush. Gjithësaherë që do t'ju duhet të përlesheni me barbarin, do të keni mundësi t'ia nisni betejës pa pësuar asnjë dëm, me guxim do ta përballoni rrezikun e me kurajë e trimëri do ta zmbrapsni e do ta shtypni armikun për fenë e vërtetë, për liri, për shpëtimin tuaj dhe për sigurimin e qytetit tuaj, sidomos në turrin e parë të barbarit, që mund të dalë edhe i papritur, por pastaj në hovin e dytë menjëherë ai lodhet dhe krejt i rraskapitur ua mbath këmbëve. E çfarë lavdie, çfarë gëzimi e çfarë çmimesh të amshuara do të përgatiten për ata luftëtarët tanë, të cilët do të bien në sheshin e nderit duke luftuar aq bukur e trimërisht për fe! Të gjithë do të shkojnë në lumen e amshuar, në vendin e paqes, që s'tregohet me gojë; atje ku, të kurorëzuar me dafinën e martirizimit në prani të mbretit të amshuar do të gëzojnë për jetë të jetës, e këta dëshmorë të stolisur me petkun e pavdekshëm do të këndojnë me lavdi melodi qiellore e himne të embla atje në mes të radhëve të engjëjve e do të shikojnë armiqjtë e vet të torturuar e të copëtuar atje poshtë në humnerën e mjerimit të pasosur. E ata që për vullnet të Hyut do të mbeten gjallë, do të marrin nga Senati i Venedikut një shpërblim aq të madh për mundimin e vet, saqë s'do t'u mungojë asgjë përtat çuar jetën me nder e me të mira.

Pas këtyre fjalëve aq u treguan të gjithë të një mendjeje e një zemre, saqë aty për aty të gjithë sa ishin u betuan se ishin të gatshëm të bëheshin fli për fenë katolike dhe për shpëtimin e Republikës së Venedikut, se do t'i shkrinin të gjitha energjitet e veta pa u trembur aspak nga vdekja. Aty për aty të gjithë u përqafuan e u puthën me njëri-tjetrin. Pastaj me përkushtim e përshpirtëri morën kungimin, u shpërndanë nëpër kisha të ndryshme dhe u drejtuan lutje të

madhit zot, të gjithë shenjtorëve e sidomos shën Markut. Ndërkaq armiku vazhdante të bënte punën e vet dhe gjithnjë synonte të shembte ledhet, sepse që ditën e parë që erdhi sulltani, otomanët shtinë me top kundër qytetit tri-dhjetë e gjashtë herë. E, ndërsa po përgatitnin mjetet e tjera luftarake për të dérrmuar ledhet e për të lodhur të rrëthuarit, turqit të nesërmen e rrahën kështjellën me tridhjetë e pesë goditje të tjera. Pastaj, prapë të nesërmen, d.m.th. më pesë korrik barbarët instaluan buzë ledheve dy artileri të tjera; njérën e vunë andej nga lindja e qytetit buzë bregut të Dritnit, që bie rrëzë kështjellës; ajo artileri hidhte predha gjashqind librash. Artilerinë tjetër e vendosën mu në mes të Kodrës së Pashës nën kishën e shën Lazrit dhe ishte shumë e madhe, sepse e hidhte predhën me peshë një mijë e dyqind librash edhe e quanin «artileria e sulltanit», sepse e kishin ndërtuar, në emër të tij, me zell e me mjeshtëri shumë të madhe. Andaj barbarët, porsa filluan ta godisnin kështjellën në këtë ményrë, sikur deshën t'u kërcënohen të rrëthuarve duke u thënë: «Tashti pritni topin e sulltanit! Thuhej se vetë e shoqja e sulltanit kishte dérguar të hollat për ndërtimin e atij topi për shpëtimin e shpirtit të vet, sepse barbarët, sipas zakoneve e ligjeve të veta, janë të bindur se sa më mizorë që të tregohen kundrejt të krishterëve, aq më tepër u falen fajet e mëkatet. Që prej atij çasti filluan barbarët ta rrithnin kështjellën me artilerinë e rëndë. Ditën e parë shtinë dyzet e tri herë kundër ledheve; ditën e dytë dyzet e shtatë herë e njëkohësisht një shumicë e madhe turqish ngulën shatorret matanë Bunës. Të nesërmen mbrëma barbarët vendosën një artileri tjetër në Kodrën e Pashës; ai top i hidhte predhat rrëth pesëqind e pesëdhjetë librash. Po atë natë, aty afër muzgut, me një lloj topi tjetër, që e quajnë mortajë e që e kishin instaluar një ditë më përpara, zunë të hidhnin mbi shtëpi shtëllunga zjarri me qëllim që të merrte flakë qyteti; ndoshta shpresonin se, ndërsa qytetarë e ushtarë sidomos natën do të kishin synuar vetëm të fiknin zjarrin, pikërisht në atë orë ata vetë do t'i futeshin qytetit brenda edhe ta shtinin në dorë; atë natë hodhën shtëllunga zjarri vetëm katër herë. Ato shtëllunga që mezi shuheshin, ishin përbërë prej rrëshire, prej pise, squfuri, dylli, vaji dhe prej elementesh të tjera të këtij lloji, të cilat e ushqenin dhe e hapnin më tepër zjarrin dhe me të vërtetë, sapo binin mbi çatitë, menjëherë këto merrnin flakë. Këto shtëllunga e përshkonin ajrin me një fuqi e shpejtësi aq të madhe dhe me një fishkëllimë të tillë, saqë të jepnîn përshtypjen sikur

disa zéra së bashku bërtitnin deri në kupë të qiellet edhe linin pas një bisht të zjarrtë e të furishëm që dukej si yll me bisht. Nga i gjithë ai zjarr, që vinte së larti, gjithë natën qyteti lëshonte flakë e dritë. Ndërkaq të rrethuarit e gjetën pér bukuri mënyrën pér të mposhtur këto dredhi e manovratë barbarit. Si e diktuan, pra, qëllimin e tyre mashtrues, të rrethuarit (e aty në qytet asgjë s'bëhej pa vendimin e këshillit, që mblidhej në çdo rast rreziku) zgjodhën disa burra të fortë e të shkathët, të cilët u ngarkuan me detyrë që të zbulonin vetëm ato shtëpi që kishin pullaze druri e pastaj të rrinin të gatshëm që, porsa të binin shtëllungat e zjarrta mbi qytet, t'i shuanim me të parën. Edhe, meqenëse ata burra të zgjedhur këtë detyrë e kryen me shumë kujdes dhe me përpikëri të madhe, çdo mundim barbarëve u shkoi kot, pra bënë përpjekje të kota. Po atë ditë ata shtinë me top kundër ledheve të qytetit plot dyzet e dy herë. Të nesërmen, d.m.th. më 7 korrik, shtinë pesëdhjetë e gjashtë herë e njëkohësisht sollën edhe një artileri tjetër jashtëzakonisht të rendë mu rrëzë kodrës në veri të qytetit mbi kishën e shën Vlashit. Ai lloj topi, që sot e quajnë mortajë, hidhte lart në quell një gur të rrumbullakët një mijë e dyqind librash dhe ky gur binte me një vrull dhe me një fuqi aq të madhe, saqë të gjithë ata, që e kishin sigruar mbrojtjen e qytetit, prej asgjëje nuk trembeshin aq fort sesa prej atij guri, sepse kudo që ai përplasej, çdo gjë digjej e shkrumbohej e hapte tmerrsi zjarri ose tamam si kokrra e rrufesë që djeg e zhurit gjithçka dhe, po të binte mbi ndonjë shtëpi, e shembte kulm e themel e, po të binte në tokë, ngulej në dhe dymbëdhjetë pëllëmbë, ndërsa, po të përplasej mbi ndonjë shkëmb, ishte njësoj sikur të kishte rënë mbi një gjë të butë. Kjo epoka jonë mund të mburret pér një shpikje të tillë e, megjithëse shekujt e kaluar mund të krenohen pér sa e sa zbulime të tjera, prapëserapë ky shekulli ynë ua kalon atyre me këtë shpikje dhe me shumë të tjera. Dhe turqit e përdornin këtë mjet shkatërrimtar jo vetëm pér të rrafshuar banesat dhe pér të vrarë e pér të bërë kërdi mbi njerëz, por më tepër pér të shkatërruar puset e krojet, me qëllim që të rrethuarit të mbeteshin pa ujë. Mirëpo, faleminderit perëndisë, barbarët nuk qenë aspak të zotët t'ia arrinin këtij qëllimi, ndonëse ato të shtëna u shkaktuan mjart mundim qytetarëve; nga këta nuk mbeten të vrarë më tepër se dy veta. Puset shpëtuan të gjitha shëndoshë e s'u prekën fare prej atyre predhave. Këtë lloj topi mund ta quajmë më fort njëfarë mortaje, sepse është i gjerë dhe i shkurtër, me zgavër të thellë, me grykë të

drejtuar lart dhe me bisht të ngulur në dhe edhe lëshon një shungullimë ose një oshtimë tamam si gjëmë deti në stuhi.

Kur zbrazej ajo farë mortaje, të dukej sikur e gjithë kështjella dridhej kulm e themel e për disa caste brenda banave çdo gjë lëkundëj, kërciste në rrezik të thyheshin sende të ndryshme. Atë ditë turqit shtinë gjashtë herë, ndërsa me mortajë, që villte predha zjarri, dy herë e me topat e tjerë dyzet e dy herë. Po atë ditë sollën andej Bunës një bombardë tjetër që i hidhte gurët me një peshë prej shtatëqind librash dhe e qitën këtej lumit jo nëpër urë, sepse do ta kishte shembur, por nëpër ujë edhe me çfarë mjeshterie e marifeti! Të nesërmen prunë dy topa të tjerë të pamasë prej vendit ku i kishin derdhur; ai vend gjendej matanë Kodrës së Pashës. Njërin prej atyre dy topave, që i kalonte të gjithë të tjerët për madhësi, e vendosën në mes të Kodrës së Pashës përmbi kishën e Shën Kryqit; ai e hidhte predhën një mijë e treqind librash; predha e kishte rrëthim nëntë pëllëmbë. Topin tjetër e vunë buzë Drinasës përbri topave të tjerë dhe që prej asaj dite zunë ta rrihnin qytetin me dhjetë copë artileri të rendë. Po atë ditë që u vunë këta topa, turqit shtinë kundër ledheve shtatëdhjetë e dy herë. Atëherë shkodranët, duke parë se artilleria shtohej përditë e më tepër me gjithfarë kalibri e se gjithnjë e më shumë po vihej në rrezik jeta e tyre dhe s'mund të qarkullonin më nëpër kështjellë pa vënë kokën në rrezik, në çdo anë të qytetit, ku turqit kishin ngulur topa, vunë roja të vazhdueshme që të vështronin me kujdesin më të madh dhe të rrinin gati që, kur të shtinin turqit me top kundër kështjellës, ata t'u binin kambanave në mënyrë që të rrethuarit, të cilët qarkullonin nëpër kështjellë, një t'i dëgjuar, të ruheshin e të futeshin nën strehë. Me një organizim të tillë të krishterët qarkullonin nëpër qytet më me siguri; mirëpo kaq të forta, të shumta e të pikatura ishin goditjet e artilerisë nga të katër anët prej anës së turqve, saqë të krishterët mezi gjenin një strehim ose fortifikim për t'u mbrojtur edhe kaq me shumicë vinin mbi qytet gurë, shigjeta e lloje të tjera predhash si breshëri, saqë shpesh përplaseshin me njëra-tjetrën dhe binin mbi banesa e vende të tjera të qytetit duke shkaktuar tronditje e lëkundje, që s'pushonin as natë, as ditë, thuase s'kishte më vend të sigurt për mbrojtje. Pahisorja dhe stomet shembeshin vazhdimisht ose nga flakët e nga zjarri, ose nga goditjet e artilerisë. Kambanat binin gjithnjë; në qytet s'kishte mbetur më asnjë vend i sigurt që të shërbente për mbrojtjen e të krishterëve. Në fund e panë

të nevojshme të hapnin disa galeri nën dhé edhe të rrinin aty brenda siç bëjnë lepujt e butë.

Nga çdo anë s'kishte tjetër veçse mjerim, ngushticë e rreziqe. Turku ishte vërsulur me një fuqi e me një turr aq të fortë, saqë kudo kishte mbjellë panik e tmerr. Nga ana e të rrethuarve s'punonte më, si të thuash, as forca; ata ishin si të trullosur, as kishte më ndonjë rregull apo ndonjë mënyrë a mjet pér t'iu shmangur rrezikut dhe vdekjes, kaq vlonë topi e havani, kaq binin si breshër predhat e ndryshme edhe kaq ishte ndezur e kishte marrë pezm barbari. Të krishterët i lëshoi zemra, thuajse u hutuan fare, mezi qëndronin, kaq i madh ishte shkatërrimi e tronditja në të katër anët. Diku mortajat bënин kërdi ndër njerëz brenda shtëpisë, diku predhat i bënин copë-copë njerëzit, gjymtyrët e të cilëve përhapeshin e përplaseshin anë e kënd nëpër qytet; diku njerëzit, që i kapte predha e pushkëve ose shigjeta, binin përdhe pikë gjallë. Tashmë dukej se qytetit s'po i punonte më fati, as të rrethuarit s'po kishin më forcë pér ta mbrojtur, kishte arritur puna thuajse në dëshpërim, kaq i tmerrshëm ishte bërë Otomani. Por i madhi zot, që i dëgjon lutjet e njerëzve të drejtë, vetëm ai mund të lehtësonte gjithë atë peshë të rëndë, vetëm ai mund ta zgjidhët atë nyjë aq të ngatëruar, ai zot, pra, nuk lejoi që të shuhej fare ai qytet aq fetar bashkë me burrat e fortë të tij, por u dha zemër shkodranëve, ua ngriti moralin, i mbushi me besim e me shpresë, i armatosi me qëndresë e shpirtmadhësi, i fuqizoi me virtytin hyjnor e qiellor. Menjëherë, pra, si shkodranët ashtu edhe të huajt ia filluan të përballojnë me guxim e me entuziazëm të gjitha ato rreziqe, që u rrinin mbi kokë, e, ndërsa më përpara kishin humbur çdo shpresë, tashti kishin një besim të patundur në fitore edhe iu përveshën veprimtarisë me gjithë shpirt pér mbrojtjen e qytetit. Natë e ditë i jepnin zemër njëri-tjetrit pa marrë aspak parasysh se orë e çast ishin me krye në gérshërë; aspak nuk trembeshin nga predhat e shigjetat që binin si breshri prej të gjitha anëve, por qëndronin sypatrembur përballë tërë tij tmerri. Të rrethuarit vunë të gjitha energjitet, të gjithë artin e strategjinë e vet pér shpëtimin e qytetit; ata ballëhapët e ftonin vetë armikun në përleshje edhe jashtë ledheve dhe dinin t'i bënин ballë ashtu si duhet; vazhdimisht merrnin masat e duhura dhe kujdeseshin pér çdo gjë e, pa iu trembur syri aspak, i dilnin përpara vdekjes pér fenë kafolike, pér nder e Kushtim ndaj shën Markut e pér atdhe; me një fjalë kaq ishin kthyer e bërë edhe një herë trima të fortë, të rreptë e të guximshëm,

saqë të jepnin përshtypjen se nuk ishin më njerëz, por viganë, edhe vetë turqit çuditeshin për atë farë trimërie.

Të nesërmen një pjesë e madhe e ledheve u shemb nga njëqind e katër goditje topash të vendosur në pozicione të ndryshme; njëkohësisht turqit shtinë dy herë edhe me mortaja që villnin lëndë djegëse dhe kështu morën flakë pahisoret në drejtim në Bunës, aty ku kishte komandën ai trimi i fortë, Karlini, kapidan i italianëve; mirëpo zjarri u shua menjëherë pa pësuar të krishterët ndonjë humbje. Nga ana tjetër barbari gjithnjë përpiquej t'u jepte zjarrin të gjitha fortifikimeve dhe t'i zhuriste fare në mënyrë që me zhdukjen e tyre të rrethuarit të mos kishin më asnjë mundësi e mjet për t'u mbrojtur, sepse, meqë ledhet ishin rrafshuar thuajse fare përdhe, shkodranëve u kishin mbetur vetëm stome e fortifikime për vetëmbrojtje. Megjithatë shumë veta, kur po vraponin për të fikur zjarrin, mbeten të vrarë prej topave e mijeteve të tjera luftarake; dhe pikërisht këtë qëllim kishte armiku. Prapë ditën e nesërmie, d.m.th. më 11 korrik, turqit vunë në Kodrën e Pashës, te kopshti i një qytetari, një artilleri tjetër shumë të rëndë, që e hidhëte gurin nëntëqind e pesëdhjetë librash. Që prej asaj dite barbarët e gjuanin qytetin vazhdimisht me njëmbëdhjetë topa të kalibrit të madh. Atë ditë ata shtinë kundër kështjellës njëqind e shtatëdhjetë e tetë herë, gjë kjo që deri atë ditë s'kishte ndodhur kurrë. Atëherë sulltani, duke parë se tashmë të gjitha ledhet e qytetit ishin dërrmuar e rrafshuar përdhe e se të rrethuarit kishin mbetur pa strehë e se muret kishin ngelur thuajse krejt pa farë mbrojtjeje, mendoi se në atë gjendje qyteti mund të shtihej në dorë, prandaj me një sulm të fuqishëm e me topa zuri t'i ndrydhte si me darë shkodranët prej të katër anëve dhe më parë lëshoi në sulm në çdo drejtim jeniçerë, azapë dhe ushtarë të tjerë, të cilët me trina e xunktha e strehë gjithnjë u afroheshin natë e ditë pahisoreve dhe zinin gjithnjë pozicione të reja. Sulltani u kishte dhënë urdhër ushtarëve që të suleshin me sa fuqi kishin mbi të rrethuarit. Edhe sikur të kishin marrë flakë fortifikimet, prapëseprapë ushtarët e tij do të hidheshin në sulm dhe do të bënin çmos që t'i futeshin kështjellës përbrenda; mirëpo sulltanit s'iu plotësua dëshira, se çdo mundim shkoi bosh. Shkodranët bënë një qëndresë heroike, s'kishte më as panik; as frikë që t'i trembte; në vend të ledheve ata kishin trimërinë; ata qëndronin si burrat aty ndër fortifikime dhe ballëhapët i dilnin para rrezikut. Secili kishte vendosur (se nevoja edhe frikacakun e bën trim) të vdiste heroikisht sesa të binte në dorë të ar-

mikut e tē vritej prej tij me turp; andaj sulltani e gjeti shumë tē vështirë atë që kishte shpresuar tē kryhej fare lehtë. Ndërkaq turqit u dhanë zjarrin fortifikimeve, mirëpo tē rrethuarit pa farë vështirësie e shuan atë zjarr pa pësuar gjë tē keqe ata vetë. Tē nesërmen prapë nisën ta gjuanin qytetin me top me sa fuqi patën; atë ditë ranë në kështjellë plot një-qind e tetëdhjetë e shtatë predha gurësh. Përsëri turqit i vunë zjarrin pиргут që gjendej mbi derën kryesore, gjithashtu edhe forcomës ku qëndronte Karlini, me qëllim dredharak që, ndërsa tē krishterët do tē vraponin pér tē fikur zjarrin, tē vriteshin prej artilerisë që e rrihte gjithnjë atë anë, dhe në tē vërtetë disa prej tē rrethuarve mbetën tē vrarë. Atëherë shkodranët e panë fare mirë se barbari me atë dredhi po i dilte në krye qëllimit tē vet, se atyre po u kanosej një rrezik i madh e se dita-ditës po dëmtosheshin sa njerëz, prandaj e gjykuant tē arsyeshme se barbari duhej luftuar jo vetëm me energjitet dhe me forcën e trupit, po edhe me strategji e aftësi mendore, ndaj vendosën që këtyre dredhive tē barbarit t'u dilej përballë me një mënyrë tjetër.

Tē rrethuarit, pra, radhitën disa pushkatarë (kështu quhen sot) dhe disa shigjetarë, nga ajo anë ku zakonisht turqit vinin pér t'u dhënë zjarrin forcomave, me qëllim që, kur këta tē vinin me pishtarë në dorë, tē vriteshin. Tē nesërmen, pra, erdhën turqit pér tē kryer punën e vet dhe, përpëra se tē hidhnin pishtarët ndër forcoma, disa prej tyre u pikuan mirë nga tē rrethuarit dhe mbetën aty në vend, disa tē tjerë u vunë në tē ikur pa hedhur asnjë pishtar.

Tashti, me qëllim që ta dinë edhe pasardhësit se ç'janë pushkët e nga ka rrjedhur ky emër, unë do tē orvatem brennda mundësive tē mia tē bëj njëfarë përshkrimi. Pushka është një lloj armë në përgjasim tē bombardës dhe në pjesën më tē madhe është prej hekuri; e mori këtë emër⁹⁴ (scopulus) nga krisma që bën kur shtihet me tē. Tytën e ka tē ngushtë e tē gjatë edhe mbushet me një lloj predhe prej plumbi që ka barut dhe lëndë tē tjera djegëse dhe mjafton një njeri i vetëm pér ta ndezur, kështu që predha del fluturimthi duke u rrotulluar dhe tē vret.

Ndërkaq turqit qitën në Bunë tē tetë galetë që kishin ndërtuar e pér tē cilat folëm më lart. Këto gale, pra, u larguan nga limani dhe natën nëpér Bunë dolën në liqen edhe aty filloj një përleshje e madhe ndërmjet turqve dhe vendësve. Në fund, meqenëse turqit ishin shumë më tepér në numër, zunë vetëm një lundër tonën me tetë burra brenda. Këta tē tetë veta, që gjithnjë kishin sulmuar shatorret e

armikut, në mëngjes i ngulën ndër hunj andej Bunës, pranë kishës së shën Mërisë Magdalënë. Atë ditë turqit shtinë me top njëqind e tetëdhjetë e tri herë, ashtu edhe të nesërmen njëqind e gjashtëdhjetë herë. Në këtë ndërkohë që turqit vinin gjithnjë pér t'u dhënë zjarrin fortifikimeve, njëri prej tyre, ndërsa po kalonte pérpara të tjerëve me pishtar në dorë, pérpara se të arrinte në vendin e duhur, u vra prej të rrethuarve.

Ushtarët e tjerë turq, të tmerruar, ua mbathën këmbëve. Ata, kur panë se në atë mënyrë çdo përpjekje u shkonte bosh e se nuk mund t'u afroheshin më forcomave dhe stomeve pér t'u dhënë zjarrin pa vënë kokën në rrezik, menduan të gjenin një rrugë tjetër pér të vënë në zbatim planin e vet dhe pér t'i dalë qëllimit në krye. Dhe zbatuan këtë strategji. Me qëllim që t'u afroheshin fortifikimeve më me siguri dhe të shporreshin nga të krishterët, që gjithnjë e shuanin zjarrin, turqit përgatitën një artileri pér qitje dhe ndezën pak barut që e kishin vendosur më tutje në mënyrë që të rrethuarit t'i kapte tmerri dhe të braktisnin fortifikimet e pastaj turqit vetë t'u jepnin menjéherë zjarrin pa hisoreve. Tashti, po të donin të krishterët t'i mbronin me këmbëngulje ato forcoma, ata patjetër do të vriteshin prej artilerisë turke dhe i gjithë ai zjarr nuk mund të shuhej ndryshe veçse duke rënë fli kushedi sa e sa të rrethuar. E, mégjithëse shumë qytetarë mbeteshin të vrarë, prapëseprapë s'kishte burrë që t'i ndalonë ata trima pér të shuar zjarrin, sepse ata kishin vendosur më parë të vdisnin sesa të braktisnin mbrojtjen e qytetit. Sulltani ishte bërë zjarr e flakë dhe kërcellonte dhëmbët nga inati, sepse s'mund ta duronte gjithë atë guxim të çuditshëm që tregonin të rrethuarit. Ai e shihte fare mirë se s'kishte fuqi në botë që t'i thyente shkodranët, s'kishte as top, as havan që t'i përkulte. Pér këtë arsyе sulltani më 15 korrik dha urdhër që të sillnin pranë ledheve një sasi të madhe balistash e katapultesh⁹⁵), me qëllim që të rrethuarit të varroseshin nën një grumbull të madh gurësh. Veç kësaj duhej të sillnin një sasi të madhe pendash e trinash në mënyrë që ushtarët turq, duke u mbrojtur me to, të kishin mundësi të futeshin brenda kështjellës.

Në fillim të rrethuarit kujtuan se ato mjete luftarake ishin përgatitur pér të flakur predha me zjarr e prandaj i hoqën të gjitha shindrat⁹⁶), me qëllim që të mos merrnin flakë dhe menjéherë morën masat e duhura kundër asaj manovre dhe kështu i gjithë ai mundim nga ana e turqve

shkoi kot. Sulltani e humbi fare shpresën që kishte mbështetur në atë farë dredhie, sepse Donati, i pari i arkitektëve, që kishte komandën e artilerisë, ngriti nga të dy anët e kështjellës disa makina, nëpërmjet të cilave ballistat e armikut u thyen e u shkatërruan në mënyrë që ishte e pamundur të meremetoheshin e të viheshin prapë në veprim. Mirëpo pikërisht atë ditë turqit e rrahën qytetin me njëqind e shtatëdhjetë e tetë të shtëna artillerie. Në datën 17 barbarët hodhën zjarr mbi fortifikimet e para dhe mbi ato të portës kryesore, ku qëndronin burrat më të fortë e më trima, gjithashtu edhe kapidanët italianë, Anton Kortonasi edhe Anton Bovini, të cilët luftonin në mënyrë të shkëlqyer. Anton Bovini u plagos shumë rendë dhe vdiq, ndërsa tjetri, i bëre gjithë plagë nga një mori shigjetash, mezi shpëtoi. Njëkohësisht turqit u vunë zjarrin edhe fortifikimeve të dyta po aty te porta kryesore dhe (si e kishin zakon) zunë t'i rrin hin fortifikimet me artileri me qëllim që të rrethuarit nga tmerri i madh të mos vraponin më për të shuar zjarrin. Mirëpo shkodranët nuk u treguan as të ngathët, as frikacakë, por aty për aty e fikën zjarrin dhe vetëm dy prej tyre mbetën të vrarë.

Atë ditë turqit shtinë me artileri njëqind e tetëdhjetë e dy herë e të nesërmen njëqind e nëntëdhjetë e katër herë; asnjëherë s'kishin shtënë më tepër se kësaj radhe as më përpara, as më vonë. Prapë të nesërmen e gjuajtën qytetin njëqind e tridhjetë e një herë. Tashmë turqit dita-ditës po forcoheshin gjithnjë e më tepër dhe po përgatiteshin përsulm. Turma-turma i derdheshin kështjellës dhe e rrethonin në të katër anët si kurorë mijëra e mijëra veta edhe i shkonin sa më afér duke kapërcyer me trina e strehë stome e gropat, të cilat i mbushnin me gurë e me lëndë gjithfarësh në mënyrë që të gjenin shteg për t'iu futur kështjellës përbrenda më lehtë, sepse sulltani kishte shpallur urdhrin që ditën e nesërme, kur të jepej sinjali, do të fillonte përlleshja. Prandaj turqit, gjithë asaj nate, bënë përgatitjet e duhura për betejë. Atëherë të krishterët, duke parë se armiku po përgatitej për luftim, pa farë vonese iu përveshën veprimtarisë me shkathtësi, duke u mbështetur gjithnjë në ndihmën e zotit dhe me besim të plotë në fitore. Disa reparte i vunë në fortifikime e në vende të rojës për të hetuar gjithnjë lëvizjet e armikut, me qëllim që, kur armiku të sulej mbi fortifikimet e veta, ata t'i pritnin hovin me guxim, si ushtarë të stërvitur që ishin, ndërsa pjesa tjetër e të rrethuarve të hipte mbi stomet e fortifikuara. Kështu, pra, ndër pozicio-

net e fortifikuara të qytetit gjithnjë rrinin në rojë katërqind burra të armatosur. Të nesërmen, d.m.th. në datën nëntëmbëdhjetë, armiqtë, aty nga mbrëmja, hodhën prapë zjarr, si zakonisht, mbi ato fortifikime që ndodheshin nga ana e portës kryesore. Duke vrapuar në masë pér ta shuar atë zjarr, mbetën të vrarë disa italianë e disa shkodranë, nga të cilët s'duhen kaluar në heshtje si burra të mirë e trima: Frano Patavini, kapidan i ushtarëve italianë, dhe Llesh Begani, shkodran, burrë fisnik e trim sa të thuash; këta të dy, duke luftuar trimërisht krahas të tjerëve, u copëtuan nga artileria dhe gjymtyrët e tyre u shpérndanë copë-copë nëpér qytet.

Atje te fortifikimet, në përlleshje me armikun, mbetën të vrarë edhe shumë e shumë të tjerë, ndër të cilët Frangesk da Santo Skorbaro, kapidan i ushtarëve italianë, Nikollë Gradisklavi dhe Nikollë Begani, qytetarë shkodranë, të cilët, duke luftuar heroikisht kundër barbarit mbetën të vrarë bashkë me shokë të tjerë. Porsa u vranë ata dy burra, armiqtë lëshuan një britmë të madhe dhe, mbas një sinjali që dha artleria, filloi një përlleshje e tmerrshme, që s'ishte parë asnjëherë më përpara, qysh prej fortifikimeve të portës kryesore e deri te forcomat e Bunës, mu aty ku kishte komandën Karlini; dhe ajo përlleshje zgjati plot një orë e prapëseprapë barbari në asnjë mënyrë s'që i zoti të kapërcente as hendekun, as stomet, as t'u afrohej fortifikimeve. Shumë ushtarë turq mbetën të vrarë, pati edhe shumë të plagosur, shumë u zmbrapsën pér turp e ikën dhe fitoren e korriën shkodranët (megjithëse u kushtoi shumë gjak).

Pra ajo ditë pér të rrethuarit qe plot hare e plot lavdi, ndërsa pér armikun qe ditë e zezë e plot turp, ndonëse atë ditë ai shtiu me artileri kundër të rrethuarve plot njëqind e nëntëdhjetë e tri herë, por ato qitje s'i vlejtën asgjë. Megjithatë turqit prapë s'pushuan së shtëni dhe të nesërmen e gjuajtën kështjellën me njëqind e dyzet e tetë qitje artlerie. Të nesërmen në mëngjes iu afrua qytetit një shumicë e madhe barbarësh, që qëndronin ndër shatorre. Ndërkaq atje ndër shatorre po përgatitej një sasi e madhe armësh e shigjetash pér betejën e aférme. Ndërsa disa i ishin përveshur me kujdes e zell kësaj pune, nga ana tjetër shumë e shumë ushtarë vëzhgues menjëherë u ngjitën nga të katër anët deri atje lart pranë fortifikimeve. Këtej shkodranët menduan se armiku brenda ditës do të sulmonte qytetin. Pér këtë arsyé aty pér aty u armatosën të gjithë dhe rrinin të gatshëm atje në pozicionet e mbrojtjes duke pritur armikun pa iu trembur syri aspak dhe gjithnjë vëzhgonin se ç'do të bënin turqit.

Edhe me të vërtetë këta, po atë pasdite, u turrën me një sulm të tmerrshëm, kapërcyen vende të fortifikuara e stome dhe arritën te pahisorja. Atëherë ia nisi beteja ndërmjet turqve e të rrëthuarve; dhe që një përleshje e llahtarshme në çdo anë të qytetit. Binin të vrarë shumë e shumë veta nga ana e armiqve, po edhe nga ana e të krishterëve pati mjaft të vrarë e të plagosur sidomos prej artilerisë. Sa fort do të ishte prekur ai që do të kishte parë aty te porta kryesore fortifikimet thuajse fare të shembura, si dhe gjithë ato kufo ma të copëtua jo vetëm qytetarësh, por edhe të krishterësh të tjerë. Tashmë armiku kishte përparuar në një mënyrë të tillë që kishte shtënë në dorë vendet e para të rojave dhe fortifikimet e portës së lartpërmendur.

Pikërisht aty filloi një përleshje e llahtarshme, sepse mu në atë vend do të vendosej fati i qytetit mbarë. Dhe në të vërtetë aq i madh qenë vrulli e sulmi i turqve kundër të rrëthuarve, aq të rrufeshme e të shpeshta qenë goditjet e artilerisë dhe të mjeteve të tjera luftarake, aq e madhe që sasia e shigjetave, saqë thuajse s'mbeti asnë i krishterë, që mbronte ato fortifikime, pa u plagosur ose pa rënë vdekur. Por, megjithatë, armikut nuk i zgjati shumë gëzimi, sepse aty për aty doli ai repart i çeliktë i shkodranëve, i stërvitur më sé miri në armë, dhe me një guxim të jashtëzakonshëm u ngjit mbi fortifikime dhe u përlesh rrëptë me armiqtë; i zmbrapsi, i vrau, i vuri në të ikur e i shpartalloi duke korrur në këtë mënyrë një fitore të shkëlqyeshme e të pashoqe. Kështu nga ana e turqve u vra një shumicë e madhe. Atë ditë luftimi zgjati plot dy orë. Turqit me turpin më të madh të tyre u zmbrapsën nga ato pozicione dhe prej asaj dite s'paten më guxim as t'u afroheshin atyre fortifikimeve. Në atë përleshje mbetën të vrarë disa burra vendës, të cilët, duke luftuar heroikisht për atdhe, kishin vendosur të falnin edhe jetën. Bashkë me këta trima lanë jetën në atë betejë edhe disa burra të huaj. Gjymtyrët e të dy palëve, të shpërndara andej e këtej copë-copë, u mblodhën dhe u varrosën me ndërimet e duhura ashtu si që e mundur dhe si e lejonin rrethanat. Ky funeral u bë një ditë përpëra se armiku të fillonte sulmin e përgjithshëm. Atë ditë mbarë qyteti u rräh nga të katër anët me njëqind e shtatëdhjetë e tri qitje artilerie. E, po të kishte dashur ndokush t'i numëronte një nga një të shtënat e topave kundër ledheve të qytetit, do të kishte parë se ato ledhe u rrähën plot dy mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë herë, pa llogaritur të njëqind e dhjetë të shtënat e mortajave dhe dhjetë predhat me zjarr. Mbas mori fund

ajo përleshje, menjéherë u kthyen ndër shatorre ushtarët turq që kishin zënë vend rrëth e përqark fortifikimeve të qytetit; shumica prej tyre kishte qëndruar natë e ditë nën trina e mjete të tjera mbrojtëse pikërisht aty pranë forcave. Ndérkaq pashai i Anadollit dhe pashai i Rumelisë u drejtuani te sulltani me urdhrrin e tij. Atëherë menjéherë u lajmëruan edhe disa gjeneralë të tjerë të ushtrisë, gjithashtu edhe disa personalitete të tjera me rëndësi dhe u paraqitën te sulltani. Të gjithë, me urdhrrin e sulttanit, u mblodhën në shatorren e tij. Në këtë mbledhje u shtrua pyetja se ç'masa duheshin marrë për ta shtënë në dorë qytetin dhe, meqenëse secili shprehte mendimin e vet, në fund sulltani vetë iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: «Ju po e shihni mirë, burra, se u bënë tre muaj që e kemi rrëthuar këtë qytet e me çfarë rrëthimi! Edhe plasëm duke e rrahur, duke e dërrmuar e duke e shembur nga të katër anët me artileri të çdo kalibri; ledhet thuajse i kemi rrafshuar përdhe; fortifikimet i kemi rrënuar e shpartalluar (sikurse e shikon i vetë) me anën e mjeteve të ndryshme që kemi. Veç asaj, gjithësaherë që ne flakim zjarr mbi vendet e mbrojtjes, aq herë i detyrojmë shkodranët që të dalin e të luftojnë; ne jemi duke ua marrë shpirtin atyre me një betejë të dyfishtë. E në fund, sikurse e dini, ne s'kemi lënë asgjë pa pravuar e pa përdorur, aq sa mund të na merrte mendja neve, për t'i lodhur, për t'i dërrmuar e për t'i shkatëruar të rrëthuarit në mënyrë që ta' pushtonim qytetin më me lehtësi. Tashti, pra, unë them se s'kemi përsë të presim më, por, përpara se armiku të rimarrë fuqi të reja, përpara se të forcohet edhe një herë, jo më larg se nesër në mëngjes duhet t'i rrasemi mirë qytetit nga çdo anë dhe të përleshemi me shkodranët në një luftim të tmerrshëm e përfundimtar. Prandaj secili prej jush të shtrëngojë rripat mirë, t'u kumtohet kapidanëve të tjerë, të cilët janë ndër shatorre, që nesër në të zbardhur të dritës të gjithë të jenë të armatosur e të përgatitur për t'iu vërsulur qytetit dhe për ta shtënë në dorë; unë do t'i dalloj e do t'i njoftoj fare mirë ata që do të meritojnë çmimin prej anës sime. Ti, pasha i Rumelisë, su lu mbi njërin anë të qytetit me taboret e tu dhe me gardën. Anën tjetër të orvatet ta shtjerë në dorë pashai i Azisë me taboret e vet. Secili lë të përgatitë çështë e nevojshme për këtë luftim të rreptë dhe ta ketë aty me vete. Neve s'na mungon guximi e, për hir të këtij guximi, asgjë s'na pengon që nesër në mëngjes të pushtojmë këtë qytet. E kush guxon të na bëjë ballë neve? Ju po e shihni fare mirë

se tē rrrethuarit kanë mbetur pa ledhe e pa mbrojtje. Fortifikimet e gropat kudo janë zhdukur, d.m.th. e kemi shtegun tē hapur pér t'iu futur qytetit. Shkodranët prej gjithë atyre luftimeve janë lodjur e dërrmuar fare; ne, përkundrazi, jemi tē freskët, jashtëzakonisht tē fortë; ata kanë mbetur fare pak, kurse ne jemi tē panumërt.

Vëç asaj kemi artilerinë tonë tē tmerrshme; edhe këtu s'na del njeri. Po atëherë kush mund tē thotë se shkodranët nuk i kemi në duart tona? Në qoftë se do tē ketë tē rrrethuar që do tē dorëzohen gjallë, unë do t'i trajtoj sipas kanunit tē luftës dhe tē robërisë. Zemër, pra, o burra! s'keni ç'pritni më. Po pse? A nuk e urreni ju emrin dhe farën e shkodranëve? Ka këtu ndër ju ndonjë që s'e kujton me zemërim e mllaf kërdinë që bënë shkodranët mbi prindërit tuaj, vëllezërit tuaj, mbi tē afërmit e dashamirët tuaj, që u vranë pranë këtyre ledheve në mënyrën më Mizore? Po atëherë ju nuk dashkeni tē hakmerreni një herë e mirë kundër tyre? Si mund tē duroni pa shfryrë urrejtjen tuaj kundër shkodranëve pér tërë atë kërdi që kanë bërë mbi ju? Por unë po i kaloj në heshtje tē gjitha ato tē zeza që patëm prej shkodranëve disa vjet përpara. Le tē shikojmë se ç'kërdi kanë bërë ata ndër ne tashti, kohët e fundit. S'ka katër vjet që kemi luftuar prapë me shkodranët. Në atë luftë patën mbetur tē vrarë qindra e mijëra veta nga ushtria jonë; gjithnjë sot e kemi parasysh atë kasaphanë; gjithë ai gjak i derdhur, pra, kërkon hakmarrje. Ja: krejt kjo kodër, tē gjithë këta shkëmbinj janë larë me gjakun e ushtarëve tanë. Nuk keni se ç'pritni, pra, o burra, por rrëmbe ni ato armë, ngjituni kështjellës me hap tē vendosur e bjeruni shkodranëve; duhet ta pushton qytetin trimërisht edhe tē hakmerrni pér kërdinë e dikurshme. Ngopuni sa tē mundeni me gjakun e tē krishterëve, sepse kështu na mëson kanuni ynë; duhet tē shtiem në punë tē gjitha energjitet dhe armët tona në mënyrë që tē mos mbetet gjallë asnjë shkodran. Edhe ju fare lehtë mund t'ia arrini këtij qëllimi, derisa i kemi tē gjitha mundësitë; asgjë s'ju pengon, asgjë s'ju mungon pér tē korru fitoren; çdo gjë është gati; e pastaj i forti kurdoherë e thyen tē dobëtin, tē ligjhtin.»

Pas kësaj bisede tē gjithë barbarët që qenë aty, i miratuan fjalët e sulltanit me një brohoritje tē madhe, duke thënë se duhej bërë një sulm i fortë kundër shkodranëve dhe sa më parë në mënyrë që tē shtihet qyteti në dorë dhe tē gjithë tē rrrethuarit tē vriteshin. Mbasit u vendos se ç'masa duhej tē merreshin, mbledhja mori fund dhe ndër tē gjitha

shatorret u shpall urdhëresa, sipas së cilës të gjithë duhej të shtrëngoheshin në armë dhe të përgatiteshin pér betejën e madhe që do të fillonte ditën e nesërme. Ndërkaq ndër shatorret e turqve shihej një lëvizje e madhe; kush shkonte e kush vinte tamam si milingonat, që vrapijnë andej e këtej pér të kërkuar ushqim e disa dalin e disa kthehen të lodhura nën peshën e barrës.

Kapedanët e ushtrisë, mbasi dolën nga shatorrja e sulltanit, u ngjitën në majë të Kodrës së Pashës dhe aty vërejtën të gjithë pozicionet e kështjellës; u mblodhën kokë më kokë dhe secili shprehte mendimin e vet pér taktikën që duhej ndjekur pér ta pushtuar qytetin. Por edhe shkodranët atje në kështjellë, duke parë tek armiku gjithë atë ngut pér luftim, menjëherë iu përveshën punës pér t'u përgatitur pér mbrojtjen e qytetit; duhej t'i bënин sytë katër, se pse ishin përparrë një armiku shumë dinak; turku kishte në mend t'i futej kështjellës përbrenda me dredhi dhe në befasi. Dhe me të vërtetë, aty nga perëndimi i diellit turqit, të armatosur deri në dhëmbë, ia behën në tregun e Shkodrës, që është larg ledheve sa hedh gurin, filluan t'i ngjiteshin kështjellës me gjithë atë mori trinash dhe t'i rraseshën nga të katër anët, duke dhënë të kuptohej se gjoja donin t'ia nisnin luftimit. Gjithë natën vinin reparte pas repartesh nga ana e ushtrisë turke dhe u rraseshën rrëzave të kodrës dhe nga tre-katër ushtarë bashkoheshin nën një trinë duke dashur t'i gënjenin të rrethuarit se tashti kishte ardhur çasti pér sulm. Simbas atyre që patën mundësi ta vëzhgonin mirë gjithë atë mori ushtrie, plot njëqind e pesëdhjetë mijë veta u ngjitën deri atje pranë fortifikimeve. Pastaj duhet ditur se ajo ishte ajka e të gjithë ushtrisë turke, ishte lulja e rinisë; ishte pjesa e zgjedhur e luftëtarëve më të fortë, që atje ndër shatorre mbaheshin si më trimat e të gjithë ushtrisë turke. Sulltanit shatorren, krejt në të kuq të ndezur, ia kishin ngritur mu në majë të Kodrës së Pashës me qëllim që ai të vëzhgonte së largu sulmin dhe betejën që do të zhvillohej. Porsa agoi drita, sultani hyri në shatorren e vet dhe turqit me dredhi të madhe përfituan nga rasti pér t'iu sulur qytetit pikërisht në kohën kur të krishterët ishin duke u lutur në kisha të ndryshme. Atë ditë ishte festa e shën Mërisë Magdalenë edhe që në orët e para të mëngjesit, sipas një shenje që u dha nga shatorrja e sulltani, ashtu edhe me katër të shtëna topi e me dy mbëdhjetë qitje të tjera, që drejtoheshin kundër fortifikimeve, aty pér aty të gjithë turqit u lëshuan në sulm nga vendet e mbrojtjes e, duke ka-

përcyer gropat e qytetit, i rrrethuan fortifikimet nga të katër anët ashtu të rrasur njëri pas tjetrit tamam si sheme bletësh e ndërkaj në çdo anë të qytetit dëgjoheshin duke rënë kambanat. Turqit lëshuan një britmë të tmerrshme dhe atëherë të rrrethuarit u flakën të armatosur jashtë kishave dhe vrapuan si rrufeja drejt pozicioneve të rojës për t'u përleshur trimërisht me armikun. Kur arriten atje, panë se ndeshja ndërmjet turqve e të krishterëve kishte filluar; turqit ia kishin nisur luftimit më shumë në formë hajdutë sesa me një ndeshje të rregullt. Por bëteja u ndez me një mënyrë të veçantë mu te porta e madhe; aty armiku ishte kapërthyer rreptë me të rrrethuarit, kishte hipur në stom dhe kishte ngulur flamurin e ushtrisë turke.

Sultani filloj t'i bëhej zemra mal prej gjëzimit, sepse kujtoi se tashmë kështjella ishte në dorë të tij. Por shkodranët, që nuk dinë se ç'do të thotë të fshihesh ose t'ua mbathësh këmbëve, kur panë se armiku ishte vërsulur me gjithë atë hov e se kishte zënë fortifikimet, u bënë të furnishëm dhe e panë fare mirë se kishte ardhur çasti të vinin në veprim të gjitha energjitet e veta dhe plot vrumullisje e kërcëllim u derdhën mbi armikun me një furi të jashtë-zakonshme. Disa nga të krishterët, fytafyt me turqit, bëjnë kërdi mbi ta me shpata e armë të tjera; disa të tjerë me gurë të mëdhei e trarë të mprehtë e flakin armikun poshtë fortifikimeve; disa të tjerë rrokullisin poshtë shtamba plot me gurë. Disa hedhin trina xunkthash dhe strehë me zift të ndezur, disa të tjerë flakin mbi turqit vorba plot me gëll-qere. Në këtë mënyrë të rrrethuarit shpartallojnë, vrasin, vënë në ikje nga çdo anë armikun e tmerruar. Mbasia përplasin përdhe edhe flamurin, e nxjerrin jashtë fortifikimeve me turpin më të madh edhe bëjnë kërdi mbi të me çdo lloj arme. Kështu u mbrojt kështjella me lavdi e fitore të shkëlqyer.

Sultani, që vëzhgonte nga maja e kodrës dhe shpresonte se tashmë qytetin e kishte në duart e veta, u tërbua sa s'bëhet dhe mezi e mbajti veten kur pa se ushtria e tij u shpartallua e u vu në të ikur me gjithë atë turp. Prandaj aty për aty nisi ta rrahë qytetin me artileri thuajse pa pushim dhe me kërcënëm i urdhëroi gjeneralët e vet, aty pranë, që t'i detyronin ushtarët e tmerruar, të cilët ua mbathnin këmbëve, të ktheheshin rishtazi dhe të suleshin mbi qytet. Kështjella aty nga ana e Kodrës së Pashës pranë portës së madhe kishte një pjerrësi disi më të lehtë, por ishte e fortifikuar më së miri dhe në të vërtetë mu aty te porta e parë, që ishte edhe dera kryesore e qytetit jashtë rrrethit të

parë të ledheve, kishin ndërtuar një pirg të lartë e të rrumbullakët, të cilin e kishin forcuar në një mënyrë të jashtëzakonshme. Në atë pirg qëndronin në krahun e djathëtë e të majtë të rrëthuarit dhe kishin mundësi të ruanin gjithë atë shesh, që ishte krejt pranë kështjellës. Ngjitur me atë pirg ndodhej edhe një kullë tjetër pak më poshtë, mirëpo të rrëthuarit kishin frikë (gjë që edhe ndodhi) se do të rrafshoheshin përdhe ato dy pirgje nga rrahjet e artilerisë, prandaj pranë tyre kishin ngritur disa forcoma shumë të forta të bëra me baltë dhe me lëndë të ndryshme dhe në të vërtetë armiku sulmin më të rreptë e kishte drejtuar pikërisht nga ajo anë e qytetit, që prej natyre nuk ishte edhe aq e fortë, dhe mu matanë kishte drejtuar gjashtë artilleritë më të mëdha, gjashtë mijë pushkë dhe një sasi të panumërueshme shigjetarësh. Aty për aty të dy kullat, gjithashtu dhe muri rrëth e rrotull tyre, u rrafshuan përdhe dhe s'mbeti tjetër për mbrojtjen e qytetit përvëç atyre fortifikimeve të bëra me dhë. Barbarët, me shpresë se do t'i futeshin qytetit brenda, u vërsulën me një turr të jashtëzakonshëm; nga ana tjetër u sulën me trimëri e guxim edhe të rrëthuarit dhe ia nisi ndërmjet të dy palëve një përleshje e tmerrshme fytafyt, sepse mu në atë pikë ishte, si të thuash, çelësi i gjithë punës. Armiku i ngjitej stomit, mirëpo prapë hidhej rrokoll poshtë prej të rrëthuarve. Pas atyre të parëve vinin prapë ushtarë të tjerë, po edhe këta flakeshin poshtë; u bë kërdi e madhe nga çdo anë e gropat u mbushën me gjak.

Të gjithë këta ushtarë turq vriteshin nga armët e ndryshme të të rrëthuarve që shtinin pa pushim. Atëherë pashai i Rumelisë, të cilit i ishte ngarkuar barra që të shtinte në dorë atë anë të qytetit, e cila shtrihej nga Rrota e deri te fortifikimet e Karlinit andej nga Buna, e pa fare mirë se sulltani po zemërohej e po ndizej flakë nga inati i fortë, sepse ai sulm po shkonte bosh, prandaj bashkë me komandanatin e taborëve aziatikë zbriti nga kodra, ku gjendej sulltani, e me shpatë në dorë i detyroi ushtarët, që iknin, të kthehen prapë për të luftuar. Atëherë filloi një përleshje edhe më e rreptë; nga njëra anë suleshin te porta e madhe barbarët turma-turma, në anën tjetër turreshin të rrëthuarit e me çfarë guximi! Aty s'mbeti armë pa u përdorur dhe aq e madhe ishte sasia e shigjetave, saqë edhe qelli u errësua dhe armiqtë, jo vetëm që u orvatën të rrafshonin e të kapërcenin fortifikimet, por donin të shtinin në dorë edhe Rrotën. Ky na ishte një vend jashtë ledheve, andej nga lindja, krejt pranë qytetit, i pashteg e plot shkëmbinj të the-

pisur. Në majë ishte i rrafshtë; aty ishte ndërtuar një kishë, kushtuar shën Pjetrit, ku grekët luteshin dhe kryenin ceremonitë fetare. Atë vend e kishin forcuar me të gjitha llojet e fortifikimeve e të armëve e pra shërbente si mbrojtja më e fuqishme si për kështjellën, ashtu edhe për një pjesë të qytetit; pikërisht prej atij vendi u bë kërdia më e madhe mbi turqit dhe ata u shpartalluan fare. Mirëpo te fortifikimet e portës kryesore ishte ndezur luftimi në një mënyrë me të vërtetë të hatashme.

Britmat e poterja arrinin deri në kupë të qiellit. Aq të tmerrshme ishin klithmat dhe ulërimat e barbarëve, aq e fuqishme ishte plasja e artilerisë dhe e mjeteve të tjera luftarake, aq e fortë ishte krisma e daulleve, aq vrull e hov kishte marrë zhurma e armëve, saqë njerëzia as nuk dëgjonin, as nuk shihnin më asgjë me sy. Toka ishte bërë krejt tym e barut e dukej se deri qielli ishte turbulluar e po shembej, kaq mbizotéronte në të katër anët pështjellimi, rrëmuja, errësira. Ndërkëq turqit vërsulen nga të gjitha anët; vijnë edhe më afër; turq e të krishterë janë përballë njëri-tjetrit dhe zihen fytafyt; të dy palët nuk i ndan asgjë tjetër përvçese disa perda dhe dërrasa që ishin ngulur aty për të mbrojtur të rrëthuarit prej shigjetave të armiqve. Nga çdo anë rrëmbehen shpata e jataganë dhe fillon përlleshja trup me trup; disa bien të vdekur dhe vijnë të tjerë për t'i zë-vendësuar. Shkodranët nuk kishin mundësi të lëviznin aspak nga ai pozicion që e kishin marrë atje lart qysh se kishin nisur t'i mbronin një herë e mirë fortifikimet edhe prej atyre forcomave ata bënin kërdinë mbi armikun me trina, me strehë me zift dhe kalptyrë. Për këtë arsyе aty zienin vozat prej druri lyer me vaj që merrnin zjarr nga baruti. Kështu kushedi sa e sa turq të djegur e të zhuritur binin rrökoll nga maja e kodrës. Apo s'kishte gurë me goxha peshë, skorpionë e mjete të tjera lufte, nga të cilat armiku bëhej copë e grimë. Pikërisht atëherë kur turqit kujtonin se ishin të sigurt nga njëra anë, shpesh e shpesh pëershko-heshin prej shigjetave matanë, ku kishin më pak dyshim. Aty pranë portës së madhe ishte një si llogore e nëndheshme e hapur në shkëmb të gjallë, ku mbaheshin shumë armë e munizione, me të cilat mbroheshin gropat dhe ajo anë e qytetit që është në drejtim të Bunës. Prej andej u vra një shumicë e madhe armiqsh, sepse nga të dalat e ndryshme të asaj llogoreje të rrëthuarit shtinin pareshtur kündër barbarëve, të cilët diku plagoseshin, diku binin të vdekur, diku merrnin arratinë. E atëherë komandantët e

shatorreve, ku me kërcënime e ku me inkurajime, i nxitnin radhët e ushtrisë së vet për betejë; asnjeri nuk falnin, përvèç të plagosurve; pra, ose duhej të suleshe mbi të rrëthuarit, ose përndryshe të priste jatagani i komandantit. Prandaj barbarët derdheshin të rrasur pas njëri-tjetrit e me shumicë mu te porta e madhe dhe te fortifikimet e saj; aty rroknin dërrasa, trarë e trungje dhe s'mund t'i shkulnin kurresti pa u dalë shpirti, d.m.th. ërisha mbeteshin të vrarë; aty të dy palët përlesheshin me shpatë.

Ndonëse të rrëthuarit ishin shumë më pak në numër, prapëseprapë asnje pëllëmbë vend nuk lëshuan; pastaj, duke qenë në një pozicion më të lartë, e përballuan atë sulm të tmerrshëm për shumë e shumë orë. Mirëpo, meqë e gjithë ajo përleshje ishte përqendruar te porta e lartpërmendur, kaq me shumicë ishin sulur barbarët tamam në atë vend dhe kaq të tmerrshme qenë armët e municionet e tyre, saqë shumë e shumë të krishterë mbeten të vrarë, shumë edhe u plagosën; kurse të tjerët, krejt të dërrmuar nga ajo përleshja e parreshtur, mezi ia dilnin të mbronin fortifikimet, sepse kishin mbetur edhe pak. Kur ja: barbarët të sulen mbi vendet e rojës, ngjiten atje lart dhe ngulin flamujt e vet ndër fortifikime. Sulltan Mehmetit, që prej një kulle vëzhgonte zhvillimin e betejës, iu bë zemra mal nga gëzimi, sepse kujtoi se tashmë qyteti ishte në duart e tij; por atij s'ia priste mendja se ç'do të bënин shkodranët me trimërinë e urtësinë e vet për mbrojtjen e qytetit. Mu në mes të sheshit të Shkodrës qëndronte e gatshme një turmë djemsh e burrash të fortë e të zgjedhur për t'u ardhur në ndihmë atyre që do të përballonin sulmet më të forta të armikut. Deri në atë çast fuqitë kishin qenë të mjafta, bile edhe të tepërtë, për mbrojtjen e ledheve dhe s'kishte qenë nevoja aspak që të vinte ndonjë ndihmë prej pozicionesh të tjera. Për këtë arsyе pozicionet e tjera të qytetit ishin forcuar e siguruar më së miri. Andaj i gjithë ai gëzim i sulltanit s'pati asnje bazë, sepse atij s'i shkonte mendja se ç'plane kishin bërë shkodranët e sé ç'aksione të shkëlqyeshme do të kryenin.

Ndërkaq të rrëthuarit lëshuan një britmë deri në kupë të qelliit; atë britmë e dëgjuan edhe djelmoshat e zgjedhur që rrinin atje në shesh: ishte shenja me të cilën kumtohej se armiqjtë kishin fituar dhe hipur në fortifikime e se të krishterët, krejt të lodhur e të rraskapur, po zmbapseshin. Atëherë djelmoshat e fortë, që mezi pritnin dhe digjeshin nga dëshira për t'u hovur kundër barbarëve, të lëshohen në pikë të vrapi drejt te porta e madhe, menjëherë i ngjiten stomit dhe, porsa

dëgjojnë trumbetën, ngulin aty në mes flamurin e Shën Markut dhe bëjnë copë e grimë flamurin e armikut, pa u trembur aspak nga armët e panumierta të turkut, dhe derdhen mu aty ku gjendej shumica më e dendur e ushtrisë turke, duke bërë në asgjë fuqinë e sultanit. E me çfarë furie turren ata djelmosha kundër mizorisë së sultanit dhe kundër besimit të keq muhamedan; ata me se të munden: a me shpata, a me shigjeta, a me gurë, a me topa zjarri, a me strehë, a me trina e me mjete të tjera të ndryshme e shtrijnë armikun përdhe, e shpartallojnë, e copëtojnë; ia shkuliu duarsh flamujt, e përzënë përtjej gropave, vrasin e presin cilindo që të gjejnë, sado që të jetë trim e i fortë. Barbarët, të tmerruar nga ky sulm, ua mbathin këmbëve dhe me të shpejtë shkojnë e futen ndër shatorre. Shkodranët u lëshohen në shpinë me qëllim që të hapej shtegu për t'u kthyer në qytet. Atëherë sultanit, që deri atëherë ishte gjithë gëzim me shpresë se do ta shtinte në dorë qytetin, i ra një hidhërim kaq i fortë dhe kaq e breu inati, saqë si i tërbuar u drejtua në shatorren e vet pa hapur gojë aspak. Atëherë shkodranët, që korrin atë farë fitoreje, plot entuziazëm e në mes të brohoritjeve e të duartrokitjeve, kthen në qytet me gjithë atë plaçkë lufte, që ia kishin marrë armikut, edhe me disa koka të prera, të cilat i varën në fortifikime me qëllim që t'i kallnin atij tmerrin. Sakaq ata djelmosha vrapijnë në kisha e altarë për të falënderuar të madhin zot që me mirësinë e vet të pamasë u kishte dhënë zemër e fuqi të jashtëzakonshme dhe e kishte dëbuar armikun jashtë ledheve të qytetit, duke bërë kërdinë mbi të. Gjithashtu falënderojnë edhe Zonjën e Papërlyer, së cilës i këndoja në himnë të shenjta, sepse disa të krishterë shumë të devotshëm e kishin parë zonjën shën Mëri duke ruajtur muret dhe fortifikimet; bille, sikurse kanë déshmuar vetë armiqtë, mbasi është marrë Shkodra, shën Mëria u është dukur edhe vetë barbarëve nën fytyrën madhështore të hyjnive, duke i mbrojtur të krishterët. Veç asaj shumë qytetarë rrëfenin se Nëna e Shpëtimtarit tonë u ishte dukur atyre edhe në gjumë, për t'u dhënë zemër që të luftonin trimërisht dhe për t'u premtuar se fitoren do ta korrin ata. Në fund falënderuan edhe shën Mérinë Magdalënë, sepse, pikërisht ditën e festës së vet, kishte dhënë ndihmën e vet bashkë me mbretëreshën e qillit.

Mbasi mori fund luftimi i asaj dite plot trimëri e heroizëm, pushoi poterja e çdo gjë ra në qetësi. Të gjithë ata që u trajtuan trima të fortë, u lavdëruan përparrë të tjerëve për meritat e tyre. Në mbledhje u ngritën deri në quell me lavde ata ushtarë që kishin mbrojtur ledhet me burräri e heroizëm dhe

iu dha zemër të gjithëve për aksione të tilla. Të plagosurve e të gjymtuarve iu bënë mjekimet e duhura, grumbulluan në një vend kufomat e atyre që kishin rënë heroikisht në luftë dhe gjymtyrët e atyre, të cilëve u ishin shpërndarë andej e këtej nëpër pullaze e rrugica të qytetit nga gjylet e topave; dhe u porositën meshtarët që t'u bënин funeralet e duhura. Atë ditë kishin mbetur të vrarë rrëth katërqind veta nga të rrëthuarit, por plagosur ishin të gjithë; asnjë s'kishte shpëtuar pa një plagë; kurse nga ana e barbarëve, sikurse e po-huan ata vetë, kishin mbetur të vrarë më shumë se dy mbëdhjetë mijë veta; të plagosurit qenë të panumërt. Gjatë betejës, prej poteres së madhe, prej rrëmujës e prej gjithë asaj kërdie që u bë atë ditë, askush nuk pati mundësi të numëronte me saktësi të shtënat e artilerisë armike kundër të rrëthuarve. Ishin disa që thoshin se atë ditë artileria turke pas-kësh shtënë kundër kështjellës më tepër se njëqind e gjashtë-dhjetë herë e të nesërmen nëntëdhjetë e katër herë. Mbas dy ditëve, d.m.th. më 5 gusht, njëqind e tridhjetë e katër herë, të nesërmen njëqind e dyzet e pesë herë e prapë të nesërmen njëqind e gjashtëdhjetë e pesë herë. Përmbi të gjithë, ai lloj topi, që e quajnë mortajë, i kallte tmerrin mbarë popullsise dhe shkaktonte dëme të mëdha. Ata që ishin gjithnjë në këmbë, ose mbeteshin të vrarë prej mortajës, ose endeshin poshtë e lart në pikë të vraptit. Ata që dergeshin në të shtruara ose se ishin të plagosur, ose se ishin të sëmurë, porsa dëgjonin oshëtimën e atij topi, aty për aty brofnin në këmbë krejt të trullo sur dhe, veshur e ngjeshur si mos më keq, dilnin prej shtëpie dhe kërkonin gjoja strehim e shpëtim ku të mundnin e disa (gjë që shumëkujt ndoshta do t'i duket e çuditshme), duke qenë me ethe të forta në shtat, bëheshin më mirë e shë-roheshin në atë farë ngushtice e paniku.

Ndërkaj sulltani turk, për të cilin ju thashë se ishte bëre tym e flakë nga zemërimi, mbasi rënkoj pér dy ditë e dy net brenda shatorres së vet, në daç se u bë gjak i madh në ushtrinë e tij, në daç se punët gjithmonë i kishin shkuar mbarë, kurse kësaj here i ishte dhënë e mbrapshëta, ishte ndezur e bëre gjithë vrer kundër shkodranëve, sidomos se s'kishte më asfarë shprese pér të pushtuar qytetin, coi e thirri dy komandantët: pashanë e Rumelisë dhe atë të Anadollit bashkë me dy këshilltarë dhe bashkë me ata mori vendim që rishtazi të fillonte një sulm krejt i ri, sepse thoshte se ishte e pabesueshme që shkodranët, të këputur e të shtetur prej terë asaj kërdie, prej gjithë atyre plagëve e përleshjeve, të kishin mundësi të qëndronin e të luftotonin përsëri. «Tashfi, — tha ai, — fare lehtë

do ta korrim fitoren, sepse tē rrrethuarit, që pērpara ishin aq tē fortē, tan i janë shkrirë e kanë mbaruar krejt; edhe atë energji e fuqi që kishin më pērpara, e shkrinë fare ndër sa luftime që u bënë, prandaj ushtarët tanë do tē futen në qytet pa kurrfarë vëشتirësie.» Mendimin e sultanit tē gjithë e miratuan dhe menjéherë u mblodhën aty gjeneralë dhe komendantë tē tjerë dhe sultani dha tē gjitha porositë e duhura pér çdo gjë që kishte tē bënte me veprimet ushtarake. Në fund e gjithë ajo mori ushtrie u derdh aty rrreth e pérqark sultanit, tē cilit i rrinin pranë krerët e ushtrisë pér tē mbajtur disi larg tē gjithë atë turmë njerëzish, e atëherë sultani urdhëroi që t'i linin ushtarët tē afroheshin, sepse ishte një çështje me shumë rëndësi dhe, i mbështetur siç ishte në një fron tē lartë, mbajti këtë bisedë: «Burra e ushtarë tē mi! Unë kurrë nuk do ta harroj se si ju bashkë me mua keni derdhur gjithë atë mundim e djersë, keni luftuar, keni kaluar rreziqe e kapërcyer vëشتirësi e pengesa shumë e shumë tē rënda e gjithnjë keni qëndruar me moral tē lartë, s'ju ka lëshuar aspak zemra dhe, sa herë që e ka kërkuar nevoja, keni vënë jetën në rrezik pa ju trembur syri aspak e gjithmonë, falë perëndisë, kemi dalë ngadhënjyes. Po pér këtë arsy unë me gjithë qejf ia nisë kësaj fushate, i mbështetur në fuqitë tuaja dhe me shpresë se ju do tē ishit po ata që keni qenë gjithmonë në sa e sa beteja tē tjera. Mirëpo unë quditem se si sot ju ka lëshuar zemra në një aksion kaq tē lehtë e thuajse tē përfunduar; çuditem se si ju mungon ajo forcë e zakonshme pér tē thyer disa njerëz, që thuajse janë tē thyer e tē stérthyer, tē këputur e tē rraskapitur. Vallë, a ka gjë më tē lehtë e më tē kollajtë sesa tē thyesh një tē këputur e tē shkallmuar, që s'mund tē luftojë më vecse kërkon tē dorëzohet vetë? Edhe s'keni përsë tē çuditeni, o burra, në qoftë se nuk arritet t'i futeshit qytetit përbrenda në këtë betejën e fundit, sepse (sikurse e dini ju vetë) nuk e sulmuam qytetin ashtu siç duhej, por zhvilluam njëfarë beteje shumë tē lehtë, pa farë rregulli e si në rrëmujë, si hajdutë: ai s'qe një luftim i vërtetë, pér arsy se nuk merrte pjesë e gjithë ushtria, as nuk u mbajt ndonjë rregull e disiplinë; as nuk u radhitën ushtarët ashtu si duhej. Pastaj, atje në kësh-tjellë ishin ngjitur pak veta, kurse tashti në këtë luftim që do tē fillojmë, duhet tē marrin pjesë tē gjithë sa janë prej më tē madhit e deri te më i vogli; duhet tē bëhet një marshim i rregullt. Asnjë s'duhet tē refuzojë, asnjë s'duhet tē mabetet ndër shatorre, tē gjithë do tē luftojnë, s'ka më asnjë justifikim as pér ushtarët e fortë tē gardës sonë, as pér ata që janë nën komandën e gjeneralëve, tē kumandarëve, as pér ushtarët e

thjeshtë, as për skllevërit, as për të lirët, as për të mëdhenj, as për të vegjël. Të gjithë duhet të shtrëngohen mirë ndër armë, të gjithë duhet të jenë të gatshëm për luftim; tashti unë do të shoh se kush është burrë, kush është trim e luftëtar i vërtetë; tashti do të shoh se kush e meriton shpërblimin që do të jap. Le të caktohen anët e qytetit që duhet të sulmohen me turma të mëdha. Ushtria duhet të radhitet mirë për betejë dhe të ndahet në reparte. Të caktohet përpara mënyra e sulmit dhe në ç'moment duhet të bëhet.

Taborët dhe repartet të ndahen ndër krahë. Njëra palë duhet të zëvendësojë palën tjetër; ata që janë të freskët në forcat e veta të zëvendësojnë të lodhurit; ata që janë shëndo-shë e mirë, të zëvendësojnë të plagosurit. Çdo gjë të kryhet ballëhapët, në rregull e me disiplinë. Pashai i Rumelisë bashkë me gardën time të marrë përsipër gjithnjë atë anë, që kishëte në luftën e mëparshme, kurse pashai i Anadolit të sulmojë me pjesën tjetër të ushtrisë anët e tjera të qytetit. Të kuptohet mirë urdhri që po jap: të gjithë duhet të armatosen e të hidhen në betejë; për këtë s'ka asnje justifikim.»

Pastaj vetë sulltani nisi të tregonte se çfarë çmimesh do t'u jepte ushtarëve; ç'shpërblime do t'u jepte atyre më trimave që do të hipnin të parët mbi ledhe, ç'shpërblime do t'u jepte atyre që do të kryenin ndonjë aksion heroik; skllevërve u premtoi liri e grada, kurse atyre që kishin fituar më përpara grada e ofiqe të mëdha e kushedi se ç'tuju, u premtoi shpërblime edhe më të mëdha dhe u rrëfeu se secili prej tyre do të grumbullonte çmime e dhurata shumë më tepër sesa u kishte thënë ai me gojë të vet; sulltani donte që ata të shpresonin se do të merrnin shpërblime shumë më tepër sesa u kishte premtuar. Pastaj i porositi që të tregoheshin trima, të merrnin zemër e fuqi, të mos përkuleshin përpara rreziqeve të mëdha. Sulltani u tha se fitoren e kishin të sigurt, sepse tashmë garnizoni i qytetit ishte dobësuar dhe ishin hapur shumë shtigje për t'iu futur brenda, mbasi vendet e rojës ishin braktisur dhe muret ishin dërrmuar e shembur përdhe nga artilleria. E, në qoftë se aty në kështjellë kishin mbetur gjallë disa të rrëthuar, tashmë kishte prova të gjalla se edhe ata pak veta ishin të këputur e të rraskapitur, me një këmbë mbi dhe e me një nén dhe, ishin të shkallmuar e të plagosur. Në fund shtoi edhe këto fjalë: «Me ndihmën e perëndisë sonë, që na premton lumturinë dhe lavdinë e amshuar, hidhuni në betejë, suluni trimërisht mbi të rrëthuarit; hakmerruni rreptësisht për dhunimet që ju janë bërë, merrni gjakun e shokëve tuaj, se në këtë mënyrë do të fitoni lavdë e nderime, në këtë mënyrë

do të fitoni grada e shpërbërime sa ujët. Të gjitha pasuritë e qytetit për ju do të jenë.» Kur sulltani i dha fund kësaj bisede, të gjithë barbarët miratuan njëzëri fjalët e tij dhe aty së bashku u betuan se do të bënин kërdinë mbi shkodranët.

Ndërkaq sulltani dha urdhër që të gjithë të përgatiteshin për betejën e afërme dhe barbarët gjithë gëzim e hare u përgatiten dhe rrokën armët menjëherë edhe shumë më tepër se përpara digjeshin nga dëshira për të hyrë në luftë sa më parë. Nga ana tjetër të rrëthuarit, kur e morën vesh atë urdhër (sepse disa prej tyre e njihnin turqishten), e kuptuan fare mirë se ç'përlleshje i priste e çfarë shpejtësie e shkathëtësie duhej tashti. Prandaj përgatitën me kujdesin më të madh çdo gjë që kishte lidhje me mbrojtjen e qytetit; për ata kishte një rëndësi të dorës së parë edhe fakti se armiku s'kishte se si t'i përbuzte, bile trimëria e tyre për armikun ishte bërë diçka e tmerrshme. Më së pari, sipas zakonit, ata i drejtohen me lutje të madhit zot, bëjnë kuştime për të dalë ngadhënyes; me uratë kërkojnë ndihmën prej Zonjës së P-apërlyer; zemra u thotë se do fë korrin fitoren mbi armikun, të cilit nuk i tremben aspak, por, të mbështetur në ndihmën hyjnore, dëshirojnë të përleshen me të, sepse kanë besim të patundur në fuqinë e trimërinë e vet. Tanimë ata ishin të bindur se mbi barbarin do të bënin kërdi shumë më tepër se përpara e se ky armik do të dilte me turp (e me çfarë turpi) prej asaj beteje. Tashti turqit, sipas urdhrit të sulltanit, ishin radhitur për sulm; vetëm ata pritnin, sipas zakonit të vet, që të dilte hëna e re. Edhe në të vërtetë turqit zakonisht ia nisin luftimit, që ata e quajnë të përgjithshëm, pikërisht mba-si del hëna e re, dhe i falen. Prandaj ditën e shën Pantaleonit, që ishte ditë e kremte, d.m.th. pesë ditë pas betejës së fundit, barbarët zunë t'i ngjiteshin kodrës të rrasur njëri pas tjetrit nga të gjitha anët dhe ta qarkojnë me pahisore në çdo anë; dhe mbanin mbi krye hunj, strehë, shtretër xunkthash për tu mbrojtur. Aq e madhe që e gjithë ajo mori njerëzish, që u lëshuan nga të katër anët, saqë u mbulua krejt kodra dhe një pjesë e fushës thuajse për nja një mijë hapa. Aq ishin të dendur e të ngjeshur ushtarët njëri pas tjetrit, saqë, siç thotë një fjalë popullore, s'kishte se ku të binte kokrra e melit; asnjë s'kishte qëndruar as për rojë pranë shatorreve. Ashtu të rrasur turqit arritën deri te gropat dhe zunë vend te stomi. Po të kishte dalë ndonjë nga të rrëthuarit atje mbi fortifikimet e mbi pozicionet e mbrojtjes, ose do të kishte mbetur i vrarë, ose do të ishte plagosur shumë rëndë. Aty turqit deri në mbrëmje vonë s'i lanë aspak në qetësi të krishterët, por i

gjuajtëن me gjithëfarë armësh e me shigjeta e, duke i sharë e duke i përbuzur gjithnjë, i ftonin për t'u përleshur. Mirëpo në orët e para të natës nga të katër anët u dëgjuan zëra e britma: turqit kishin rënë përmbysh dhe po i falestin hënës. Hoxhallarët filluan të këndonin e atëherë e gjithë ajo mori njerëzish lëshoi një klithmë aq të tmerrshme, saqë të dukej se qelli e dheu po shungullonin. Ndërkëq fra Bartolomeu i urdhrit të shën Françesku, njeri shumë i devotshëm, për të cilin kemi folur edhe më përpëra, i hipi kalit e i ra qytetit kryq e tërthor duke kontrolluar me kujdesin më të madh të gjitha fortifikimet bashkë me Nikollë Monetën, kapidanin e kalorësve, trim mbi trima edhe shumë i zoti në artin ushtarak. Si njëri, si tjetri shkonin duke u dhënë zemër popullit e ushtareve që të qëndronin si burra dhe të luftonin deri në fund për fe e për atdhe.

Sikur të donte kush ta krahasonë fra Bartolomeun me ndonjë tjetër, mund të thoshte se ky njeri qe tamam si Johan Kapistrani⁹⁷), i cili në rrëthimin e Belgradit atje mbi brigjet e Danubit luftoi kundër turqve, sepse edhe aty, për hir të shenjtërisë së tij dhe të lutjeve të tij, panonët, luftëtarë e trima të fortë, bënë kërdi mbi barbarët e i shpartalluan fare. Po ashtu edhe fra Bartolomeu gjithë asaj nate s'bënte tjetër veçse u jepte zemër të rrëthuarve e gjithnjë lutej e këndonte himne të shenjta; e, në qoftë se u lirua Shkodra, i duhet ditur shumë për nder edhe fra Bartolomeut. Pra, përpëra se të fillonin turqit sulmin e tmerrshëm, fra Bartolomeu iu lut të madhit zot që t'i falte e t'i shpëtonte besnikët e vet; këshilloi edhe popullin e Shkodrës që t'i drejtonte perëndisë së vërtetë këngë e lavde, kurse lutjet e kota e boshe të barbarëve i vinte në tallje.

Lutja e tij qe kjo: «O zot i gjithëpushtetshëm e i mëshirshëm, o zot i ushtrive, atë e krijues i gjithësisë, sundues e rregullues i mrekullueshëm, që ke në dorë të gjitha pushtetet dhe tagret e të gjitha mbretërive, ti që na vure ne mëkatarët e shkretë në këtë farë sprove, ti që nuk lejon kurrë t'i bëhet ndokujt ndonjë dhunë e turpshme, drejtoji, të lutem, sytë e tu mbi ne dhe ki mëshirë për të krishterët e tu, të cilët të gjithë shpresën dhe besimin e vet e kanë mbështetur vetëm e vetëm në dashurinë, në mirësinë dhe në fuqinë tënde të pamasë, me qëllim që dora jote e tejfuqishme t'i ndrydhë barbarët, të cilët të gjithë shpresën e kanë mbështetur në mizorinë e vet. O Jezus, i biri i Davidit, ndihmona ne mëkatarët, mbrona dhe ki mëshirë për ne e për mbarë popullin tënd të krishterë, për të cilin nuk kurseve as gjakun as jetën. O shpëtimtari

ynë, eja e ngjitna dorën, sepse dallgë të mëdha po na përpjijnë gjallë. Po s'erdhe e s'na dhe dorën, humbëm fare, mbaruan. Vetëm ti je shelbuesi ynë, ti vetëm mund të na shpëtosh. Ja Orku, ja Pluti⁹⁸), të gatshëm pér të na gëlltitur. Ja, po çahet, po hapet toka pér të na përpirë. Shiko se ç'janë tërbuar e bërë të furishëm barbarët, të cilët po sulen pér ta prishur e pér ta shkatërruar fenë tënde të shenjtë. E bash pér këtë fe ti, o shpëtimtari ynë, i the shën Pjetrit «Pér ty, o Pjetër, u luta me qëllim që të mos cenohej e të mos dobësohej besimi yt.» Tashti, pra, o zot i gjithëpushtetshëm e shumë i mëshirshëm, mos vono, por na eja në ndihmë e rrëthona me murin tënd të pathyeshëm, mbroña më armët e tua të fuqishme.

O zot i Izraelit, po të thërrasim në ndihmë, librona. Jepi nder e lavdi emrit tënd, bëj një mrekulli pér ne, që, pér të ruajtur fenë e besimin tënd të shenjtë, po durojmë mbi kurrizin tonë gjithë këtë stuhi mizore, gjithë këtë shkatërrim e gjakderdhje. Lejoje, të lutem, engjëllin tënd ndëshkimitar që të vijë e ta ndrydhë, ta shpartallojë e ta shfarosë armikun tënd, turkun, pikërisht ashtu si ndodhi me çlirimin e popullit tënd izraelit nga mizoria e Senaharibit⁹⁹), në ushtrinë e të cilit, sipas urdhrit e vullnetit tënd, engjëlli yt pati vrarë vetëm pér një natë njëqind e tetëdhjetë mijë veta; vepro me ata, o zot, sikurse me Madien e Sysarin, sikurse me Jabin te pérroi i Cysonit, ata u shpartalluan në Endor dhe u bënë si plehu i tokës. Dërrmoji krerët e 'tyre sikurse Orebin e Zebin e Zebenë e Salmanin». Pastaj iu drejtua Virgjinës së Papatryieme me këtë lutje: «O Virgjinë e lavdishme dhe e lumtur, nëna e të madhit mbret, mbretëreshë e qiellit, e dheut dhe e detit, mikpritësja, shtylla dhe mbrojtja jonë, përvuajtërisht kërkojmë mëshirën tënde që t'i ndihmosh të krishterët e tu besnikë, të cilët, pér të mbrojtur nderin dhe fenë e shenjtë të tét biri, një të vetmi, po luftojnë pa pushim me sa fuqi që kanë. Këta besnikë rë gjithë shpresën dhe besimin e vet e kanë mbështetur vetëm e vetëm në fuqinë e lartë dhe në mëshirën e birit tënd, mbretit të të gjithë mbretërve, gjithashtu edhe në lutje, ashtu edhe në përkrahjen e ndihmën e madhërisë e të hyjnës sate. Vetëm ti mund të na ruash e mund të na shpëtosh nga mizoria e barbarizmi i turqve të pashpirt e të tmerrshëm. Ti nga yt bir mund të kërkosh çdo nder; çdo gjë të lejohet; mjafton që të duash ti. Ndihmona, pra, e dilna zot, o mbretëreshë e perandoreshë (sepse puna nuk pret aspak); shkurtoja krahun mëkatarit dhe armikut shpirtlig. Preja hovin dhe dërrmoja, thyje fuqinë, merrja drithën

e syve, lidhe këmbësh e duarsh, sepse nuk e duam zotërimin e një kombi aq mizor e të prapë.»

Në këtë ndërkokë zuri të fryjë një erë kaq e madhe, saqë as në stinën e dimrit nuk e ka zakon të fryjë në atë mënyrë. Aq e fortë qe ajo erë, saqë, me sa thonë, dukej sikur donte ta shkulte qytetin mbarë. Atëherë barbarët, që tërhiqen lehtë nga bestytnitë dhe i vërejnë me èndje oguret, menduan se do të fitonin epërsinë në atë luftim dhe do të dilnin fitues, sepse edhe era rrithët më tepër vendet e larta edhe frynte gjithnjë përkundrejt qytetit, duke marrë me vete vendet e rojës dhe të mbrojtjes, ku qëndronin të rrëthuarit, të cilat mjaft po i vriste ajo erë. Gjithnjë të shurdhonte klithma e turqve deri në kuptë të cilëllit dhe fishkellima e tmerrshme e asaj ere, përvog kërmës së armëve dho plasjes së topave, sikur shungullonin malet përreth. Edhe në ato orë që janë më të qëta, cdo lëvizje e zhurmë dëgjohet më lehtë, kështu që kisha përshtypjen se po binte ndonjë tërmët i madh dhe se po lëkundej e po çuhej toka deri në qendër të vet. Barbarët gjithë natën një çast s'pushuan së gërrhituri. Kur ja, porsa filloj të zbardhë pak drita (sikurse besohet), bëri zoti mrekulli dhe ajo erë e fortë ndërroi drejtim e zuri të fryjë fare poshtë, tamam kundër turqve, të cilët, derisa doli dielli, filluan të hutoheshin dhe u shpartalluan për turp prej të kristerëve, të cilët bënë kërdi mbi ta me ndihmën e asaj ere dhe fituan. Veç asaj, prej fesë së gjallë që u tregua, ndodhi edhe një mrekulli: gjatë gjithë asaj nate u panë duke shkëlqyer aty-këtu nëpër vendet e rojës dhe në fortifikime disa drita në majë të heshtave, të shtizave, të shtëpive; duhet të besohet se ato drita u dukën aty për hir të perëndisë si në shenjë ngadhënjimi. Edhe të mos kujtojë kush se në këtë drejtim gjënjehet mendja e njeriut, se ka diçka të pathemel, sepse një gjë e tillë thonë se u ndodh shpesh edhe barkarëve në det, të cilët, kur i ka zënë ndonjë stuhi e madhe, vetë e kanë dëshmuar se kanë parë mu në anijen e vet drita dhe qirinj të ndezur, ndërsa i kërkonin ndihmë dhe i luteshin shën Nikollit ose shenjtorëve të tjera. Ndonëse antikiteti i rremë e plot bestytni një gjë të tillë ua atribuon Kastorit e Poluksit, kurse Plini thotë se në madhështinë e natyrës ekziston diçka e fshehtë, fakti është se shkodranët, nga ai fenomen që u duk, morën zemër e u mbushën me shpresë dhe nuk u trembën aspak nga britmat e ulërimat e vazhdueshme të barbarëve, të cilët vikatin gjithnjë me qëllim që të mbillnin panik kudo; bile të rrëthuarit nga kjo merrnin edhe më zemër. Ata gjithë një u luteshin Krishtit, Nënës së Papërlyer, shën Markut e

shën Shtjefnit dhe rrinin në rojë më me shpirt e me entuziazëm, duke mos i lënë asgjë mangët shërbimit për sa i takonte mbrojtjes së qytetit; nuk pushonin një çast, se fitoren e kishin në dorë në saje të kushteve, të lutjeve dhe të veprës bujare që po kryenin. Ata ishin të bindur, gjë që e provojnë edhe vetë faktet, se i madhi zot nuk u vjen në ndihmë përtacëve e të ngathtëve, por vetëm atyre që punojnë e qëndrojnë gjithnjë të gatshëm. Prandaj disa prej tyre rregullonin rishtazi stomini dhe fortifikimet; disa vendosnin në pozicionet e duhura artillerinë, disa të tjerë përgatitnin mjetet e mbrojtjes dhe mbushnin vorbat me gëlqere, lyenin shtambat me vaj, zift e rrëshirë; mbushmin vozat dhe enë të ndryshme me barut e me gurë, s'kishte njeri që të mos ishte i ngarkuar me një punë. Të gjithë ishin dhënë me mish e me shpirt për të përgatitur sa më parë q'ishte e nevojshme për betejën e afërme; nuk linin asgjë pa provuar dhe çdo gjë që ishte e domosdoshme e kryenin me kujdes të madh; i jepnin zemër njëri-tjetrit; qëndronin të fortë dhe plot gjallëri, nxitnin shoqi-shoqin përfitore.

Të njëjtin qëndrim burrëror mbanin edhe gratë, të cilat në çdo pikëpamje s'u lëshonin rrugë burrave a për zell, a përgatishmëri, a për punën e pareshtur për të përgatitur çdo gjë që kishte lidhje me shpëtimin e atdheut. Gratë, natyrisht, si seks i butë, meritojnë lëvdata të veçanta për veprime të tillë. Ato bashkë me burra u ngjiteshin fortifikimeve, luftonin trimërisht me armikun; shumë prej tyre mbeten të vrara nga artleria.

Sulltani e kishte caktuar sinjalin për fillimin e luftimit, d.m.th., porsa të dëgjoheshin në të zbardhur të dritës plasjet e artilerisë, ushtria turke do të hidhej jashtë fortifikimeve, do të sulej kundër të rrethuarve dhe t'u ngjitej me guxim vendeve të mbrojtjes dhe do të orvatej me të gjitha fuqitë përtë shtënë në dorë qytetin. Të krishterët e dinin fare mirë se, si zakonisht, barbarët do ta nisin betejën në të gdhirë dhe do t'i vërsuleshin qytetit, prandaj, si të regjur që ishin, rrinë të gatshëm për t'u përleshur me armikun kurdoherë dhe e pritnin prej një çasti në tjetrin, sidomos te fortifikimet dhe te pirqjet e portës së madhe, ku ishte përqendruar fuqia më e madhe ushtarake, sepse aty ishte çelësi i gjithë betejës (kurse, siç thamë, pozicionet e tjera të qytetit ishin mjaft të sigurta e të forta). Vlonte puna në të katër anët. Të gjithë ishin me krye në rrezik; aty kishin ardhur ushtarë turq ku ishin më trimat, aty do të vinte me të gjithë suitën e vet edhe vetë sulltani. Megjithëse në atë vend gjendeshin edhe

ushtarë italianë e marinarë, prapëseprapë pjesa më e madhe e ushtrisë përbëhej nga qytetarët, aty ishte grumbulluar edhe një repart shumë i fortë djelmoshash fshatarë. Aty ndodhej edhe vetë komandanti i qytetit, tek i cili rastësish u fol se kush do të hipte i pari bashkë me repartet e veta atje mbi stom, t'i priste turrin e parë armikut e të përleshej me të, sepse sulmi e hovi i pari i barbarit është përherë shumë më i tmerrshëm. Natyrisht, ata që janë më të fortë e më trima, hyjnë të parët në një betejë të tillë; ata përpinqen ta kryejnë punën e vet edhe me tri sulme. E, në qoftë se nuk arrijnë të kryejnë punë në çaste të tilla, atëherë fillojnë të lodhen e të bëhen më të dobët dhe në fund dështojnë thuajse fare. Të dy palët kundërshtare qëndronin të gatshme për betejë. Në anën e të krishterëve, ndonëse s'kishte asnë që të mos e garantonte privilegjin për t'u përleshur i pari me armikun, megjithatë brofi aty në mes përpara të gjithëve Jakob Moneta, një qytetar fisnik e trim mbi trima, i cili, si burrë i pjetur e i urtë, i mbërthyer në armë për bukuri dhe shumë i zoti në artin ushtarak, dallohej ndërmjet të tjerëve; shtatin e kishte selvi, ishte njeri i gojës e prej familjes kishte trashëguar të gjitha të mirat. Kur po mungonte edhe pak kohë për të hyrë në një përleshje të tmerrshme me armikun, Jakobi kerkoi që të printe ai i pari me njerëzit e vet në atë luftim; ai kishte me vete më tepër se nja njëqind veta; të gjithë djem të rinj e të fortë, qytetarë e fshatarë bashkë. Aty ndodhej edhe vëllai i tij, Moncini, edhe ky mjaft trim, i zoti dhe shumë i zellshëm kur ishte puna për të rregulluar fortifikimet dhe sillej bujarisht si me qytetarët ashtu dhe me ushtarët. Mirëpo të gjithë pranuan me gjithë qejf Jakobin, sepse kishte autoritet e rëndësi, gjithashtu kishte kryer aksione të shkëlqyera në sa e sa beteja edhe më përpara. Jakobi, pra, mbledhi repartin e vet dhe filloi t'i ndizte të gjithë për betejë dhe t'i entuziazmonte për fitore me këtë bisedë.

«Burra, ju e keni provuar dhe e dini mirë se sa ju çmon sulltani ju dhe trimërinë tuaj, sepse në këto ditë kushedi se me sa urdhra e kercënimë u është gërmushur njerëzve të vet dhe i ka detyruar të gjithë, pa asnë përjashtim, për t'u flakur kundër jush; e, derisa, sulltani vë në dukje ngathësinë e njerëzve të vet, ai njëkohësisht rrëfen edhe frikën e vet; nga ana tjetër tregon edhe se sa ju çmon ju. Ai nuk mbështetet në trimërinë dhe në fuqinë e ushtarëve të vet, që i ka mbledhur e përzier nga të gjitha kombësitë; pastaj mendoni se ai të gjithë ushtarët i ka ushtarë të thjeshtë dhe sklevë, ata janë të pastërvitur dhe s'kanë fare dijeni për

artin ushtarak; sulltani kujton se mund t'ju tmerrojë vetëm e vetëm më numrin e ushtarëve. Po ku kujton ai se mund t'a arrijë qëllimit në këtë mënyrë? Derisa s'qe i zoti të na shtinte në dorë me ushtarë veteranë e të vaditur, ku kujton ai se mund të na thyejë tashti me një ushtri të dobësuar e me një grusht mjetesh luftarake? Ju e dini, o burra, se, sa herë që kemi hyrë në luftë e jemi përleshur me armikun, gjithmonë e kemi thyer e kemi bërë kërdi mbi të, e kemi ndjekur me turp deri te shatorret e mëdha. Ajka e ushtrisë turke tashmë është shuar; veteranët dhe trimat luftëtarë turq thuajse të gjithë janë vrarë. Mos kujton ndoshta sulltani se do të futet në qytetin tonë me lundërtarë, me druvarë e me gjellëtarë? Mund të besohet se turku deri tashti do të ishte larguar prej këtej, sikur të mos i kishte ardhur turp e turp i madh? Tashti sulltani po vë në veprim gjithë dredhinë dhe mprehësinë e mendjes së vet. Kjo është përpjekja e fundit e tij; ai nuk do të orvatet më pér ndonjë sulm tjetër. Ju e patë se ai nuk nxori asnje fryt me dhëlpërinë dhe dinakërinë e vet, dhe besomëni së as këtej e tutje nuk do të nxjerrë asgjë në dritë (sepse ne na ka në dorë perëndia). Tashti s'mbetet tjetër veçse të shtrini sot përdhe edhe ata njerëz që kanë shpëtuar pa u vrarë. Barbarët të gjithë i ka lëshuar zemra dhe i ka kapur tmerri, sepse e njohin mirë trimërinë tuaj, i kanë prouuar fuqitë tuaja. Ata ju kanë frikë; ata luftojnë me pahir, sepse janë të detyruar. E shikoni se si hidhen kundrejt vdekjes? Tamam si bisha të egra. Sulltani i flak në prehër të mortjes sikur të ishin dhen e asgjë tjetër. Pa le të më thotë një herë ai që gjykon me mend: Çfarë heroizmi mund të kryejë një njeri frikacak që lufton me përdhunë? Drejtoni, pra, sytë tuaj, o burra, nga familjet tuaja, nga atdheu juaj, që sot duhet të mbrohen me zjarr e hekur! Kini mëshirë pér gratë tuaja, pér fëmijët tuaj, që i rritët e i edukuat me aq mundim, me aq zell e kujdes! Mos i lëshoni nën zgjedhë e në robëri, sepse barbari s'ka farë dhimbjeje e mëshire. Sot do të marrin fund sprovat tuaja; mos i lëshoni asnje pëllëmbë vend armikut, sepse është dobësuar, s'ka fuqi të luftojë. Po u zmbrapsët, të gjithë do të thereni si bagëtia; s'keni se ku të ikni; pér atë mos mbani asnje shpresë, as ka se kush t'ju vijë në ndihmë. Shpëtimin tuaj, të atdheut e të fëmijëve vetëm ju sot e keni në dorë; në qoftë se do ta përbalлони armikun si trima të fortë që jeni, armiku do të largohet prej jush. Mos kujtoni se turqit janë të pathyeshëm; ata mund të thyhen fare mirë prej jush ashtu si i keni thyer sa e sa herë. Se sa të fortë janë turqit dhe armët e tyre, këtë e ka treguar trimëria juaj në

Rrethimin e Parë. Për besë, turqit nuk janë aq të fortë sa e kanë namin. E gjithë kjo mori ushtrie që ka ardhur të luftojë kundër nesh, nuk është aq e armatosur, s'është aq e aftë; ne do të kemi mundësi ta shpartallojmë pikërisht sikur të ishte një tufë dhensh. Mos u trembni nga poterja e tyre, nga ulërimat e tyre. Duhet shikuar më tepër cilësia, trimëria, sesa numri i madh. Fitorja nuk varet nga sasia e ushtrisë, ajo vjen me ndihmën e zotit. Perëndia sjell ngadhënjimin në daç me pak ushtarë, në daç me shumë. Kauza jonë është e Hyut; ne luftojmë për drejtësi, për ligjet hyinore, për fe e atdhe, për altarë e vratat tonë, për fëmijët tanë. Përkundrazi turqit na sulmojnë me të padrejtë për të shtënë në dorë diçka që s'është e tyre, por vetëm e vetëm pse kështu ia do qejfi një personi të vetëm, pse ai lakmon të sundojë, për këtë orvaten të na marrin jetën, të na lënë pa atdhe, pa gjë e mall. Qëndroni të fortë, pra, o burra, sepse ai zot, që ka në dorë gjithësinë e që s'lejon t'i bëhet ndokujt e padrejta, as të preket kush me forcë, ai zot do t'i shtypë armiqjtë këtu në sytë tanë; sot do të na sjellë ngadhënjimin prej qiellit. Ne patjetër fitoren e kemi në dorë. Po atëherë pse të trembemi? Pse të dyshojmë? Ne këtu jemi ajka e luftëtarëve, jemi pjesa më e zgjedhur e ushtrisë, jemi të stërvitur në armë; armë e municione s'na mungojnë, edhe dimë t'i përdorim si duhet. Pastaj ne na imbron vetë pozicioni i vendit, që vjen shumë lart e thikë. Atyre, duke u ngjitur përpjete, do t'u dridhen e do t'u këputen këmbët, do t'u dalë shpirti, do t'i kapë frika sikur të ishin fëmijë, do të heqin mundim të madh për të ardhur këtu lart, sepse kodra është mjaft e rrëpirët. Prandaj sot barbari do ta provojë mirë forcën tonë, sot do të provojë trimërinë e të krishterit, fenë e të krishterit, sot turku do të thyhet, sot do të bëhet copë-copë dhe do të shtypet tèrbimi i furishëm i sultani; sot do të shembet e do të perëndoje mendja e madhe e tij. T'i rrëmbejmë, pra, armët plot entuziazëm e t'u ngjitemi fortifikimeve si burrat, pa na u trembur syri aspak; t'i biem armikut me guxim e trimërisht. Sot duhet të shporrim këtë murtajë, këtë sëmundje, këtë epidemi, ta flakim atë jashtë qytetit tonë, jashtë krahinës sonë. Armiku është i dobët, ai nuk mund të na thyejë ne, veçse në daçim ne të thyhem prej tij; ai me sulmin e parë do të shpartallohet dhe do të marrë arratinë. Mos keni ndoshta ndonjë dyshim? Po pse, ç'na pengon ne? Ata barbarë, që deri tashti na kanë shpëtuar duarsh, një pjesë i ka zënë tmerri, një pjesë janë këputur e shkallmuar fare, një pjesë janë plagosur. Ata, përvëçse i ka kapur frika, janë edhe të carmatosur, ne për-

Kundrazi të gjithë jemi të ngjeshur në armë; ne jemi veshur e ngjeshur me pancirë, me parzmore e me tarogza ku janë më të mirat. Shtati ynë fund e krye është i mbërthyer në hekur. Kushdo prej nesh mund t'i bëjë ballë heshtës së hekurt ose katapultës.

Sot një i vetëm do të luftojë heroikisht kundër një mijë vetave. Ata në asnje mënyrë s'do të kenë mundësi të qëndrojnë; ata asgjë s'kanë të mbarë; përkundrazi ne po; ne gjemë ndihmë e mbrojtje kudo këtu rreth. E më parë na ndihmon e na mbron Virgjina shën Mëri edhe shën Nikollli. Shikjeni, burra, tempullin, kishën e këtij shenjtori; seç e dhu-nuan e seç e shëmtuan me artileri këta njerëz të pashpirt, këta rrënimqarë të gjérave të shenjta. Jo, o qytetarë, s'duhet kaluar në heshtje mrekullia që ky shenjtor pati bërë në Rethimin e Parë kundër barbarëve (sikurse e kanë dëshmuar edhe ata vetë): mu të parën gjyle, që vetë barbarët hodhën mbi këtë kishë, shën Nikollli e ktheu mbi kokat e tyre dhe bëri mjaft dëm mbi ta, sepse shumë prej tyre mbetën të vrarë. Drejtojuni, pra, o burra, me lutje këtij shenjtori, se edhe unë kam një nderim të madh për të. Të gjithë besimin tuaj ta mbështetni te shën Nikollli, sepse do të na ndihmojë; ai armët e armiqve do t'i kthejë kundër tyre; ai do ta copë-tojë artilerinë e tyre, fuqinë e tyre dhe do t'i shpartallojë. Shën Nikollli do të na mbrojë e do të na lirojë nga këta njerëz të pashpirt e mizorë, sot armiku do ta lajë fajin e kobeve të veta. Prandaj, o burra, sot që keni në ndihmë të madhin zot, gë-zoni e shendoni; vetëm atij sot këndo-jini lavde për këtë mirësi të madhe që po ju bën; sot nami juaj do të përhapet në të katër anët e botës, sot nami i qytetit tonë do të marrë dhenë, sot me ndihmë të zotit do të fitoni palmën e ngadhë-njimit e do të triumfoni mbi armikun me nder è lavdi. Ju sot do t'u rrëmbeni armiqve armë e plaçka, sot do ta shpëtoni fenë katolike, se shpëtimin e saj ne e kemi në dorë; sot do të madhërohet emri i shën Markut, mundimi e djersa juaj nuk do të shkojnë kot. Do të shpërbleheni më së miri, sepse Republika e Venedikut secilin prej jush do ta nderojë me ofiqe e çmime të larta. Të gjithë të krishterët do t'ju ngrenë deri në qiell dhe do t'ju këndo-jnë lavde për jetë të jetës. Rrokni, pra, shpatat përkundrejt barbarëve; hovuni me furi kundër hajdutëve dhe armiqve të pashpirt të fesë së vërtetë. Prejuani hovin armëve dhe zjarrit të armikut; t'ia thyeni ato mjete luftarake që ka. O ju gra e zonja, bjerini armikut me gurë dhe ta pikoni mirë! Turruni, bre djelmosha, mbi turqit! Se ja: po thyhen, po zmbrapsen, po ikin!»

Nga këto fjalë kaq u ndezën ata luftetarë me dëshirë pér të luftuar, saqë kishe përshtypjen se s'po drejtoheshin pér luftim, por pér ndonjë lodër, pa iu trembur syri aspak. Edhe ishin veshur e ngjeshur me armë pér bukuri, të gjithëve u qeshte buza; të gjithë ishin të gjallë e të sigurt pér fitore. Ndokush që do t'i kishte parë kaq entuziastë e të fortë, do të kishte thënë: A janë luanë këta apo çfarë janë? Mbasi i kryen ceremonitë fetare, vunë në ballë të ushtrisë flamurin me kryq e të gjithë vrapuan së bashku pér të luftuar.

Ndërkaq, pa dalë ende drita, sulftani u ngjit te qafa e Kodrës së Pashës, nga kishte zakon të vëzhgonte zhvillimin e luftimeve. Porsa zuri vend në pozicionin e duhur, artileria e rëndë shtiu njëmbëdhjetë herë dhe ajo e lehta dymbëdhjetë herë kundër fortifikimeve dhe mbrojtjeve të qytetit, të cilat filluan të shembeshin e të rrafshoheshin përdhe. Barbarëf, porsa dëgjuan ato të shtëna, u lëshuan fluturim nga të gjitha anët dhe me potere e britma të mëdha (siç e kanë zakon ata) rrethuan qytetin dhe hipën ndër mbrojtje e fortifikime; ata u treguan aq të gatshëm e të shpejtë, saqë e kishin zënë stomin e portës së madhe përparrë se ta zinin tanët dhe aty kishin ngulur flamujt e vet. Mirëpo atje vrapoi menjëherë Jakov Moneta, bashkë me repartin e vet dhe, kur pa armikun mbi fortifikime, iu drejtua të vete e u tha:

«Po ç'pritni, bre burra?» e, duke vringelluar shpatën, se koha s'priste, u lëshua si luan e u pëрlesh me armiqtë. Duhet ditur se aty ndodhej ajka e ushtrisë turke (sepse turqit e kanë zakon që në betejë futin më parë ata më trimat e më të fortët); këta, pér t'u kallur tmerrin tanëve, bërtitnin deri në kupë të qiellit, rrudhnik fytyrën pér shëmtim, shtati i tyre merrte një hixe të hatashme. Megjithatë aq i tmerrshëm që sulmi i atij udhëheqësi dhe aq e madhe trimëria e qëndresë e të krishterëve, saqë këta, pa iu trembur syri aspak, arritën ta shpartallonin armikun, mbasi ia hodhën përdhe flamujt, edhe bënë kërdi mbi të mu aty mbi fortifikime. Mirëpo barbarët s'mbaronin kurrë; gjithnjë vinin të rinj nga çdo anë pér t'iu vërsulur qytetit, prandaj duhej luftuar me ta gjoks pér gjoks, duhej përleshur me shpata e jataganë, e kështu threshin e vriteshin pér turp tamam si bagëtia. Dhe nuk i korrte vetëm shpata, por edhe topi, pushka e sa e sa armë të tjera; veç asaj kërdi të madhe mbi ta bënин edhe gurët, gëlqerja, zjarr, dhe kaq ishin të dendur e të rrasur njëri pas tjetrit, saqë një predhë e një shigjetë nuk shkonte bosh, pastaj as nuk mund të zmbrapseshin, sepse rrinin grumbull, me shumicë flate madhe. Pér këtë arsyë të krishterët morën zemër dhe flate madhe.

keshin në betejë më me guxim. Në këtë mënyrë, në të zbardhur të dritës, të dy palët po luftonin rreptë. Barbarët tri herë u zmbrapsën me turp deri te gropat dhe te stomet. Sa doli dielli, Jakob Moneta, i cili atë natë kishte luftuar heroikisht bashkë me repartet e veta, kur pa se disa nga njerëzit e vet ishin vrarë e disa plagosur, u ndez edhe më tepër me inat kundër armikut, megjithëse trupi i tij ishte fund e majë gjithë plagë e vrima e megjithëse ia kishte prishur shumë fytyrën barbari i fortë, të cilin e kishte shtrirë përdhe mu aty te stomi. Ndonëse Jakobi ishte i mbërthyer mirë në hekur e në armë (e me çfarë armësh!), prapëserapë nga të katër anët e trupit i shkonte gjaku rrëke si ndonjë krua. Dy herë kishte rënë përdhe prej shigjetavë dhe armëve të tjera të armikut dhe dy herë kishte brofur në këmbë dhe kishte qëndruar mirë. Me ndihmë të zotit aspak s'u përkul, por qëndroi i fortë dhe filloi t'u jepte zemër ushtarëve të vet me zë të kulluar: «Burra e trima të fortë, ju sot keni përsë të gëzojeni. A shihni? I dhamë fund luftimit, e thyem barbarin, s'keni pse të shqetësoheni, ta mban moralin lart, syrin kokërr, sepse tri herë rresht e thyem armikun, e shpartalluam, prandaj tri herë dolëm ngadhënjes, tri herë triumfues. Shikoni se si u zmbraps me turp; s'i mbeti as fuqi, as zemër, iu thye hovi.»

Pa mbaruar mirë këto fjalë, aty për aty ranë disa gjyle të armikut mu tek ai grumbull i dendur i luftëtarëve dhe disa mbetën të vrarë e disa të trullosur fare nga krisma e poteria e gjyleve, ranë përblysë përdhe. Si e vërejtën barbarët këtë skenë, morën zemër, lëshuan papritmas një klithmë dhe u hodhën prapë në sulm me energji të reja. Mirëpo ai burri i fortë aspak nuk u tund, veçse, pa iu trembur fare syri, me ata pak veta që kishte, ua preu hovin armiqve bash tek ajo pjesë e stomit që u kishte mbetur të krishterëve, aty ai gjithnjë u jepte zemër të vetve e i shtynte të luftonin përtë korru fitoren; edhe s'lëvizi më aspak prej atij pozicioni derisa mori fund luftimi një herë e mirë. Me shpatë në dorë i nxiste të krishterët një nga një përbërë me qytetarë, vendës e të huaj; kur të gjithë këta së bashku, me guxim e trimëri, filluan t'i bënin ballë furisë së armikut, atëherë u ndez lufta përmerr. Kjo përlleshje zgjati shumë, pati të vrarë me shumicë nga të dy anët dhe të krishterëve do t'u kishte shkuar puna mjaft mbarë, sikur artilleria e vendosur

në Kodrën e Pashës të mos i kishte prishur radhët e qytetarëve dhe sikur të mos ua kishte prerë fuqinë të krishterëve dhe, në të vërtetë, kaq vinin me shumicë gjylet nga të katër anët, saqë mbrojtësve të qytetit u mungonin edhe vendet e mbrojtjes.

Turqit, që s'do mend se për numër ishin shumë e shumë më tepër, gjithnjë zëvendësosheshin me fuqi të reja; për këtë arsyе dilnin më të fortë dhe hap-hap shkonin përherë e më tutje. Kur ja: vjen fluturim një djalë trim, i shkathët, Lukë Moneta, nip i Jakob Monetës, për të cilin folëm më lart; prapa tij vinte një turmë e madhe të armatosurish, të cilët u derdhën me kaq furi mbi turqit, saqë këta, të dërrmuar e të shkallmuar prej atij sulmi, u zmbrapsën pakëz. Mirëpo pjesa më e madhe e ushtrisë turke i kishte kapërcyer stomet e gropat me një shumicë të madhe shtretërish e trinash dhe ishite e pamundur të dëbohej prej andej. Turqit aty përbri mbrojtjeve luftonin rreptësish me të rrëthuarit; tri herë e kapërcyen gropën edhe hipën deri te fortifikimet, por të tri herët u zmbrapsën për turp nga shkodranët. Për këtë arsyë, kur e pa sulltani të gjithë këtë trimëri e qëndresë të të krishterët, shumë u zemërua dhe i urdhëroi komandantët e shatorreve që të gjitha repartet dhe trupat që kishin rrëthuar qytetin, aty për aty të vraponin te porta e madhe dhe aty t'ia nisin betejës më me rreptësi e më me furi se përpara; edhe të mos largoheshin aspak prej andej, por t'i nxitnin të gjithë një nga një të luftonin, cilindo që do t'u mbathë këmbëve, ta vritnin në vend dhe të mos pushonte një cast beteja dhe sikur të gjithë të mbeteshin të vrarë nga të krishterët, derisa të shtihej në dorë qyteti. Kur ja, e gjithë ajo mori e madhe barbarësh ose pjesa dërrmuese e ushtarëve më trima i kthyen flamujt drejt portës së madhe dhe vrapuan te pahisorja e saj. Pikërisht nga ajo anë ndodhej sulltani dhe, porsa u dha sinjali me anën e trumpetave e të daulleve, e gjithë ajo ushtri lëshoi një klithmë të madhe e me flamuj përpara u turr në sulm me tërbim, kaloi stome e llogore dhe arriti deri te pahisorja; aty nguli flamujt dhe nisi të përleshej me të rrëthuarit, nisi luftimi me shpata e jataganë. Aq i tmerrshëm qe sulmi dhe furia e barbarëve, aq e madhe qe sasia e armëve, e shigjetave, e gjylave të tyre, saqë shkodranët, që luftonin aty përpara fortifikimeve, thuajse të gjithë mbeten të vrarë ose të plagosur rëndë, kështu që armiku s'kishte më me kë të luftonte. Atëherë sulltani, kur pa se shkodranët u shtypën dhe flamujt e vet u ngulën në pahisore, sic kemi dëgjuar nga ata që në ato çaste i rrinë aty përbri, gjithë entu-

ziazëm paska gérthitur: «Tashti po shoh se të krishterëve u ka ardhur fundi, u thyen shkodranët; qytetin e kemi në dorë. A ka burrë në botë që mund t'i bëjë ballë ushtarit tim? Ku ma gjen në botë një vend të vështirë e të pathyeshëm që të mos e pushtojnë ushtarët e mi? Jo, jo, e shoh fare mirë se s'ka të krishterë në botë që t'i bëjnë ballë ushtarit tim. Për zotin, ra Shkodra në duart e mia!» Atëherë thonë se ai komandanti i shatorreve, që e kishte sulmuar qytetin në Rrethimin e Parë, i qenka drejtuar sulltanit me këto fjalë: «O i pathyeshmi sultani, besa, kam frikë se mos po na gënjejnë. Më thotë mendja se puna qëndron ndryshe; Shkodrën nuk e kemi pushtuar ende; të rrëthuarit ende s'janë thyer. I krishteri eshtë dhelpër e gënjeshtar, besomë mua, ai di të shtiret që ç'ke me të; sepse edhe sot katër vjet e kam provuar mirë këtë gjë, kur isha komendant në Rrethimin e Parë. Shkodranët, me atë dhelpërinë e dinakérinë e vet, e kanë zakon që gjatë luftës repartet e freskëta i ruajnë për çastet më kritike me qëllim që ta dërrmojnë e ta shtypin armikun mu atëherë kur eshtë i shkallmuar e i shteruar fuqish, kurse ata vetë janë të freskët e plot energji. A nuk e pamë ne se ç'trupa të organizuara e c'rezerva të forta kanë ata?»

Pa mbaruar mirë këto fjalë, aty për aty repartet e të krishterëve, që kishin qenë të gatshëm atje në shesh, dolën fluturim drejt e te porta e madhe me një flamur të artë dhe menjëherë, sa krisi trumbeta dhe thirrën Jezuin në ndihmë, t'u flakën me furi mbi turqit dhe me zemër gladiatori kudo bënë kërdi mbi ta, duke vrarë e prerë, derisa i hodhën jashtë pahisoreve, flakën përdhe flamujt e tyre dhe i shpartalluan. Sulltani, që deri atëherë mburrej gjithë gjësim për fitoren e korrur, kur i pa ushtarët e vet të sprapsur e të thyer për turp e flamujt të shpërndarë e të zhgërryer përdhe, u trondit sa s'bëhet dhe psherëtiu thellë, dhe plot zemërim aty për aty u dha urdhër artilerëve që të shtinin gjithnjë kundër të rrëthuarve nga të katër anët e të bënин kërdinë mbi ta. Atëherë të kiske parë ti se c'rrëmujë e c'kiqmet solli artleria turke, që ishte vendosur në Kodrën e Pashës. Derdheshin gjyllet mbi qytet e mbi fortifikime tamam si breshër, udhëheqësi dhe komandantët e shatorreve, që ishin në pozicione më të ulëta, me të shpejtë rrroknin jataganët dhe ngjiteshin më lart dhe i nxitnin ushtarët një nga një për luftim, u bërtitnin, i jepnin zjarr përlleshjes. Ushtarët, të trembur gjithnjë, ekzekutonin urdhrat e komandantëve dhe, duke u dridhur disi me turp nga prania e tyre, lëshoheshin në sulm si të tërbuar mbi shkodranët; vërsuleshin nga të katër anët mbi

vendet e mbrojtjes. Mirépo edhe të rrethuarit qëndronin e luftonin si burra, e mbronin qytetin si duhet, e prapsonin armikun me çelik e me hekur, e shpartallonin me gurë e me zjarr e mjete të tjera; barbarët kudo binin të therur, kudo të vrarë, rrézoheshin andej e këtej përdhe tamam si kallamat që përplasen përtokë, kur i këput stuhia ose breshri. Veç asaj, kaq i fortë ishte sulmi i armiqve të panumërt, që zë-vendësonin pala palën, kaq ishin të shpeshta e të tmerrshme të shtenat e armëve e të shigjetave, që gjithnjë fluturonin nga të katër anët, saqë të krishterët mezi mund ta duronin më gjithë atë furi e kiamet, sepse thua jse të gjithë i kishte dëmtuar topi apo pushka ose i kishte shpuar shigjeta; nuk kishte më burrë që të ngulte këmbë në një vend. Kur pesha e të gjithë atij sulmi, që kishte aq rëndësi, u përqendrua mu te porta e madhe, atëherë nëpër mbarë qytetin u dha me të madhe kushtrimi që e gjithë turma e mbrojtësve të sulej në ndihmë, sepse, me sa dukej, armiqtë ishin duke iu futur qyettit përbrenda. Kur ja: një repart i shkëlqyeshëm të krishterësh, veshur e ngjeshur në hekur e çelik për bukuri, i ngjitet pa hisores edhe të përlleshet trimërist me armikun; ishte një mrekulli t'i shikoje të krishterët, ndezur e bërë flakë në fytyrë dhe me zjarrin e fessë në gji, duke u vërsulur mbi barbarin jo si njerëz, po si luanë, dhe s'kishin pikësynim tjetër veçse t'u merrnin hakun Krishtit të dhunuar dhe shokëve të vrarë në luftë kundër tiranisë dhe mizorisë. Dhe të gjithë pa dallim, duke luftuar kundër barbarit aty në pahisore, turfulloni furishëm si luanë të tèrbuar e me mjete të ndryshme shtrinin përdhe armikun e sidomos me zjarr; zjarri i merrte frymën pjesës më të madhe të turqve. Ndërkaq gjylet dhe predhat e armikut binin si breshër mbi shkodranët dhe kjo i lodhët e i dërrmonte ata më tepër; me to armiku bënte kërdi e sillte dëm për t'u qarë me lot; asgjëmangu të krishterëve s'u luante qerpiku i syrit, por, pa marrë parasysh fare rrezikun e vdekjes, turreshin plot zjarr në luftim. E, megjithë se ishin me kokë në gërshërë dhe jeta e tyre varej për një fije peri, megjithëse vazhdimisht lëshohej armiku në sujm kundër tyre, prapëseprapë një çast nuk mbeteshin pa thirrur në ndihmë Krishtin dhe Virgjinën Mari; i jepnin zemër, njëri-tjetrit duke e thirrur «vëlla», se emrat nuk u binin më në mend. Të gjithë një mendjeje e një zemre, thua se ishim një familje e vetme (sikurse thuhet për familjen e Fabëve¹⁰⁰), i bënin ballë mizorisë barbare aq heroikisht, saqë ajo trimëri e shkëlqyeshme për nder të tyre mund të mbetet ndër këngë, se vdekja me nder është kapak floriri.

Luftëtarët më trima, në përleshje e sipër, duke i dhënë zemër njëri-tjetrit, i ngjiteshin së bashku pahisores dhe aty mbi kufomat e shokëve të vet, pa iu trembur syri aspak zembrapsnin armikun gjithnjë e më tepër. Aty mund të shikoje burrin që binte përdhe mu ndër sytë e së shoqes, djalin që rrëzohej ndër sytë e babës, babën që qëndronte krejt i fortë pa nxjerrë pikë loti para djalit të vdekur, vajzën që s'e kthente kryet me dhimbje për t'anë e vdekur ose që ishte duke dhënë shpirt. Gjylet e topave të të rrethuarve s'u bënin më asnje përshtypje, s'i kishin për gjë as shigjetat, as pushkët, as armët e tjera, s'i jepej më rëndësi as egërsisë, as mizorisë, as numrit të pambarim të armiqve; të gjithë kishin vetëm një qëllim e një dëshirë: të mbronin e të shpëtonin qytetin, ta shpëtonin atdheun edhe jashtë fuqive deri në pikën e fundit të gjakut; të luftonte e të vdiste secili trimërisht për fe e të jepte jetën që ia kishte kushtuar perëndisë. Sultani, i cili nga pirgu i kodrës kishte vërejtur fare mirë se si shkodranët kishin qëndruar si burrat, pa lëshuar asnje pëllimbë vend e se në asnje mënyrë s'ishin thyer, u ndez e u bë flakë nga zemërimi i madh dhe u dha urdhër artiljerëve që të shtinin në top pareshtur kundër të krishterëve dhe t'i gjuanin pa pushim me shigjeta e gurë, pa marrë parasysh se mund të vriteshin edhe të vetët, gjithashtu kapelanët dhe komandantët e shatorreve i urdhëroi që ta mblidhnin tok ushtrinë, pa lënë jashtë asnje ushtar e, me sa fuqi që kishin, duke përdorur të gjitha mjetet e duke vënë në zbatim krejt artin strategjik, të synonin për ta pushtuar qytetin medomes, dhe ata vetë të përdornin si të thuash fishekun e fundit.

Për më tepër atyre u kërcenohej në mënyrë të tmerrshme duke u thënë se do t'i vinte në tortura të hatashme, në rast se nuk do ta pushtonin qytetin. Menjëherë, pas një shenje që dha sultani, të gjithë turqit, deri ata më të ngathëtit, duke u përpjekur për herën e fundit, u hovën me një turr të furi shëm te porta e madhe.

Tashti gjylet e armikut binin jo vetëm mbi të rrethuarit, por edhe mbi vetë turqit, të cilët vriteshin me shumicë; tri herë me radhë artilleria turke bëri kërdinë ndër vetë turqit, gjë kjo që i dha mjaft dorë fitores së të rrethuarve. Por, megjithëse të krishterëve u vinte një ndihmë nga ajo anë, prapëseprapë kaq shtoheshin gjithnjë fuqia e barbarëve dhe vrulli i artillerisë, saqë, sikur të mos kishte qenë ndihma hyjnore e të madhit zot, e Virgjinës Mari dhe e shën Nikollit (sikurse besohet se ka qenë kjo përkrahje), puna e qytetit do të kishte marrë fund aty për aty. Dhe në të vërtetë u panë nëpër qytet

duke luftuar pranë ledheve disa heronj e hyjni që nuk duke-shin njerëz (sikurse e pohuan më vonë vetë barbarët mbasi u bë marrëveshja); edhe ata i binin barbarit dhe gjithnjë e largonin nga pahisorja dhe nga fortifikimet me qëllim që në asnjë mënyrë të mos e linin t'i futej qytetit përbrenda. Ndërkajq një repart i mrekullueshëm i rinisë së krishterë, që kishte ardhur në ndihmë prej pozicioneve të tjera, u vërsul nga ajo anë plot me guxim e me një hov të tmerrshëm; hipi në stomin e pircut të portës së madhe dhe ia nisi të përleshej rreptë me barbarin, kështu, nga të katër anët po bëhej kërdi e madhe.

Mirépo turqit s'mbaronin kurrë, sepse ishin të panumërt, ata s'pushonin kurrë së luftuari, u vinin gjithnjë forca të reja; përkundrazi të krishterët tashmë mezi po rezistonin; mezi po mbroheshin. Ndër barbarët njëra palë zëvendësonte tjetrën dhe hipnin mbi grumbujt e kufomave, në këtë mënyrë formuan si njëfarë shkalle pér t'iu futur qytetit përbrenda. Ndërkajq armiku gjithnjë shtinte me top kundër të krishterëve dhe asnjë gjyle nuk shkonte bosh, kështu bëhej kërdi ndër të rrerthuarit. Njëherë (dhe kjo tregon c'kasaphanë bëhej aty) u vranë tetëmbëdhjetë të krishterë vetëm prej një gjyleje guri e kjo kërdi vazhdonte pa pushim, gjylet nuk mbaronin kurrë. Po edhe shigjeta e predha të tjera vinin gjithnjë nga të katër anët dhe bënin dëm jo vetëm në ato anë të qytetit pér ku drejtosheshin, por arrinin edhe në shumë e shumë vende të tjera, duke sjellë shkatërrim e gjakderdhje. Kaq me shumicë flakeshin shigjetat dhe predhat e tjera në çdo anë të qytetit, saqë toka kudo ishte mbuluar me to plot një pëllimbë, bile edhe litarët e kambanave nuk shiheshin më nga shigjetat e ngulura në to. Shkodranët pér një muaj rresht, pér të ndezur zjarrin, s'përdorën dru të tjere përvëç shigjetave të armikut. Sa neveri të vinte t'i shikoje nëpër ajër gjymtyrët e të krishterëve, të copëtuara nga topi; s'kishte vend në fortifikime e në mure ku të mos gjendeshin copa mishi. Të gjitha lagjet e qytetit, rrugë e rrugica ishin lyer e zhyer me gjakun e të krishterëve. Shtëpitë shembeshin, kishat rrafshoheshin përdhe.

Të dukej sikur vetë ajri po e vajtonte shkatërrimin dhe shkretimin e të krishterëve; topi e mortaja s'pushonin një çast. Kaq me shumicë vinin predhat dhe kaq të dendura ishin krismat dhe goditjet e tyre, saqë me të drejtë mund të kras-hasoheshin me breshrin. Po ç'të them pastaj pér zhurmën e tmerrshme të trumbetave e të daulleve? Ç'të them pér britmat dhe ulërimat shtazarake të barbarëve? Prej tyre të gjithë ishin shurdhuar; nuk mund të dëgjohej asgjë tjetër. Dukej

se quell e dhé ishin çakërdisur. Nga çdo anë s'të shikonte syri tjetër veçse shëmtim e tmerr; kudo shihje kufoma e gjymtyrë të copëtura, të këputura nga trupi prej gjyleve. Sikur të kishte pasur mundësi ndokush të vërente me gjakftohtësi kërdinë e madhe që ishte bërë te porta kryesore, do të kishte thënë se ajo pamje s'ishte hiç më pak e shëmtuar sesa ajo që përshkruhet plot me tortura të ndryshme atje në fund të ferrit, kaq i kishte rënë qytetit një hije e zezë, e shëmtuar dhe e tmerrshme. Ndërkaj në të katër anët e qytetit dëgjoheshin zëra, që bërtitnin duke lëshuar kushtrimin: «O të krishterë e besnikë, ju burra, gra, djem e vajza; o ju të plagosur e të shituar, edhe ju o të sëmurë, që dergjeni në të shtruara, vraponi te porta e madhe; shpejtoni, shpejtoni në ndihmë të shokëve që u këputën fare e po mbarojnë: shpejt, se armiku po shtohet gjithnjë e më tepër, na mbyti me sulme; thuajse e shtiu në dorë qytetin, iu fut përbrenda. Kaq e madhe ishte poterja e të gjithë asaj artilerie, kaq me shumicë flakeshin shigjetat e kaq pluhur i madh ishte ngritur nga e gjithë ajo përlleshje, saqé askush s'shihte më quell me sy, as shihte tokë, sepse edhe këtë e kishte mbuluar gjaku, e kishin mbuluar kufomat. Kishe përshtypjen sikur gjithnjë kristë bu-bullima e rrufeja. sikur gjithnjë vetëtinte; nuk dëgjohej asgjë tjetër përvçese zhurmë, potere, ulërima, britma të tmerrshme barbarësh, gjëmat e klithmat e të rrrethuarve, që e nxitnin njëri-tjetrin për të vrapuar fluturim te porta e madhe, ku ishte pika më delikate, dhe jo vetëm ata që ishin shëndoshë e pa asnje plagë, por edhe të plagosurit, edhe ata që dergjeshin të sëmurë prej shumë kohësh, mbasi e morën veten e u mblodhën tok të gjithë së bashku, u sulën mbi turqit pa kur-syer aspak jetën dhe pa farë frike nga gjylet e predhat që binin si breshri. Aty papritmas të krishterët bënë kërdinë mbi armiqtë, të cilët u vranë me shumicë, po megjithatë këta prapë nuk i ndaheshin sulmit, sepse të vrarët e të plagosurit zëvendësoheshin nga ushtarë të tjera e kështu përlleshja bë-hej edhe më e furishme. Këtej barbarët vinin në veprim të gjitha energjitet e veta me qëllim që ta shtinin në dorë qytetin, për të cilin ishin shkrirë fare, por pa frysht, andej të krishterët, shpëtimi i të cilëve varej në një fije peri, nuk kishin synim tjetër veçse të shpëtonin një herë e mirë prej armikut. Nga të dy anët po bëhej gjak i madh. Turqit herë shtyhesin përparrë, herë zmbrapseshin dhe vriteshin për turp. Herë-herë të rrre-thuarit prapësobeshin nga turma e madhe dhe e dendur.

Luftimi po zgjatej tepër e nuk dihej se si do të përfundonte; s'dihej se cila anë do të korrte fitoren. Në fund, meqe-

nëse të dy palët e pësuancë rendë jo vetëm me të vrarë, por edhe me të plagosur dhe në pjesën më të madhe, që të mos themi të gjithë, beteja filloj të bjerë dalngadalë, ra ai hovi i parë dhe as gjak nuk u bë më. Të gjithë sa ishin, lodhur e rraskapitür nga përleshja e të këputur nga plagët, mezi bënin një hap përpara.

Megjithatë të krishterët gjithnjë mbronin me këmbëngulje fortifikimet dhe qytetin e, meqë panë se barbarët ishin lodhur e këputur fare, si e morën veten mirë e mirë, u lëshuan në sulm mbi ta dhe i vunë në të ikur, duke i vrarë e duke i copëtar, deri te shatorret e tyre.

Atëherë sulltani, mbasi s'i mabeti farë shprese për fitore dhe pa se ç'humbe pësoi ushtria e tij, dha urdhër për tërheqje. Aty për aty ushtarët e tij, sikur t'u kishte rënë rrufeja, kthyen shpinën dhe braktisën betejën. Shkodramët, të cilët gjithmonë kishin qëndruar sypatrembur e të pathyeshëm, kur panë atë tërheqje harruan plagët e gjithë atë gjak të derdhur edhe t'iu vunë në shpinë turqve duke i ndjekur deri te shatorret. Aty prapë bënë kërdinë mbi ta e pastaj u kthyen triumfues në qytet me gjithë atë plaçkë lufte, që ia kishin marrë armikut e me sa flamuj ushtarakë e me gjithë ato koka turqish.

Një gjëzim i pamasë, përzier edhe me pikëllim, i pushtoi të gjithë qytetarët; nga një anë gjzonin se kishin mbrojtur atdheun me faqe të bardhë, nga ana tjetër i këpuste hidhërimi, sepse, ndërmjet kufomave, dikush kishte gjetur prindërit, dikush djemtë e vet, dikush vëllezërit, dikush miqtë e dashmirët. Por më tepër u pikonte zemra gjak kur mendonin se ato gjymtyrë të copëtuara e të shpërndara në të katër anët duheshin mbledhur e grumbulluar në një vend. Megjithatë i mblodhën dhe i varrosën me nderim e dashuri. Dhe të krishterët, me qëllim që të mos dukej se e kishin harruar ndihmën hyjnore që kishin pasur dhe me qëllim që t'i drejtonin falënderimet e duhura të madhit zot për një fitore aq të shkëlqyer, për tri ditë rresht u dhanë me shpirt mbas lutjeve e ceremonive të shenjta dhe i kënduan shpëtimtarit të njerëzimit himne të devotshme; në të gjitha kishat e shfaqën me gjithë zemër mirën johjen e vet. Po ndërkëq as rojës së qytetit nuk i ndaheshin aspak; bile vazhdimisht ndreqnir e rregullonin edhe fortifikimet; forcoheshin nga të gjitha anët dhe bënë rojë ndër pozicionet e duhura, thua se ishte duke u sulur përsëri armiku për të pushtuar qytetin.

Sulltani i turqve, përpara asaj tërheqjeje të turpshme e përpara të gjithë asaj kërdie që u bë në ushtrinë e tij, kér-

cëllói dhëmbët, turfulloi dhe çfarë nuk tha; shkurt: tregoi se ishte penduar pér atë fushatë e në fund plot inat doli në këto fjalë: «Ah, sikur të mos ia kisha dëgjuar kurrë zërin Shkodrës! Kot erdha; të gjitha përpjekjet e mia shkuani kot.» Pastaj mori guximin e c'nuک volli nga goja e vet kundër të madhit zot, që s'ia kishte plotësuar dëshirat dhe s'po e linte të sundonte botën ashtu si pati lënë dikur Aleksandrin, mbretin e Maqedonisë, dhe Jul Cezarin. Edhe shtonte pastaj se, po të donte zoti të mbahej si një rival i tij, atij i mjaftonte sundimi i qiellit.

Në këto fjalë e kapi një tërbim i hatashëm, u ngrit dhe shkoi e u fut në shatorren e vet; aty qëndroi dy ditë e dy net duke ngrënë vetveten dhe s'pranonte njeri, ishte bërë i padurueshëm.

LIBRI I TRETE

Në të tretën ditë sulltani mblodhi shpejt e shpejt këshillin e përgjithshëm dhe shfaqi mendimin se Shkodra duhej sulmuar edhe një herë, duke u mbështetur në faktin se të krishterët, të dërrmuar prej gjithë atyre përlleshjeve plot gjakderdhje, nuk do të kishin më mundësi të rezistonin e pér këtë arsyeshpresahej se turqit do ta korrnin lehtë fitoren. Pas këtyre fjalëve aty pér aty të gjithë të pranishmit u ngritën e thanë njëzëri se në asnjë mënyrë s'mund të bëhej ajo punë, sepse edhe ata ushtarë turq që kishin shpëtar pa u vrarë, ose ishin plagosur shumë rëndë, ose ishin këputur e shkallmuar, kështu që nuk do të nxirrin asgjë në drithë; pastaj thoshin se ata, kundër të cilëve do të luftonin, nuk ishin njerëz, por perëndi. E kush është ai që guxon të rrëmbejë armët kundër perëndisë? Ata thoshin se më parë pranonin të vriteshin me njëri-tjetrin, ose vetë sulltani t'ia nxirrtë shpirtin secilit një nga një me jataganin e vet, sesa të vriteshin pér turp nga të krishterët. Atëherë u ngrit njëri prej këshilltarëve, Ahmet beu, i cili dallohej mbi të tjerët si burrë i pjekur e i përmendur, sì gojëtar i mirë e njeri plot autoritet. Rridhte nga familja e Evrenozëve, familje shumë e vjetër dhe (siq thonë) nga më të famshmet, nga ato që sot në Evropë ndjekin ligjin e Otomanit. Gjatë sundimit të sulltan Mehmetit nga kjo familje dolën të përmendur tridhjetë meshkuj plot autoritet e dinjitet të lartë edhe i shkuar prapa sultananit të parë kur ky po kalonte prej Azie në Evropë.

Gjithashtu edhe dy familje të tjera, që meritojnë të përmenden, e ndoqën sulltanin atëherë kur ky pati sulmuar Rumelinë: shtëpia e Mial beut, që dikur kishte qenë sundim-

tar i Danubit, dhe shtëpia e Ali pashës. Tashti pra ky Ahmet
beu aty në këshillin e sulltanit mbajti këtë bisedë:

«O i pathyeshmi sulltan, me të vërtetë burrëria jote nuk
e ka shoqen në botë. Kush mund ta përshkruajë lavdinë tën-
de? S'ka njeri që mund ta kuptojë; përparrë saj mendja mah-
nitet, gjuha shtanget, le që s'do të mjaftonte as koha pér-
ta përshkruar gjerë e gjatë. Edhe mbarë bota di ta çmojë
e ta ngrejë në quell atë njeri, i cili është i zoti ta mbrojë e
ta ruajë shtetin që i kanë lënë të parët; po merita është edhe
më e madhe pér atë njeri, i cili shtetin e trashëguar e rrit
dhe e zmadhon me lavdi e në fund arrin kulmin e meritave
ai që me trimëri e burrëri të vet prej asgjëje ose prej një
shteti fare të vogël krijon një shtet të tejfuqishëm; edhe të
gjithë janë të një mendimi se kjo e fundit i detyrohet burrë-
risë dhe fatbardhësisë sate; pér këtë jam dëshmitar unë më
i pari.

Unë kam dëgjuar më se një herë nga të parët e mi, të
cilët janë larguar nga Azia dhe kanë ardhur në këto vise
bashkë me sulltanin, se, kur të parët e tu kanë ardhur në
Evropë, kanë zënë vend (si të thëm) vetëm në një kënd atje
në rrëthet e Helespontit e, kur deshi perëndia të vije ti, pas-
ardhësi i tyre, me trimërinë tënde veçanërisht të shkëlqyer,
shtove kaq mbretëri, kaq krahina, kaq perandori, saqë do të
zgjatesha shumë po t'i numëroja një nga një. Po kush do
të ishte i zoti të tregonte ashtu si duhet se si ti e pate
shtruar Trakinë në Evropë? Si e pate shtruar Stambollin,
kyeqytetin e perandorisë lindore? Ti pushtove Galipolin,
qytetin e shquar të Helespontit, apo Akajën, apo Greqinë, apo
Beotinë me një qytet aq të përmendor si është Teba. Ty të
ra në dorë krahina e Atikës, ku dikur lulëzoi ai qyteti i
famshëm, Athina, djepi i të gjitha diturive. Ti pushtove
Trapezuntën, mbasi nxore jashtë perandorin e saj;¹⁰¹ ti nën-
shtrove me lavdi mbretërinë e Myzisë së Sipërme e të Posht-
me po ashtu edhe Peloponezin, duke i shporrur zotëruesit e tij.

Po atje në Anadoll shtrove rrëth dymbëdhjetë mbretëri:
Pontin, Bitininë, Kapadocien, Panflagoninë, Cilicien, Panfi-
linë, Licien, Karien, Lidinë, Friginë, Nikomedinë, Niqenë, Pruz-
ën, qytet shumë i pasur, veç këtyre Joninë, Dorinë, Smirnën,
Kolofanën, Efezin, Miletin, gjithashtu Alikarnasin, Pergamin,
Trojën¹⁰²). Për më tepër ti shtove Tanain dhe krahinën tau-
rike dhe me një ushtri të fuqishme u fute edhe në Armeninë
e madhe. Ti raguzanët i bëre tributarë të tu; ti nënshtrove
Kion dhe Koasin; ti detyrove që të pranonin kushtet e tua
shumë qytete të partëve, mbasi pate dëbuar prinçin e tyre;

ti i shtove mbretërisë sate ishullin e famshëm, Lesbin, Folien e vjetër dhe të renë, po ashtu dhe Merlinin. Ti shtrove jacicët dhe vinelicët; ti provincën e Domait, që është nën sultanicin e vet, e dërrmove; ti more ishullin e Eubesë, Larisën, Qefalonien, Skandelorin, mbasi, qite jashtë Karamanin. Ty në fund t'u dorëzua edhe Kruja, një qytet aq i fortë; ti hyre edhe në Maqedoni; shpartallove trakasit; shfarose triballët; nënshtrove penët; akarnanasit dhe etolët i nxore jashtë vendeve të tyre. Po g'rri e numëroj unë këtu të gjithë ata popuj, të cilët i theve e i dërrmove? Këtu duhet përmendur vetëm një gjë: ti (si ta them) u hoqe duarsh të krishterëve njëzet krahina dhe dyqind qytete.

Do të shkoja shumë gjatë sikur të tregoja se sa princa, sa udhëheqës e sa mbretër muhamedanë ke thyer e nënshtruar; ti me fushatat e tua të gjithë i vure nën pushtetin tënd. Nuk duhet të ngrihen më deri në quell njerëzit e mëdhenj të antikitetit: Cezari, Skipioni, Pirroja, Hanibali e sa e sa burra të tjerë romakë e të vendeve të tjera; s'ka dyshim se të gjithë këta burra ta lëshojnë ty kryet e vendit pér sa i takon numrit të madh të qyteteve dhe të provincave të fituara prej teje. Qenka thënë prej fatit që vetëm emri otoman të zotërojë në botë. Shkurt, bota mbarë do të hyjë nën zgjedhën tënde; të gjithë popujt, vetëm ty do të binden. E, pér sa i takon pushtimit të Shkodrës, mos ki dyshim se nuk do të nxjerrë shumë telashe. Ti e di se në këtë botë ndonjëherë punët nuk dalin ashtu si i mendojmë ne; të shumtën e herës punën e ka në dorë fati. Megjithatë pér një gjë të jesh i sigur't dhe pér këtë, madhëri, të jap fjalën e ndërit: unë do të bëj çmos që brenda pak kohe Shkodra të bjerë në duart e tua. A nuk qeshë unë ai që para pak ditësh futa nën zotërimin tënd Krujën, një qytet aq të fortifikuar e aq të mbrojtur? Por, që ne ta sulmojmë Shkodrën përsëri në atë mënyrën e mëparshme, unë nuk jam i këtij mendimi. Unë kam mendim tjetër, kam plan tjetër; është punë e lehtë pér këdo që të shkojë e t'i bjerë murit me kokë, por janë të paktë e të rrallë ata që dinë ta mundin armikun e të dalin ngadhënjyes mbi të. Ai që merret me punë kaq të rëndësishme, por edhe të rrrezikshme, duhet të jetë i zhveshur nga çdo pasion e mllef. Shkodranët nuk duhet t'i ngacmojmë më me beteja; çdo përpjekje jona kundër tyre do të na shkonte kot. Edhe në të vërtetë, në qoftë se ne nuk qemë të zot ta shtnim në dorë Shkodrën me ajkën e ushtrisë sonë, si është e mundur të dalim fitues tashti që na kanë mbetur vetëm një grusht ushtarë, edhe ata të shkallmuar e të shtetur fuqish? Unë i

kontrollova shatorret, i shqyrtova çadrat një nga një dhe s'gjesta vend, s'gjeta skutë ku të mos dëgjoja a gjëmë, a pshërtima, a ulëritje e vaj; kudo mbizotërojnë dhimbja e vdekja; të katër anët e shatorreve i kanë mbuluar zia e trishtimi. Më tepër se tridhjetë mijë veta nga tanët kanë mbetur të vrarë në betejën e fundit. Edhe numri i të plagosurve e i të shituarve është i pamasë; asnë ushtar s'ka mbetur pa pësuar diçka sado të vogël; askush nuk ka guxim më t'i ngjitet kodrës përpjetë. Të gjithë i ka kapur tmerri, të gjithë i ka lëshuar zemra. Edhe unë i kam pyetur, pér ç'arsye i pushtoi një tmerr kaq i madh, pér ç'arsye pikërisht ata, që ishin aq të rreptë e të papërkulur që në sulmin e parë, ua mba-thën këmbëve. E di si m'u përgjigjën? «Fytyrat, fytyrat e shkodranëve na kallën tmerrin; sytë e tyre nxirrnin shkëndija, flakéronin si prushi. Sytë e tyre të shtrembër, fytyrat e tyre të shëmtuara e të hatashme na kanë tmerruar.» Ja, kjo është arsyaja pér të cilën unë mendoj se sulmi duhet lënë mënjanë; tashti duhet të punojmë me takt e urtësi, sepse Shkodra është syri e koka e mbarë provincës, është selia dhe principata e të gjitha qyteteve të tjera. Ajo është nën urdhrat e Senatit të Republikës së Venedikut edhe ti e di mirë se sa i madh e i fuqishëm është ky shtet në tokë e në det. Vetëm venecianët janë ata që i bëjnë ballë gjithnjë pushtetit tënd, vetëm ata guxojnë të kundërshtojnë ligjin tënd; ata, pra, e kanë forcuar më së miri këtë qytet a me ushtarë trima, a me munizione, a me artileri, a me çdo mjet tjetër lufte. Po ç'të them pastaj pér ushtarët shqiptarë? Edhe janë bash ata më trimat e më të zgjedhurit që po e mbrojnë heroikisht Shkodrën. Shqiptarët janë fis bujar, fis mbretërish, gjak Eacidësh¹⁰³). Njeriu në botë ndjek gjurmët e gjakut e të fisit të vet, ky është ligj, pra edhe shqiptarët kanë shpirtin dhe zjarrin e Pirros, sepse prej tij rrjedhin. Pirroja (ti e di mirë) u quajt, edhe me të drejtë, si një nga udhëheqësit më të mëdhenj e më të fuqishëm në botë; ai artin ushtarët e pajisi me disa krijime me të vërtetë të shkëlqyera. Ai qe i pari që mësoi se si duhesin ngulur shatorret; ai qe i pari që atje në Itali u vuri përballe romakëve elefantët. Ky është, pra, ai Pirroja, udhëheqësi i epirotëve, që i mësoi ushtarët se cili ishte vendi i përshtatshëm pér të ngulur shatorret, se si mund të lehtësoheshin nga barra e nozullimeve, se si duhej të ruheshin prej pusive, se si betejës i duhej gjetur çasti i volitshëm, se si duhej radhitur ushtria e me ç'mjete duhej të forcoheshin shatorret. Edhe çfarë burri ka qenë Pirroja në daç pér luftë, në daç pér paqe, e dëshmojnë sa e sa dokument

mente të lashtësisë; gjithmonë ai ka dalë i pari ndër ndeshje e beteja, saqë me arsyen e quajtën: rrufeja e luftës. Prandaj ne sot kemi punë jo me disa aziatikë të ngathët e me njerëz të çoroditur, por kemi të bëjmë me epirotët trima e të pathyeshëm. Të themi të drejtë, madhëri, shkodranët në lutfë janë trima të fortë e guximtarë.

Ti e pe fuqinë dhe guxmin e epirotëve, ti e pe se ata s'përkulen, nuk thyhen e, si të p'athyeshëm që janë, ata nuk shtrohen me armë; ata s'i binden askujt përveçse atij që duan vetë t'i binden. Ata s'e pranojnë sundimin e huaj, ata tregohen besnikë ndaj zotit të vet; fjala «besë» për ta është diçka e vecantë e tradicionale. Ata kanë vetëm një mbret e perandor, ata duan të kenë gjithmonë vetëm një princ venecian dhe s'pranojnë të tjerë.

Ja, po bëhen tridhjetë vjet që jemi në luftë të pareshtur me shqiptarët e prapëseprapë s'jeni të zot t'i shtrojmë dhe t'i vëmë nën sundimin tënd. Ka njeri që nuk e di se ç'kërdi është bëre e ç'gjak është derdhur gjatë gjithë kësaj lufte? Po mbushet gati një vit që kemi nisur rrëthimin e këtij qyteti; kemi vrarë mendjen natë e ditë për t'i dalë në krye kësaj fushate. Sulmet tona kanë qenë të tmerrshme dhe ja: me një-mbëdhjetë artileri të kalibrit më të madh brenda tridhjetë e gjashtë ditëve rrafshuam përdhe të gjitha muret e qytetit. Nuk po përmend këtu të gjitha armët e mjetet e tjera luftarake, që askujt s'i shkon mendja se në ç'sasi janë përdorur, e megjithatë të gjitha shkuant kot. Veç asaj, në të gjitha sulmet e luftimet e deritashme kanë marrë pjesë ushtarët tanë më trima, e me çfarë hovi e rreptësie janë flakur kundër armikut! S'kemi lënë asgjë pa provuar; s'kanë munguar as mendja e mpréhtë e komandantëve, as zjarri e turri i taborëve në këto luftime kaq të tmerrshme. Ka burrë që mund të tregojë se sa herë e kemi gjuajtur dhe qëlluar armikun me artillerinë tonë? Ç'të them pér predhat tona, që janë derdhur si breshri mbi armikun? E megjithatë shkodranët aspak s'u trembën, s'i ndanë aspak rojës së qytetit; bile morën zemër më tepër, u bënë edhe më trima e gjithnjë na dolën para me gjoks e ballëhapët. Unë besoj se ata s'kanë vetëm fuqinë e një njeriu, ata janë të pajisur me një forcë hyinore. Unë, përf besë, them se ata (lejomëni shprehjen) janë bijtë e Marxit; nën këtë diell e hënë s'gjen burra më të fortë e më trima. Ata tallen me taborët tanë të panumërt, me trimërinë tonë, me armët tona. Për ta është lavdi e nder i madh po të japid jetën për atdhe; nga kjo anë ata s'i japid aspak rëndësi jetës së vet, s'e kanë për asgjë.

Gjatë luftimit ata ngulin këmbë në një vend, aty luf-tojnë pa u zembrapsur asnjë pëllëmbë, aty i ke a gjallë a vdekur. Janë me të vërtetë burra. E kanë zanat luftën; meritojnë të nderohen e të çmohen jashtëzakonisht; meritojnë të përmenden në mbarë botën, meritojnë të ngrihen në quell me lavdërimet më të mëdha. Tashti, pra, mbasi nuk qemë të zot t'i mundim me armë, të përpinqemi t'i thyejmë me imprehtësinë e mendjes sonë. Madhëri, njëherë im atë, ndërsa po më fliste për moralin dhe për disiplinën, më pati treguar këtë shembull më të vërtetë shumë të bukur: Po të donte kush të kapte një pemë ose një send të çmuar mu në mes të një mbulesë të shtruar përdhe, por pa vënë këmbën aspak në mes të asaj mbulesë, do të detyrohej që pak nga pak ta rrotullonte atë mbulesë q'merr prej thekëve e deri te pema ose te sendi i çmuar, derisa ta kapte atë fare lehtë me dorë.

Unë besoj se në këtë mënyrë duhet të veprosh edhe ti. Po deshe ta shtiesh në dorë këtë qytet kaq të fortifikuar, së pari duhet ta rrighthosh nga të katër anët me shumë e shumë kështjella dhe të vësh roja të forta; pastaj të ndërtosh një urë të fortë mbi Bunë, në mënyrë që në të dy brigjet e këtij lumi të ngrihen kulla sa më të forta; kështu duhet të shtohen në dorë qytetet që kemi këtu ndër rrethe dhe duhet të futen nën zotërimin tënd vendet kufitare. Pastaj Shkodra, e qarkuar nga të katër anët, do të bjerë në dorë pa ndonjë vështirësi.

Shkodra pa dyshim është epiqendra e të gjithë kësaj province, por tashmë ajo u shkallmuva e u dërrmuva fare. Vendet e tjera, si gjymtyrë të rraskapitura, të prishura e thuajse të cunguara, kanë mbetur pa farë fuqie. Po qytetarët e Krujës a s't'u dorëzuan menjëherë vetëm e vetëm pse nuk e duruan urinjë? Prandaj në këtë mënyrë ti do t'ia arrish qëllimit tënd pa humbur asnjë ushtar.»

Mbasi mendimi i Ahmetit u pranua nga sulltani dhe nga i gjithë këshilli, atëherë u vendos që të mos bëhej ndonjë luftim tjetër me shkodranët dhe të merrte fund përdorimi i artilerisë dhe i mjeteve të tjera luftarake. Menjëherë u caktuan qytetet që do të sulmoheshin. Pashai i Azisë mori urdhër që të drejtohej me taborët e vet për fushatë kundër Drishtit, ndërsa pashai i Rumelisë të sulmonte Zhabjakun¹⁰⁴⁾ dhe pikërisht të nesërmën, në të zbardhur të drithës, ky i dyti u nis me të gjitha repartet e veta; me të shkuat edhe shumë kalorës të tjerë me streme e ngarkesa të veta, ashtu dhe dy kohorta jenicerësh e dy kohorta azapësh; udhëtimi i tyre zgjati dy ditë. Pastaj në datën 2 gusht të gjitha anijet turke që

gjëndeshin në Bunë, dolën në ligen dhe morën drejtimin nga Zhabjaku. Zhabjaku është një qytezë e vendosur në breg të liqenit, në kufi me Dalmacinë, jo shumë larg prej Askrivit. Kjo qytezë ishte nën sundimin e një princi me kombësi dalmate dhe gjendej mbi një shkëmb të lartë; qytezë shumë e fortë prej natyre, ishte larg Shkodre nga dyzet milje. Ndër ato ditë princi i kësaj qyteze nuk ndodhej aty, por kishte lënë si zéwendës dhëndrin e vet me disa burra të tjera të zotërimit të vet.

Këta, ose pse u trembën, ose pse barbarët u premtuan kushedi çfarë, u dorëzuan menjëherë. Pas këtij dorëzimi pashai i dëboi të gjithë vendësit nga kështjella dhe aty lanjë garnizon të fortë, pastaj në datën 14 gusht u kthye me taborët e vet ndër shatorre. Ndërsa dorëzimi i Zhabjakut qe me të vërtetë plot turp, drishtjanët dolën më burra e më të fortë; ata, gjatë rrëthimit të Shkodrës, si ditën si natën, e bënë zakon të dilnin e të sulmonin në të katër anët stremet e barbarëve, repartet e kalorisë, turmat e deveve dhe të kafshiёve të tjera që vlenin për ngarkesë me gjithë ushtarët e thjeshtë; i plaçkitin dhe i bënин robëri. Shpesh u binin edhe shatorreve të armikut, duke i shkaktuar në këtë mënyrë kushedi se qëdëme të mëdha. Kur i arriti sultaniit në vesh kjo punë, u zemërua shumë dhe priti kohën që djelmoshat e Drishtit të dilnin nga qyteza me qëllim që ta shtinte në dorë më lehtë dhe në datën 11 gusht dërgoi pashanë e Azisë me të gjitha repartet e tij për të pushtuar Drishtin. Pashai, mbasi ia preu shtegun repartit më të fortë të të krishterëve, duke dëshiruar qytetin që do të merrej të nesërmend. Dhe me të pushtuar qytetin që do të merrej të nesërmend. Dhe me të vërtetë, më 1 shtator, porsa zbardhi drita, u dha shenja dhe barbarët iu vërsulën nga të katër anët qytetit dhe iu futën brenda pa farë vështirësie, së pari sepse nuk pati kush t'i përballonte e pastaj sepse muret e fortifikimet ishin shembur fare.

Duhet ditur se ajo kështjellë kishte një rrëth të madh; pastaj të gjithë djelmoshat, që mund të ishin nga tetëqind veta (sikurse u tha më lart), kishin mbetur jashtë qytetit. Veç asaj, ata që ishin brenda në qytet, dita-ditës dhjetoheshin nga murtaja. Ata pak veta, që u përpqoën ta zbonin armikun prej ledheve, u vranë e u prenë një nga një.

U zunë gjallë nja treqind veta dhe më 2 shtator i quan në shatorre; pastaj, me urdhër të sulltanit, të gjithë i vranë përnjëherë në sy të shkodranëve. Të nesërmen turqit u mblo-dhën në këshill dhe morën vendim që të niseshin për të shtë-në në dorë qytetin Lissus që sot me një emër të ri quhet Lezhë; është larg Shkodrës tridhjetë milje, i shkon përbri lumi i Drinit. Disa gjeografë thonë se ky qytet ndan Epirin nga Dalmacia. Për atje më 5 shtator u nis pashai i Rumelisë me repartet e veta dhe e gjeti qytetin krejt bosh, pa njerëz, dhe i vuri zjarrin. Pastaj u kthyte prapë të shtinte në dorë kështjellën e Drishtit, që kishte mbetur pa u marrë. Në atë kështjellë ishin thuajse nja njëqind burra, të cilët, prej urie, u detyruan të dorëzoheshin; edhe si të gjithë të tjerët, u vranë. Si mori fund edhe puna e Drishtit, sulltani dha urdhër që të bëheshin të gjitha përgatitjet e duhura me kujdesin më të madh atje në rrethimin e Shkodrës. Pastaj sulltani, sipas këshillave të Ahmetit, la disa taborë të mëdhenj në atë rrethim dhe me pjesën tjetër të ushtrisë vendosi të kthehej në Bizanc. Pra më 8 shtator, mbasi kishte urdhëruar që tu vihej natën zjarri shatorreve, pa lindur ende dielli, u nis prej Shkodre në mes të krismës së trumbetave dhe të sa veglave të tjera, me dy flamuj të mëdhenj përpara, njëri i bardhë e tjetri i kuq, me një ushtri të radhitur për bukurin që, me sa thonë, përbëhej prej nja dyzet mijë vetash. Në çastin e nisjes s'la gjë pa mallkuar e pa sharë; a të gjithë Epirin, a banorët e saj, a të gjitha vendet e saj një nga një, a të mbjellat e të korrat, a pemët; të gjitha, të gjitha. Apo nuk e mallkoi Shkodrën me të madh e me të vogël! Ai kishte nënshtuar me lehtësinë më të madhe sa e sa mbretër e princa, sa e sa popuj, kurse në Shkodër kishte lënë gjithë ato koka njerëzish, kishte ngrënë një grusht aq të madh e tashti po ndahej me turp e faqe të zezë. Prandaj ai të gjithë fajtin ia vinte vetëm fatit, që gjithmonë kishte punuar në të mirë të tij, mirëpo kësaj here s'e kishte ndihmuar aspak, bile i kishte dhënë të mbrapshëtën, sa në fund sulltani ia mbushi mendjen vetes se ky ishte, si të thuash, një ogur i zi, se i kishte ardhur fundi ose perandorisë së tij, ose atij vetë.

Dhe në të vërtetë nga kjo anë ai nuk u gabua, sepse nuk kaloi një kohë e gjatë dhe, kur u nis për një fushatë atje në Azi, u nda këso jete.

Mëbasi u dogj qyteti i Lezhës dhe si u nis sulltani, të dy pashallarët u kthyen përsëri në Shkodër me të gjitha repartet e veta dhe morën me vete si robër nja pesëdhjetë të krishterë, të cilët i kishin zënë në njérën nga anijet tona,

kur kishin shtënë në dorë ishullin, që gjendet mbi lumin e Drinit; ky ishull ishte i madh shtatë milje. Aty turqit kapën shumë veta, i sollën pranë qytetit të Shkodrës e aty i vranë të gjithë. Pastaj urën, që kishin nisur ta ndërtonin mbi lumin e Bunës, e zgjatën deri tek ai vendi që quhet Katilinë. Në të dy brigjet e lumi pranë urës ngritën nga një pirg, me qëllim që luftanijet e të krishterëve të mos kishin mundësi të kalonin andej për t'i ardhur në ndihmë qytetit. Pashai i Anadollit, si i dha fund njërit prej të dy pirgjeve andej lumi, më 18 shtator u nis me taborët e vet për të kaluar dimrin në Anadolli, kurse pashai i Rumelisë pirgun e vët e ndërttoi më vonë, sepse ai kishte një udhëtim më të shkurtër për të arritur në vendin ku do të dimëronte. Mbasi i forcoi të dy pirgjet me të gjitha mjetet dhe municionet e duhura, më 8 dhjetor u nis, duke lënë në rrëthimin e Shkodrës Ahmetin me nja dyzet mijë kalorës.

Ndërkaq shkodranët, të cilët i kishte pushtuar një gëzim i pamasë për atë farë ngadhënjimi, mbasi pamë se prapë ishin të rrëthuar nga të katër anët, në vështrimin e parë ù tronditën disi, meqenëse pas asaj fitoreje të madhe s'ia kishin arritur lirisë së vërtetë; po megjithatë nuk i lëshoi zemra, sepse mbështeteshin edhe në ndihmën e të madhit zot, në ndihmën e Krishtit, për fenë e të cilit kishin duruar së të zeza, dhe në ndihmën e shën Markut e të Senatit venecian, të cilët i kishin qëndruar aq në besë. Mirëpo dita-ditës në qytet po shtohej zia, vetëm bukë e ujë kishte mjaft, po nuk jetohet vetëm me bukë e ujë, sidomos kishin nevojë për ushqim ata që detyroheshin të rrinin ditë e natë pa gjumë e të armatosur në vendet e rojës.

Duhet ditur se në fillim qytetarët të gjitha ushqimet i kishin bashkuar dhe hanin si të thuash në një kazan, pra edhe gatuanin e shpenzonin pa dhimbje e pa kursim. Ata kujtonin se sulltani, në qoftë se nuk do të kishte pasur mundësi ta pushtonte qytetin me luftë, patjetër do të kishte ikur me gjithë ushtrinë.

Pérndryshe, sikur t'u kishte marrë mendja se rrëthimi do të dilte aq i rëndë, patjetër do të kishin shkuar më me kursim. Pra në qytet aq fort u ngritën çmimet e ushqimeve, saqë edhe për të sëmurët vetëm me një çmim shumë të lartë e me shumë lutje mezi mund t'i gjeje. Do të shkoja shumë gjatë dëre do të ishte diçka për t'u vajtuar, sikur të përshkruaja zinë e urinë e madhe që pësuan asokohe të rrëthuarit. Ata, ngâ nevoja, filluan të ushqehen me gjërat më të ndyra e më të

fëlliqura. Ç'nuk hanin: a mish kali, a mish qeni, a mish miu, me gjithë zorrë e rropulli të tjera.

Po edhe lëkurët i hidhnin në ujë e i zienin duke u shtënë pak uthull. Nuk do të më besonte askush, po të tregoja se sa shitej një mi gjysmë i ngordhur, sa shiteshin suxhukët e bërë me zorrë qeni. Po q'të them pastaj pér mungesën e madhe të verës, të vajit e të uthullës së zbutur me ujë? Si të thuash, një gllénjkë verë, vaj ose uthull shitej me një çmim aq të lartë, sa nuk besohet.

E, megjithëse të krishterët i kishte pushtuar një zi kaq e madhe, saqë (siç tregojnë) pér pak jepnin shpirt nga mungesa e bulmetit, prapëseprapë kishin vendosur ta duronin atë torturë deri në vdekje më parë se të hynin nën zgjedhën e një armiku aq të pashpirt. (Edhe në të vërtetë a ka gjë më të rendë e më të vështirë sesa të mbetesh edhe pa diçka që vet natyra ta kërkon e të mos jesh i zoti ta gjesh?) As ushqimi më i ndyrë, që vetë natyra e detyron njeriun të mos e përdorë, as uria, as etja mizore nuk arritën t'i përkulnin të rrëthuarit. Tashmë po mbushej viti që ishte rrëthuar Shkodra. Kur ja: më 20 dhjetor një ditë të diel po duken nën ledhe disa italianë, të cilët i përshëndetin shkodranët dhe i lajmërojnë se kishte ardhur një i dërguar i Venedikut, i cili po nisej pér Stamboll pér të kërkuar paqe nga sulltani. Ata italianë i këshillojnë të rrëthuarit që ta mbajnë moralin larë, sepse nuk do të zgjaste edhe shumë ai rrëthim. Sulltani tanimë kishte arritur në Bizanc dhe atje kishte rënë në marrëveshje me të dërguarin e Venedikut, i cili, porsa u nënshkrua paqja, më 4 prill u kthye drejt e te komandanti i flotës, e cila kishte hyrë në Bunë. Prej andej, me miratimin e të gjithëve, iu dërgua komandantit të qytetit dhe qytetarëve shkodranë një letër, me anën e së cilës u kumtohej se ishte nënshkruar paqja me sultatin me këto kushte: Shkodra t'i lëshohej sultani dhe qytetarët të mos prekeshin aspak, por të dilmin lirisht me të gjitha plaçkat e familjet e veta; po të dëshironin, ata mund të jetonin nën sundimin e sultosit ose edhe mund të shkonin ku të donin. Qytetarët, me të vërtetë burra të besës e shumë të devotshëm, u mblohdhën të gjithë në kuend. Aty u shprehën shumë e shumë mendime të ndryshme, por në fund u pa e arsyeshme të ndiqej rruga më e mirë, që kishte pér pikësynim shpëtimin trupor e moral të qytetarëve: u vendos që të shpëtonin nga tirania e pashpirt e sultani, të merrnin ç'kishin e ç'nuk kishin dhe të kalonin nën mbrojtjen e Senatit të Venedikut, nën zotërimin e të cilit do të shkonin një jetë të qetë e të rehatshme, sikurse e kishin ka-

luar deri atëherë ata vetë dhe të parët e tyre. Edhe me qëllim që të qëndronin në atë vendim, u ngrit Flor Jonima, komandant i rojave, shumë i zoti si në luftë ashtu edhe në paqe. Shkodra ishte mbajtur shumë e fortë kundër armikut dhe në sajë të këtij burri, që kishte treguar një zell të jashtëzakonshëm në organizimin e rojave. Pra ky Jonima brofi aty në mes të kuvendit dhe mbajti një bisedë, me anën e së cilës i bindi kryekëput qytetarët që të iknin nga zgjedha barbare e turqve. Biseda e tij qe kjo:

«Qytetarë trima! Besoj, të gjithë e dini mirë se deri në ç'pikë arrin zemërimi i padrejtë e i padurueshëm i barbarëve; ata janë të egër prej natyre, ata na salvojnë pa farë të drejte, por vetëm pse na urrejnë, dhe këtë e kanë në gjak, duan të na dëmtojnë. Po bëhen tridhjetë vjet që na mundojnë vazhdimisht, me luftëra, të cilat na kanë sjellë sa dëme e rreziqe pa qenë ngacmuar një herë nga ana jonë. Në atyre s'u kemi bërë asnje të padrejtë e ata na kanë plaçkitur tokat tonë, na kanë dhunuar për turp qdo gjë të shenjtë e njerëzore dhe, duke mos mbetur të kënaqur me të gjitha këto të zeza e dëme, janë përpjekur të shtien në dorë qytetin tonë me sulme të tmerrshme e me çfarë rrëthimi; ata janë përpjekur ta zhdukin emrin tonë nga faqja e dheut, por, me ndihmë të zotit dhe në sajë të trimërisë sonë, përherë ne kemi dalë fitues. Ata janë thyer për turp duke derdhur gjithë atë gjak. Po kush është ai që mund ta shprehë me gojë urrejtjen e tyre kundrejt nesh? Ata premtojnë qdo gjë, por nuk u duhet besuar fjalëve të tyre. Ata do të përpinqeshin me gjithë shpirt për ta ngopur mirë atë lakmi që kanë, për të shfryrë të gjithë mërinë kundër nesh. Në kohën kur vetë sulltan Mehmeti, i cili tashti u përpooq të na shtypte, pati ardhur me të gjithë taborët e vet për të pushtuar Krujën, të cilën atëherë gjithnjë e kishte Skënderbeu, mu ky sulltan pati dërguar Grekulin, komandantin e Rumelisë, me shtatëdhjetë mijë kalorës për të plaçkitur viendin tonë dhe e plaçkiti mjaft; dogji e poqi dhe zuri një shumicë të madhe të krishterësh me gjithë bagëtitë e tyre. Në fund, si e rrëthoi qytetin, e sulmoi me një repart të rrezikshëm tamam në mënyrën e gladiatorëve; mirëpo tanët e dëbuani dhe ai iku me turp, mbasi humbi në atë betejë gjithë ata njerëz të vet. Më vonë plasi një luftë edhe më e ashpër, edhe më e shëmtuar prapëseprapë me turqit. Burri i fortë, Sulejman pashai, ishte komandant i taborëve të Rumelisë; ai komandonte një ushtri të tejfuqishme, të përgatitur e të stërvitur më së miri. Ky pasha, pra, çfarë nuk i shkaktoi

qytetit tonë; të zezat dhe dëmet ku ishin më të mëdhatë, sepse na mbértheu me një rrithim që zgjati aq shumë.

Ai na katandisi deri në atë pikë, saqë tri mijë veta nga tanët vdiqën me tmerr prej etjes, megjithëse edhe ai vetë hëngri grusht të fortë prej nesh edhe iku. Tashti në fund ngrihet vetë sulltani dhe, i ndezur flakë nga zemërimi, vjen e na sulet me të gjitha ushtritë e fuqitë e vëta dhe na plakit thuajse mbarë vendin, na rrëthon mirë nga të katër anët qytetin dhe për një vit na sulmon natë e ditë me sa fuqi ka, duke zbatuar të gjithë taktilikën dhe strategjinë e vet e duke mos kursyer asnjë kokë ushtari, asnjë shpenzim, asnjë pikë djersë. Në fund, mbasi derdhi gjithë atë gjak dhe hëngri grushte të forta prej nesh, me turp u largua plot hidhërim e trishtim, duke na lënë gjithnjë të rrëthuar. Tashti pikërisht ky sulltan gënjeshtar e i pabesë, që është aq i etur për gjakun tonë e të fëmijëve tanë, tamam si një bishë e egër, meqë tashmë thuajse e ka në dorë qytetin tonë, për t'u hakmarrë për të gjithë ato humbje e grushte që ka ngrënë prej nesh, shtiret sikur gjoja na çmon e na ka për zemër; na këshillon, bile edhe na lutet që të mos largohemi nga atdheu, nga vatrat tona, të mos i braktisim ashtu në këmbë e në dorë tokat dhe pasuritë tona, që me aq mundim e djersë i kanë fftuar e lënë trashëgim gjyshërit, stërgjyshërit e të parët tanë. Pra ky armik kaq dinak, njeri si mësalla me dy faqe, na shtiret sikur gjoja ndieka dhimbje për ne.

Por duhet ditur mirë se çfarë hidhërimi fshihet nën atë farë maske; ai, që lakmon të hakmerret, di të bluajë e të përbluajë kaq hakmarrje nën atë ballë të rrudhur. Për këtë po përgatitet barbari i tmerrshëm; ai vepron me dredhi pa u dukur aspak, me qëllim që të na futë në grackë e të na marrë shpirtin me tortura dhe të veprojë me ne ashtu si ka vepruar gjithmonë me ata që i ka futur në kurth, tamam në këtë mënyrë. Kur ky njeri, i cili mizorinë e ka në gjak, nuk ka kursyer as njerëzit e vet, si është e mundur që të mos na prekë ne, që kemi bërë kërdinë mbi të, i kemi shkaktuar sa dëme e i kemi dhëni sa grushte? S'ka farë dyshimi se ne do të na hedhë në tortura edhe më çnjerëzore.

Prandaj ai na përkëdhel e na miklon me qëllim që paskëtaj të zbatojë në trupin tonë të gjitha torturat që i ka pjellë mendja. Po ku ka besë barbari? Ku ka ai ndjenja njerëzore? Ku ka ai mëshirë? Ai, si i thonë një fjale, s'ka as idenë e mëshirës. Ai, veç në mos qoftë i zoti, se për shpir't dhëmbët e vet do t'i ngulte në mishin tonë 'dhe të fëmijëve tanë edhe do të na shqyente për së gjalli. Do të ishte shumë e rëndë

dhe e vështirë bashkëjetesa ndërmjet nesh e barbarëve, sepse ne jemi shumë larg prej tyre me fe, me zakone e me natyrë. Ata gjithnjë synojnë të hakmerren tamam si bisha 'të egra. Me ç'sy do të na shikonin ata ne e ne ata, kur atyre do t'u kujtohesin njerëzit që u kemi vrarë? C'do të provojë kjo zemra jonë kur të kujtojmë prindërit tanë, vëllezërit tanë, fëmijët tanë, që këta barbarë na i mbytën në një mënyrë aq çnjerëzore? Po fundi, me çfarë syri do ta vështrojë armiku armikun? A s'do të na pëlcasë zemra, a s'do të na ngjethjet mishtë fund e krye kur në të katër anët e këtij qyteti s'do të shikojmë tjetër, veçse gjermadha ledhesh, kishash e ndërte-sash? Të mos harrojmë, pastaj, se shtepitë janë rrafshuar përdhe; bashtinat në të katër anët janë shkatërruar e shkretuar; janë prishur vreshtat e prerë drurët; të korrat janë plaçkitur e djegur, të gjitha të mbjellat janë zhuritur e pothuajse shfrosur. Në rrëthana të tilla të dhemb shpirti dhe zemërimi merr hov edhe më tepër.

A do të na bëjë zemra t'i shikojmë barbarët duke hyrë në qytetin tonë me brohoritje? Ata do të futen ndër banesat tona e aty do të rrojnë më së miri, kurse ne do të braktisim qytetin dhe do të dëtyrohem i të ndërtojmë ndër fusha disa kolibe e kasolle të këqija si stane barinjsh. Si do të kemi mundësi të qëndrojmë pa tregun tonë, pa kishat tona, pa varrezat e të parëve tanë? Si do t'i zhvillojmë, vallë, ceremonitë e shenjta të fesë sonë pa farë këngë e melodie? Aty ne do të jemi tamam si shurdhët e të pagojët. Në rrëthana të tilla a s'do t'u pëlcasë zemra atyre që janë të devotshëm? Pastaj, ç'marrëdhëniet mund të kemi ne me barbarët? Ne jemi gjak tjetër, kemi të tjera zakone, të tjera kanune e ligje, tagre të tjera e institucione të tjera, ne kemi tjetër fe; pastaj, as martesa me ta s'është legitime. Po ç'të them pastaj për mënyrën e të jetuarit dhe për zakonet e tyre? Për jetën e përditshme të tyre? Për kuvendet e djallëzuara të tyre? Për miqësinë e shoqërinë e tyre? Ne me këto punë jemi prej atyre aq larg, sa janë njerëzit prej kafshëve të egra. Ndërsa të gjithë popujt, sipas rregullave më të lashta, kanë qëndruar të matur e të përkorë dhe gjithmonë i kanë urryer më së forti fëlligshitë e trupit, përkundrazi këta kanë përhapur disa zakone që s'mund të thuhen me gojë dhe në këtë mënyrë i kanë hapur shteg vetës së vet për të gjitha aktet ku janë më të poshtrat. Ata nuk e kanë të ndaluar të thyejnë kurorën e martesës edhe me një njeri të farefisit, të ndjekin ëndjet e poshtra të mishit e të gjakut, me një fjalë të bëjnë çdo poshtërsi e paturpësi. Ata janë ndjekësit e atij Muhameti, i cili themë-

loi një kanun hyjnor e njerëzor që s'mund të thuhet me gojë. Që se u krijua bota, s'u gjet një tjetër si ai që të ketë zhdukur çdo fe, çdo virthyt e që të ketë vepruar kurdoherë në mënyrë aq të prapë e të poshtër. Prandaj këta nuk kanë asnjë ndryshim nga bishat e egra, bilit mund të thuhet se janë edhe më të këqij, sepse bishat veprojnë simbas instinktit, ashtu si ua ka dhënë natyra, e këta, përkundrazi, me një lakmi e etje të furishme, lëshohen si të tèrbuar ndër të gjitha mbrapështitë. Prandaj, o qytetarët e mi të dashur, në qoftë se s'doni të kujdeseni për veten tuaj, të keni parasysh të paktën fëmijët tuaj dhe pasardhësit tuaj, sepse këta, duke jetuar pranë tyre, do t'i kapë sémundja, epidemia, do të infektohen rëndë. Do të duroni ju që fëmijët tuaj të rriten e të edukohen në gjithë këtë llum vesesh, në mes gjithë këtyre zakoneve kaq të liga? Kujtoni ju se fëmijët tuaj do të dalin njerëz të mirë e të ndershëm në mes të një murtaje kaq të rëndë dhe në gjithë këtë pellg mbrapështish? Mos dëshironi, ndoshta, të humbni me trup e me shpirt ju vetë bashkë me fëmijët tuaj? A s'ju kujtohet, o prindër, se c'poshtërsi bënë këta barbarë edhe një herë tjetër? E çfarë poshtërsie! Tmerr! Ata rrëmbyen nga krahët e nënave të krishtere foshnjat dhe fëmijët e rritur dhe ua hoqën sytë prindërve. Ata dhunuan gratë në sytë e burrave të tyre; u çnderuan vajzat; torturuan meshkujt ashtu si u pëlqente atyre; i bënë skllevër dhe i mbajtën si bagëti. E kush do t'ua ndalojë atyre që të veprojnë prapë në këtë mënyrë? E kush do t'ua presë hovin? Ku do të anko hemi ne? Kush do të na japë të drejtë? Kujt do t'i kérkojmë ndihmë e mbësh'tetje? Ata do të jenë vetë fajtorë e vetë gjyqtarë. Sigurisht vullneti juaj do ta ndjekë këshillën që po ju jap. Pra, o qytetarë, ju, zonja, e ju, o djem, mundësisht, të mos humbim kohë: të ikim nga ky atdhe i pafat e i mjerë; të ikim nga këta njerëz mizorë e të humbur.

Ndoshta ndokush prej jush mund të më drejtohej me këtë pyetje: «Po ku të shkojmë? Nga t'ia mbajmë? Kush do të na pranojë ne? Kush do të na ndihmojë?» Sa për këtë, s'duhet të dëshpërohem. Derisa jemi në fe të vërtetë dhe besojmë te Krishti, për fenë e të cilit luftuam kaq kohë, derisa derdhëm gjithë atë gjak e vuajtëm aq shumë, s'kemi asnjë arsyë që të mos e mbajmë shpresën, sepse i madhi zot kurrë s'i braktis të drejtët. Veç asaj, ne do të na ndihmojë shën Marku, të cilin e nderojmë dhe e respektojmë me uratat e lutjet tonë; nën mbrojtjen e tij gjithmonë kemi qenë si ne, ashtu edhe të parët tanë dhe gjithnjë kemi qenë të devotshmit e tij.

Ne kurrë nuk i jemi shmangur detyrës sonë ndaj Republikës së tij; për atë jemi përpjekur gjithnjë në luftë kundër barbarit edhe kemi vuajtur të zezat e ullirit. Jemi përleshur aq herë me armiq, kemi pësuar aq sulme e rrëthime e kemi bërë aq luftëra si ne ashtu dhe të parët tanë nën zotërimin e Venedikut, të cilin ne vetë e patëm pranuar vullnetarisht e në asnje mënyrë nuk do ta braktisnim më sundimin e tij; ne kurrë s'kemi dashur zotërimin e tjetërkujt. Më së pari vendin tonë e pati sulmuar Balsha¹⁰⁵), i cili mbante sundimin e të dy Myzive, të Greqisë e të mbarë Rumelisë; ai kërkoi prej nesh që t'i dorëzonim edhe qytetin tonë. Meqenëse të parët tanë nuk deshën t'i binin në dorë, atëherë ai e mbajti të rrëthuar për një kohë mjaft të gjatë; mirëpo në fund vdiq dhe qyteti u lirua nga qarkimi. Më vonë ai princ Stefan u nis prej viseve të poshtme të Myzisë dhe erdhi e rrëthoi qytetin tonë me forca të mëdha¹⁰⁶), mirëpo s'kaluan tre muaj dhe u largua prej qytetit, duke lënë si komandant të ushtrisë së vet njëfarë Mazrreku. Ai e mbajti qytetin tonë të rrëthuar për dy vjet rresht dhe Shkodra, e ngushtuar shumë nga zia, për pak do të ishte dorëzuar, sikur të mos kishte ardhur një ushtri e madhe nga fiset kufitare dhe sikur të mos ishte zmadhuar edhe kjo ushtri me fiset e të gjithë krahinës. Kjo ushtri, pra, t'u sul mbi shatorret e armiqve, të cilët aq i theri e i shpartalloi, saqë vetë Mazrreku mezi shpëtoi me një pakicë fare të vogël. Pastaj, me një ushtri të pamasë u drejtua kundër nesh nipi i Stefanit, Gjergj Vuku¹⁰⁷), i cili iu sul Shkodrës dhe e rrëthoi, por në fund, mbasi hyri në marrëveshje me princin tonë, iku. Pas shumë vjetësh erdhi edhe princ Johani¹⁰⁸), kushëri i Balshës së lartpërmendur; Johani, mbasi qëndroi një kohë të gjatë në këto vise, kaloi në Apuli. Pastaj me ndihmën e disa princave prapë u fut në Epir dhe ia nisi luftës kundër qytetit tonë, por në fund u dëbua nga mbretëria dhe mezi mundi të dilte në Dauni. Pas vdekjes së Stefanit përsëri nipi i tij, Gjergji, u kthyte dhe prapë nisi luftën kundër qytetit tonë, por menjëherë u bë një marrëveshje me të me kusht që Tivari e Drishti të kalonin në zotërimin e tij. Mbas pak kohe dukë Stefanit¹⁰⁹), vjehrri i Balshës, u nis nga Myzia e Sipërme me një ushtri shumë të madhe dhe e plaçkiti, e dogji dhe e poqi gjithë vendin, por në fund u thye me krejt ushtrinë e vet, humbi Tivarin e Drishtin dhe mbarë tokat që kishte pushtuar edhe iku me turp. Tashti vonë, në kohët tona, na u sul edhe Altomani¹¹⁰) me një ushtri të pamasë. Ky, mbasi na plaçkiti vendin, kaloi Bunën dhe tanët e ndoqën edhe e kapën bashkë me të vëllanë pranë një

qyteti tē quajtur Svaç¹¹¹), edhe e dërguan tē lidhur nē Venedik. S'do tē mbetem pa përmendor edhe Skënderbeun, princin e epirotëve; thonë se tē parët e tij dhe ai kanë mbretëruar nē Maqedoni dhe nē Epir njëqind vjet. Ky, pra, është ai Skënderbeu që thonë se ka kryer sa e sa vepra tē shkëlqyera pér fenë katolike kundër turqve. Ky, kur ishte nē lulen e moshës dhe tē fuqisë së vet, mbasi pati grumbulluar një ushtri tē madhe, u furr mbi viset e Shkodrës dhe nisi tē ngacmonte qytetin tonë¹¹²), mirëpo nē fund hyri nē marrëveshje me Venedikun dhe u shpall sundimtar i mbarë provincës dhe i dhanë si dhuratë nënshtetësinë venedikase. Veç asaj edhe Lekë Dukagjini i është kërcënuar qytetit tonë me një luftë mjaft tē gjatë dhe¹¹³), mbasi u derdh mjaft gjak, hyri nē marrëveshje tē drejta. Në fund erdhi e plasi mbi ne një murtajë edhe më e tmerrshme: po bëhen njézet e tetë vjet që se ka filluar turku tē na mundojë shpirtin gjithnjë me sulme e me luftëra. Tashti, pra, o prindër tē dashur, meqenëse si ne, ashtu edhe tē parët tanë, vuajtën tē zezat e ullirit pér fenë katolike dhe pér Venedikun, vumë jetën nē irrezik pa na u trembur syri aspak e nē fund humbëm atdheun e djemtë tanë, le tē nisemi me gëzim e buzagaz pér t'u bashkuar me shoqërinë e shenjtë tē tē krishterëve, tē drejtohami pér nē Itali, tē cilën vetë zoti e ka zgjedhur si nënë e si dishepull tē mbarë botës, tē drejtohami nē qytetin e lashtë tē Venedikut, që është limani i shpëtimit tē vërtetë dhe i tē gjitha tē mirave, kryeqyteti i botës, qendra më e sigurt e fesë dhe e pages, sepse, ashtu si është themeluar nga vetë perëndia, ashtu do tē sun- dojë pér jetë tē jetës. Atje ne na presin çmime e shpërblime tē mëdha, atje pér ne është përgatitur një kurorë e artë.

Le tē shkojmë, pra, pa frikë e ballëhapët te shën Marku, te padroni dhe mbrojtësi ynë. Te ky shenjtor zakonisht kërkijnë strehë njerëzit e lodhur, tē mjerët dhe ai asnjeri s'kthen prapa, asnje shtegtari s'ia mbyll derën, por tē gjithë i pret me gjithë zemër e sidomos ata që janë tē devotshmit e tij; atyre u ndihmon me qdo mënyrë dhe i shtrëngon nē gjii...»

Pas këtyre fjalëve tē Flor Johimës përpëra tē gjithë atij kuvendi, shkodranët u entuziazmuam e u bindën edhe më te-pér dhe tē gjithë një mendjeje e një zemre morën vendim që tē braktisnin atdheun (megjithëse ishte punë shumë e rëndë dhe e vështirë), sesa tē duronin zgjedhën e rrezikshme e tē tmerrshme tē barbarit. Prandaj shkodranët iu bindën Venedikut, tē cilit gjithmonë si ata vetë, si tē parët e tyre, ia kishin mbajtur besën dhe e kishin nderuar sikur tē ishte njëfarë hyjnie. Ata u siguruan, pra, se turku as s'do t'i prek-

te, as s'do t'u vinte ndonjë pusi, sado që këtij prapëseprapë s'i besohej dhe përsëri mund t'i vriste ose t'i dëmtonte rëndë në një mënyrë ose në një tjetër.

Vetëm atëherë kur turqit dorëzuàn disa njerëz të vët si peng me qëllim që të rrëthuarit të dilnin të sigurt dhe pa u prekur, si i thonë një fjale, as me pupël, vetëm atëherë shkodranët ua lëshuan qytetin. Dhe turqit aty për aty, plot gjëzim e hare, midis brohoritjeve dhe duartrokitjeve u futën brennda në qytet dhe, duke u endur andej e këtej, ngulën flamujt e tyre në të katër anët; i qhanë shfrim qejfit të vët (siç e kanë zakon në raste të tilla) me trumbeta, me daulle e me sa e sa instrumente të tjera, entuziazmi i tyre ishte i pamasë, po çmendeshin nga gjëzimi që shtinë në dorë Shkodrën. Nga ana tjetër shkodranët lanë qytet e atdhe edhe të gjithë së bashku me plaçka e orendi u drejtuan të sigurt te flota veneciane, që kishte zënë vend nja pesë milje larg qytetit. Atje u furnizuan me gjithçka nevojitej për një lundrim të gjatë dhe, mbasi hipën ndër anije, u nisen prej limanit dhé thonë se ku me vela e ku me lopata dolën në det të hapët, derisa shkuan e ranë në gjirin e mëshirshëm e të dhimbshëm të Venedikut. Për madhështinë e Venedikut dhe për zotërimin e shenjtë të tij ata kishin luftuar aq trimërisht për sa e sa vjet, për të ata kishin derdhur gjakun, kishin flijuar prindërit, fëmijët, ata kishin thyer një armik aq të rrëzikshëm. Nën hijen atdheun, jetën dhe pasuritë e veta. Për madhështinë e Venedikut ata kishin ditë të bardha e të gëzuara derisa të vdisnin, dhe aty do t'i vinin kapak jetës së tyre të lavdishme si burra të fortë që ishin.

F u n d

Shtypur në Venedik nga venedikasi Bernardin de Vitalibus, më 10 janar 1504.

LUFTA E SHKODRËS

Gjergj Merula aleksandrinas¹¹⁴⁾, Jakob Merulës dhe Françesk Gambarinit shëndet.

Ma merr mendja se ju të gjithë pritni me padurim të dini se g'po bluan kundër nesh më i rrepti dhe më i fuqishmi armik i krishiterimit¹¹⁵⁾, sidomos po të marrim parasysh se çfarë arriti të bënte ai kësaj vere dhe, po t'ia kishte dalë atij qëllimi, pa dyshim do të kishte kryer kabin më të madh që prej sa e sa vjetësh ka ndër mend të kryejë.

Më së pari deshi t'i binte Italisë dhe të bënte kërdi në të ashtu si e patën pësuar rëndë ata të parët tanë, që për sa e sa vjet e patën kaluar jetën si egërsirat ndër skajet më të largëta të maleve dhe ndër skuta të shpellave¹¹⁶⁾. Dhe në të vërtetë turku më së pari i dha dërmën mbretit të Persisë, duke shpartalluar një pjesë të madhe të ushtrisë së tij në saje të një pozicioni të mirë që kishte zënë dhe në saje të mjeteve luftarakë që kishte¹¹⁷⁾; kuaj e kalorës persianë, dërrmuar e trumhasur nga ato goditje të potershme, braktisën sul-fushën e betejës dhe morën arratinë. Pastaj vendosi të sulmonte atë pjesë të Maqedonisë që gjendet buzë Adriatikut e që sot quhet Arbëri; po ta kishte shtënë në dorë atë vend, menjëherë do të kishte qenë pushtuar i gjithë bregdeti që përfshin Dalmacinë dhe Liburninë¹¹⁸⁾ dhe, duke u mbështetur në krahët e njerëzve, me një shpenzim të vogël ai do të kishte ndërtuar një flotë të madhe lufte. Pastaj, duke ruajtur po me këtë flotë Adriatikut, meqë kalimi në anën tjetër është Apulëshë i shkurtër, mbasi të kishte plaçkitur bregdetin e Apulës së dhe të Kalabrisë, do t'i hapte vetes shtegun për t'u futur brenda në Itali. Priti, pra, kohën e volitshme për ushqimin e gjithë asaj ushtrie në tokën e armikut. Dhe pikërisht atë-

herë kur në arat e Epidamnit¹¹⁹⁾ dhe në të gjithë atë krahinë bregdetare po afrohej koha e korries, dërgoi në Mizi¹²⁰⁾, qendër operacioni, një gjeneral të vetin, që turqit në gjuhën e vet e quajnë pasha i Rumelisë, për të grumbulluar ushtri. Ky njeri, mbasi mblodhi atje më shumë se njëqind mijë veta, pa e ditur askush se ç'do të bënte: a do të mësyntë Pano-ninë¹²¹⁾ apo do të kalonte në Azí, u sh'ti se gjoja po kthehej në Traki dhe në Adrianopol edhe, mbasi marshoi pér dy ditë rresht, përsëri u kthye, duke përpire pér një natë rrugën e dy ditëve. Mbasi nisi përpara gjashtëdhjetë mijë kalorës, aty nga mesi i majit u ra papritmas e krejt në befasi maqedonasve dhe i dërrmoi. Pastaj, si i kapi rrugës disa vëzhgues, përpara se të merrej vesh arritja e tij e papritur, shkoi e zuri vend në rrëthet e Shkodrës, që dikur ka qenë qytet romak.

Shkodra, mu në kufi me Dalmacinë dhe me Maqedoninë, është një qytet i forcuar më së miri, thuajse në të katër anët, nga vët natyra dhe dora e njeriut; rrëth e përqark ka shkëmbinj të mëdhenj dhe që nga lart syri përlan atje poshtë krejt fushat; vetëm nga njëra anë ka një të përpjetë të lehtë që të shpie deri në majë të kështjellës. Thuajse rrëzë kësaj kodre kalon uji i Bunës; nëpër këtë lumë derdhet në det një ligen i formuar vonë, ai lumë është pak më i madh se Taneri¹²²⁾ ynë. Mos u çuditni që thashë se ai lijenë është i epokës sonë, sepse me të vërtetë atë nuk e përmenden në veprat e veta as shkrimitarët grekë Straboni e Ptolemeu, as romakët Mela e Plini; këta, kur përshkruajnë këtë krahinë, çekin vetëm Drinin. Ky lumë kalon përbri Lisusit që sot e quajnë Lezhë dhe ndan Dalmacinë nga Maqedonia. Tash'ti neve na e merr mendja se, sikur të kishte qenë ky lijen që atëherë, s'ka dyshim se këta gjeografë kaq të përmendur nuk do ta kishin kaluar në heshtje. Dhe në të vërtetë, sikurse dalin në det ishuj dhe shkëmbinj, sikurse shpërthejnë edhe prej toke kroje e lumenj, bile dalin dita-ditës, ashtu na thotë mendja se edhe lijeni në fjalë do të jetë formuar shumë kohë pas shkrimitarëve të lartpërmendur. Ai shtrihet në një rrëth prej njëqind mijë hapash dhe nuk është më i vogël se Lariu dhe Benaku¹²³⁾ dhe këta dy lijenë në Galinë tonë përmenden shumë. Qytetin në fjalë vendësít në gjuhën e vet dhe të të parëve e quajnë Shkodër; sot italianët i kanë vënë një emër të ri dhe të huaj: Skutari. Sundimtar i këtij qyteti ishte Andon Loredani, një asi nipi që i zbardhi faqen gjyshit të vet, Pjetrit, dhe që djalë i denjë i Jakobit; dhe pikërisht atij i mbeten nderi e lavdia për shpëtimin e atij vendi apo më mirë për mbrojtjen e krishterimit. Ai i la nder veçanërisht derës së vet për arsy

se arriti të kryente diçka të jashtëzakonshme, doli fitimtar mbi një armik aq të rreptë.

Andon Loredani, pra, mbasi mori vesh se në tokën e Mizzisë po përgatitej e gjithë ajo mori ushtrie, i shqetësuar si përvete ashtu edhe për qytetin, sepse e dinte mirë se Shkodra kishte rëndësi të madhe për qëllimet e tarkut, dha urdhër që të grumbullohej në qytet gjithë drithi, kudo që të gjendej. Dhe një ditë përpara se të arrinte barbari, thirri dhe mbajti aty në kështjellë edhe disa prej djelmoshave fshatarë, që kishin dalë maleve. Pastaj dha urdhër që me kafshë barre të sillej ujë lumi brenda në qytet aq sa nevojitej për një rrëthim mjافتë gjatë.

Ndërsa ushtarë të armatosur lehtë bashkë me pararojën po e rrëthonin qytetin dhe po shtohej numri me njerëz, që vraponin nga të katër anët me mendje të plaçkitja, ndërsa edhe njerëz vullnetarë po ndiqnin fatin e luftës, më 4 qershori ia behu, me pjesën tjeter të ushtrisë, vetë komandanti. Ky burrë (në qoftë se mund të quajmë burrë një eunuk që kishte qenë rojtar i dashnoreve të sultanicës), sikurse thonë, është i bëshëm me trup dhe mjaf i shëndoshë, më tepër trim sesa i shkathët në zbatimin e detyrave të veta si ushtarak. Këtë njeri sultani e kishte ngritur deri në këtë shkallë dinjiteti për sukseset që kishte korru ndër luftëra. Ky kishte marrë me vete burra të shquar në artin ushtarak, të fortë nga trupi dhe trima. Nga pas vinin, përvëç stremeve të tjera, edhe një mijë gamile, ngarkuar me bronzi për derdhjen e topave, me të cilët zakonisht qëllohen dhe shemben ledhet.

Kur arriti e gjithë ajo mori ushtrie, u drodhën mbarë krahinat bregdetare. Edhe banorëve të bregut të Ilirisë dhe të Maqedonisë u hyri tmerri nga frika se mos po bëheshin kafshatë e barbarëve. Disa u arratisën ndër male të thepisura, disa të tjerë, mbasi braktisën qytetet, u shpërndalën ndër ishujt më të afërm me gra e fëmijë e pasuri. Një palë kishin zënë vend në grykat e lumenjve dhe po pritnin anijet, me të cilat do të drejtosheshin atje ku do ti conte fati.

Porsa e mori Senati këtë lajm, krerët e Venedikut, aq bujarë e shpirtmirë, rekrutuan ushtarë të rinj dhe pa dhimbje derdhën para të madhe; papritur një çast u dhanë me gjithë shpirt për të ndihmuar me çdo gjë të nevojshme vetëm për dëbimin e armikut; u dërguan të holla e ndihma sidomos disa krerëve që kishin nën sundim një pjesë të madhe të brigjeve të liqenit për t'u bërë ballë sulmeve të barbarëve ndër ngushtica e gryka të rrezikshme.

Nga ana tjeter ishte Triadan Griti, që kishte komandën e

lartë të detit¹²⁴), me të vërtetë tetëdhjetëvjeçar, por, me gjithë moshën e shkuar, kishte qëndruar shumë i fortë dhe e kishte mendjen top për ta kryer si duhet atë detyrë, gjë që askush nuk e besonte, sepse ishte diçka tepër e rrallë. Ky pikërisht ato ditë po udhëtonët nëpër détin Egje duke kontrolluar ishujt e atjeshëm dhe për pak sa s'po dilte në ishullin Kios, kur dëgjoi se Shkodra, një vend aq me rëndësi strategjike, ishte rrethuar dhe, mbasi ndërroi drejtim, mori rrugën drejt Adriatikut, mblodhi anije lufte, hyri në grykën e Bunës edhe dha urdhër që triremet dhe biremet të ngjiteshin përpjetë lumi me anën e lopatave, meqenëse, përveç rrymës së ujit, edhe era fynëtë në drejtim të kundërt. Mirëpo, tek arriti në një shenjë vendi ku ishin ngritur penda gurësh për t'ia frenuar rrjedhën ujit dhe për t'ia pritur vrullin e fortë e ku peshkatarët kishin ndërtuar kasolle të vogla pikërisht për të zënë peshk, mbasi anijet nuk po kalonin dot më tutje, ai e pa me vend, si punë më të sigurt, ta kalonte natën afér kishës së vjetër të shën Shirqit, që ndodhej një pesë milje larg qytetit, kështu që të nesërmen, në të zbardhur të dritës, me lundra dhe me barka të lehta të shikonte nëse mund të gjente ndonjë shteg për t'u ardhur në ndihmë të rrëthuarve. Armiku, porsa e mori vesh këtë plan me anën e vozitësve të arratisur, gjithashtu, si u vu në dijeni se mbarë flotës mund t'i pritej rruga, po të hidheshin trarë mu aty ku lumi ishte më i ngushtë për t'ua ndalur kalimin triremeve, menjëherë dha urdhër që të pezullohej çdo punë dhe të priteshin vetëm drurë edhe pjesa më e madhe e ushtrisë të dilte andej lumi, kështu që ushtarët tanë të goditeshin nga të dy brigjet me të gjitha llojet e armëve.

Në mes të këtyre përgatitjeve, ndërsa të gjitha shtigjet po ruheshin me kujdesin më të madh me qëllim që këtë tak-tikë të mos e diktonin venedikasit me anën e spionëve ose të arratisurve, ngrihet një djalosh grek që, i zënë rob nga turqit, kishte hequr gjithë të zezat prej tyre, por pastaj pashai e kishte afruar dhe bërë një nga zyrtarët e lartë të rrethit të vet dhe, duke sjellë nëpër mend atë fe në të cilën dikur ishte rritur dhe edukuar, vetëtimë i kërcen në shpinë kalit të pashait, rrëmben edhe heshtén e tij dhe me vrap turrejt drejt atje ku ishin ndalur anijet; kërkon të flasë me komandantin e flotës dhe, mbasi e futin në një triremë, ua zbulon planet e armikut dhe u thotë haptas sa i madh ishte rreziku që po u kërcenohej. Me të marrë këtë lajm, jepet urdhri që e gjithë ushtria e flotës të armatosej dhe të radhitej për luftim. Zgjidhen litarët, ngrihen spirancat, kthehen kiçat e anijeve në anën e kundërt, radhiten triremet në një mënyrë që me lar-

gësinë e duhur nga njëra-tjetra të ecin sa më shpejt pas rrjedhës së lumi, kur ja, që në lindje të diellit, dëgjohet nga çdo anë një turfullim e rrapëllimë kuajsh, një krismë mjetesh luftarake e armësh, që vezullonin së largu, një klithmë e potere kaq e madhe, saqë atë që nuk ishin mësuar, mbetën si të mahnitur. Turqit aty për aty fillojnë të gjuajnë flotën me shigjeta e me gurë, ashtu si të munden, kush me duar e kush me mjete të tjera; megjithatë flota ekte përpara, por aq e madhe ishte sasia e gurëve dhe e predhave, saqë të thoshte mendja se një breshër i fortë po i rrihte dhe po i mbulonte anjet. Ata që ishin më larg dhe s'mund të gjuanin, u jepnin zemër shokëve me britma të potershme. Po edhe venedikasit, duke parë se u zunë ngushtë dhe po qëlloheshin nga të dy anët, filluan t'i binin armikut me skorpionë e me pushkë dhe me aso mjetesh që ka shpikur kjo epoka janë e që i quajnë bombardë dhe spingarda¹²⁵); në këtë mënyrë ua prenë hovin armëve të armikut, dolën në breg dhe iu vunë mbrapa për më se dhjetë mijë hapa, duke e thyer keqas. Të dy palët vraponin të zinin një vend ku kalon lumi rrëzë dy sukave dhe ku është një pjesë e ngushtë, d.m.th. kaq afër janë dy brigjet, saqë mezi mund të kalojë vetëm një trireme. Barbari, me sa fuqi që kishte, përpiquej të arrinte i pari dhe ta zinte atë pozicion; ai e shihte mirë se aty mund t'u pritej kalimi anijeve tonia me trarë e me çengela. Përkundrazi venedikasit, me përpjekjen e vozitësve, përpjekje që s'kishte se ku të vente më, u jepte përpara me gjithë shpirt biremeve dhe triremeve¹²⁶ me qëllim që, mbasi të kalohej ajo ngushticë, ku kishte mbështetur të gjithë shpresën armiku, t'i shkonte këtij kot çdo mundim e orvatje. Megjithékëtë, në daç pse deshi fati, në daç pse të dy palët dolën të forta, si venedikasit ashtu edhe barbarët arritën thuajse përnjëherë në Shkallë (kështu e quajnë ngushticën e atyre dy sukave) dhe më aty u bë luftë e rreptë. Por tanët shpëtuan nga rreziku; anjet jo që jo, por asnjë lundërzë e tyre as u pengua, as u kap. Kjo punë e egërsoi shumë barbarin, sidomos për arsyen hëngri një grusht mjaft të fortë, nësa tanët po drejtoheshin te gryka e Bunës, prandaj ai zuri ta gjuante triremen e fundit mjaft rreptë me gurë e me mjete të tjera, ashtu si i erdhën për doresh në kulum të zemërimit. Po edhe kalorësit turq, grumbull siç ishin, u derdhën në lumë dhe u sulën me furi mbi vozitësit, duke ua kapur lopatat ndër duar, dhe nuk i lëshonin për vdekje, veçse kur tanët ua këputnin duart ose kur i flaknin poshtë me ndonjë goditje shumë të rëndë.

Së fundi, pa rënë rob asnë prej tanëve, flota shkoi e u fut në një vend të sigurt, por mbetën pesëqind veta të plagosur dhe tetëmbëdhjetë të vrarë, kurse mbi turqit u bë kërdi e madhe. Kjo u vërtetua të nesërmen kur, mbas largimit të barbarëve, tanët u kthyen përsëri te kisha e shën Shirqit me qëllim që edhe të rrrethuarit t'i shihnin nga lart, edhe ata vetë t'i jepnin armikut të kuptonte se ishin têrhequr jo nga frika, por për arsyen strategjike. Dhe gjetën përgjatë bregut kufoma njerëzish e kuaj të ngordhur sa të duash, disa kishin dalë edhe mbi ujë; tanët, duke mos e duruar gjithë atë erë të rëndë, u kthyen përsëri te gryka e Bunës. Mirëpo armiku ndërtoi një urë dhe i zuri të dy brigjet; këtej lumiit nguli shatorret dhe la atje si rojë nja dhjetë mijë kalorës dhe pastaj filloj të bënte pre në gjithë ato vise të begatshme, plaçkiti fshatra, u vuri zjarrin shtepive dhe prishi arat me grurë.

Ndërkaq prej Venedikut u transportuan në Askurium dërrasa të zdrukthuara, të lyera me zift. Askuriumi është një qytet që sot e quajnë Kotor; prej këtej gjithë ajo lëndë do të mbartej me kafshë barre e me njerëz nëpër disa male të vështira e rrugë pa rrugë dhe do të shkarkohej në breg të liqenit; aty, pastaj, ustallarët do të ndërtonin barka lumore që do të përdoreshin më tepër për luftë sesa për transport. Veç kësaj, u dërguan më tepër se një mijë marinare, të cilët, me lundra të lehta dhe me monoksila¹²⁷, do fëruanin liqenin dhe do ta ndiqnin e s'do ta linin një çast të qetë armikun, që kishte ngulur shatorret gjatë bregut të lumiit. Por, megjithëse bënë çmos t'u shkonin në ndihmë të rrrethuarve, s'ia dolën dot, nga njëra anë sepse barbari mbante rojë natë e ditë te një grykë e ngushtë ndërmjet malit e lumiit, që aty mund të ishte i gjerë nja pesëqind hapa, dhe prej atij vendi roja s'tundej fare, po ta gjuanin edhe me shigjeta, në dac prej malit, në dac prej lundrave; nga ana tjetër sepse një vojvodë i pabesë, për të shpëtar pasuritë e veta, hëngri para dhe nuk u dha tanëve ndihmën e duhur. Atëherë, duke mos pasur më besim te ky njeri, ushtarët tanë që qarkulloin me lundra, meqë shatorret e tyre nuk ishin më të sigurta përgjatë lumiit, hoqën dorë nga përleshja ballë për ballë dhe u kufizuan në aksione të vogla, duke mos i lënë armiqtë një minutë të qetë, saqë këta as ujë nuk mund të mbushnin pa vënë kryet në rezik. Dhe njëherë, ndërsa ata barbarë po shkonin duke plaçkitur tamam si hajdutë dhe po gjurmonin disa fshatarë vendës, të cilët ishin fshehur ndër pyje të

dendura, nja treqind veta prej tyre kishin zbritur te një krua për të pirë ujë dhe aty për aty u lëshuan mbi ta banorët e vendit bashkë me ushtarët tanë, i rrrethuan dhe i copëtuan pothuaj të gjithë sa qenë. Kështu shpëtuan pa u prekur edhe disa shkëmbinj dhe ishuj të liqenit, ku ishin ndërtuar për meshtarët grekë¹²⁸⁾ disa manastire shumë të bukura, të cilat do të kishin qenë dhunuar prej atyre njerëzve të pashpirt.

Ndërkaq armiku përgatiti disa topa të një madhësie të jashtëzakonshme; ata ishin të një kalibri aq të madh, saqë, kur u gjuajtën ledhet e kështjellës, këto u lëkundën sa s'ka dhe pjesa më e madhe u rrafshua përdhe. Mirëpo të rrrethuarit, që kishin grumbulluar mjaft lëndë për t'u mbrojtur dhe për të bërë fortifikime, të cilat nevojiteshin sidomos tashti, që qyteti mbeti pa mure, morën një grumbull trarësh dhe i mbërthyen kryq e têrthor, i ngjeshën me dhë e me baltë edhe sajuan një pengesë, që doli me të vërtetë diçka e potershme dhe që do të shërbente si një ledh shumë i fortë për të përballuar sulmet e armikut. Atëherë barbari zuri e shtiu me bombarda plot një mijë e nëntëqind herë, duke rrënuar e rrafshuar përdhë ledhe e shtëpi, dhe kujtoi se tashmë do ta kishte shumë lehtë ta pushtonte qytetin me një mësymje të ushtrisë. Dha urdhër, pra, të përgatiteshin hekurishte, drunj dhe mjete të tjera për rregullimin e trinave dhe të strehëve dhe të gjithë të qëndronin gati për mësymje, kështu që me pushtimin e qytetit me anë të forcës të korrnin në njëfarë mënyre frytin e fitores mbas gjithë atij mundimi e djerse. Dhe menjëherë me britma të mëdha, me krisma daullesh dhe borish, me zjarrë, që u ndezën në të katër anët, mbasi u falën, përshëndetën hënën e re duke rënë përbysë mbi tokë sipas zakonit. Sepse duhet ditur se otomani kurrë nuk ia nis luftës së ashtuquajtur «të përgjithshme» pa dalë hëna e re dhe pa e përshëndetur atë me devocion të madh. Pra, më 15 gusht, pashai, mbasi u premtoi shpërblime atyre që do t'u ngjiteshin fortifikimeve deri në majë, radhiti ushtrinë dhe me dy të shtëna bombardash dha shenjën për sulm. Porsa u dha shenja, të gjithë dolën prej kampit dhe u turri vap përpëra. Pastaj, mbasi bërtitën deri në kupë të qiellit, duke sjellë me vete strehë, trina e grremça, shkëmb më shkëmb e rrugë pa rrugë, iu ngjitën malit vetëtimë deri atje lart.

Loredani, si ai që për trimëri e për art ushtarak s'i lëshonte rrugë askujt, sipas një plani që pati përgatitur qysh me fillimin e rrithimit, i vendosi repartet e veta ndër po-

zacione në një mënyrë të tillë që të rrrethuarit, së bashku me garnizonin italian dhe me rininë fshatare, të zinin vendet e veta aty pranë, por të qëndronin në heshtje dhe të fshehur dhe në këtë mënyrë të lihej armiku të vinte deri rrëzë fortifikimeve. Pastaj zgjodhi treqind veta, të cilët do të qëndronin mu te sheshi i kështjellës me armë në dorë për t'u sulur kudo që ta lypte nevoja.

Mbasi pjesa më e madhe e shigjetarëve u soll rrith e përqark ledheve me qëllim që t'i dyndte të rrrethuarit prej fortifikimeve, u dha një klithmë e madhe dhe atëherë turqit iu afroan mureve, vunë shkallët, nisën të mësynin me furi nga të katër anët, kështu që me atë farë sulmi nga çdo drejtim të mos dihej më se në ç'anë duhej të bëhej më qëndresë dhe ku duhej të jepej ndihma urgjente. Pikërisht në këtë strategji e kishte mbështetur barbari gjithë shpresën e vet. Dhe, ndërsa në kështjellë derdheshin si breshri gjithfarë predhash e gjylesh, papritur e pa kujtar shpërthyen nga të gjitha anët të rrrethuarit, të cilët u mblo-dhën tok dhe me të gjitha mjetet e luftës e ashtu përzier filluan t'i binin armikut që ishte ngjitur deri atje lart. Disa flaknin nga lart shkrepët e mëdhenj dhe trarë të thepisur, ashtu si u vinte për doresh, por turqit nuk u ndaheshin dhe njëra palë zëvendësonët tjetrën. Aty pranë qëndronte edhe pashai, duke dhënë urdhra; vërente dhe lavdëronte ata që tregoheshin trima, kurse frikacakët dhe të ngathëtit gjithnjë i shante. Po të shihte ndonjërin që tërhiqeji, i gërmushej me shpatë dhe e shtynte të luftonte duke e kërcënuar se do t'ia merrte shpirtin aty për aty. Prandaj, sado që pjesa më e madhe e turqve nuk mund t'i bënte ballë gjithë atij materiali gurësh e predhash që binin së larti e me gjithëse shumë prej tyre përplaseshin të vrarë përdhe, prapëserapë askush nuk guxonë të kthehej mbrapa, as të luante nga vendi. Përkundrazi shkodranët, herë duke rrrokullisur shtamba mbushur me gurë aty ku brinjë e kodrës ishte më thikë, u binin turqve ashtu grumbull siç ishin, herë hidhnin tatëpjetë trina xunkthash lyer me zift e të ndezura dhe prej flakës së tyre këshedi sa e sa veta nga armiku digjeshin e përcelloheshin dhe për më tepër lëshonin gjithë atë dritë sa t'u mjaftonte të rrrethuarve për të parë mirë; sepse turqit e kishin nisur luftën natën me qëllim që t'u kallnin tmerrin atyre lart e njëkohësisht ta mbulonin mirë dredhinë dhe taktikën e vet. Lufta vazhdoi gjithë natën shumë e rreptë; të rrrethuarve s'iu la një çast pushimi.

Të nesërmen sulmi u bë edhe më i fortë. Kujtuan barbârët, se tashmë fitoren e kishin në dorë, prandaj u lëshuan me turr në mes të të plagosurve dhe të shigjetave e, duke kaluar nëpër kufoma, për pak sa s'arritën të pozicionet e fortifikuara, sidomos nga ajo anë ku ledhet ishin bérë rrafsh përdhe. Disa prej tyre zgjatnin me forcë aty në pahisore ca shtaga me çaponj hekuri të mprehtë për t'u ngulur rojave dhe pastaj me atë grremç të kërrusur t'u shqyjenin mishin ose t'i têrhiqnin këtej. Por shkodranët, pa iu trembur syri aspak, qëndronin si burra aty te pahisorja dhe, duke u përleshur me armikun me shpata e me sëpata, e përplasnin aty në vend copë-copë. Dhe kishte ardhur çasti në të cilin të rrethuarit që nga lart po bënин kërdi mbi armikun me gjithfarëlloj mjetesh e gjylesh, duke mbrojtur qytetin me gjithë shpirt e me sa fuqi që kishin, dhe luftimi kishte arritur në kulm, kur, ç'të shohësh, barbarët nga të katër anët e fortifikimeve detyrohen të marrin tatëpjetën. Nja tri orë mbasi kishte dalë dielli, ngaqë shkallët e rrethuesve me gjithë njerëz po plandoeshin përdhe dhe ushtria turke filloi të ligështohej e të binte moralisht, qytetarët morën zemër, iu shtua guximi, iu ngrit morali në kulm; kapercyen ledhet dhe me një hov të tmerrshëm iu vunë në shpinë armikut që drejtohej me vrap drejt shatorreve dhe s'i ndanë aspak derisa arritet në kampin e tyre, ku u ndez një luftë e rreptë dhe e përgjakshme midis dy palëve dhe shatorret u shkatërruan e u bënë copë-copë. Menjëherë iu vu zjarri trinave e, mbasi era u frynte në shpinë turqve, disa prej tyre u dogjën e u shkrumbuan në flakë, disave iu mor fryma nga tymi i madh dhe u vunë në të ikur.

Shkodranët po ktheheshin në qytet me flamuj të ushtrisë armike dhe me kokat e disa komandanëve që kishin mbetur të vrarë gjatë sulmit e i eksposuan rreth e përqark ledheve dhe me shpata flakëruese në dorë talleshin me armikun duke e thirrur të përllesheshin përsëri.

Edhe pashait i kishte rënë një gur në kofshë dhe e kishte vrarë mjaft. Siç u duk pastaj nga letrat e princave kufitarë dhe me sa treguan vetë të arratisurit, në atë luftë kishin mbetur të vrarë nja shtatë mijë veta dhe shumica ishin plagosur; mezi gjeje ndonjë njeri që të ishte kthyer në kamp pa një plagë; s'kishte shatorre ku të mos dëgjoje vajtime apo gjëmë të plagosurish. Luftë me të vërtetë e rreptë, aq sa pashai, i tmerruar, i kishte shkruar sulltan Mehmetit për trimërinë e të rrethuarve dhe për dëmet e

mëdha të të vetve. Veç kësaj, ajo krahinë, sidomos në muajt gusht dhe shtator, aq është e murtajosur, saqë vetë vendësit mezi e durojnë atë klimë të dobët, jo më të huajt që do të bartin mundimet e jetës ushtarake, dhe do ta kalojnë kohën jashtë me gjithfărë mungesash e vuajtjesh. Për këtë arsyebas gjithë asaj gjakderdhjeje shumë veta nga tanët dhe nga barbarët vdisnin prej eteve, që shkaktonte ajri i prishur dhe uji i kënetave. Për këtë shkak, kur otomani e mori vesh këtë punë, megjithëse e shihte se do t'i ulej autoriteti, po ta kthente ushtrinë prapa, prapëse-prapë dha urdhër që të hiqe rrëthimi. Kështu më 17 gusht, në të zbardhur të dritës, turqit, mbasi u vunë zjarrin shatorreve, u larguan në heshtje të plotë nga rrëthi i Shkodrës ose sepse, sikurse thamë më lart, të dërrmuar prej sëmundjesh, s'patëndë mundësi ta duronin atë klimë të ligë, ose sepse kishin në shpinë një armik tjetër, ose sepse (që ka më shumë të ngjarë) e kishin humbur shpresën përmes shtimin e qytetit, duke marrë parasysh se të rrëthuarit do të qëndronin më gjatë dhe do të duronin çfarëdo mundimi, apo pse patëndë frikë nga kalorësia italiane, që kishte ardhur me anije dhe ishte shkarkuar në Durrës dhe kështu, duke u mbështetur në ndihmën e ushtrive fqinje, në ndeshjen e parë do ta kishin shpartalluar dhe dërrmuar dhe dobësuar rëndë ushtrinë turke.

Sidoqoftë, neve na punoi fati, sepse, po ta kishte pustuar turku Shkodrën, do t'i kishte hapur vetes shtegun përmes tij që dalë në Apuli dhe përmes t'u sulur drejt Romës. Nuk ka njeri më të pashpirt se ky tiran; qëllimi i tij është të pushtojë Romën. Prandaj, gjithësaherë që mësyhej Shkodra, dëgjoheshin ndër ato klithma zëra që gjithnjë bërtitnin deri në kupë të qiellit: Romën, Romën! Kështu, kujtonin se, duke shtënë në dorë Shkodrën, s'do të dilte njeri që t'u ndalonte hovin përmes marrë në dorë Perandorinë Romake, mbasi të shtrohej Italia, dhe të bëheshin zotër të dy Romave, d.m.th. të asaj së lashtës, që dikur pati zotëruar mbarë botën, dhe të asaj së resë, të cilën Konstantini, një mijë e dyqind vjet përpara, mbasi i pati shpërngulur romakët prej Trakisë, e quajti në emër të vët, Konstantinopol.

S'kam gojë t'i pëershkruej trimëritë e shkodranëve, qëndresën dhe durimin e tyre në të gjitha ato vështirësi; ata hoqën aq, sa dikur s'patëndë hequr as saguntinët atje në Spanjë, as kasilinatët¹²⁹⁾ në Itali, kur i rrëthoi Hënibali, sikurse na thotë historia. Në një rrëth aq të ngushtë të asaj kësh-tjelle ishin grumbulluar nja gjashtë mijë shpirë: burra, gra-

e fëmijë, kurse ata që ishin të aftë për mbrojtjen e qytetit a ishin a s'ishin nja dy mijë veta; të tjerët nuk ishin në gjendje të rrroknin armët për luftë.

Gjatë rrithimit filloj t'u mungonte edhe uji, sepse aty pinin ujë shiu të mbledhur ndër ubla, dhe nisën të hanin kokrra drithi gjysmë të përzhitura. Bile s'kaloi shumë kohë dhe mbetën fare pa ujë apo me një sasi fare të vogël (sepse për pesëdhjetë ditë rresht nuk ra asnjë pikë shi) dhe atëherë atyre që s'ishin të aftë për luftë s'u jepej asnjë pikë ujë, kështu që, duke mos pasur mundësi ta njominin pak gojën e shkrumbuar dhe t'i ushqenin zorrët e thara, rrith tri mijë veta vdiqën në mënyrë të padenjë dhe si mos më keq; gruaja ndër krahët e burrit, foshnja në sy të prindit, motra dhe vëllai i vogël aty përpara vëllait më të madh. Aq u bënë të fortë njerëzit dhe aq u kalitenë në mes të atyre vështirësive, saqë ai ushqim që kishte mbetur, u rezervohej vetëm atyre që ishin në gjendje të luftonin. Në fund, mbasi edhe uji që ndahej po fillonte të mungonte (vetëm nga dy kupëza në ditë jepeshin për secilin) dhe mbasi njerëzit, të tharë për ujë, boshatisën fundet e qelburat të ublave dhe s'po mund ta duronin më rrithimin, duke humbur çdo shpresë për shpëtim, vendosën që, mbas shembullit të burrave të fortë, me një mësymje të rrufeshme mbi armiq, ose t'i hapnin rrugë vetes, ose të vdisnin duke luftuar si burrat. Loredani, i cili pikërisht në ato rrithana tragjike po përgatiste njëfarë plani, me urtësinë dhe me njerëzinë e vet të pashoqe arriti t'i qetësonte ato zemra të brengosura që morën vendim për diçka të rrezikshme dhe nuk e quajti aspak për turp t'u lehtësonte atyre të shkretëve me fjalë të ëmbla e me lutje gjithë atë mori të zezash, por, i gjunjëzuar ndër këmbët e tyre dhe me lot në faqe, hapi kraharorin dhe u tha se ishte gati t'u jepte gjakun e dejve të vet për ta pirë dhe zemrën e vet si ushqim përtta, veçse të kishin durim të paktën edhe dy ose shumë-shumë tri deri në katër ditë ndër të zezat e luftës e të rrithimit, sepse ishte duke u ardhur ndihma e duhur dhe kështu armiku do të zmbrapsej dhe emri i tyre do të përmendej brez pas brezi. E, në rast se e kishin humbur shpresën te ndihma e njerëzve, ata duhej të kishin besim 'në të madhen dhe në të plotfuqishmen perëndi dhe në Krishtin e kryqëzuar, që do t'i shpëtonë prej atij tirani të pabesë e të pashpirt, ashtu si në të vërtetë ndodhi. Sepse i madhi zot, duke pasur mëshirë për gjendjen e mjeruar të atij pozulli, i erdhë në ndihmë në një mënyrë fare të papritur.

Dhe, siç mora vesh me anë letrash, Krishti i lumtur e paska shpëtar popullin e vet nga thonjtë e atyre të pafeve, gjatë gjithë atyre përleshjeve, nga të rrëthuarit vepse, pesëdhjetë veta paskan mbetur të vrarë dhe më pak se njëqind veta të plagosur e, ajo që na u duk si mrekulli, dy gjyle të mëdha të barbarit kishin rënë mu në mes të një grumbulli të madh të rrëthuarve që ishin mbledhur tok dhe vetëm dy veta prej tyre kishin mbetur të vdekur, aq fort iu gjet ndihmë perëndia të vetve dhe i shpëtoi prej gjithë atij armiku e prej gjithë atyre armëve.

Gjatë kësaj lufte sëmundja, e shkaktuar nga kutërbimi i kënetave ose nga malarja, mbyti, përvëç sa të tjerëve nga tanët, edhe dy kapidanë, Ludovik Bembon, përfaqësuesin e Venedikut, dhe Triadan Gritin, kryekomandantin e flotës detare. Në vendin e tyre si përfaqësues i Venedikut e pastaj si prefekt i Shkodrës u emërua Anton Loredani dhe të gjithë këtë emërim e pritën me gëzim të madh, sikur t'ia ndiente zemra gjithkujt se nën udhëheqjen dhe me oguret e këtij njeriu jo vetëm që do t'u thyhej hovi turqve, por këta do të dërrmoheshin fare. Dhe sikurse motit familja e Skipionëve ia nënshtroi sundimit të Romës dhe ia hoqi qafe Kartagjenën, që e kishte shemër, ashtu edhe udhëheqësit Loredanë do t'ia thyenin hovin otomanit dhe do të dilnin triumfues mbi një armik kaq të tmerrshëm.

Tashti turku po përgatit në Konstantinopol një flotë të madhe, siç po thonë ata që kanë ardhur këto ditë prej atyre viseve. Edhe qytetin vetë po e përtërin dhe po e fortifikon me sa fuqi që ka, duke grumbulluar gjithfarë materiali dhe duke thirrur nga të katër anët teknikë të zotët pér fortifikime të tilla. Kërcënime të mëdha priten prej këtij tirani të tërbuar e mendjemadh, të cilit sivjet i shkuani punët si mos më keq; vetëm në fushatën e Shkodrës ka humbur më tepër se njëzet mijë veta pér turp e faqe të zezë të tij.

Djali i tij më i vogli, i cili udhëhiqte në territorin e Cilicisë¹³⁰⁾ ajkën e ushtrisë kundër persianëve, kur pa se iu shpartallua ushtria, u sëmur rëndë dhe vdiq. Atëherë sulltani Mahmud pashën, një nga këshilltarët e vet dhe një nga shokët e fushatave, që me zotësi pati shtruar Eubenë dhe pati dalë faqebardhë në luftën kundër persianëve, e vari në litar ose sepse i kishte hyrë frika pér ndonjë tradhti, ose sepse kishte dashur të hakmerrej pér vdekjen e të birit, të cilin, sikurse flitet, e paska helmatisur Mahmudi, sepse ai djalë paskësh adhuruar gruan e tij dhe e paskësh shtënë


në dorë tinëz burrit. Dhe, duke mos u mjaftuar me kaq, edhe të vëllanë e përshkoi me hu tejpërtej duke e mbytur me torturat më çnjerëzore. Deri gruan me gjithë fëmijët e njomë ia mbyti po me aso torturash.

Kalorësit tanë, që luftojnë në Peloponez, pashanë turk bashkë me dy mijë kalorës i zunë robër dhe i përshkuant të gjithë me shpatë. Veç kësaj ata pushtuan edhe kështjellën e pathyeshme të Rampanit^[34], mbasi zunë në befasi dhe vranë rojat.

Por me shumë kushte e me shumë lutje duhet zbutur i madhi zot, për hir të të cilit punët po na shkojnë pérherë e më mirë, që këtë murtajë dhe këtë shuplakë të popullit të vet ta largojë prej nesh. E, në qoftë se të zezat dhe mbrapështitë tona kërkojnë ndëshkim, derisa për fajtorët ka gjithfarë kërbacësh dhe derisa perëndisë nuk i mungojnë mjetet për dënimin e fajtorëve, me vishkull tjetër le të na rrahë dhe me mundime të tjera le të na ndëshkojë.

Shëndet e të fala

Venedik, 10 shtator
1474



PANEGJIRIK¹³²⁾ i MARIN BEÇIKEMIT SHKODRAN
(DREJTUAR) SHUMË TË KTHJELLËTIT DOGJË
LEONARD LOREDANIT DHE SHUMË TË NDRITURIT
SENATIT TË VENEDIKUT.

Sikur unë të isha lindur jo nën sundimin e Venedikut, por edhe në një skaj të viseve më të largëta, në një botë tjetër dhe për pak sa s'thashë nën një diell tjetër; sikur unë të banoja jo në Itali, jo në Breshja¹³³⁾, jo në një qytet kaq të përmendur e besnik të shtetit tuaj, por mu në skaj të botës, prapëseprapë nuk do të përtoja të kapja fëmijët e mi dhe, duke udhëtar me vrap, qoftë edhe nëpër rrugë shumë të gjata, të drejtohesha nga Venediku që të kisha mundësi të shihja lartësinë tënde, të shikoja madhështinë e këtij Senati shumë të lavdishëm dhe t'ju nderoja...

Pastaj unë të falënderoj ty, o i larti princ, ty me gjithë Senatin, që ma plotësuat dëshirën time; bile ju falënderoj me gjithë zemër dhe nxehësisht që e patë të arsyeshme se e méritoja këtë nder; dhe falënderimet e mia janë më të mëdha e më të ngrohta në qoftë se pa meritën time më gjykuat të denjë për një nder kaq të madh. O zot i madhërishëm, se me çfarë zemre më ftuat të vija këtu pikërisht atëherë kur unë kisha frikë t'ju dilja përpëra. Sa mirë që më pritet...¹³⁴⁾

Sulltan Murati II... si rrufe pëershkoi mbarë Greqinë me gjithë tokat e ishujt e afërm dhe s'mbeti njeri pa u dridhur e pa u tmerruar dhe të gjitha ato vende i shtiu në dorë deri në Vlorë. Bile pushtoi edhe Epirin. Së fundi, mori edhe Krujën, një kështjellë, që nga natyra e vendit nuk mund të pushtohej në asnjë mënyrë, por atë ia dorëzoi prinçi Gjon Kastrioti bashkë me tre djemtë e vet si peng: Konstandinin, Reposin e Gjergjin (të cilin pastaj turqit e quaj-

tën Skënderbej), megjithëse edhe djalin e madh, Stanishin, bashkë me pengje të tjera më bujare ia pati dorëzuar që më parë si dhuratë Isak beut me anën e djemve të vet, Barakut dhe Isa pashait¹³⁵).

Dihet mjaft mirë se ç'kanë vepruar venedikasit kundër këtij armiku, atëherë kur perandori Sigismund dhe Filipi, duka i Burgundisë, në luftën kundër tij u shpartalluan keqas¹³⁶); dhe në të vërtetë Filipin, i cili qe dërguar në Adriapol për të stolisur triumfin e ngadhënjyesit, venedikasit e shpëtuan kundrejt një shpërblimi të madh në të holla, kurse Sigismundin, në ikje me disa të tjerë, prapë venedikasit me flotën e vet, që ruante detin e Propontidës¹³⁷), e shpëtuan prej armikut që po e ndiqte me një kalorësi të shpejtë; e çuan në Raguzë dhe prej andej ai u kthyte në Panoni.

S'po i përmend ndihmat që venedikasit i dërguan despot Gjergjit kur ky iu kthyte mbretërisë së Myzisë me ndihmën e Vladislaut, mbretit të virthshëm të panonëve¹³⁸.

S'po përmend se çfarë trimërie treguan ata në brigjet e Propontidës, kur pikërisht Vladislau pati vendosur të bashkohej me ushtritë venedikase; por çdo shpresë i shkoi kot, sepse gjenovezët, me sa thuhet, të thyer me të holla prej Amuratit, transportuan me anije të veta prej Azie ushtrinë me të gjitha mjetet e tjera luftarake dhe, përrpara se të bashkoheshin të dy ushtritë armike, turku mendoi t'i dilte përballë panonit dhe, mbasi u ndez beteja mu rrëzë kështjellës së Varnës, megjithëse Sabendini, pashai i Rumelisë, d.m.th. kryekomandanти i ushtrisë turke të Evropës, u thye prej Gjon Huniadit, guvernatorit të mbretërisë, prapëseprapë mbreti, si djalë i ri që s'diti të ruhej, u vra dhe krishterimi qysh me atë luftë e pësoi rëndë për një kohë të gjatë.

S'ka njeri që të mos jetë aq në dijeni të ngjarjeve, që të mos e dijë se ç'keni vepruar ju kundër Mehmetit II, sa gjak keni derdhur për perandorinë konstantinopolitane, sa gjak për shpëtimin e Perandorisë së Trapezuntit¹³⁹) dhe për sigurimin e për lirinë e Bosnjës¹⁴⁰), d.m.th. të Panonisë së Poshtme. Vallë ju lëshoi zemra ju në mbrojtjen e Peloponësit¹⁴¹)? S'qetë ju që me një flotë madhëshfore e të fuqishme dhe me këmbësori e kalorësi u nisët nën komandën e burrit të shquar, Kristofor Mauros, porsa dha shenjën papa Piu II¹⁴²)? Nuk qetë ju, vallë, që e armatosët Usung Hasannin¹⁴³) kundër armikut të përbashkët- S'qetë ju që i dhatë dërmën kalifit të ushtrisë aziatike që e quajnë pasha i Anadollit? A nuk u dalluat dy herë në këtë farë trimërie? A nuk

qetë ju, vallë, që e shporrët prej tokave tuaja pikërisht Mehmetin, duke bërë kërdi mbi të e duke e mbuluar me turp e faqe të zezë?

Po sot, a nuk qetë ju që ia thyet hovin mbretit të sotëm, Bajazitit^{143a)}? S'qetë ju, vallë, që i dolët përballe fuqisë turke, e cila faqe gjithë botës kërcenohej se do të bënte çmos ta lante në gjak Italinë me gjithë viset e Perëndimit? Unë me këta sy kam parë gjakun e venedikasve duke shkuar rrëke; kam parë të vrarë sa kapidanë trima, kam parë sa limane e brigje plot me kufoma burrash në nam e në zë, kam parë se në c'gjendje u katandisën sa e sa qytetarë nga më fisnikët, sa anije që u mbytën; sa qytete që u pushtuan i kam parë duke u zhdukur në çast; të dridhet zemra në shtat po t'i kujtosh kërcenimet e tmerrshme të ditëve tona.¹⁴⁴⁾

Por nuk do të ndalem të flas më gjatë mbi këtë pikë, jo aq për të mos përtërië kujtimin e sa të zezave që janë harruar, sesa për të mos lënë pas dore në këtë bisedë lavdet tuaja të shkëlqyera, ndërsa po nxjerrim në shesh mbrapështitë e tjetërkujt. Deri këtu u rashë shkurt ngjarjeve. Po fundi pse të zgjatem në përshkrimin e fatkeqësive, derisa po shoh se ju nën udhëheqjen e princit tonë thuajse çdo punë e keni rregulluar më së miri?

Këto që thashë, të gjithë i mbajnë mend, të gjithë i rrëfejnë dhe, në i paçin sytë në ballë, të gjithë i shohin: Senati i Venedikut përditë e më me zjarr shkon duke ia prerë hovin tërbimit barbar dhe s'do ta durojë më gjatë një shëmtim e një turp kaq të madh; jo, nuk do të mbetet pa e shkulur me rrënje këtë murtajë kaq të tmerrshme e kaq mizore, e cila orvatet ta helmojë e ta zhdukë fënë e krishterë; jo, nuk do të mbetet pa e flakur, me sa fuqi që të ketë, përtej Skythisë¹⁴⁵⁾ dhe Kaukazit dhe pa e shfarosur tiranin turk, Bajazitin, të vetmen shuplakë të krishterimit, njeriun më të pabesë e më gjakësor që ka parë bofa.

MERITAT E DERËS SË LOREDANËVE

Këtu, mbasi përshkrova shkurt se si veproi Republika përfund e për nderin e vet, mund të dalë ndokush dhe të më thotë se mos, vallë, kam ndër mend t'i kaloj në heshtje lëvdatat e derës së Loredanëve, derisa ajo i ka bërë shërbime aq të mëdha Republikës, saqë thuajse s'ka pasur as lavdi,

as fatkeqësi ku tē mos ketē qenē komandant ushtrie ndonjë prej Loredanëve dhe tē mos i ketē dalë nami, sikurse duket sheshit nga dëshmitë e tē gjitha analeve.

Oh, sikur tē kisha mundësi t'i rreshtoja tē paktën vetëm emrat e tyre dhe t'i këndoja trimëritë e tyre ashtu si e kam pér detyrë e si ma do zemra; mbasi, pérveç arsyes së kësaj barre që mòra përsipër, del edhe fakti se, megjithëqë Shkodra i nderoi dhe i respektoi njësoj tē gjithë senatorët dhe bujarët e Venedikut, prapëseprapë që në fillim zgjodhi si pajtorë tē vet Loredanët, sikurse motit Sidicinët patën zgjedhur si pajtorë Kasejtë, Puteolanët Brutët, Lacedemonët Klaudejtë... Marcelët, Alobrogët Fabejtë, Bononensët Antonejtë, Dyrrahinët Ciceronët¹⁴⁶); pikërisht nën mbrojtjen e Loredanëve kanë qenë dikur tē parët tanë, nën hijen e tyre kanë jetuar baballarët tanë; edhe sot ne dhe bijtë tanë, Loredanët i kemi si prindërit tanë¹⁴⁷.

Vetë perëndia, zot i gjithësisë, veproi në mënyrë që prej çdo ngushtice e vështirësie tē na shpëtonte një udhëheqës nga dera e Loredanëve dhe pikërisht në shoqëri me njërin nga Loredanët dhe nën udhëheqjen e tij tē përshkoheshin (sikurse do tē tregojmë më vonë) nëpër sa e sa vuajtje, rreziqe e tē zeza...

Por tē gjithë këtyre burrave nuk do t'u vijë rëndë në rast se do t'i kalojmë në heshtje, sepse këtu na del përparrë Antoni, i quajtur Shkodrani¹⁴⁸), i cili edhe gjetiu kërkon tē themi pér tē se me çfarë durimi e trimërie qëndroi në rrëthimin e Shkodrës në një çast kur tē gjithë kishin humbur çdo shpresë pér shpëtim; dhe prej andej, që t'i dilte përballë me fuqinë detare armikut tē thyer në tokë, mbasi u zgjodh komandant flote pothuaj me tē gjitha votat, e rimëkëmbi fatin e Venedikut, që ishte në rrezik tē perëndonte dhe me çfarë shpejtësie u lëshua dhe bëri kërdi mbi një mori tē madhe barbarësh që i kishin vënë rrëthimin Nau-paktit¹⁴⁹); u kalli tmerrin dhe i vuri përparrë; një fitore tē tillë ai korri kur çliroi ishullin e Lemnit...

MERITAT E SHKODRËS NDAJ VENEDIKUT

Mirëpo, mbasi e solli puna që unë tē jap përshtypjen e një oratori ose tē paaftë ose mosmirënjos, do tē preferoja ta kisha namin më tepër si gojëtar i pazoti sesa mosmirënjo-

hës dhe do të orvatem të mos mbetem pa ju parashtruar dot shenja nderimi e mirënjoheje që i kam për detyrë.

Unë detyrohem t'ju falënderoj, o krerë e senatorë, si nga ana e opinionit publik, ashtu edhe nga ana ime.

Dhe më së pari shkodranët, ose më mirë të themi shumica e shkodranëve, njëzëri flasin për bamirësitë tuaja kundrejt tyre dhe këtu shfaqin dëshirën t'ju falënderojnë ju, shpëtuesit e tyre, edhe ju të dëgjoni zërin e tyre, me të cilin ata dita-ditës e ngrejnë në qill mirësinë tuaj.

Por, mbasi një dëshirë e tillë nuk ka se si të kryhet, meqë bashkëqytetarët e mi janë të shpërndarë në të katër anët e shtetit tuaj, unë vetë e mora përsipër barrën që të mos flisja si një letrar privat, por si një orator i atdheut tim fatzi.

Përpara se t'ia filloj falënderimit më tepër me zemër sesa me zotësi, marr guximin të them se bamirësitë tuaja aq të mëdha e aq të shkëlqyera nuk kanë rrjetet nga fati ynë i mirë, por nga zemra e mirë që ka punuar me drejtësi; dhe me të vërtetë, sunduesi i mirë e ka për detyrë t'u bëhet krah të gjithë njerëzve, por një sundues i mirë e i urtë t'u vijë në ndihmë sidomos atyre që kanë shërbyer më së miri dhe që janë dërrmuar rëndë, sikurse jemi ne shkodranët e shkretë.

Dhe këtë nuk e them edhe aq nga dëshira për t'i thurur lavde atdheut tim apo për të nxjerrë në pah meritat e të parëve të mi, sesa nga detyra që kam për të nxjerrë në shesh kujdesin tuaj për ne.

Krerë e senatorë shpirtmirë, sikurse patët durimin të ma vinit veshin deri këtu, tashti, me qëllim që t'i njihni mirë bamirësitë tuaja, ju lutem me gjithë zemër të dëgjoni jo meritat tonë, por të zezat dhe mjerimet që kemi pësuar; ndër të mira, kujtimi i të zezave të kaluara nuk mund të jetë vecse i ëmbël, ashtu siç është për detarin kujtimi i stuhive dhe për ata që shërohen kujtimi i sëmundjeve.

Dhe ju, të mallëngjyer nga lotët dhe nga pshëritimat e mia, mos ma ndërpritni fjalën, sepse njeriu, duke përshkruar mjerimet e veta, e lehtëson disi dhimbjen e vet dhe përmes ofshamave dhe lotve i jep shfrim zemrës së vet.¹⁵⁰⁾

Tashti, cili është ai qytet që guxon, s'po them t'ua kalojë shkodranëve, por edhe të krahasohet me ta për sa i takon besnikërisë dhe dashurisë ndaj shtetit të Venedikut? Këta qenë të parët nga të gjithë popujt e mbarë Dalmacisë, të Maqedonisë, të Epirit, që, pa pësuar ndonjë humbje luftarake, pa u dërrmuar prej ndonjë rrëthimi, pa qenë thirrur në luftë vetë, pranuan zotërimin tuaj; me sa kam dëgjuar, ata pa-

tën dërguar te ju si përfaqësues pikërisht gjyshin tim, Pjetër Beçikemin.

Ky, kur iu dha fjala, nisi e tha: «Paçim ardhur me këmbë të mbarë për ju, o krerë e senatorë të Venedikut, dhe për krejt shtetin tuaj; daltë puna me dobi për ne dhe për popullin e Shkodrës për sa të jetë jeta. Unë dhe ky shoku im, Shtjefën Jonima, me vendimin e pleqve tanë, gjithçka kemi: veten tonë, qytetin tonë, fushat tona, kështjellat tona juve jua kemi falur dhe juve po juva dorëzojmë. Sepse e dimë mirëfilli se atdheu ynë do të jetojë më mirë nën zotërimin e Venedikut, sesa nën drejtimin e vet dhe me ligjet e vëta. Pranojeni, pra, këtë besë në emër të mbarë Shkodrës, e cila, po të kishte mundësi të shkulej me themel dhe të vinte deri këtu, do të ishte kënaqur edhe më tepër duke e kryer vetë këtë punë. Kjo besë, që sot po ju jep Shkodra, gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë e shenjtë, e qëndrueshme, e parakur, çfarëdo që të ndodhë, si në ditë të mirë, ashtu edhe në ditë të keqe.»¹⁵¹⁾.

Atëherë Balsha, mbret i të dy Myzive, i Trakisë dhe i Greqisë¹⁵²⁾, i cili, mbasi s'mundi të na shtinte nën zgjedhë, ishte bërë tym e flakë, sepse ne vullnetarisht juva kishim lëshuar juve në dorë veten tonë, lirinë tonë dhe të gjithë krahinën tonë ashtu siç ishte, nisi të sulej mbi ne me një ushtri jashtëzakonisht të fortë dhe mu atje rrëzë ledheve në përlleshjen e parë e pati zënë ungjin e tim gjyshi, Flor Beçikemin, të plagosur, që pikërisht për këtë arsy nuk mundi të shpëtonte dhe, mbasi e hodhi në pranga, e mbyti në torturat më barbare dhe ne për dy vjet rresht na mbértheu me një rrëthim të tmerrshëm; dhe ky rrëthim do të kishte vazhduar edhe më tepër, sikur të mos e kishte marrë mortja mbretin në kohën e duhur¹⁵³⁾ duke na shpëtar prej atij tèrbimi të poshtër pikërisht ne që po qëndronim në besën e dhënë.

Edhe Stefani, despot i Myzisë¹⁵⁴⁾, duke dashur të na shtipoqi me hekur e me zjarr, pastaj vendosi të na pushtonte qytetin me të gjitha mjetet luftarakë që kishte; mirépo, kur pa se çdo orvatje po i shkonte kët, mbas katër muajsh u kthye në mbretëri të vet dhe aty la kapidanin e vet, trimin e fortë e të papërtueshëm, Pjetër Mazrekun, i cili thua jse për tre vjet u përpoq të na detyronte të dorëzoheshim prej urie. Aq e madhe qe zia që e kishte kapërthyer qytetin, saqë shëndetligët, nga mungesa e çdo gjëje: vdiqën me shumicë. Atëherë morën një vendim të rrezikshëm, por të domosdoshëm: dërguan tek armiku shtatë fisnikë prej shtatë familjesh bu-

jare nga më të parat, gjoja sikur ishin të arratisur; këta, me dinakëri, vepruan në mënyrë që armiku u besoi se ata do t'ia dorëzonin qytetin me tradhti, po t'i lejonte t'u afroheshin mu në pellg të natës vrap e vrap portave të qytetit me një çetë të të vetve. U drejtuan atje dhe dhanë shenjën siç i kishin pasur fjalët; qytetarët hapën portat dhe u turrën jashtë, i zunë e i dënuan armiqtë, që s'e pritnin asfare dhe porsa ishin zgjuar; Mazrrekut ia plaçkitën shatorret dhe ai vetë mezi shpëtoi duke ikur majë një kali ku e gjeti më të shpejtin.

Pasardhësi i Stefanit, Gjergj Vuku¹⁵⁵⁾, me atë shpirt mizorie dhe me një përpjekje më të madhe se i ungji, sulmoi Shkodrën, e rrëthoi nga të katër anët me pahisore e hendeqe, por edhe ai, meqë u bë kërdi e madhe në ushtrinë e tij, pas shtatë muajsh rrëthimi, u largua.

S'kaloi shumë kohë dhe u lëshua kundër nesh Balsha i ri, që quhej Johan¹⁵⁶⁾; këtë, me anë të armëve tuaja dhe me ndihmën e proveditorëve, Françesk Kuirinit dhe Nikollë Loredanit, jo vetëm që e vunë përpëra, por edhe e dëbuan jashtë mbretërisë. Atëherë ai kaloi në Dauni¹⁵⁷⁾ dhe me ndihmën e disave, që e kishin halë në sy lavdinë e Venedikut, ndezi një luftë edhe më të rreptë; por ju këtë luftë me të shpejtë e shuat, duke hyrë në marrëveshje me të, në mbështetje të së cilës atij i lëshuat kështjellat e Tivarit dhe të Drishtit¹⁵⁸⁾.

Pas pak vjetësh duka Stefan, vjehrri i Balshës¹⁵⁹⁾, në krye të një ushtrie të pamasë c'merr nga Myzia e Sipërmë, plaçkiti mbarë krahinën dhe atje dogji edhe kështjellen e Danjës; por, nësa ai po shpejtonte ta nënshtronte qytetin tonë, Alois Loredani i doli para me ushtri në anije dhe e shpartallloi e atëherë shkodranët iu qepën prapa dhe ai farë kapidi mezi shpëtoi me një pakicë që kishin kuajt më të shpejtë dhe çdo gjë që kishte në krahinën e Shkodrës e humbi. Asoçohe gjyshit tim iu vra i vëllai në sulmin e Drishtit; nuk shkoi shumë kohë dhe atë vetë e gjeti ai fat.

Më vonë trimi vojvodë Altomani¹⁶⁰⁾, me një mori ushtrie, shtiu në dorë krejt atë krahinë me gjithë kështjellat dhe thua jse krejt rrëthet e Shkodrës dhe plot mburje për atë fitore synonte t'i futej edhe avtetit brenda. Mirëpo shkodranët, mbasi gjetën kohën dhe vendin e përshtatshëm, u hodhën në sulm mbi këtë armik, që, i kapardisur, po kalonte Bunën; ai në atë çast, i tmerruar prej sulmit të papritur, mori arratinë dhe, mbasi tanët iu vunë në shpinë duke e ndjekur këmba-këmbës, e zunë bashkë me të vëllanë pranë Shasit, kështjellë jona, dhe e dërguan në Venedik; edhe kjo

betejë mund të vlejë si dëshmi e trimërisë dhe e besës së atdheut tim, në qoftë se mund të quhet betejë e vërtetë, se, fundi i fundit, aty shkodranët armikun e thyen më tepër me guxim, sesa me armë, dhe e vunë përpara aq me shpejtësi, saqë më shumë mënd të zgjatej përshkrimi i atij luftimi, sesa u zgjat në realitet zhvillimi i tij.

Nuk po i përmend zotërinjtë e krahinës që vazhdimisht na dolën armiq të rrezikshëm.

Në mes të sa e sa rreziqeve e të zezave, vallë, a nuk do të dilte, o bujarë e senatorë të ndritur, Shkodra ime më e para nga gjitha qytetet e tjera që tregohen, janë treguar e do të tregohen jashtëzakonisht besnikë?

Nuk po përmend këtu se sa vuajti ai qytet, çfarë pa, se ç'grabitje e ç'plaçkitje shtëpish e çfarë dhunimesh ndër tempuj provoi për më tepër se njëqind vjet; sa shenjtore e faltore u dogjën, sa ndërtesa publike e private u shkumbuan në flakë, sa fshatrave dhe bashtinave iu vu zjarri; sa ushtri të tmerrshme kaluan atje duke plaçkitur jo një herë, por sa e sa herë. Nuk po përmend britmat barbare, jo britma, por ulërima, apo shungullimat e papritura të shtëpive kur shembeshin. S'po përmend se sa gjak u derdh, se ç'plagë të tmerrshme u hâpën, se sa rrëthime u bënë atje, por, me një besë të pashoqe, kur ledhet e qytetit ishin rrafshuar në të katër anët, përballë armëve dhe topave të armikut doli gjoksi i qytetarit, që s'donte t'ia dinte as rrezikut, as vdekjes. Kurre s'do të mbaroja, po t'i përshkruaja të gjitha. Por tashti të kalojmë në një pikë tjetër.

Shkodra thuajse pér tridhjetë vjet arriti të përballonte sulmet e rrepta dhe të rrezikshme të otomanit, Shkodra korrë gjithë ato fitore kundër një armiku jashtëzakonisht mizor në sa e sa luftime vdekjeprurëse; Shkodra, nën komandën e Pal Loredanit, kalifin bejlerbej të hordhive të Anadollit, i cili, me gjashfëdhjetë mijë ushtarë pas vetes, ishte mburrur se brenda katër ditëve do ta pushtonte qytetin, me turp e faqe të zezë të tij, e dëboi prej ledheve dhe e detyroj të braktiste shatorret e veta thuajse me të gjitha stremet që kishte dhe t'ua mbathte këmbëve që të shpëtonë ai vetë me gjithë ushtrinë⁽¹⁶¹⁾.

Nuk po e përmend veprimtarinë tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut, të cilin ju e patët shpallur si kryeprijësin tuaj në atë krahinë dhe e patët bërë bujar venedikas atëherë kur, mbasi u largua fshehtas prej Mezid beut, komandanit të ushtrisë turke, ku shërbente si ushtarak, përsëri shtiu në dorë

sundimin atëror. Vallë, nuk qemë ne që u ndeshëm me sultani Muratin, gjyshin e këtij sulltani që mbretëron sot?

E rrëzë ledheve të Krujës a s'qemë ne që, duke bërë kërdinë në shumicën e ushtrisë së tij, ia prumë shpirtin në fyt nga zemërimi? A nuk qemë ne që i bëmë shkrumb e hi krahnat e tij? S'qemë ne, vallë, që me Skënderbeun në krye dhe me ndihmën e tesalëve dhe të epirotëve arritëm deri në breg të Strumës?¹⁶²⁾

Nuk po përmend se ç'kemi bërë nën komandën e mëkëmbësit, Josafat Barbarosës, kur Lekë Dukagjini pati mbledhur disa mijëra turq kundër të vëllait, të cilët ne i shpartalluam me një luftim të rregullt, megjithëse si numër ishim më pak dhe aq mirë e ndoqëm, ç'merr nga bregu i Drinit nëpër lugjet dhe nëpër shpatet e Malit të Zi, saqë të gjithë sa qenë mbetën të vrarë, përvëç një pakice që në pikë të vravit ua mbathën këmbëve nëpër male e rrugë pa rrugë me gjithë Lekën^{163).}

RRETHIMI I PARË I SHKODRËS

Do të dalë ndokush të më thotë: Këto janë punë të vjetra. E di edhe unë dhe, sa më të vjetra që të janë, aq më të shenja janë; gjithë këto merita të tillë dhe kaq të mëdha me kohë fitojnë dinjitet, rëndësi e autoritet dhe, si të thuash, njëfarë nderimi fetar, pikërisht si pleqtë që shkojnë duke u moshuar përditë dhe ne përditë e më tepër i nderojmë, kurse moshatarët tanë, megjithëse dashuria ndaj tyre është më e ëmbël, prapëseprapë i respektojmë më pak; kështu edhe bëmirësitë e vjetra kanë më rëndësi sesa të rejat, ndonëse të tashmet duken më të ëmbla. Le pastaj që Senati i Venedikut, i cili është gjithmonë i njëjti, as nuk vdes, as nuk liget, as nuk plaket, as nuk pëson gjë, siç pësojnë mbretërit dhe sundimtarët e tjerë; meritat e qytetarëve, të shokëve, të miqve, të kujtdo tjetër nuk do të zhduken me kohë, as mund të zhduken, as mund të lihen në harresë. Po le t'i quajmë të vjetruara ato që përmendëm, le të janë vyshkur e tharë, le të janë bërë hi e pluhur; po ç'do të themi për këto ngjarjet e freskëta, që i kemi parë me këta sy në rininë tonë? Të flas apo të rri në heshtje?

Se me çfarë bese e qëndrese, mes dallgëve të fatit shko-

dranët e patën duruar atë luftë aq të gjatë, një nga më të rëndat e më të rrëzikshmet që u pati shkaktuar Mehmeti, ai tirani më mizor i turqve, këtë të gjithë e dinë më së miri; të gjithë e dinë se si Sulejman pashai, me njëqind mijë ushtarë të grumbulluar nga krahinat e Evropës dhe nga vetë hordhitë e tiranit, e pati rrëthuar Shkodrën¹⁶⁴⁾; se si i pati rrafshuar përdhe muret e qytetit dhe ndërtesat publike e private, se si, ku me kërcënime e ku me premtimë, i pati bindur qytetarët që të dorëzoheshin, se si qyteti im e pati pritur trimërisht gjithë atë mori ushtrive mu aty te muret e veta; mu aty sa e sa herë i dërrmoi, bëri kërdi të madhe dhe iu vu në shpinë jeniçerëve, të cilët lëshoheshin në rrëmujë, në për kufoma të shokëve të vet, deri rrëzë kodrës; se si shtiu në dorë flamujt ushtarakë dhe plaçkat e një triumfi të mrekullueshëm; se si zembrapsi dhe thuajse i dërrmci me plagë nja njëzet mijë veta të armikut bashkë me tridhjetë komandanë, ndër të cilët ishte edhe Ali beu, pasha i Serbisë.

Kjo fitore u arrit nën komandën e Anton Loredanit, të cilin me të drejtë mund ta quaj një Fabius¹⁶⁵⁾ venedikas; ky njëkohësisht kryente detyrën e ushtarit dhe të komandanit dhe me një vëzhgim të vëmendshëm vështronte çdo gjë; parashikonte, askund nuk linte gjë mangët, këshillonte, lutej dhe stërlutej e ngushëllonte.

Megjithatë Sulejmani nuk hoqi dorë prej rrëthimit dhe i katandisi të rrëthuarit në një gjendje aq të ngushtë dhe në një mungesë aq të madhe të sendeve më të nevojshme, saqë i detyroi jo vetëm të ushqeheshin me kafshë të ndyra që nuk shtiheshin në gojë, po ëdhe, të djegur etjeje, të pinin ekskrementet e veta; pastaj prindër, fëmijë, gra dhe gjithë ajo mori dashamirësh që s'ishin për luftë, as të aftë për qëndrësë, ose jepnin shpirt si mos më keq në mes të puthjeve dhe të përqafimeve të fundit, ose flakeshin ndër thonjtë e armikut, pamje kjo që të këpuste shpirtin; dhe të gjitha këto i shkaktoi Sulejmani; pastaj edhe ajo pakicë ujë krejt i turbullt, që nuk u ndahej të gjithëve, por vetëm luftëtarëve, dhe çdo gjë që mirë a keq viente si ushqim, tashmë kishte filluar të mungonte dhe ata luftëtarët më të fortë, që sa herë e kishin zembrapsur, armikun nga ledhet, shiheshin të fikur e të tharë fizikisht deri në gradën e fundit jo aq prej mundimit të vazhdueshëm dhe prej pagjumësisë, sesa prej urie e prej etjeje. Pleqtë, që fati i zi i kishte mbajtur gjallë për të parë atë ditë të zezë, të vendosur për t'i dhënë fund jetës (sepse e shihnin se kjo ishte për dobi të të rrëthuarve) ia rekomandonin rinisë trimëreshë atdheun, që ata vetë s'po e

mbronin dot. Gratë, duke vajtuar e duke u endur poshtë e përpjetë, pa ditur se çfarë vdekjeje të zgjidhnin për vete e për fëmijët, pyesnin herë njërin, herë tjetrin, këdo që takonin, pastaj u drejtoheshin njerëzve të vet dhe, duke i shtrënguar me shpirt për të fundit herë, me lot e me klithma u luteshin, me be e rrufe, që më mirë t'ua ngulnin thikën në zemër.

Kur, pastaj, të rrethuarit, të shtangur, panë jo së largu, por mu aty ndër sy pleqtë e shkretë të têrhequr zvarrë te këmbët e turqve (a ka më mjerim për ngadhënjimtarët e dikurshëm?) duke mbaruar nën poshtërimin e skillavërisë dhe jo nën shpatën e armikut, ashtu edhe gratë e grabitura, që i shtrëngonin fëmijët sa më fort që mundnin dhe ashtu lidhur ndër pranga dhe të vëna përpara drejtonin sytë herë nga qielli e herë nga qyteti, atëherë të rrethuarit, po them, lëshuan një vikamë deri në kupë të qiellit dhe thuajse e humbën të gjithë atë qëndresë prej burrash të vërtetë. Dhe nuk është për t'u quditur: dëgjohej vajtimi i robëreshave, dhimbja për njëri-tjetrin përtërinte lotin e vajtimit tek shiheshin për herën e fundit. Fatkeqësi me të vërtetë e madhe, një skenë që të këpuste shpirtin, që ishte më e hidhur se vetë shkatërrimi.

Ka pasur, vallë, qytet të pushtuar më fatzi që të ketë parë shenja të një dëshpërimi kaq të madh?

Po ku po vete unë? Do të duhej përroi i rrëmbyeshëm i Demostenit dhe deti i pamasë i Ciceronit për t'i qarë paksa me lot mjerimet tona. Se, po të donim të thurnim historinë e atyre të zezave, për përshkrimin e tyre të denjë nuk do të gjenin fjalë as Herodoti, as Tuqididi, nuk do të gjente fjalë as Salusti aq i përmendur për vërtetësi historike, as Livi që shkëlqen me një gojtari aq të rrjedhshme e të kulluar. Por të kthehemti atje nga u nisëm.

Në cilin qytet (si në Shkodër), në një gjendje kaq tragjike, ka arritur puna deri në një vendim të tillë, saqë natën, ashtu papritmas, thuajse në një të rrahuar qerpiku, ndodheshin të gatshëm disa veta qëllimisht për t'i dhënë zjarrin qytetit e njëkohësisht të gjithë qytetarët e tjerë të dilnin befas dhe të derdheshin mbi shatorret e armikut, duke iu lutur të madhit zot, pa u'ngutur, verbtas e marrëzisht, sikurse ndodh ndonjëherë që s'je as në gjendje të rrëmbesh armët, jo më të hysh e të përleshesh? E kjo s'bëhej, jo, me qëllim arratie, mbasi askund nuk kishte mbetur ndonjë shpresë për shpëtim, as një shteg i sigurt për t'u arratisur, por ashtu siç ishte caktuar e vendosur, siç kishte marrë formë të prerë,

të gjithë sa ishin, të vdisnin, por jo pa u hakmarrë e pa bërë kërdinë mbi armikun.

Në një dëshpërim të tillë Loredan Shkodrani qëndroi si burrat e, duke dalë para të rrethuarve, me be e rrufe, në emër të besës së tyre të jashtëzakonshme, në emër të përendisë dhe të këtij shteti, duke pasur paraqysh trimërinë me të cilën do të mbrohin atdheun, veten e vet, fëmijët e gratë, objektet e shenjta dhe laike, Venedikun dhe vetë Krishtin, iu lut që ta shtynin edhe për një ditë shpërthimin dhe sulmin mbi armikun. Ujë kishte mbetur edhe për një ditë. Solli si dëshmitarë gjykatësit e qytetit dhe kërët e kuvendit. Ai goxha burrë, përvèç lutjeve, nxori edhe lot; dhe arri i t'u thoshte që t'ia ngulnin thikën në zemër (e ndërkaq zbuloi edhe kraharorin), t'ia merrnin gjithë gjakun deri në pikën e fundit dhe ta ndanin ndërmjet tyre për ta pirë; dhe nuk u ndahej në asnje mënyrë veçse gjithnjë ngulte këmbë dhe gjithnjë u thoshte që t'ia pinin gjakun.

Duket e pabesueshme, por menjëherë, porsa qytetarët i dëgjuan ato fjalë të mallëngjyera dhe shikuani fytyrën e dhimbshme të atij farë kapidani, ndërruan mendimin.

Edhe unë kujtoj se jo vetëm fatkeqësia dhe vajtimi i mbarë qytetit, por edhe fjalët dhe dhimbja e atij burri ia prekën zemrën zotit dhe prej mëshirës së tij mbas ca orësh një lajmëtar i tiranit të pashpirt i dorëzoi një letër Sulejmanit, me anën e së cilës këtij i jepej urdhri që pa fare vonese të linte çdo gjë, të hiqte rrëthimin dhe të kthehej në Maqedoni.

O madhëri e veprës hyjnore! O mrekulli qelllore! Pa u larguar mirë armiku, qytetarët, të djegur për ujë, u lëshuan vrapi drejt lumit të Bunës për fë pirë asi uji, që e kishin dëshiruar për ditë e ditë, dhe shumë veta nga populli e përpinë me aq ashk saqë, duke mos pasur mundësi ta duronin, sepse nuk ishin mësuar, ranë përdhe krejt të fikur.

Lajmin e largimit të armikut e pruri në Venedik si përfaqësues i vendit tonë ungji im, Shtjefën Beçikemi, që i solli një gëzim të jashtëzakonshëm kësaj së shkëlqyerës republikë, e cila gjithë kujdes u ngrit në këmbë për sigurimin e shtetit të vet (sikurse ishte e dërejtë në një luftë kaq të rrezikshme).

Im ungj u priti me nderime. Me vendim të Senatit qytetit të Shkodrës iu kushtua një flamur i artë për kujtim të paharrueshëm, d.m.th. iu ngrit një trofe në tempullin e

shën Markut. Antonit iu dorëzua një fletë lavdërimi, gjithashtu morën lëvdata edhe shkodranët e tij për besën, për qëndresën dhe për trimërinë e pashoqe që treguan në mbrojtjen e qytetit. Të dy palëve iu dërguan edhe dhurata.

RRETHIMI I DYTË I SHKODRËS

Shkodranët, për t'i shkuar në ndihmë kështjellës së Krujës, që rënkonte urie, rrëmbyen armët dhe bashkë me dy mijë këmbësorë e kalorës, që i dërguat ju, dolën kundër Amar beut dhe në fushën e Tiranës u ndeshën me njëzet mijë barbarë, i vunë përpëra dhe u ranë pre shatorreve të tyre¹⁶⁶). Kjo do të kishte qenë një fitore e shkëlqyeshme dhe e paharrueshme, sikur këmbësoria mercenare, tepër e dëshiruar për plac-kitje, të mos ishte ndarë veç nga ushtria, kështu që barbari, duke çarë ushtrinë dysh, mësyu pjesën tjetër, e shpartalloi dhe, duke bërë kërdinë mbi tanët, iu vu në shpinë deri te lumi Jalmiasa.

Së fundi sulltan Mehmeti, njeri idhnak dhe plot mburrje për ngadhënjime e plaçkë që u kishte marrë sa e sa mbretërve, vendosi t'ia merrte hakun prindit të vet të vdekur¹⁶⁷) dhe disfatës së fundit që kishte pësuar (në Shkodër); nisi të grumbullonte brenda katër vjetve të gjitha forcat e veta, spacialistë, teknikë dhe mjete luftarakë. Breznive të ardhshme do t'u duket e pabesueshme, por, siç e dini, është një fakt: ai për pushtimin e Shkodrës mobilizoi mbi treqind mijë veta. Përpëra nisi Ali beun, pashanë e Danubit, dhe Skënder beun, vëllanë e tij, pashanë e Myzisë së Sipërme, dhe Malkocin, pashanë e Myzisë së Poshtme; ky, me njëzet e pesë mijë luftëtarë, zuri vend nga lindja; pas tij erdhë edhe pashai i Anadollit me aq sasi ushtrie dhe nguli shatorret nga jugu. Në fund arriti vetë sultani me një mori aq të madhe njerëzish, saqë, ç'merr krejt krahina gjatë e gjerë vërreth qytetit, u mbulua me shatorre e çadra në një hapësirë pesë (?) miljesh.

Me gjithfare përdredhoresh (ndër të cilat kishte nga ato që hidhnin gurin një mijë e dyqind librash¹⁶⁸) dhe nga ato që lëshonin gjyle zjarri të pashueshëm pikërisht për t'i vënë flakën qytetit; kishte nga ato që u thonë mortaja e që hidhnin deri në quell gjyle të potershme dhe kaq me vrull përplaseshin, saqë nuk ishin të sigurt as ata që futeshin ndër llogore, mure

e forcoma, faltore e shtëpi e deri vetë ledhet i shëmbi kulm e themel; dhe aty në sy të tij, si luftëtarët e tij, ashtu edhe tanët u treguan trima të tmerrshëm, sa nuk besohet. Dhe mua më duket se nuk meriton të lihet në heshtje fakti se, mbasi e lodhi qytetin me sa e sa luftime të vogla, së fundi me të gjithë ushtrinë dhe me sa fuqi që pati, tri herë e mësyu. Ndër këto përleshje ai me topa bënte kërdi në njëritët e vet dhe në tanët që në atë rrëmujë vraponin andej nga binin zjarret; deri në tri mijë gjyle guri mblodhën pastaj ata që shpëtuan dhe vetëm prej njërsë humbën jetën nga njëzet qytetarë; gjithashtu armiqtë gjuanin me një sasi aq të madhe armësh gjithfarësh e sidomos shigjetash që binin si breshri, saqë arrinin të pritnin edhe diellin siç e pret reja, e tokë e çati mbuloheshin krejt prej tyre.

Flamujt e armikut një mijë herë u ngritën majë ledhevë; u zhvilluan përleshje fytyrët edhe në zemër të qytetit; asnjë qytetar, i çfarëdo orte, nuk mbeti pa marrë një plagë. Orvatej babai t'u jepte zemër djemve, vëllai vëllait, qytetari qytetarit dhe, duke kaluar nëpër kufomat e të vetve, turreshin mbi armikun.

Edhe vajzat e gratë s'ua lëshonin vendin burrave për trimëri; shihje djalin që po mbaronte aty në prani të nënës, burrin në sy të gruas, vëllanë të shtrirë përdhe bri motrës e prapëseprapë nuk i drejtonin sytë aty, por gjithnjë u përgatitnin luftëtarëve më të fortë armët për kundër armikut, kryenin çdo punë që u ngarkonin, zëvendësonin në shumë punë luftëtarët, që pushonin për pak kohë ose që do të lidhnin plagët. As topi, as arma, as plaga, as vdekja s'trembe njeri; të gjithë ishin të vendosur për një qëllim: të shpëtonin qytetin duke derdhur gjakun deri në pikën e fundit. Në të katër anët mbretëronte e zeza kërdi, kudo shihej mortja me sy; shihje qytetarë të bérë copë-copë prej topash, trupa të tërë që hidheshin në erë; mure, rrugica, rrugë, sheshe, ndërtesa të përrlyera me gjak, me copa mishë e me zorrë të copëtuara; nga çdo anë rridhite gjaku si përrua.

Në fund, kur, pas marrëveshjes që u përfundua, fatziu atdhe ra në dorë të armikut, shkodranët e braktisën atë tokë të bekuar, ku ishin lindur e rritur, shkodranët lanë atje faltore e varreza, vatrat e shtëpi, tokë aq pjellore e të këndshme, lanë atje thuajse të gjithë pasurinë.

Ja një vepër e mrekullueshme, që duhet të përmendet sa të jetëjeta: nga të gjithë ata qytetarë të tri shtresave, nga bujarët, nga pronarët, të cilët, sikurse dikur kalorësit romakë, fërmonin ortën e mesme, dhe nga vegjëlia,asnjeri

nuk u gjet, megjithëse të ftuar publikisht dhe privatish, dhe, ndonëse shumë veta u tërroqën me premtim e dhurata prej barbarit, asnjë, po them, nuk u gjet që të mos pranonte më parë ta çonte jetën në mërgim e në zi, i mjeruar, i shkretuar, i varfëruar, por nën sundimin e Venedikut, sesa të qëndronte në mes të pasurive dhe të të mirave të atdheut të dashur ose ta thyente në një mënyrë ose në një tjetër besën e dikurshme të dheut të Shkodrës.

Kur armiqtë, megjithëse armiq e armiq të vërtetë të pashpirt, panë grumbullin e qytetarëve, që në heshtje të zyntë po merrnin rrugën e mërgimit, ashtu edhe gjendjen e mjerueshme të zonjave shkodrane, të cilat, përmes radhvëve barbare, tërhiqnin si shokë mërgimi fëmijët e vet që vajtonin, s'patën se si të mos mahniteshin dhe të mos çuditeshin përatë besë e qëndresë dhe të mos i mbanin lotët.

Në ato rrethime të fundit ndodhej im atë edhe ungji, një tridhjetë kushërinj nga ana e babait dhe e nënës dhe të gjithë vëllezërit e mi; prej tyre vetëm shtatë shpëtuan; të tjerët bashkë me babanë tim të dashur mbetën të vdekur; disa u therën, disa, sikurse burri i sime motre, Nikollë Maloni, u copëtuan prej topave; disa, gjatë përleshjes, u varrosën për së gjalli bashkë me armiq nën gërmadhat e fortifikimeve të shembura/ dhe aty mbetën të shtypur.

O Leonard, princ zemërbardhë, dhe ju, senatorë të dashur, sikurse i parashtrova sa më shkurt që munda meritat dhe lavditë e vendit tim, dhe këtë ma këshilloi vetëm modestia, ashtu dhimbja nuk më la të shfreja duke kujtuar fatin e zi të tij; por, sidqoftë, thashë diçka kështu që të kujtonit se çfarë bamirësish u bëtë shkodranëve që me të vërtetë i meritonin.

Tashti mbetet të flas pikërisht për nderet tuaja dhe t'ju falënderoj, edhe në qoftë se jo ashtu siç duhet, të paktën aq sa kemi mundësi.

MERITAT E SHTËPISË BEÇIKEMI

Vetëm kjo do të kërkonte një ligjëratë të gjatë, sikur modestia juaj të më lejonte të ndalesha për të folur për veprat e bujarisë dhe të mirësisë suaj; por unë do të kufizo-

hem vetém në një përbledhje të shkurtër, do ta prek çesh-tjen, si të thuash, fluturimthi, por në një mënyrë që jo vetém unë, as bashkëqytetarët e mi, të shpëtar prej jush bashkë me mua, por mbarë botë, të gjitha breznitë e ardh-shme ta marrin vesh ashtu siç duhet.

Këtu më së pari nuk duhet t'i lihet mangët tim eti lav-dërimi që meriton. Ai, sikurse del nga dokumentet zyrtare, gati pér dyzet vjet si sekretar eshtë marrë pa ndërprerje e besnikërisht me çështjet tuaja aq të rëndësishme pranë sull-tanëve të Turqisë, duke përballuar në tokë e në det sa e sa vështirësi e rreziqe nëpër popullsi barbare dhe të armato-sura. Çdo mision që i ngarkohej si detyrë, pa iu trembur syri aspak ua parashtronte sundimtarëve më të pashpirt, të cilët i kanoseshin edhe me rrezikun e vdekjes; ua plaste ndër sy pabesinë e tyre, ndonjëherë edhe në sy të ushtrisë që vinte e dëgjonte me armë në dorë. Shpeshherë ra në dorë të ar-mikut, por aq mirë diti t'i mbronte të drejtat e veta si përfaqësues, saqë jo vetëm u respektua, por u përcoll edhe me dhurata. Në fund, që të vdiste ashtu siç kishte jetuar, ia kushtoi madhërisë së Republikës së Venedikut edhe vdekjen, ashtu si jetën: mbeti i shpuar prej një shigjete.

Në një çështje të tillë edhe mua, o senatorë të shquar, të më jepet leja të mburrem që sekretet e asaj lufte aq të madhe e aq të rrezikshme, të cilën me një ushtri të mbledhur shpejt e shpejt dhe ashtu në rrëmujë, e përfunduat vetëm me një betejë, përpëra se t'i dëgjohej zëri, ashtu edhe sekretet e luftës që prej kohe jeni duke zhvilluar kundër turqve, në një kohë në të cilën unë as në tokë as në det nuk mun-gova të përballoja rrezikun e vdekjes pér lavd e pér nder tuajin, ato sekrete, po them, që janë shkruar me dorën time dhe janë radhitur ndër akte zyrtare të vitit të kaluar, ruhen me një rregull të tillë që, derisa ato të qëndrojnë aty, nuk do të mbetet pa dalë në shesh besnikëria ime kundrejt jush.

Të flas më gjatë pér meritat e tim eti dhe të miat, nuk më lejon turpi dhe modestia, veçse unë do të përmend vetëm si ai gjithmonë ka pasur dëshirë dhe gjithmonë me lutje e me kushte i ka kërkuar perëndisë një vdekje, qoftë edhe të tmerrshme, në shërbim të Republikës së Venedikut dhe pikë-risht si i ati ashtu edhe i ungji, me një fjalë të gjithë Beçikemët s'u kursyen të jepnin jetën pér këtë Republikë; një vdekje kësi soji ai e quante të lavdishme dhe ua dëshironë djemve dhe nipave. Perëndia i pranoi lutjet besnike të shërbë-torit të vet dhe besoj se ai bashkë me të gjithë qytetarët

është hovur fluturim drejt banesës gjëzimplotë të besnikëve, ku mbrojtësit e atdheut dhe dalzotësit e shenjtë të fesë gjëzojnë shpërblimin e plagëve e të mundimeve, shpërblimin e gjakut të derdhur.

PRITJA E SHKODRANËVE NË VENEDIK

Ne shkodranët, siç mbetëm të mërguar, erdhëm në Venedik; shtatëqind burra, një mijë e treqind fëmijë dhe aq gra. Kaq, pra, kishim mbetur gjallë prej gjithë asaj popullsive.

Dëgjoni të gjithë ju, o të krishterë e barbarë, bamirësitë e vërteta të Republikës së Venedikut, jo të blera me dredhi, jo të kërkuara me lutje, por të dala nga një bujari, që Republika e ka në gjak, dhe nga ajo mirësi, që asaj i vjen prej vullnetit të mirë.

Neve na ishte mbyllur goja dhe na ishin zënë sytë prej turpit pérpara gjithë kësaj madhërie të jashtëzakonshme; si të hutuar qëndronim përmbyt te këmbët e fronit të dogjës. Pamë dogja e senatorë të prerë në fytyrë dhe me lot në faqe, lot që për ne qenë shpëtim dhe për ata qenë një nder, ndërsa qenë shenjë dhimbsurie e jo vuajtjeje. Aty për aty na ngrenë në këmbë, na ngushëllojnë me dashuri e mëshirë, na përqafojnë me gjithë zemër; deshëm t'i shihnim dhe émbël të na i pajtonin plagët, dhe si mjekë të mirë kërkonin dhe zbulonin ç'fshihej thellë brenda atyre plagëve. Na bënin gjithfarë mjekimesh simbas rastit dhe na pyesnin nëse dëshironim të tjera. O mjekim hyjnor i një republike hyjnore! Cili prej nesh është ai që nuk po them s'e mban mend, por që nuk e ka, si të thuash, të gjallë para sysh faktin që, mbasi harruam çdo pikëllim, po derdhnim lot gjëzimi aty pérpara? Dhe ai vajtim ia kalonte çdo vajtimi tjetër të mëparshëm, sepse mbas gjithë asaj zie e zymtie të gjatë, neve na u freskua shpirti në atë hare të papritur, kur më pak shpresonim, dhe përtej fuqive tona.

Edhe vetëm kaq mund të mjaftonte për ngushëllim dhe për nevojat tona; por venedikasit janë aq të prirur dhe të gatshëm për bamirësi, aq e mëshirshme është zemra e tyre, saqë nuk deshën të na bënin të pritnim më siatë të gjitha mjekimet që lypeshin për mjekimin tonë; as deshën të na linin në dyshim se me ç'ndihma do të na bëheshin krah, por,

çka urtësia e tyre kishte menduar menjëherë, u shpall me një vendim të mrekullueshmët të Senatit: shkodranëve u dhanë jo vetëm nënshtetësinë, por edhe privilegje më tepër se qytetarëve të tjerrë. U caktuan zyra të shumta financiare, komanda kështjellash e vendesh të tjera, nëpunësi fitimprurëse, rroga jetike, grada ushtarake me rrögë të mirë sipas gjendjes së secilit, kështu që askush prej gjithë asaj popullsie dhe prej fisit të shkodranëve nuk mbeti pa u rimëkëmbur me bamirësitë e Republikës; nga arka e shtetit u shtuan ushqimin vejuhave, vajzave dhe fëmijëve deri në moshën e pjetur e pastaj edhe këtyre t'u jepej një vend i përshtatur si burrave, dhe atyre që do të martoheshin, do t'u jepej një pagë nga arka e shtetit në përpjesëtim të pasurive të tyre të dikurshme...

S H È N I M E T

- 1) Në Republikën e Venedikut pushteti ishte në duart e aristokracisë së pasur. Përfaqësuesit e kësaj aristokracie zinin vend në këshillat që drejtonin punët shtetërore, midis të cilave më i rëndësishmi ishte Këshilli i të Luturve («i pregadi»), i quajtur edhe Senat. Në krye të shtetit qëndronte, i zgjedhur përjetë, dogja ose duka.
- 2) *Leonard Loredani* — dogjë i Venedikut prej 1501-1521
- 3) *stoikët* — anëtarë të një shkolle filozofike greko-romake
- 4) *poet andin* — poeti romak i shek. I para e.r. Virgjili, i lindur në fshatin Andes të Italisë së Veriut; Virgjili është autor ndër të tjera i «Eneidës», vepër epike, në të cilën këndon ngjarjet e lidhura me udhëtimin e Eneas nga Azia e Vogël në Itali, pas prishjes së Trojës.
Udhëheqësi dardan — Enea, i biri i Priamit, mbretit të Trojës; dardan — trojan.
- 5) *Horaci* — poeti lirik romak i kohës së Augustit
- 6) *Helikoni* — Mal në Beoti, krahinë e Greqisë së vjetër, i cili u ishte kushtuar hyjni të Apolon dhe muzave, ashtu si edhe mali Parnas.
- 7) *Sagunti, Kasilini* — I pari qytet në Spanjë, i dyti qytet në Italinë e Mesme, u bënë të famshëm për qëndresën heroike kundër Hanibalit, kur i rrethoi (Saguntin më 221, Kasilinin më 217).
- 8) Sipas zakonit të humanistëve, që përdorin në vend të emrave modernë të vendeve dhe popujve emrat e dhënë nga autorët antikë, Barleti nuk përdor emrin Arbër, siç quhej Shqipëria në kohën e tij, por emrin historik Epir, që e gjén tek autorët e vjetër.
- 9) *Herakliu* — hero i mitologjisë greke, i pajisur me fuqi të jashtë-zakonshme.
- 10) *Teukër* — Emër i lashtë i trojanëve. Për arsyen e ngashmërisë së emrave, turqve iu atribua origjinë trojane prej disa autorëve të shekullit XV.
- 11) *skithët* — Popullsi e lashtë që banonte në bregun verior e veriperëndimor të Detit të Zi.
- 12) *festë saturnale* — festë kushtuar Saturnit, një hyjnie të pjellorisë.

- 13) *Oktavian Augusti* — Perandori i parë romak, vdiq më 14 të e.r.
 14) *Tanai* — lumi Don në Ukrainë
 15) *Pomponi* — Pomponius Mela, gjeograf romak i shek. I të e.r.
 16) *Gelonët* — fis fqinjë me skithët në bregun veriperëndimor të Detit të Zi.
 17) *jo turci... por turcae.* Pomponi përmend një fis me emrin *turcae* (shqipto: *turce*); për këtë arsy, thotë Barleti, disa janë të mendimit se emri i turqve nuk duhet shkruar me mbaresën latine –i, por –ae (e).
 18) *Pipini* — sundues i frankëve në shek. VIII;
 Halanët ose Alanët — popullsi e lashtë në bregun verior të Detit të Zi dhe në Kaukaz, të parët e ossetinëve të sotshëm;
 Kolhët — banorët e bregut lindor të Detit të Zi;
 Saracenët — Në kohën e mesme quhen e kështu gjithë arabët. Barleti e ka fjalën këtu për kalimin e një grupi fisesh turke me emrin ogusë nga Azia e Mesme në Azinë e Vogël. Ky shtegtim në të vërtetë ka ndodhur pak më vonë nga, q'mendon Barleti d.m.th. në shek. X-XI.
 19) *avarët* — Popullsi e lashtë, banuese në bregun verior të Detit të Zi. Prej andej që nga shek. VI u përhap edhe në Evropën Juglindore dhe të Mesme.
 20) *Ponti dhe Kapadocia* — krahina të Azisë së Vogël Veriore dhe Qendro-lindore.
 21) *Galatia, Bitinia, Lykaonia, Pisidia, Pamfilia, Karia* — krahina të Azisë së Vogël Qendrore dhe Jugperëndimore.
 22) *Otoman Saladin* — Barleti, ka të ngjarë, ka përzier këtu emrin e sundimtarit turk Osman (Otoman) me emrin e sundimtarit arab të Egjiptit e Sirisë Saladin, i cili u bë i njojur në Evropë për shkak të luftërave të tij me kryqtarët në shek. XII. Osmani, i biri i Ertogrolit, sundoi mbi turqit prej 1281-1324; prej tij, më vonë, një grup fisesh turke morën emrin turq osmanë, për t'i dalluar nga fise të tjera turke.
 23) *Amyrat* — Fjalë arabe që do të thotë princ, sundues.
 24) *Orhani* — sundues i turqve osmanë prej 1324-1359.
 25) *Murati I*, sultani i turqve osmanë prej 1359-1389
 26) *Theodor Kantakuzeni* — Ngjarjet që tregohen këtu, në të vërtetë kanë të bëjnë me Johan Kantakuzenin, i cili shpalli veten perandor dhe luftoi kundër Johan Paleologut. Johan Kantakuzeni është i njojur edhe si historian.
 27) *Helesponti* — ngushtica midis Evropës dhe Azisë së Vogël, Dardanelet
 28) *Galipoli*, qyteti i parë që pushtuan turqit në Evropë në vitin 1354 në bregun e detit Marmara.
 Kersonëzi — gadishulli i Galipolit
 Greqia — këtu ka kuptimin e Perandorisë Bizantine dhe jo të Greqisë së sotme
 29) *Millosh Kobiliku* — Fisniku serb që vrau sultan Muratin I gjatë luftës së Kosovës më 1389.
 30) *Bajaziti* — sultan Bajaziti I, 1389-1403.
 31) *Myzët* — Emër i popullsisë së lashtë që banonte në Myzinë, truallin e Serbisë së sotme. Emrin e vjetër Barleti e përdor për serbët.
 32) *Focidë, Beoti, Atikë* — krahina të Greqisë

- 33) *ilirë e tribalë* – Tribalët banonin në kohët antike në një territor që shtrihej pjesërisht në Bullgari, prandaj këtë emër Barleti e përdor për bullgarët. Ilirët ka të ngjarë që të jenë, si dhe për humanistët e tjerë, sllavët e Dalmacisë.
- 34) *Tomir Mesageta, Tamberlani* – pushtuesi dhe udhëheqësi i njojur turko-mongol Timurlengu (vdiq më 1405) Timuri ose Tomiri (hekuri) quhet nga Barleti Masageta, sepse mendohej që ai ishte nga fiset masagete që patën banuar në kohën antike në Azinë Qendrore.
- 35) Në të vërtetë beteja u zhvillua afër Ankarasë në vitin 1402.
- 36) *Kalapini, Çelebiu* – Princ, titull nderi që u jepej të bijve të sultananit, më vonë gjithë fisnikëve. Këtu është fjala për njërin nga të bijtë e Bajazitit I, ndofta për Sulejmanin.
- 37) *Sigismundi, mbret i Panonisë* – Sigismundi nga shtëpia e Luksemburgasve, që prej vitit 1387 mbret i Hungarisë, që prej vitit 1411 perandor gjerman, vdiq më 1437. Beteja që përmendet këtu u zhvillua në të vërtetë midis Sigismundit dhe Bajazitit, më 1396 në Nikopol.
- 38) *Streme* – Bagazhi që kishte me vete ushtari e që përbëhej nga armë, ushqime, veshje, të transportuara me qerre etj.
- 39) *Moisiu* – Musai, njëri nga djemtë e Bajazitit; luftoi më 1410-1412 me të vëlezërit, Sulejmanin e Mehmetin, për pushtetin.
- 40) *Murati II* sundoi në vitet 1421-1451.
- 41) Selaniku ra në duart turke në vitin 1430.
Elida – krahinë e Greqisë
fusha e Ilirisë – Nën këtë emërtim të përgjithshëm është përfshirë edhe Shqipëria, e cila, në vitin 1430, u shkretua nga turqit.
- 42) *Vladislavi* – Mbret i Polonisë dhe Hungarisë, u vra më 1444 në betejën e Varnës, duke luftuar kundër turqe. *Panonët* – banorët e lashtë të Panonisë, e cila shtrihej pjesërisht në territorin e Hungarisë së sotme. Këtu panonë quhen hungarezët.
- 43) *Kruja në Epir* – Shihet qartë se për Barletin Epiri është Shqipëria. Rrethimi i Parë i Krujës, i bërë nga ushtritë e Muratit, ndodhi më 1450.
- 44) *Mehmeti II* – Sundoi prej 1451-1481.
- 45) Konstandinopoja ra në duart e Mehmetit II më 29 maj 1453.
- 45a) *Bajaziti II* – Sundoi prej 1481-1512.
- 46) Siç shihet, Barleti për Shqipërinë përdor dy emra të marrë nga autorët antikë; në mënyrë të rëndomtë emrin Epir dhe, më rrallë, emrin Maqedoni, ndonëse ekziston, siç tregon ai vetë, dhe emri vendës Arbëri. Arbëria quhet kështu, sipas Barletit, sepse gjithë banorët flasin arbërisht, do të prisnim ne, epirotisht, thotë Barleti, duke na dhënë kështu të kuptojmë edhe një herë se kuptimi i fjalës epirotisht është krejtësisht identik me atë të arbërishtes ose shqipes.
- 47) *Ematia* – disa autorë antikë, duke filluar nga Homeri, emrin Ematia e japid si emrin më të vjetër të Maqedonisë.
- 48) Për arsy se territori i Shqipërisë së sotme, në kohë romake, ishte përfshirë në provincën e Maqedonisë dhe ndofta edhe pse emri Ematia ngjante me emrin e krahinës shqiptare Mati. Barleti Maqedoninë e vë barazi me Arbërinë – Shqipërinë. Por, nga kufijtë që jep, tregon se ka ndërmend Maqedoninë në kuptimin historik, që shtrihej deri në Detin Egje.
- Peonia dhe Pelagonia – e para, krahinë e banuar nga fisi ilir i peonëve, në brigjet e Vardarit të Sipërm: e dyta, krahinë e Manastirit të sotëm.

- 49) *qytezat e qytetarëve romakë* — Barleti na jep të dhëna që i përkasin kohës së lashtë, sikur të ishin të kohës së tij. Qytetet Rizini (Rizan në grykën e Kotorrit në Dalmaci), Askrivi (Kotorri) etj. që përmend ai, gjëzonin privilegjet e qytetarëve romakë.
- Kolqini* — Për arsyet e njësiasë së emrave, disa autorë antikë ishin të mendimit se Ulqini duhej të ishte themeluar nga banorët e Kolhit, të bregdetit lindor të Detit të Zi, dhe prandaj duhej quajtur Kolqin.
- 50) *Akrilisi* — Në kohën e lashtë një kështjellë e ndërtuar mbi qytetin Lezhë, prandaj edhe emri, që do të thotë Lezha e lartë. Gërmadhat e saj duken edhe sot në malin e Shelbuemit mbi Lezhë. Barleti bën sikur Akrilisi ekzistonte në kohën e tij, aq e gjallë ishte e kaluara antiqe për humanistin e shek. XV-XVI.
- 51) *Korcyrasit* — banorët e lashtë të ishullit Korcyra ose Kerkyra të Korfuzit të sotëm.
- ogurzi* — Ishte për romakët emri Epidamnus, se fjala damnum, që në të vërtetë s'ka të bëjë me emrin, do të thotë dëm, fatkeqësi.
- 52) *Apollonia* — qytet antik, sot Pojani afér Fierit.
- 53) *Posidoni* — shkrimitar grek i shek. I të e.r. — lajmet që përsërit Barleti sipas autorëve antikë rrith burimit të zjarritë të Nymfë afér Apollonisë vërtetohen sot nga shpërthimi i naftës në Marinëz.
- 54) *Kaonët* — fis ilir që banonte në bregdetin Jon, në jug të maleve të Llogarasë. Edhe këtu Barleti përzien kohën antiqe me kohën e tij.
- 55) *mile, stade* — masë gjatësie; një mile kishte afro 1480 metra, një stad rrith 177 metra.
- 56) Emrat e vendeve që rreshton Barleti këtu, për të treguar pushtimet e maqedonasve, janë të gjitha pothuajse në Azi, me përjashtim të Ilirisë. Emri Albania — që përmend këtu Barleti, mund të jetë Arbëria — Shqipëria si pjesë e Ilirisë, por mund të jetë edhe Albania e Kaukazit, një krahinë që bie në territorin e Azerbajxhanit të sotëm.
- baktrianët, medët* — popullsi të lashta të Persisë.
- 57) *ati Liber* — Hyj romak i pjellorisë, për të cilin, ashtu si edhe për Herakliun, mitologjia tregonte se kishin bërë rrugë të largëta e i kishin rënë poshtë e përpjete botës së njojur deri atëherë.
- 58) Nuk mund të thuhet se për çfarë djegie dhe për cilët barbarë flet Barleti. Nga ana tjetër autorët antikë që flasin për pushtimin e Shkodrës nga romakët nën Anicin, nuk thonë gjë për shkatërrimin e Shkodrës prej tij. Në kohët e vona, në shek. e 14 e të 15 Shkodra është djegur disa herë, siç na tregojnë dokumente bashkëkohëse, siç qe p.sh. zjarri i madh në vitin 1448.
- 59) *Nemanja* — Dinasti sunduese në Serbi. Ndonëse nuk na jep emrin e parë, ka të ngjarë që Barleti e ka fjalën këtu për mbretin serb Uros II (1282-1321) nga shtëpia Nemanja, megjithëse ky nuk zotëronte akoma gjithë Maqedoninë dhe Rumelinë. I biri i tij është Urosi III (1351-1331), për të cilin flet Barleti këtu.
- 60) *Stefani, perandori serb* — Stefan Dushani (1331-1355), nën sundimin e të cilët Serbia mesjetare arriti kulmin e fuqisë. I biri, dhe i fundit nga dinastia e Nemanjave, qe perandori Uros (1355-71), me të cilin fillon tatëpjeta e Perandorisë Serbe.
- 61) Mbi gërmadhat e Perandorisë Serbe u krijuan një varg zotërimi mesh feudale të vogla në çerekun e fundit të shek. XIV. Në Serbi Lazar Grabeljanoviçi, në Zetë (Mali i Zi dhe Bosnjë) Nikolla Al-

- tomanovigi, në Maqedoni mbreti Vukashin me të vëllezërit, në Shqipérinë e Veriut Balsha me të bijtë.
- 62) *Gjergj I Balsha* sundoi 1360-1378
Strazimir Balsha » 1360-1372
Balsha II » 1363-1385
- 63) Formën Sopë Barleti, siç duket, e përdor për emrin e feudalëve të Shqipërisë së Mesme Topia, emër që në jetëshkrimin e Skënderbeut, botuar disa vjet më vonë, ai e shkruan me *th* e jo me *s*.
- 64) *Stefan Tvrtko*, mbret i Bosnjës (vdiq më 1391), me të luftoi Balsha II për zotërimet në bregdetin Adriatik në vitin 1385; lumi Narenta bie në Dalmacinë e Mesme.
- 65) *Faria, Faros*, koloni antike greke në ishullin me të njëjtin emër, sot Hvar.
- 66) *Alba* – është përkthimi latin i emrit sllavisht Belgrad të Beratit të sotëm. U quajt Alba greke për ta dalluar nga Belgradi tjetër, buzë Danubit, sepse gjendej në territor të kishës lindore. Në tekst emri do të përkthehet tani e tutje Berat.
- 67) *Hieurenez* – Evrenozi
Burime të tjera na jasin emrin e Hajredin pashës si udhëheqës të ushtrisë turke, me të cilën iu desh Balshës II të luftonte më 1385 në fushën e Savrës.
- 68) *Gjergj II Balsha* (1395-1403). Nga dokumentet bashkëkohëse rezulton se Shkodra gjendej nën sundimin turk në vitin 1394 e 1395 dhe se u kthye përsëri nën zotërimin e Gjergjit II jo me hirin e sulltanit, por iu shkëput me armë.
- 69) Shkodra iu dorëzua Venedikut nga Gjergji II Balsha në bazë të një marrëveshjeje, si pasojë e rritjes së presionit turk.
- 70) Nuk është e mundur të përcaktohet përfarë sulm «barbarësh» është këtu fjala dhe për kohën që ka ndodhur ky sulm, të cilin Barleti e përmend si një ngjarje relativisht të re.
- 71) Rrethimi i Parë i Shkodrës nga turqit u bë në vitin 1474.
- 72) Dega e vogël e Drinit është Drinasa. Siç shihet nga pëershkrimi i Barletit, gjendja e ujërave rreth Shkodrës në shek. XV është si e sotmjë dhe siç ishte në kohën e luftërave të romakëve me Gentin; sipas pëershkrimit të Tit Livit Drini, përvëç rrymës kryesore që derdhej në det pranë Lezhës, kishte edhe një degë tjetër që derdhej në Bunë. Por në një kohë që nuk e caktojmë dot, gjendja ndryshoi. Dega e dytë e Drinit u zhduk dhe vetëm në vitin 1856, me një shpërthim të vrullshëm të ujërave, u hap përsëri rruga për bashkimin e Drinit me Bunën.
- 73) Mendimi i Barletit se lijeni i Shkodrës në kohë të lashtë nuk ka ekzistuar, nuk është me vend. Por fakt është, siç kanë tre-guar studimet përkatëse, se gjatë shekujuvë është ngritur nivele i ujërave dhe lijeni është rritur.
- 74) *meshtarë grekë* – Sipas zakonit të kohës, grekë këtu ka kuptimin ortodoksë. Është fjala përmurj ortodoksë që qëndronin p.sh. në manastirin e ishullit të Vraninës.
- 75) *Daunie* – emri antik i krahinës së Puljes në Italinë Juglindore.
- 76) *Maj 1474*
- 77) *rektor* – titull i qeveritarit venecian në Shkodër e krahina të tjera të Republikës
- 77a) Është fjala përmurj Muratin II, për të cilin Barleti thotë se vdiq nga marazi që nuk mori Krujën në Rrethimin e Parë.
- 77b) *Antonio da Lece*

- 78) *akinxhinj* – kalorës të lehtë, që sulmonin befas e plaçkitnin krahinat kufitare.
- 79) *Shën Marku* ishte pajtori i Venedikut.
Shën Stefani (quhej protomartir, sepse ishte i pari që dha jetën pér fenë e krishterë) është pajtori i Shkodrës.
- 80) *Mali i shën Markut*, siç del nga pozita e tij, duhet të jetë Taraboshi i sotëm.
- 81) *Shih shën.* nr. 38.
- 82) *Jenicerë* do të thotë trupë e re.
- 83) Ishulli i Eubesë në Greqinë e Mesme u pushtua nga turqit më 1470.
krahina taurike – Gadishulli i Krimesë, që u pushtua nga turqit më 1475.
- 84) Cezari luftoi me Pompeun në vitin 49 në jug të Durrësit.
- 85) *pahisore* – stome, grumbuj dheu të forcuar me hunj
- 86) Kruja përmendet në dokumentet që nga shekulli i 9. Fakti që Barleti këtu, si dhe në Historinë e Skënderbeut, Karl Topinë e quan themelues të Krujës, mund të shpjegohet ndofta duke pranuar që Karl Topia të ketë ndërtuar muret e kala-së.
- 87) *Karl Topia* nuk u vra nga Balsha II, me të cilin qe në luftë, por vdiq 3 vjet pas këtij, më 1388.
- 88) *libra* – peshë, barazi me 327 g.
- 89) Në të vërtetë kishin kaluar më se dy javë (Kruja ishte dorëzuar më 16 qershor 1478).
- 90) *Princat rashianë* – Ishin dy princa serbë, të bijtë e Gjergj Brankoviçit, të cilëve, me urdhër të Mehmetit II, iu nxorën sytë. *Rashka* – emër i një krahine serbe
- 91) Emrat e shumtë që rreshtohen këtu pér të arritur një efekt retorik, pér të shprehur përbuzjen e Shqipërisë kundrejt turmave të panumërtë turke, janë emra banorësh të krahinave e qyteteve të ndryshme të Anadollit dhe Rumelisë, të familjeve feudale turke, të funksioneve të ndryshme ushtarake dhe oborrata turke.
- 92) Emrat që vijojnë janë emra figurash biblike dhe u referohen ngjarjeve të marra nga historia e Izraelit dhe të krishterimit.
- 93) Perandori romak Teodori I luftoi më 394 kundër rivalit të tij, Eugjenit, dhe udhëheqësit ushtarak barbar, Arbogasit, të cilët kishin ngritur krye kundër tij në Gallie dhe kërkonin të rivendosnin përsëri paganizmin.
- 94) *slopus*, latinisht do të thotë pëlcitje, krismë. Bombarda është emri pér topat e parë.
- 95) *balestra, «katapulte»* – Makina lufte mesjetare që me anë të kordhavë hidhni shigjeta, trarë, gurë në një largësi mjaft të madhe.
- 96) *shindra*, drunj që përbëjnë pullazin (në vend të tjegullave).
- 97) *Johan Kapistrani* – Murg, i cili luajti një rol mobilizues në mbrojtjen e Belgradit kundër turqve që e rrethonin më 1456.
- 98) *Orku, Pluti*, hyjni greko-romake të botës së të vdekurve.
- 99) Emrat që vijojnë janë marrë nga bibla dhe tregojnë pér ngjarje, në të cilat ndërhyrja e perëndisë shpëtoi izraelitët në mënyrë të mrekullueshme nga armiqtë e tyre.
- 100) *Fabët* – familje e madhe patricësh romakë.
- 101) *Trapezundi* – Perandoria e Trapezundit, shtet i vogël grek në Azinë e Vogël, ishte pushtuar nga turqit më 1461.
- 102) Emrat që vijojnë janë emra qytetesh e krahinash të Azisë së

- Vogël dhe të Evropës që pjesërisht as nuk ekzistonin më, por që janë të njohura nga autorët antikë. Emrat e tyre rreshtohen këtu me qëllim, për të treguar pushtimet e shumta turke dhe për të vënë në dukje nga ana tjetër paaftësinë e tyre për të push-tuar Shkodrën.
- 103) *Eacidët* — Shtëpi mbretërore e Epirit, prej së cilës rriddhë dëmbreti Pirro.
 - 104) *Zhabjaku* bie në V.L. të Shkodrës, në breg të ligenit.
 - 105) *Balsha III* rrezikoi disa herë Shkodrën, më 1405 ai mundi edhe ta merrte për pak kohë, ndonëse pa kalanë. Zotërimet që i atribuohen këtu Balshës, ai nuk i ka pasur kurrë.
 - 106) *Princ Stefani* — Princi serb Stefan Lazareviç, i ungji i Balshës III, më 1421. Në ushtrinë e tij ndodheshin edhe trupa të Gjon Kastriotit.
 - 107) *Gjergj Vuku* — Gjergj Brankoviç, si komandant i trupave të Stefan Lazareviçit e vazhdoi rrëthimin edhe më 1423.
 - 108) *princi Johan* — Quhej në të vërtetë Stefan Balsha ose Maramonte; e sulmoi Shkodrën më 1429.
 - 109) *duka Stefan* — Stefan Vukçiq i Bosnjës, luftoi më 1439-1442 me venedikasit për zotërimet e bregdetit, midis tyre edhe për Shkodrën.
 - 110) *Altomani* — mëkëmbës i despotit serb Gjergj Brankoviç në Tivar.
 - 111) *Svaç* — Qytet mesjetar, tanë i shkatërruar, në bregun verior të Bunës.
 - 112) Konflikti i Skënderbeut me Venedikun për Danjën u përket viteve 1447-1448.
 - 113) Lekë Dukagjini në vitin 1456 ishte në konflikt me venedikasit për disa zotërimë në rrëthin e Shkodrës.
 - 114) *Aleksandrinas* — Merula ishte nga qyteti Aleksandria e Piemontit (Itali e Veriut).
 - 115) Është fjala për sulltan Mehmetin II.
 - 116) Merula e ka fjalën për kushtet e vështira që u krijuan në Itali gjatë dyndjeve të popullsive gjermanike në mesjetën e herët.
 - 117) Është fjala për fitoren e korruar më 1473 nga ushtritë e Mehmetit II kundër Üzun Hasanit, sundimtarit të Turkmenisë.
 - 118) *Liburnia* — krahinë e banuar në kohën antike nga liburnët ilirë, sot Dalmacia Veriore.
 - 119) Është fjala për Durrësin, shih shënimin 51.
 - 120) *Mizia* — Këtu Merula flet për Maqedoninë.
 - 121) Shih shënimin 37.
 - 122) *Tanaro*, lumi që rrjedh pranë Aleksandrisë.
 - 123) *Lario* — emri antik i ligenit të Komos; Benako — emri antik i ligenit të Garfës, Galia — këtu është fjala për Galinë këndeje alpeve, d.m.th. për Italinë e Veriut.
 - 124) *komanda e detit* — funksioni i kryekomandantit të flotës së luftës së Venedikut.
 - 125) emër i një lloj arme artilerie
 - 126) *birema e trireme* — anije të mëdha, ku remtarët janë vendosur në dy a tri radhë njëra mbi tjetrën
 - 127) *monoksila* — barka të vogla, të gdhendura në një trung
 - 128) Shih shënimin 74.
 - 129) *Saguntinët e kasilinatët* — Shih shënimin 7.
 - 130) *Cilicia* — krahinë në jug të Azisë, së Vogël
 - 131) *Rampani* — kështjellë në More (?)

- 132) *Panegjirik* – fjalim mburrës, një gjini letrare e lëvruar në letërsinë antike dhe, pas shembullit të saj, dhe nga humanistët e shekullit XV-XVI.
- 133) *Breshja* – Qytet i Italisë së Veriut që bënte pjesë në zotërimet venedikase. Këtu M. Beçikemi ka jetuar disa kohë si drejtues i një shkolle.
- 134) Me këtë hyrje M. Beçikemi i bën nderimet e duhura së pari kryetarit të shtetit venedikas. Pastaj ai në një frymë pane-gjirike që shpjegohet pikërisht nga kushtet në të cilat rronin të mërguarit shqiptarë në tokat e Venedikut, vë në dukje meritat që ka Republika në luftërat kundër Turqisë dhe prek, lidhur me këtë, edhe ngjarjet e Shqipërisë e të Shkodrës, të cilat Beçikemi, si shqiptar e shkodran, i kishte veçanërisht përmëzi. Pikërisht këto pjesë janë zgjedhur e përkthyer në botimin tonë.
- 135) Të dhënat që jep këtu Beçikemi, nuk dihet se me çfarë prejardhje, përbëjnë një burim me interes të pavarur për historinë aq të errët të rinisë së Skënderbeut, aq më tepër që botimi i Beçikemit është të paktën pesë vjet më i hershmë nga «Historia e Skënderbeut» e Barletit dhe kujtimet e Gjon Muzakës. Këtu na vërtetohen edhe një herë emrat e djemve të Kastriotit, dhënia peng e tre më të vegjelëve, kurse më i madhi, Stanisha, paska qenë dorëzuar më përpara. Me rëndësi është edhe fakti se ky i paska qenë dorëzuar Isak beut, komandant të Shkupit, të njojur edhe nga burime të tjera. Për sa i përket Krujës, Beçikemi nuk gjen gjë mështetje nga burime të tjera që ajo t'i përkiste Gjon Kastriotit.
- 136) Kjo ndodhi në betejën e Nikopolit më 1396.
- 137) *Propontida* – emri antik i detit Marmara.
- 138) Despot Gjergj Brankoviçi mundi të rifitonte zotërimet e veta në Serbi me rastin e ekspeditës hungareze në Ballkan më 1443.
- 139) Shih shën nr. 101.
- 140) M. Beçikemi i jep Venedikut merita që nuk i ka. Në fakt, përmbrojtjen e Bosnjës, qenë hungarezët nën mbretin Matia Korvin ata që luftuan në vitet 1461-1463.
- 141) Është fjalë për luftën që filluan venedikasit kundër turqve më 1463 për zotërimin e Moresë.
- 142) Në gusht 1464 papa Piu II u vu në krye të një kryqëzate që do të nisej nga Ankona për të zbarkuar në Dalmaci ose Shqipëri. Me vdekjen e papës kryqëzata u shpërndë menjëherë.
- 143) *Uzun Hasani* – sundimtar i Turkmenisë, aleat i Venedikut në luftën kundër turqve në vitet 60-70 të shekullit XV.
- 143a) *Sultani Bajaziti I* (1481-1512)
- 144) Beçikemi e ka fjalën për luftën veneto-turke që u zhvillua në vitet 1499-1503.
- 145) *Skythia* – Shih shënimin 11.
- 146) Popullsi antike të nënshtuara nga Roma, të cilat, sipas mendimit të Beçikemit, kishin lidhje të veçanta mbrojtjeje me familje të shquara të Romës antike. Midis tyre Beçikemi vë edhe durrsakët që paskan pasur si mbrojtës Ciceronin; pa dyshim ky mendim shpjegohet nga fakti se oratori romak për disa kohë pati rrojtur në mërgim në Durrës.
- 147) Kompliment lajkatar përpëra dogjës venedikas Leonard Loredano!
- 148) *Antoni*, i quajtur Shkodrani, është Antonio Loredano, koman-

- dant i Shkodrës gjatë Rrethimit të Parë nga turqit në vitin 1474; prej kësaj fitoreje Beçikemi i jep epitetin e lartpërmendur.
- 149) *Naupakti* – emri antik i qytetit Lepanto në Greqinë e Mesme. Lemos – Ishull në detin Egje. Është fjala për luftime që u zkipilluan në vendet e lartpërmendura në luftën veneto-turke të viteve 1463-1479.
- 150) Edhe pas një çerekshekulli, dhimbja për atdheun e humbur në zemrën e shqiptarëve në mërgim është fare e gjallë.
- 151) Mënyra se si iu dorëzua në të vërtetë Shkodra Venedikut, nuk përpushtet me tregimin e Beçikemit. Shkodra bashkë me një varg qytetesh të tjera rrëth saj iu dorëzuan Venedikut nga Gjergj Balsha II në bazë të një marrëveshjeje që i siguronte atij një pension vjetor. Nuk ka dyshim se shtyta kryesore për këtë hap që paniku i shkaktuar nga sulmet osmane. Edhe Beçikemi, si Barleti, tashmë nënshtetas i Venedikut, hesht për konfliktet e shpesh ta midis qytetarëve shqiptarë dhe sunduesve të tyre venedikas.
- 152) *Balsha III*, për të cilin bëhet fjalë këtu, nuk ka mbajtur titullin «mbret», as nuk ka pasur ndonjëherë zotërimin e Serbisë, të Bosnjës, Trakës dhe Greqisë. Shih dhe shënimin 105.
- 153) *Balsha III*, që kishte ardhur në fuqi më 1403, vdiq më 1421.
- 154) *Stefani*, despoti i Serbisë, kërkoi të shtinte në dorë Shkodrën si pjesë të trashëgimit të të nipit, Balshës III.
- 155) Shih shënimin 107.
- 156) Shih shënimin 108.
- 157) *Daumia* – emri antik i Apulisë.
- 158) Venediku në të vërtetë nuk i lëshoi kurrë Stefan Balshës as Tivarin, as Drishtin.
- 159) Stefan Vukçiq i Bosnjës quhet gabimisht vjehërr i Stefan Balshës ose Maramontes. Shih shënimin 109.
- 160) Shih shënimin 110.
- 161) Nuk është e qartë për cilën betejë bëhet fjalë këtu.
- 162) Le të vihet ré se Beçikemi këtu nuk bën fjalë më vetëm për betejë e ngjarje që prekin Shkodrën, por për ngjarje që u përkintin në përgjithësi shqiptarëve të udhëhequr nga Skënderbeu. Është një ekzagjerim thënia se veprimet e Skënderbeut arritën deri në lumin e Strumës në Bullgari.
- 163) Nuk është e qartë për cilin konflikt të Lekë Dukagjinit dhe me cilin vëlla e ka fjalën Beçikemi këtu.
- 164) Rrethimi i Parë i Shkodrës, më 1474.
- 165) *Fabius* – komandant romak, ngadhënjes mbi Hanibalin në një varg betejash.
- 166) Është fjala për një fitore që korrën shqiptarët më 2 shtator 1477 përpëra Krujës, por që nuk e shfrytëzuani.
- 167) *Beçikemi*, Barleti, si dhe autorë të tjerë, mendojnë se Murati II, i cili vdiq më 1451, vdiq nga zemërimi që nuk mundi të merrte Krujën në Rrethimin e Parë më 1450. Prandaj Mehmeti II, i biri, kishte për të marrë hakun nga shqiptarët për këtë vdekje.
- 168) Shih shënimin 88.